


DHIMITËR S. SHUTERIQI

E

BIBLIOTEKA

8SH.
5497
SHTETI
GJIROKASTER



NAIM FRASHERI

Redaktore: ELENA KADARE



O. Paskali, Busti i Naimit (*Tiranë*)



H y p j e

Të vihesht e të shkruash një libër për Naimin, është një kënaqësi e madhe, por edhe një ndërmarrje që mund të të trembë.

Për Naim Frashërin është shkruar shumë dhe, paravarësish nga ndonjë ndërkryerje e kritikës, ai e bashkoi gjithmonë rrëth vetes opinionin admirues e mirënjo-hës. Prapë, ai ka mbetur një nga autorët, që po i quaj «fatkeqë» të letërsisë shqiptare. Zor se është zbuluar ndonjë gjë e panjohur e tij ose mbi të, që të térheqë sa duhet vëmendjen, këto 80 vjet pas vdekjes së shkrimitarit. Ndryshe ka ngjarë, bie fjala, për Kristoforidhin, De Radën, Seremben, Çajupin e Mqedën, për të mos përmendur dhe të tjerë.

U zhdukën si kripa në ujë dorëshkrimet e rilindësit të madh? Nuk mbeti asgjë nga dora e tij prej atyre dhjetëra mijëra vargjeve që shkroi? Dhe nuk mbeti asgjë e parabotuar? Ç'u bë gjithë ai letërkëmbim që duhet të ketë pasur? Prej tij dhe prej të vëllezërve nuk kemi veçse

10-12 letra, që ata këmbyen midis tyre e me ndonjë tjetër, si fjala vjen ato që Samiu dhe Naimi i dërguan Visar Dodanit në Bukuresht. Po ky fat ndoqi tërë letërkëmbimin e Vëllezërve Frashëri, të cilët nuk ishin një e dy dhe të gjithë njerëz të kulturës e të veprimit politik e shoqëror, të lidhur fort në mes tyre nga idetë e idealet. Ndarjet e shpeshta dhe tallazet e jetës i kanë detyruar të shqetësohen për njëri-tjetrin e të lidhen vazhdimisht me letra, sikundër e vëmë re në një rast, në vitet 1875-77.

Burimet arkivale gati s'po na japin gjë për Naimin. Kërkimet e bëra në Rumani, për dorëshkrimet që ai pati dërguar të botonte atje dhe që shpresohet të ruheshin nëpër familjet e patriotëve shqiptarë, nuk dhanë gjë. Nuk u gjetën as edhe dorëshkrimet e letrave që na thotë Dodani se i ruante. Në Stamboll, a thua se arkivat nuk do të zbulojnë gjë të poetit dhe mbi të? Po arkivat arbëreshe? Po arkiva të tjera, që ruajnë letërkëmbimin e shqiptarëve e veçanërisht të miqve të Vëllezërve Frashëri nëpër botë? Naimi jetoi gati njëzet vjet në-punës në Stamboll, miqtë i pati të shumtë dhe që e çmuani; ata qenë gjithfarësh, shqiptarë e të vendit, një numër i madh intelektualë, të cilët edhe e kanë për zakon të mos i zhdukin shkrimet. Në Stamboll, për Naimin gati s'ka punuar njëri. Pra, kemi një burim prej të cilët presim shumë. Ndërkohë, kemi mësuar se ai hartozi turqisht një gramatikë të persishtes, që, ishte i pari botim i tij (1871) dhe që pat edhe një ribotim (1887); përktheu turqisht edhe këngën I të «Iliadës» (1886), siç bëri dhe shqip dhe e botoi pas një dhjetëvjeçari (1896). Por ato libra nuk i njohim dhe nuk besohet t'i shtojnë gjë me rëndësi zbulimit të mendimit të autorit.

Eshtë e domosdoshme që në arkivat e bibliotekat turke të bëhet një punë kërkimore jo vetëm për Naimin, por edhe për vëllezërët e tij. Për Samiun di-*gka* eshtë bërë, por ende pak; për Abdylin, më pak; për Tahsinin e Mehmetin gati asgjë. Për Sherifin fare. Po s'ka dyshim se, duke kërkuar për ta, do të gjej-

më edhe për Naimin ose mbi të. Çdo gjë që të gjendet për ta, për Naimin s'ka për të qenë vërtet e huaj. Kur është fjala për poetin, Abdylin e Samiun, ata formojnë një treshe të pandarë dhe jo vetëm plotësojnë mirë shoqi-shoqin, por edhe e shpjegojnë, pa harruar edhe vëllezërit e tjerë.

Thamë se për Naimin është shkruar shumë. Po, pikërisht ata që mund të na informonin gjatë e gjerë për të, ata gati sa nuk heshtën. Mitat Frashëri, — Lumo Skëndoja, na ruajti vetëm faqen e parë të «Historisë së Skënderbeut» në dorëshkrim, edhe këtë në faksimile! Ai la një biografi (1901), po prej jo më shumë se 20-25 faqesh të vogla me dorë mbi të ungjin, dhe disa faqe pak më vonë, te «Kalendar kombiar», në krye të një çerek-shekulli (1926). Nxori disa vjet një revistë të trashë për ko-hën, po mbi Naimin nuk tha asgjë të re gati. Këtij xhonturku dhe kryeballisti i njohim më shumë kujdesin përt'u shfrytëzuar famën babait dhe të ungjërve, «derës» së tij. Çajupi, që i adhuronte ata, nuk pyeti asgjë kur u sulmoi djalin. Këtë, që për Vëllezërit Frashëri Lumo Skëndoja shkroi pak e aspak, këtë, nuk mundet ta përmendë pa zëmëratë kujtesa jonë dhe kujtimi i tyre.

Priste opinioni publik se vallë diç do të dilte e re nga penda e tij, në 25-vjetorin e vdekjes së poetit, në përbledhjen që botuan studentët shqiptarë të Grcit të Austrisë, të cilët iu drejtuan atëherë shumë njërzve që mund të ruanin kujtime të çmuara. Botimi i tyre mbetet i pari që duhet përmendur mbi Naimin, pas librushkës së të nipit. Ky nuk u përfaqësua më shumë se me dy faqe. Janë aty pak faqe të përgjëruara të një Sevasti Qiriazi dhe Asdreni; është edhe një shkrim i Nobert Joklit, albanologut të shquar, mbi gjuhën e Naimit.

U mëshua atëherë dhe në raste të tjera në anën mistiko-fetare të veprës së Naimit, u fol shpesh në vitet 20-30 mbi bektashizmin e tij, nuk u zbulua demokratizmi i veprës dhe nuk u pa saktë humanizmi i saj. Vlerat artistike u kaluan për zgrip dhe ato gjuhësore nuk u njohën në mënyrë të mjafueshme. Mbi përbaj-

tjen dhe rolin patriotik të veprës së Naimit u fol zakonisht, kurse mbi mendimet shoqërore të tij, shumë pak.

Ka dhe një kritikë përsëndyese. Shqip. ajo kishte filluar kundër Naimit, — kritika e Faik be Konicës, — por jo ende me cinizmin që ky do të tregonte më pas.

Duhet të vijë viti 1930, që të shkruhet një kapitull për Naimin, nga historiani i letërsisë dhe kulturës, arbëreshi Gaetano Petrota. Në librin e tij, ai bëri si për shumë të tjerë: grumbulloj informimin bazë, bashkë me disa gjykime të të tjerëve mbi poetin. Më 1896, kur arbëreshi tjetër, Albert Stratiko, kishte nxjerrë «Manuallin» e tij mbi letërsinë shqipe, për Naimin ai nuk kishte shkruar asgjë. S'duhej ta njihte, si nuk njihte, në përgjithësi, letërsinë e Shqipërisë dhe sidomos atë bashkë-kohëse. Të vjen keq, sepse Stratikoi qe njeri i mendimit përparimtar. Më 1930 jemi në kohën e fashizmit dhe, kur është fjala për kulturën amtare. Petrota ka parapëlqimet e tij. Ai thotë fjalën e mirë për Naimin, e çmon vërtet, po syrin e ka te Fishta, sikundër, kur duhet të «zgjasë» De Radën e Sqironë, kandari do t'i peshojë nga ky i fundit. De Rada kishte vdekur duke paditur imperializmin italian, — Sqiroi u bë njeriu i atij imperializmi dhe do të duartrokiste edhe ardhjen në fuqi të fashizmit. Padre Fishta ishte bërë një nga ata që po i çelnin rrugën pushtimit fashist të Shqipërisë dhe që do të përfundonte akademik i Musolini.

Në ato vite 30, kur rinia, nëpër shkollat amtare, e mësonte veprën e poetit nga mësues të zellshëm patriotë. Naimit i kushtoheshin, edhe më shumë se më parë, artikuj të vegjël në shtyp dhe një vend në antologjitetë shkolllore. Antologjité i jepnin vendin e merituar, duke dhënë edhe informimin e domosdoshëm, po varreshin nga serioziteti i punës së përpiluesit dhe nga tendencioziteti i tij; ato linin shpesh për të dëshiruar. Artikujt zor re sillnin gjë të re, ndonëse përgjërimi shtohej. Po ja Faik beu në Uashington rimori pendën më 1937, që me rastin e 25-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, të nënqmonte veprën e kryepoëtit të Rilindjes Kom-

bëtarë. Patriotin nuk guxoi ta prekte. Përgjigjja që i dha Nonda Bulka, qe një paraspatë, — dackë. Nuk dimë se si i përdrođhi buzët beu përfjej Atlantikut. «Paska një-rëz që shkruajnë bukur në Shqipëri», mund të ketë thënë esteti, që cilësitë e stilit i njihëte. Ai nuk guxoi këtë radhë të përgjigjej, siç kishte bërë më 1906 me disa djem të Korçës, që e kishin vënë përparrë se hidhët poshtë veprën e Naimit dhe i merrte nëpër gojë jetën.

Po Konica më 37 shkuante një libër mbi Shqipërinë, — «Shqipëria kopshti-shkëmb i Evropës Juglindore». Titulli, sado përgjysmë i vërtetë, në gojën e ambasadorit, të Zogut tingëllonte i terti huq. Shqipëria ishte një «kopsht» i shkretuar dhe një «shkëmb» që Konicat me shokë kishin bërë e po bënин shumë që të mos mbrohej dot, ashtu siç bënë vërtet pas dy vjetësh, jo më shumë. Libri nuk e pa dritën e botimit me gjallje të të zot. Ai ishte një skandal më tepër nga ata që bënte beu. Kur ia botuan pasuesit më 1957, ata nuk kishin se si të fshihnin se aty mungonin dy emra të mëdhenj të shkrimt të shqipes, pikërisht emrat e Naimit e të Samiut. Duhej korrigjuar dhe e korrigjuan. Shtuan edhe ndonjë person, si këmishëziun Ernest Koliqi, të cilin Konica nuk duket ta ketë lexuar. Do thënë se, në vitet 30, Konica gazetën «Washington post» e lexonte, po shtypin dhe librat që dilnin në Shqipëri, pak i zinte me dorë. Pra, i kishte shpëtuar «tregtar i flamujve», që s'kishte pse t'i shpëtonte ndryshe. Samiu dhe Naimi s'i kishin shpëtuar: u kishte vënë vizë.

Le të përmendim për ato vite 30 një artikull të bukur të Kostaq Cipos mbi «Lulet e verës» dhe antologjinë e komentuar të Eqrem Çabejt.

Dhe erdhë 39-a, me agresionin e atij 7 prilli. Për Naimin, domosdo që do të shkruhej, si më parë, një artikull më pak a një më shumë. Do të bëhej edhe diçka tjetër: Zogu i pati sjellë eshtrat që nga Erenqoj, për të lezetuar veten në 25-vjetorin e pavarësisë, Jakomoni, «mëkëmbësi» i Viktor-Emanuelit, i vuri mbi varr sëpatat e liktorit, po liktorin e bëri edhe më të urrejtshëm. Naimi kishte

pasur motit një mik jo për të qenë në Stamboll, avokat Gjergj Çakon. Më 1919, në shtypin italian, ky botonte një artikull. Për të treguar se si Naimi e çmonte shumë Virgilin, ai «arsyeto» se poeti «e donte posaqërisht» Italinë! Atëherë, imperializmi italian, që ëndërronte te Roma e lashtë, përgjakte Shqipërinë pas Abisinisë. Tani që na shkeli për së dyti, pushtuesi rikujtoi Naimin, duke shvarrosur artikullin e avokatit. E përfytyrojmë lëndimin që ka ndier në zemër Andon Zako Çajupi, kur lexoi në kohën e vet shkrimin e të kushërit, që dikur e kishte shpënë te Naimi.

Po viti 1939 paralajmëroi furtunën popullore. Mallet e Dangëllisë u bënë shpejt fole partizanësh. Përmët qe selia e një kongresi të madh, që do t'u këndonte «rekuejemin» armiqve fashistë e nazistë dhe Zogut «sallanë». Djemtë e vajzat e rritur me vjershat e Naimit, do t'i pagëzonin me emrin e tij aradhët e tyre. Italia u flak edhe një herë në det, po keq e më keq kësaj here, duke lënë në Shqipëri armata të vdekurish. Naimi priste lirinë, me librat që i kishin kënduar aq me zjarr lirisë. E priste me emrin në ballë të një batalioni partizan.

Po, pak gjë për të kujtuar mban kritika dhe historio-grafia letrare mbi Naimin pérpara Çlirimit. U desh Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe socializmi, që të merrej shkenca vërtet seriozisht me të dhe me veprën e shkrimtarit. Kjo kthesë i përket kthesës së madhe të shkencës e të kulturës shqiptare me epokën e re që u çel. Ishte bërë punë në të kaluarën për të ribotuar herë pas here veprat e Naimit. Veprat e tij populli i kërkonte përherë e më shpesh. Nuk ishte vetëm bukuria e vjershës dhe e gjuhës, ishte veganërisht aktualiteti që ato ruanin gjithmonë, në një atdhe gjithmonë të rrezikuar, të prapambetur shumë e të tradhtuar prej feudo-borgjezisë, atdhe të cilin poeti e ëndërrroi të lirë e të lulëzuar.

Tani populli kishte jetuar epopenë më të madhe të historisë së vet mijërvjecare. Ishte «përtëritur», po të flasim me gjuhën e Naimit, historia. Armikut «i kishim pirë

gjakun», si Kastrioti Muratit dikur. Vetëm «Historia e Skënderbut» e Naimit njohu dy botime shkencore gjer më sot, dhe të parin të përgatitur nga prof. Cipoja. Nuk është vendi këtu për të dhënë një ide mbi botimet për Naimin pas Luftës. Mjafton të shënohet se Akademia e Shkencave ka gati për shtyp vëllimin e dytë të veprave të zgjedhura të tij, gjë që është një përpjekje për të dhënë shkenca shqiptare një botim kritik, në vitet e afërtë, të veprave të plota të shkrimtarit.

Shkencës sonë i është dashur, pas Luftës, të merret me paraqitjen e gjerë të procesit historik të zhvillimit të letërsisë shqiptare, si për opinanin e përgjithshëm, askiftu edhe për arsimin e shkallëve të ndryshme. Studimet monografike, gjer tanë, i kanë parë autorët e vrorat për aq sa kërkonte ajo detyrë e parë e rëndësishme. Nuk ishte një punë e vogël e ca më pak një cështje e sigurimit të gjithë informimit të mundshëm. I duhej hvrë në themel studimit të autorëve krvesorë, por edhe të të tjera e përparimtarë, për të dhënë një gjykim marksist-leninist mbi një letërsi pesë herë shekulllore. Kurorëzimi i kësaj pune u arrit më 1959-60 me «Historinë e letërsisë shqipe» për shkollat e larta, botuar nga institucionet tona shkencore. Një punë e re është bërë këto vjet për ta shpënë më tej atë përpjekje, në bazë të arritjeve të reja të shkencës shqiptare.

Tanimë ka ardhur koha për studime të gjera monografike, studime të veçanta dhe të imëta, dhe disa janë bërë. Midis autorëve, ndër të parët, i vjen radha Naim Frashërit. Prapë nuk duhet hartuar këtu, se gjithë njerëzit më të autoritetshëm të shkencës e të mendimit tonë të ri janë marrë, kush më pak e kush më shumë, edhe me veprën e Naimit. Nonda Bulkës i lindi në zemër të qëmtonte frazeologjinë e pasur të autorit.

Ndihmesa që kanë dhënë studiuesit nga Kosova është edhe ajo e çmueshme, sidomos puna e prof. Rexhep Qoses, i cili bëri edhe një botim të parë të veprave të autorit, ndonëse jo një botim kritik, por i çmueshëm shumë për atje, ku veprat e Naimit e përgjithësisht letërsia shqipe e

së kaluarës, — pa harruar edhe të tashmen, — nuk patën atë mundësi që të përhapen e të njihen si tek ne. Se si ka për të vazhduar kjo punë me reaksionin e ri revisionist serbomadh, vetëkuptohet. Pengesat që i nxirren në Jugosllavi zhvillimit të kulturës kombëtare të shqiptarëve janë duke u shtuar përditë. Po Naimi ka për të qenë përherë një fjalëflamur në betejat që bëjnë shqiptarët për të drejtat e tyre kombëtare në tërë fushat.

Kam pasur fatin të mbaj një ligjëratë mbi Naim Frashërin në Universitetin e Kalabrisë, në Kozencë, dhe të shoh interesin e arbëreshëve për të njohur kulturën e tyre amtare në gjithë zhvillimin e saj, veçanërisht në Shqipërinë mëmë. Fjala e Naimit, — si dhe ajo e De Radës së tyre dhe tonit, — i emociononte me tingullin aktual të saj si zëri i kombit, për zhvillimin e kulturës shqiptare dhe përparimin shoqëror. Gjuha e përbashkët letra-re që u krijua dhe që tanimë përdoret gati kudo që shkruhet shqip, i detyron aq shumë Naimit, shkrimin e të cilit ajo ka ni bazë. Edhe vetëm me këtë, Naimi mbetet ngaherë një element bashkimi i forcave të kombit për shpënien përpara të kulturës së tyre.

Naimi ëndërroi «ditë të mira për Shqipërinë paskëtaj», ditë përparimi të përgjithshëm. Ato ai i shihte me syun e kohës dhe nuk i imagjinonte përtëj përparimit që kishte arritur shoqëria borgjeze me gjallje të tij. Por idealët e tij për të ardhmen ishin për një zhvillim të gjithanshëm e të pandalshëm të kombit e të njerëzimit vetë. Samiu, një mot përpara vdekjes së poetit, kishte botuar veprën manifest «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet» (1899), ku ai konkretizonte mendimet e veta, që ishin edhe të të vëllait, — ato ishin edhe një «dhjatë» e Abdylit, — për një të ardhme të përparuar të Shqipërisë. Aty ai fliste, ndër të tjera, për arsimin e përgjithshëm e për të gjithë, për shkollat e larta që duhen ngritur, për «gjithëmësimjen», universitetin, për një akademi të shkencave, dhe kështu e tutje. Këto i ngriti në Shqipëri socializmi dhe po i zhvillon me hov.

Naimi e Samiu, me kujtimin e tyre, duartrokasin arritjet e mëdha e të shpejtë të kulturës së re shqiptare, për të cilën ata vunë gurë themeli. Burri i shtetit Abdyl nuk do të kishte përfytyruar shtet më të fortë e më të pavarur. A do t'u shkonte ndërmend atyre se çmimi më i madh i kulturës që do të jepej nesër në Shqipëri, do të mbante emrin «Urdhri Naim Frashëri»? Ata ishin të vetëdijshtëm për rolin kryesor udhëheqës që po luanin përmes një lufte plot rreziqe, në të cilën iu desh të punojnë e të flijojnë shumë, duke vdekur të rinj, 54 e më pak vjeç secili. Shqipëria e re, që u shpreh gjithë ndërimin, veprimtarinë dhe veprën e tyre i bëri vërtet të njo-hura në tërë masat e popullit, duke i vështruar ata si pishtarë të patriotizmit e të përparimit, ashtu siç i vështron shoku Enver Hoxha, kur thotë:

«Naim Frashëri mbetet Naim, poeti ynë më i madh që adhurohet nga të gjithë, sepse ai i ka kënduar me patos të madh bukurisë së atdheut, u shkri si qiriri për lirinë, gjuhën shqipe; ëndërroi, punoi e luftoi për të ardhmen e popullit tonë, të cilën e bënë realitet Partia e Punës e Shqipërisë me pushtetin popullor.»¹⁾

Ne do të përpinqemi, në këto faqe, të japim një ide të përbledhur, po tërësore, mbi jetën dhe veprën e Naim Frashërit. Nuk do t'i ngarkojmë këto faqe me referime. Do të japim në fund një bibliografi të domosdoshme, kryesisht burimore. E shkruajmë këtë libër përmasën e gjerë të lexuesve, që asaj t'i bëhet i njobur Naimi përmes arritjeve më të mira të shkencës mbi letërsinë tonë kombëtare.

1 Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», Tiranë, 1977, f. 132.

111

111

K o h a

Naim Frashëri lindi në mes të shek. XIX dhe i mbylli sytë në prag të shekullit të ri.

Shek. XIX është periudha e lëvizjeve kombëtare në Evropë e gjetiu. Kjo lëvizje u zhvillua veçanërisht edhe në Ballkan, ku sundimi i sulltanëve po bënte katërqind vjet që vetëm rëndohej e kishte sjellë dëme të pashe-mbullta. Që nga çereku i parë i shek. XIX, — Revolucioni Grek është i vitit 1821, — lëvizja kombëtare, nisi të mobilizonte gjithë popujt e robëruar të gadishullit.

Lëvizja kombëtare shqiptare e arriti kulmin në atë shekull me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, më 1878-81, po fillimet e saj janë më të hershme. Është menduar se ato u përkasin viteve 40, duke dhënë si cak botimin më 1846 të «Qarkores» («Enqiklikës») së Naum Veqilharxhit. Një mendim tjetër, fillimet e lëvizjes sonë kombëtare i vendos në vitet 30, fill pas zhdukjes së principatave («pasallëqeve») të mëdha të Ali Tepelenës e të Bushatllinjve (1822-31).

Përpjekjet e këtyre kryefeuodalëve për t'u shkëputur

nga Turqia ishin një parathënie e rëndësishme për lëvizjen kombëtare shqiptare. Dinastia e Bushatlinjve sunroi për gati tre të katërtë shekulli në veri, ndërsa Ali Pasha për gati 35 vjet në jug. Nuk qenë, sikundër shihet, përpjekje të shkurtëra. Ato e çuan në një shkallë më të madhe zhvillimi ndërgjegjen e shqiptarësisë, duke provuar se shqiptarët i kishin forcat për të dalë më vete, duke i bërë ballë e duke e tronditur fort perandorinë osmane, që e kishte marrë udhën e rrökullimës që në fillim të shek XVIII e pakta. Ndërsa shteti i Ali Pashës ishte etnikisht i përzier, shteti i Bushatlinjve kishte vetëm një pakicë të huajsh. Si i pari edhe të dytët synuan të bashkonin nën vete gjithë tokat shqiptare.

Kjo nuk ishte një lëvizje feudale thjesht «separatiste», se nuk kërkonte shkëputjen e një ose më shumë pashallëqeve turke nga shteti i madh turk, po shkëputjen e dy principatave shqiptare. Të dy palët e kishin të zhvilluar ndërgjegjen e shqiptarës: Karamahmudi e mbante veten si «*pasardhës të Skënderbeut*», ndërsa Aliu fliste se kishte në lashtësi një paraardhës shumë të dëgjuar, Pirron (ai e quante shqip «*Burri*»). Ata ishin krenarë të këtyre origjinave dhe se ishin shqiptarë. Shtetin e tij, Ali Pasha e quante «*Shqipëri*» dhe, përpëra vitit 1807, bejtexhiu i njojur Hasan Zyko Kamperi i uron «*të bashkojë gjithë Shqipërinë*» dhe t'ua lërë si trashëgim të bijve. Të dy palët vetëm formalisht i bindeshin Portës së Lartë, që mezi i likuidoi. Masat e fshatit e të qytetit i mbështetën.

Lëvizja kombëtare shqiptare erdhi, pra, fill mbas dy përpjekjesh të rëndësishme dhe paralele, për t'i shkëputur tokat shqiptare nga sundimi osman, përpjekje të prira nga feudalët, të cilët nuk arritën të bënin një bashkim të fortë të vendit as në veri, as në jug. Borgjezia shqiptare, ndonëse e re, mund të nxirrte mësimin se lëvizja qërimtare që ajo e lakmonte dhe do ta rindizte, nuk mund të arrihej nën drejtimin feudal.


Lëvizja kombëtare e kishte bazën në fillimet e krijimit të një tregu të përbashkët shqiptar, në zhvillimin e tregtisë dhe të artizanatit, në krijimin e një klase të

re shoqërore në Shqipëri. Këto fillime ishin të dobëta. Marrëdhënet feudale në prodhim mbaheshin ende fort. Borgjezia, që do të bëhej bartëse e idealeve të reja të çlirimit, ishte ende e paktë dhe e pamëkëmbur, me një përvojë politike të vogël, që të mund të organizohej me kohë dhe të krijonte shpejt një lëvizje të gjerë kombëtare. Çështja ishte që ajo të dinte të mbështetetë në forcat e mëdha të një fshatarësie në gjakosje shekullore me pushtuesit e huaj, pra që kishte një gatishmëri të madhe për ta ndjekur e zhvilluar edhe më fuqimisht këtë luftë. Borgjezia jonë e re u vu në veprim vonë, sidomos aty nga mesi i viteve 40. Po që në vitet 30 në lëvizjet fshatare e qytetare, — p.sh. në Shkodër e në Berat (1835, 1836), — u ndie zëri i përbashkët i shqiptarëve për vetëqeverisje (vetadministrim).

«Qarkorja» e Veqilharxhit erdhi kështu në kohën e duhur, bashkë me librat e tij. Jemi në vigjiljen e kryengritjes së madhe fshatare të jugut (1847) kundër Tanzimatit, — «reformave», që e rëndonin sundimin osman mbi masat e fshatit me sistemin e taksave, shërbimin e detyrueshëm ushtarak, zullumin e administratës. Kryengritje të tjera i kishin paraprirë asaj të jugut në veri dhe në Kosovë. Pas Tanzimatit, siç shkruan Marks, në perandorinë osmane «*padituria, paturpësia, grabitet(...)* mbetën po ato që kishin qenë në lulëzim të arbitrariteteve të satrapëve aziatikë.»¹

Në këtë kohë, me sa dimë gjer më sot, nis organizimi i shqiptarëve për të drejtat e tyre kulturore. Me një provë të tillë organizimi është e lidhur veprimitaria botuese dhe politike e Veqilharxhit në vitet 1844-46: shqiptarët kishin krijuar një si shoqëri kulturore në Braila të Vllahisë, ku patrioti rronte. Në Shqipëri. — Korgë, Përmet, Berat, — njerëzit u treguan entuziastë për mësimin e gjuhës amtare me abetaren e tij dhe ishin të gatshëm ta ndihmonin financiarisht për një shtypshkronjë shqipe, provë që e bëri në Elbasan Dhaskal Todhri

1 K. Marks. F. Engels. Werke Berlin, vell. XI, f. 400.



në fillim të shekullit. Ndeshja me Patrikanën qe e menjëershme: Veqilharxhin e helmatisën në Stamboll një-rëzit e Patrikanës (1846), ashtu siç patën vrarë në Shqipëri Todhrin (1805).

Ngjarjet që do të pasojnë, gjer më 1878, kur Turqia humbi luftën me Rusinë, do ta bëjnë përherë e më të quartë se lëvizja kombëtare shqiptare është hedhur mirë në veprim. Në fund të viteve 50, Thimi Mitkoja përpinqet të përsërisë në Stamboll provën e Brailës. Në kryegjendrën e perandorisë, në pjesën e dytë të viteve 60, Kostandin Kristoforidhi, Hasan Tahsini, Pashko Vasa, Ismail Qemali me të tjerë, veprojnë për një shoqëri të tillë, që të botonte libra dhe të përkohshme shqip, pra, të zhvillonte propagandën kombëtare. Kësaj përpjekjeje, në vitet 1870-71, i shtohen Sami Frashëri dhe Jani Vretoja. Për herë të parë, një nga të tre vëllezërit Frashëri, që do të marrin më pas drejtimin e lëvizjes sonë kombëtare në shek. XIX, e shohim të duket në krye të kësaj lëvizjeje, ta renditë veten midis personalitetave më të shquara shqiptare të saj atë kohë, ndonëse shumë i ri, 20-21 vjeç. Përpjekja nuk pati sukses, ndonëse, në fillim, qeveria turke ishte e detyruar të jepte njëfarë pëlqimi. Por ajo përpjekje qe një përgatitje e nevojshme për sukseset që do të pasonin.

Tani shqiptarët nisnin të vihen kudo në lëvizje për të drejtat kulturore, të cilat, në fakt, nuk mund t'i fshehin synimet e tyre politike. Po kështu, që në vitet 40, edhe reaksioni serbomadh e grekomadh ka nisur ta rrezikojë haptazi Shqipërinë, duke planifikuar copëtimin e saj. Shqiptarët fillojnë t'i dalin rrezikut përpara. Në kolonitë e Rumanisë e të Stambollit ata po ndihen. Në vitet 60 kërkojnë të organizohen arbëreshët e Italisë, por edhe ata të Greqisë, në shoqëri kulturore-patriotike. De Rada, pionieri i madh i këtyre përpjekjeve, të cilat në fillim kanë pak sukses, e ka nisur me kohë punën për një letërsi të re shqipe me synime kombëtare. Vepra e tij e parë e rëndësishme, poema «Këngët e Milosaos», ishte botuar që më 1836, nën ndikimin e ngjarjeve të kohës në atdheun e stërgjyshërvë të tij. Mund të shënonim fakt

tin se që më 1824 Veqilhárxihi, pasi tre vjet përpara mori pjesë në Rumani në revolucionin që dështoi, e nisi punën për një alfabet origjinal të shqipes; kjo flet, që në atë kohë, për idetë e tij kombëtare.

Në vitet 60 vihen në veprim shqiptarë dhe arbëreshë për lëvizjen kulturore shqiptare. Mitkoja e Jubani, Kristoforidhi e Kullurioti, De Rada e Kamarda, Dora d'Istra, grua e njohur në Evropë për kulturën dhe idetë e saj përparimtare, që u lidh ngushtë me lëvizjen tonë. Ata shkruajnë gjuhën, mbledhin folklor, propagandojnë mbi popullin e tyre, arrijnë të botojnë disa vepra.

Më 1847, arbëreshi i Kalabrisë, Vinçenco Dorsa, botonte librin e tij të rëndësishëm «Mbi shqiptarët», ku fliste për historinë, gjuhën e letërsinë, zakonet etj, të populit të vet, duke shpallur haptazi se në atdheun stërgjyshor «*flitet vetëm për rilindje*». Dhimitër Kamarda, arbëresh i Sicilisë, botonte më 1870 një përbledhje poetike për nder të Dora D'Istrias, ku përfaqësoshezin poetë shqiptarë nga atdheu, Italia dhe Greqia, — Mitkoja me Jubanin, De Rada dhe Santori me Seremben, Kamarda vetë etj. Mitkoja dhe Serembeja ngrinin pa ngurrim zërin për lirinë e Shqipërisë. Kjo dëshirë që ziente me kohë midis tyre, tanimë shpalaj botërisht dhe letërsia e vinte veten në baflë të lëvizjes kombëtare. Ajo përbledhje poetike ishte si një manifest i vërtetë politik i lëvizjes kulturore dhe ideologjike shqiptare që kishte marrë tanimë hamull.

Dora d'Istria, De Rada dhe Jubani, shpresonin t'ia arrinin ditës kur të takoheshin në Shqipërinë e lirë, në Shkodër. Kështu idealet u paraprinin mundësive konkrete. Merita e tyre e veçantë qe se ato kërkonin që lëvizjet kryengritëse shqiptare të bashkëpunonin me ato të Ballkanit dhe të Evropës. Marksi dhe Engelsi «*zgjidhjen e problemit turk*» e shihnin pikërisht «*si detyrë të revolucionit evropian*».¹

Çasti i madh për lëvizjen kombëtare në shek. XIX ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, të cilën shoku

1 K. Marks, F. Engels. Po aty, vëll. IX, f. 33.

Enver Hoxha e quan «organizatë politike me karakter militant revolucionar».¹ Ajo u krijua në qershori të vitit 1878, kur në Berlin mblidheshin fuqitë e Evropës që, në pazarllëjet e tyre për ta grabitur, por edhe për ta shpëtuar nga prishja e plotë perandorinë e sulltanëve, rrezikonin tokat tona. Shoku Enver Hoxha shkruan mbi përgjigjen që ato fuqi morën nga shqiptarët: «Ju e bëtë punën tuaj, — u tha Abdyl Frashëri pjesëmarrësve në Kongresin e Berlinit, — tash fillon puna jonë.» A ka mendim më të madh revolucionar se ky? A ka veprim më luftarak se ky? A ka vendosmëri më të madhe se kjo?»²

Për Lidhjen Shqiptare janë dhënë gjykime të ndryshme nga armiqjtë e popullit tonë. E kanë cilësuar si «të shtyrë» nga Porta e Lartë, apo si një «lëvizje myslimanë», duke u mohuar shqiptarëve ndjenjat kombëtare. Po Lidhja bashkoi shqiptarët e çdo krahine dhe të çdo besimi, duke i hedhur në luftë heroike jo vetëm për të mbrojtur trojet amtare nga copëtimi prej monarkive shoviniste fqinjë, të cilat pjesërisht dhe ia arriten qëllimit, por edhe për të krijuar një shtet autonom shqiptar. Rrëmbimi i tokave shqiptare u bë me përkrahjen e ndërrhyrjen mizore dhe të hapur politike e ushtarake të Fugive të Mëdha, ndonëse shqiptarët i mbrojtën me gjak Plavën e Gucinë, Hotin e Grudën, Ulqinin etj. Porta e Lartë, e pazonja të mbronte tërësinë e perandorisë, tregtoi me pjesë të Shqipërisë dhe ishte aktive për t'i detyruar me të përdhunë shqiptarët që të dorëzonin vatrat e tyre. Domosdo, acarimi i marrëdhënieve të shqiptarëve me sunduesit turq ishte i vazhdueshëm e i pashmangshëm dhe forcat ushtarake të të dy kundërshtarëve u ndeshën më 1881.

Samiu, sikundër dihet, i shkruante De Radës për-

1 Enver Hoxha, *Për zhvillimin e shkencës dhe përgatitjen e kuadrit llogaritë t'i bëjmë mirë dhe me kohë* (në rev. «Studime politiko-shoqërore», T. 1981/1, f. 17).

2 Enver Hoxha. «Disa mendime për rilindasit» (shënimë, II. V. 1978, në «Studime politiko-shoqërore», 1982/2, f. 14).

para asaj ndeshjeje, në shkurt të atij viti, se «*pun'e Lidhjesë*» është «*pun' e vëllazërësë shqipëtarëvet edhe e bashkimit e e ngjalljes Shqipërisë*», «*e të ngjallturi të gjuhësë shqipe*», «*e të dritësuarit të kombit tënë*». Dhe ai vazhdonte: «*Shqipëtarëtë e kupëtuanë fort mirë që mbretëria (osmane) nuk do të bënë gjë kurrë për ta, edhe Lidhja e Prizrenit pa nevojë të bashkonjë Shqipërin' e t'e bënë një me otonomi, le mbasë me çkëputje fare, pas punësë.*» Këto i kishte dekluarar me kohë i vëllai, Abdyli. Kështu Lidhja provoi të parin organizim të një shteti autonom kombëtar shqiptar, me qeverinë, administratën dhe ushtrinë e tij kombëtare, duke u nisur edhe nga dëbimi i qeveritarëve osmanë, siç ka ngjarë në Kosovë, në Dibër e gjetiu, — na e mëson vetë Samiu. Ky i shkruan De Radës: «*Për pakë kohë do të dëgjoni për një ngritje të madhe në Shqipëri.*» Ishte fjala për një veprim të përgjithshëm kryengritës, që do t'i impononte sultani kërkesat e Lidhjes, në mos do të arrinte puna gjer në qëllimin e plotë, sikundër thotë vetë Samiu se mund të ngjasë. Dhe Samiu i shkruan patriotit arbëresh se Shqipëria do të qeveriset «*prej një dhimokratie prej pleqet, sikundër kanë qenë prindëtanë qëmotit dhe sikundër jan' edhe sot në malësit' e Shqipërisë, që janë thua të dliroi e më vetëhe.*»

Kështu patriotët shqiptarë kanë formuar gjer mendimet e tyre mbi organizimin demokratik të shtetit shqiptar, dhe këto janë, sigurisht, jo vetëm mendimet e Samiut, por dhe të Abdylit e të të tjera. Samiu do t'i riformulonte edhe në fund të shekullit. Ishin kërkesa përnjë demokraci që t'i përshtatej vendit dhe ishte një qëndrim i qartë antimonarkik.

Ndeshja e armatosur me turqit përfundoi me thyerjen e forcave të Lidhjes (prill-maj 1881). Shteti autonom shqiptar nuk pati jetë dhe nuk u krijua shteti i lirë shqiptar.

Edhe përpëra Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kishte pasur një «çështje shqiptare», që përpinqeshin ta minimi-

1 Të lirë.

zonin ose injoronin shovinistët fqinjë dhe Fuqitë e Mëdha. Austria me Rusinë, p.sh., kishin qenë të detyruara jo një herë që të kenë parasysh këtë çështje, në traktativat për synimet e tyre hegemoniste në Ballkan. Ishte folur për mundësinë e krijimit të një Shqipërie autonome. Grabitja e tokave tona më 1878-81 vërtetoi se shqiptarët ishin të vendosur t'i mbrojnë trojet amtare dhe t'i kërkojnë të drejtat e tyre me qdo kusht. Pra, «çështja shqiptare» nuk mund të injorohej më. Po lëvizja jonë kombëtare nuk qe aq e fortë sa të mund të thyente perandorinë osmane, kurse, nga ana tjetër, shqiptarët u gjendën vetëm kundrejt armiqsh, pa ndonjë aleat. Kuptohet tronditja e thellë që ndjeu ndërgjegjja kombëtare, në të tëra shtresat e popullsisë së vendit. Tragjedinë nuk e ndienin vetëm ato pjesë të klasave sunduese dhe të klerit që ishin të lidhura më ngushtë me pushtuesit ose me fuqitë armitë të Shqipërisë.

Ato vjet të Lidhjes qenë një si provë e madhe, më e madhja për aktivizimin përfundimtar që u duhej shqiptarëve për të arritur çlirimin e tyre.

Në krye të lëvizjes kombëtare u shqua figura e «politikanit të madh» Abdyl Frashëri, sic e ka quajtur shoku Enver. Samiu, nga ana e tij, duke qëndruar në Stamboll, ishte atje koka e vërtetë e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë. Më 1879, ai do të zgjidhej kryetar i Shoqërisë së Shkronjave, — Shoqëria e Stambollit, e cila, në fushën e veprimtarisë kulturore, ishte një «pendent», një krah i veprimtarisë politike dhe ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Është koha kur në letërsinë shqipe bën ballë vëllai tjetër Frashëri, — Naimi.

Pikërisht sepse u trondit ndërgjegjja kombëtare, shqiptarët e kuptuan se duhej bërë edhe më shumë për zgjimin dhe forcimin e kësaj ndërgjegjeje. Humbja e Lidhjes nuk duhej të ngjallte pesimizmin, po të ishte një mësim i madh për lëvizjen tonë të çlirimit, — për një organizim përfundimtar të saj. Tani që pushtuesit osmanë ishin hedhur me tërë egërsinë për ta shtypur lëvizjen kombëtare të Shqipërisë dhe që shovinistëve përf-

qark iu shtua oreksi për tokat e shqiptarëve, posa një fillim të copëtimit të tyre e kishin arritur, tanj duheshin vënë në veprim të gjitha mjetet e mundshme të organizimit e të propagandës kombëtare. Në rrethanat e reja politike, populli shqiptar duhej të gjendej i gatshëm që ta çlironte vendin nga zgjedha e gjatë. Dhe kështu lindi ajo lëvizje e gjerë ideologjike e veçanërisht kulturore e letrare shqiptare e tre dhjetëvjeçarëve që erdhën e që u mbyllën me shpalljen e shtetit tonë të lirë kombëtar në Vlorë 1912.

Në këto rrethana lindi si poet i lëvizjes kombëtare dhe luajti rolin e tij të madh Naim Frashëri. Në vitet 1880-99, me shkrimet e botimet e tij, me një krijimtari të dendur e të pandalur Naimi u bë, si të thuash, udhëheqësi shpirtëror i lëvizjes. I thanë që me gjallje «*apostull i shqiptarizmit*».

Kultura dhe letërsia shqiptare përpara Naim Frashërit

Në «Fjalorin enciklopedik» të tij, Samiu pohon se shqipja shkruhej që nga shek. XIV. Se nga e ka nxjerrë ai këtë të dhënë, që është e saktë, nuk e dimë. As nuk dimë nëse rilindës të tjerë e njihnin një fakt të rëndësishëm si ky, që pohonte shkrimin e gjuhës së shqiptarëve përpara pushtimit osman dhe që, tërthorazi, të çonte në përfundimin se pushtuesit shkatërruan një kulturnë më të vjetër në shqipen e shkruar, se shqipja e shkruar nuk filloi gjatë pushtimit osman, sikundër dihej gjer atëherë.

Naimi nuk bën fjalë për një fakt si ky. Kristoforidhi me Vreton, si shkrimtar më të hershëm shqiptar njohin Pjetër Budin e pas tij Pjetër Bogdanin, të shek. XVII. Vepra e parë e Budit, «Doktrina» (1618), kishte qenë ribotuar në kohë të tyre mbas 250 vjetësh. Anton Santori dhe Zef Jubani kishin bërë të njojur diçka prej shkrimeve të Bogdanit. Buzuku, ndonëse nga ndonjë arbëresh

dihej si autor më i vjetër, p.sh. nga Zef Krispi (1836), në Shqipëri nuk dimë të jetë përmendur prej ndokujt, përparrë se «Mesharin» (1555) ta rizbulonte një arbëresh tjetër, Pal Sqiroi, dhe të jepte lajmin në shtypin shqiptar të mbarimit të Rilindjes (1909).

Sidoqoftë, që herët, shqiptarët ishin interesuar për origjinën e tyre, si një nga popujt më të hershëm të Evropës, ndofta më i hershmi në Ballkan. Kështu ata ishin të bindur edhe për lashtësinë e kulturës së tyre, të kishte qenë shkruar apo jo herët fort gjuha shqipe. Për këto, mjaft të kujtojmë veprat e Marin Barletit (1504-10) dhe, përparrë tij, letrën krenare që Skënderbeu i dërgonte princit të Tarantos më 1461, letër e cituar nga historianët, e pakta që nga shek. XVIII. Duke e njohur popullin e vet si pasardhës të epirotëve të dikurshëm, duke i dhënë vetes emrin «epirot», kaq sa dhe «arbëresh», udhëheqësi i madh fliste edhe për «*kronika tonat*», që i vërtetotonin pohimet e tij. Si njeri i kohës së Rilindjes Evropiane, Gjergj Kastrioti me ato kronika kuptonte, më me siguri, veprat e klasikëve grekë dhe latinë, në mos edhe shkrime shqipe. Shqiptarët nuk injoronin se ç'ishte shkruar për pelazgët, të cilët i vështronin si stërgjyshër të tyre. Ilirët, epirotët e maqedonët e qëmotit ata i vështronin si degë të një trungu, bij të pellazgëve. Pellazgët Homeri i kishte quajtur «*hyjnorë*».

Pasi humanistët tanë, Marin Barleti, Dhimitër Frengu, Frang Bardhi etj, kishin pohuar prejardhjen e lashtë epirote të popullit të tyre, ose atë të lashtë maqedone, arbëreshi Nikollë Keta, më këtej, ishte përpjekur ta argumentonte hollë e gjatë atë prejardhje në një vepër vëllimore që mbeti dorëshkrim, «*Shënimë mbi maqedonët*» (1777). Keta nuk e dinte se tre vjet përparrë gjermani Johan Thunman kishte trajtuar në mënyrë mjeshtërore të njëjtën çështje, duke provuar prejardhjen ilire të shqiptarëve. Një pohim të tillë e kishte bërë filozofi Lajbnic që në fillim të shek XVIII. Në fillim të shek. XIX, ndër arbëreshë e ndër shqiptarë shkruhen traktate mbi ilirësinë e shqiptarëve (Engjell Mashi më 1807, Mikel Skutari më 1825, një Veqil në jugë para vitit 1813).

Puna e Ketës pati një të ardhme të madhe, kur nxënësit e tij ia përhapën idetë ndër arbëreshë (1834-36) e sidomos kur ato ide i përqafoi De Rada(1840). Ky deshi të riprovonte se perënditë e tyre, — ashtu siç e kishte pohuar Herodoti, — grekët i kishin nga pellazgët: këtë De Rada u përpinq ta arrinte duke treguar se si emrat e disa perëndive greke shpjegoheshin me gjuhën shqipe. Teza mori dheun kur atë e mbroi albanologu Georg Hahn, i cili e bëri shumë të njojur në Evropë me veprën e tij të rëndësishme «Studime shqiptare» (1853-54). Madje Hahni, duke zbuluar në Elbasan alfabetin origjinal të Dhaskal Todhrit, pandehu se gjeti «alfabetin pellazgjik» vetë dhe këtë emër i vuri (1849).

Lexuesi e kuption përsë u ndalëm në këtë çështje, që është pasionante edhe në vetvete: shqiptarët, me kohë dhe seriozisht, ishin preokupuar për origjinën e tyre, për lashtësinë e gjuhës, pra, edhe të kuturës së tyre. Të zat për të cilat folëm, me ngjyrën romantike që u veshi domosdo koha, ishin në themel të drejta. Ideologët e letrarët tanë rilindës i bënë menjëherë të vetat. Kështu bëri Abdyl, kështu edhe të tjerë, si Kristoforidhi, Pashko Vasa dhe Anastas Kullurioti me shokë. Shkenca nisi të përmendë domosdonë e ndjekjes së tragës së shqipes për të arritur në burimet e gjuhëve evropiane, gjer edhe të greqishtes e latinishtes. Ky ishte një shkas i vërtetë krenarie për shqiptarët.

Kur në vitet 20 të shekullit të kaluar, frencezi Foriel botonte me sukses të jashtëzakonshëm këngët popullore greke, ndër arbëreshë, një shok i De Radës, Ëngjëll Bazile, i krahasonë me këngët tradicionale shqiptare dhe i gjente këto më të bukura. Profesori i universitetit të Vjenës, Bartoleme Kopitar, bënte pyetjen se mos këngët shqiptare u prinin në kohë atyre greke dhe shtronte problemin e njojjes së këngëve shqiptare për të folur për vjetërsinë e këngëve të fqinjëve tanë jugorë. Këto ide ai nuk duhej t'i kishte vetëm të vetat. Gjuhëtari ishte miqësuar me shumë ballkanas që tregonin në Austro-Hungari dhe këta kishin opinionet e veta mbi kulturat e Ballkanit. Midis këtyre kishte edhe

shqiptarë. Qenë këta që më 1814 i mbushën mendjen përfaqësuesit të Shoqërisë angleze të Biblës, që «Dhjata e Re» të përkthehej shqip, gjë që nuk vonoi të vihej në jetë, me anë të Vangjel Meksit nga Labova (që më 1819, — botimi u bë më 1824 dhe 27, përparrë botimit bullgarisht dhe shumë përparrë atij rumanishët).

Kur bisedojmë për kulturën shqiptare përparrë Naim Frashërit, e kemi fjalën, sidoqoftë, kryesisht te kultura e popullit tonë që i paraprin ose që lidhet me fillimet e krijimtarisë së tij. Që shqipja të ishte shkruar në shek. XVI-XVII, siç e provonin veprat e Buzukut, Budit e Bogdanit. Kjo për rilindësit tregonte një gjë së pari: se pas pushtimit osman, shqiptarët reaguan për ta shkruar pa vonesë gjuhën e tyre, gjë me rëndësi të madhe për qëndresën dhe mosasimilimin e popullit tonë.

Po rilindësit shihmin edhe se shqipja nuk kishte qenë lëruar sa duhet, po përkundrazi, për të krijuar një kulturre diçka të zhvilluar me shkrim. Ata ishin pak të njojur me shkrimin e shqipes përparrë tyre dhe e ndienin thellë fatkeqësinë se kishin një trashëgim të varfër të gjuhës së tyre të shkruar. Ata, me zemërim të drejtë, bënin fajtorë pushtuesit anadollakë dhe shtronin çështjen e domosdosë së zhvillimit të shpejtë të një kulture të re kombëtare. Kur kryeministri turk Ali pasha, më 1870, dha pëlqimin që shqiptarët të vepronin për një alfabet të përbashkët, ai praktikisht e anuloi atë koncesion, duke thënë se mysli-manët shqiptarë nuk duhej të merreshin me këtë punë, se ata, për të, ishin «turq»! Po atë kohë, Jubani ngrinte zérin kundër klerit të huaj katolik në Shqipëri, sepse ky punonte kundër interesave të kulturës së vendit. Shqiptarët e dinin se kush e helmatisi Veqilharxhin, në Stamboll, sepse ai u vu në ballë të përpjekjes së re për shqipen e shkruar.

Shqipërisë së mbushur me shkolla kuranike iu shtuan pak shkolla të reja fillore e ndonjë gjysmëgjimnaz a gjimnaz i arsimit «të reformuar» turqisht, por asnjë shkollë shqipe nuk lejohej të hapej. Ndërkaq, shkollat greqishtë, që ishin shumëzuar në shek. XVIII, shtoheshin akoma, — ato arrinin mbi 700! — dhe po çeleshin serbe,

bullgare, italiane dhe ndonjë rumune. Kultura shqiptare dhe e ardhmja e saj ishin vënë në rrezik jetë. Populli shqiptar rrezikohej të tretej, të asimilohej. Lëvizja për një kulturë të re shqiptare kundër kulturës së pushtuesit dhe asaj orientale në përgjithësi, kundër kulturave të tjera penguese ose dhe agresive, ishte një anë shumë e rëndësishme e lëvizjes politike për zgjimin dhe forcimin e ndjenjës kombëtare, për çlirimin e vendit.

Përpjekjet e rilindësve për të njojur kulturën e tyre të kaluar, si p.sh. përpjekjet e një Kristoforidhi, të Kamardës e Dorsës, Vretos, Samiut e Mqedës me shokë, qenë të meritueshme. Merita të veçanta pati mbledhja e botimi i letërsisë popullore, sidomos nga De Rada e Mitkoja, por edhe nga të tjerë. U zbuluan kështu jo vetëm shkrime dhe autorë të së kaluarës, por edhe një letërsi gojore shumë e pasur e me cilësi nga më të qmueshmet, e mogme dhe e re, që nuk iu bë e njojur vetëm opinionit të vendit, por edhe atij të jashtëm.

Kjo qe e domosdoshme dhe pati efekte të shumanëshme. Dora D'istria argumentoi me të qënien e kombësisë shqiptare, që mohohej. Albanologu Gustav Mejer, i cili në vitet 80 iu vu studimit të shqipes dhe bëri një punë të qmuar për të treguar originën e saj ilire, deklaronte me admirim, duke lexuar «Bletën» e Mitkos, se edhe shqiptarët kishin epikën e tyre historike. Për epikën historike shqiptare ishte folur që nga Barleti, — për këngët mbi Skënderbeun, — po këto ishin fakte pak e aspak të njohura

Këngët popullore shqiptare provonin vlerat e shquara të një kombi që luftonte të riafirmohej në Ballkan. Ato ishin një provë e gjallë e lashtësisë dhe e vlagës së kulturës shqiptare. Ja tek duhej të bazohej kultura e re që nisen të ndërtonin rilindësit. Poeti De Rada, me mbështetjen në krijimtarinë popullore arbëreshe, kishte dhënë një shembull të shkëlqyer. Kristoforidhi po honte se kishte hartuar një fjalor të shqipes me 40 mijë fjalë, — ai kuptonte në këtë shifër edhe frazeologjinë e pasur që kishte në veprën e tij. Ky thesar, po të shfrytëzohej e të përpunohej ashtu siç bëri Kristoforidhi vetë

në botime të shumta, jepte fryte të paçmueshme. Naimi, Samiu dhe të tjerë e patën model për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës së re të shkruar dhe e çuan përparrë përpjekjen e tij.

Nuk i mungonte, pra, asgjë kulturës shqiptare, — as lashtësia, as vlerat e cilësitë, as mundësitë e një zhvillimi të ri dhe të shpejtë. Tani, pas bjerrjes ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur lëvizja kombëtare nuk mund të ishte, për njëfarë kohë, një lëvizje e veprimeve të mëdha të armatosura, ajo duhej të ishte një lëvizje e veprimeve të mëdha të kulturës. Për këtë e ndjeu veten «të thirrur» Naim Frashëri, i cili iu vu menjëherë punës, që në valën e Lidhjes Shqiptare, po sidomos që nga viti 1884. Te vjersha «auto da fe» e këtij viti. «Fjalët e qiririt», patrioti shpallte detyrën e shenjtë me të cilën e kishte ngarkuar veten:

*Në mes tuaj kam qëndruar
e jam duke përvëluar,
që t'u ap pakëzë dritë,
natënë t'ua bënj ditë...
Unë zjarrit nuk i ndruhem
dhe kurrë s'dua të shuhem,
po të digjem me dëshirë,
sa të mund t'u ndrinj më mirë.
Kur më shihni se jam tretur,
mos pandehni se kam vdekur;...
unë jam në shpirtit tuaj.*

Fjalë të tilla dhe një besim si ky në misionin drithë dhënës, — mision të përhapësit të idesë së çlirimt kom-bëtar përmes krijimit të kulturës së re kombëtare, — shqiptarët nuk i kishin dëgjuar tjetër herë më të zjarcta.

Aksionet për lëvizien kulturore shqiptare kishin nisur e pakta që nga Veqilharxhi e De Rada dhe kishin arritur suksesin e parë të madh me Shoqërinë e Stambollit e mc degët e saj në Aleksandri të Misirit e sidomos në Bukuresht, në vitet kur Naimi do të hidhej në vjershërinë shqipe. Kjo lëvizje mori një hov sidomos kur u

krijua shoqëria «Drita» e Bukureshtit, më pas «Dituria» (1884, 1887), e cila mbajti emrat e një reviste kulturore që Samiu, Naimi dhe Vretoja me të tjerë nisën të nxirrin në Stamboll, po që nuk pat më shumë se një mot jetë (1884-85).

Shtypi shqiptar nuk vonoi, pra, të duket, si me gazeten «Zëri i Shqipërisë» të Anastas Kulluriotit në Athinë (1879-80), me revistën e De Radës «Fjamuri i Arbërit» në Kalabri (1883-87), apo me fletën «Shqiptari» të Nikolla Naços në Bukuresht (1888 e këndej). Po ky shtyp do të priste fundin e shekullit për të marrë hov, kur nisën botimin më 1897 revista «Albania» e Erukselit, ajo «Shqipëria» e Bukureshtit dhe «Kombi shqiptar» i arbëreshëve në Kalabri, «Kalendar kombiar» në Sofje. Pas tyre, erdhën gazeta të shumta.

Naimi ishte në mbyllje të punës së tij krijuese, i sëmurë, me një këmbë në varr; ai botonte diçka në atë shtyp dhe nxirrte «Historinë e Skënderbeut», vepra të krijuara përpëra vitit 1895.

E lamë për në fund të flasim për një rrymë të gjetrë letrare të periudhës përpëra Rilindjes, por edhe që jetoi gjatë kësaj periudhe të re, ndonëse përherë më e dobët, — rryma e bejtexhinjve.

Emri tregon se kemi të bëjmë me një rrymë poetike, ndonëse nuk mungoi edhe proza (ajo fetare). Nuk munguan edhe disa mjete për mësimin e gjuhës, si fjalorët dygjuhësh, për të mësuar turqishten, po që mund të shërbenin të mësonin edhe turqit shqipen. Kemi edhe ndonjë gramatikë për mësimin e shqipes (që në vitet 30 të shekullit), apo ndonjë abetare po për këtë qëllim (1861). Këto kujdese të fundit nuk janë pa lidhje me mendimin rilindës.

Sidoqoftë, e gjithë letërsia e quajtur e bejtexhinjve u shkrua me alfabetin arab, i cili, për disa arsy, nuk i shkonte gjuhës sonë. Dhe kjo, nga ana tjetër, tregonte përherë ndikimin e kulturës osmane e përgjithësisht orientale ndër autorë që ishin nxënës të medreseve të Shqipërisë dhe të Lindjes. Nezim Frakulla, themeluesi kryesor i rrymës, studioi në Berat e në Stamboll, ku edhe vdiq

në burg, nuk dimë përse, por ai pati qenë përndjekur dhe tjetër herë. Bashkëkohësi beratas i tij, Sulejman Naibi, në Persi i kishte kaluar disa vjet të rinisë. Muhamet Kyçuku bëri medresenë e lartë në Misir.

Shek. XVIII, në letërsinë osmane, njihet si periudha e një ndikimi të ri dhe të fortë nga letërsia persiane. Persizmat u bënë të modës dhe vërvshuan në fjalorin poëtik e në rimarin e osmanishtes, ashtu si arabizmat ishin bërë në masë pronë e fjalorit të degëve të ndryshme të dijes. Ato fjalë nuk ishin si «kripa e gjellës», po qka vështrohej më «e stolisshme» në poezinë osmane. Osmanishja me letërsinë e saj ishte gjuha e shtresave të larta të shoqërisë, — feudalë, klerikë, nëpunës, — dhe thua se nuk kuptohej nga populli. Në perandorinë e sultaneve, turqit kishin dy letërsi: njérën e krijonte populli në gjuhën që fliste, sipas dialekteve, tjetrën e krijonin përfaqësuesit e klasës feudale sunduese, intelektualë e fetarë, prej të cilëve popullin e ndante jo vetëm gjendja shoqërore, por jo pak edhe shija artistike e bejlerëve.

I shënuam këto, sepse edhe në Shqipëri, — edhe në ndonjë vis tjetër të myslimanizuar të Ballkanit, si Bosnja, — gjuha e vendit nisi të shkruhej nga e njëjtë klasë dhe të njëjtat shtresa të shoqërisë, nën ndikimin shumë të ndjeshëm të osmanishtes, arabishtes e persishtes. Kjo kishte ngjarë me kohë në Spanjë me pushtimin e gjatë arab. Ndonjë nga bejtexhinjtë tanë më të parë në kohë nuک shkroi vetëm shqip; madje nuk e nis me shqipen, po me osmanishten e persishten. Nezimi na ka lënë nga një «divan» në secilën nga këto gjuhë.

Bejtexhinjtë nuک sollën vetëm ndikimin e thellë të gjuhëve orientale; ata sollën tematikën e letërsive të atyre gjuhëve, një tematikë e bërë tradicionale dhe që kishte rënë në rutinën e klisheve, me ndonjë farë përtëritjeje që, domosdo, e sillte koha. Kështu, bejtexhinjtë pas-qyruan në shkrimet e tyre mënyra të menduari e të ndjeri, tërë një mentalitet e shije estetike që nuk pajtohesin me jetën e popullit, po që ishin të pranueshme dhe të afërtë për bejlerët dhe shtresat e larta të shoqërisë shqiptare. Mbi gjithë këtë mentalitet sundonte botëkuptimi mistik islam.

Po, sikundër në fe kishte sekte të ndryshme, zakonisht rivale, ndonjëherë edhe që s'pajtoheshin me myslimanizmin zyrtar, kjo pasqyrohej edhe në botëkuptimin mistik të veprave të bejtexhinjve. Në shek. XIX, p.sh. sekti i bektashinjve, që pati qenë ai i ortës ushtarakë të jeniçerëve pér kaq shekuj, u bë kundërshtar. Naimi dhe familja e tij ishin bektashinj. Panteizmi, që ishte në thelb të botëkuptimit të sektit, do të luajë një rol të veçantë edhe në botëkuptimin e tij, që do të ruajë kështu edhe ndikimin mistik të prejardhjes.

Vetë fakti që bejtexhinjtë nisën të shkruanin shqip, — kjo ka ngjarë aty nga fundi i shek. XVII, kur myslimanizimi në masë i vendit ishte kryer, — kishte edhe digka pozitive, meqë gjuha shkruhej. Po kjo nuk u bëhej dot kundërpeshë ndikimeve negative që depërtonin përmes asaj letërsie të pushtuesve në Shqipëri. Shkrimet e bejtexhinjve, kur sillnin diçka ngajeta, apo kur shprehnin protestën kundër pushtuesve të huaj dhe merrnin anën e përpjekjeve pér t'u çliruar nga sundimi osman, si në kohën e Bushatlinjve dhe të Aliut të Tepelenës, madje edhe në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ato shkrime fitonin një brendi realiste dhe pozitive.


Kjo brendi, në veprat e një Hasan Zyko Kamberi në Kolonjë (fundi i shek. XVIII, fillimi i shek. XIX), apo të një Zenel Bastari në Tiranë (mesi i shek. XIX), arriti të mbushet me një kritikë të shoqërisë së kohës, me një përbajtje klasore protestuese dhe denoncuese, disa herë shumë të fortë.

Kur është fjala pér mjetet e shprehjes, trajtimi i poemave të gjata tregimtare, pasurimi i prozodisë, nuk duhen nënçmuar. Me bejtexhinjtë, letërsia shqipe, e cila më parë ishte kryesisht e karakterit didaskalik fetar, nisi të bëhet një letërsi artistike e mirëfilltë në gjintë poetike.

Po rilindësit pak i patën parasysh këto anë. Ata iu kundërvunë kulturës osmane, pra edhe ndikimeve të saj. Naimi, fjala vjen, që nuk ua mohon meritat Nezimit dhe Hasan Zykos, i dënon rreptë ata pér keqtrajtimin e



Frashëri



Shtëpia muze e vëllezërve Frashëri (*Frashër*)

Iati i Naimit, Halili



Nëna e Naimit, Emineja





Vellezërit Frashëri (Janinë 1866)



Naimi dhe Samiu me disa nxënës të tjera shqiptarë
(Janinë 1866)



Naimi (*Ianine* 1865)



Naimi dhe Samiu (Janine 1868)



Naimi me Mehmetin e Tahsimin (*Janinë* 1868)



Naimi (Janinë, në vitet '70)




Naimi me Mehmetin (*Janiné* 1868)



Abdyli në vitet '70




Naimi dhe Samiu me familjet (Stamboll 1882)



Naimi dhe Asija (Stamboll 1882)





Naimi (Stamboll 1896)



Varret e Vëllezërve Frashëri (Tirane)

Shtëpia ku vdiq Naimi (Stamboll)





gjuhës amtare. «*Të gjithë kanë bërë faj që s'faletë e të metë që s'ndjehetë kurrë*», shkruan ai. Është shenja e luf-tës që, në një mënyrë a në një tjetër, letërsia dhe kultura jonë e re, kombëtare në substancë e nën ndikimin e kulturës përparimtare të Evropës së dalë nga revolu-cioni borgjez, i kundërvihet në tërësinë e vet kulturës feudale dhe orientale, me misticizmin dhe mykun e saj, me presionin që kjo kulturë e pushtuesit e bënte mbi kulturën tonë.

Për një poet si Naim Frashëri, i cili u zhvillua në kontakt të afërt jo vetëm me kulturën e vjetër e të re pe-rendimore, por edhe me atë të vjetër e të re lindore, këto kanë rëndësi të kihen parasysh. Përmes veprës së tij, ndeshja midis dy kulturave, — të asaj kombëtare dhe asaj të pushtuesve, — bie menjëherë në sy, me sukse-set e rëndësishme që kultura dhe veçanërisht letërsia jo-në shënoi.

Këtu do të merremi edhe me luftën që rilindësve iu desh të mbanin. të ndezur e ta çonin më tej kundër kulturave të tjera të huaja, që bëheshin atëherë pengesë ose kërcënonin zhvillimin e kulturës shqiptare. Kjo ishte një shfaqje e luftës drejt-përdrejt politike kundër shovinistëve fqinjë, po dhe kundër fuqive imperialiste, të cilat, me tërë mjetet, edhe kulturore, — feja, arsimi etj., — përpinqeshin të depërttonin në Shqipëri ose të forconin aty pozitat e fituara. Kjo luftë qe veçanërisht e ashpër me kishën dhe shkollën greke.

Kultura greke, — pa harruar atë antike, — që prej shekujve të gjatë të Bizantit, luante një rol mbisundues midis të krishterëve të Ballkanit e të Lindjes. Ajo luajti edhe role pozitive në zhvillimin kulturor të përgjithshëm të kombësive të ndryshme, si bie fjala me përhapjen e ideve të humanizmit apo të iluminizmit në shekujt e errët të pushtimit osman. Po kisha ortodokse e Fanarit, e cila e pati kulturën greke gati monopol, ishte dorë e dja-thë e sulltanëve për sundimin e ballkanasve dhe i luf-tonte përgjithësisht idetë e reja. Me krijimin e një shteti të lirë helen, por edhe më parë, kultura e qarqeve zyrtare kishte nisur të bëhej një pengesë serioze në

zhvillimin e kulturave kombëtare të fqinjëve ballkanas, qoftë me anë të kishës e të shkollës në duart e klerit fanariot, qoftë me veprimtarinë e borgjezisë grekomadhe në pushtet. Kështu, bie fjala, në Bullgari, kështu dhe në Shqipëri.

Në rrrethet e borgjezisë sonë dhe të fqinjëve gjenden shin njerëz që viheshin në shërbim të asaj veprimtarie minuese, — grekomanët. Mjafton të përmendim një Vangjel Zhapë e një Kristaq Zograf. I pari ishte hedhur kundër Vegilharxhit dhe pasuesve të tij; i dyti u hodh kundër rilindësve tanë të viteve 70. Ata jo vetëm e përkrahën me të madhe arsimin grek në Shqipëri dhe lufthan përpjekjet pér krijimin e shkollës shqipe dhe pér botimin e librave shqip, po përdorën pasurinë e tyre të konsiderueshme në shërbim të megalidesë. Apo të përmendim dhespotin famëkeq të Gjirokastrës, Anthimin, i cili u ngrit me egërsi kundër Shoqërisë së Stambollit dhe shkrimit të shqipes.

Një luftë e veçantë u desh të bëhej në veri kundër klerikëve katolikë të huaj, që, kur përdornin shqipen pér propagandën e tyre fetare, e mbysnin me fjalë të turqishtes, njësoj si bejtexhinjtë, duke mos bërë asgjë, nga ana tjetër, pér arsimin shqiptar, po duke mbajtur në Shqipëri ndonjë shkollë fetare, ku gjuha e mësimit qe italishtja. Jubani, që pamë se i sulmoi, ishte i përndje-kur prej tyre. Ata ishin në shërbim të imperializmit austro-hungarez, por edhe të atij italian. Arqipeshkvi i Shkodrës, një italo-dalmatin, Paskual Guerini, dhe kleri i tij i sollën pengesa p.sh. Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Guerinit i përvëloj lufta që Pashko Vasa bënte edhe kundër klerit të huaj katolik, kur më 1880, në vjershëm e tij kushtruese «O moj Shqypni!», patrioti sulmon-te dasinë fetare, hidhte parullën e bashkimit: «*feja e shqyptarit asht Shqyptaria*».

Edhe nëse lufta e Naim Frashërit nuk qe e drejtpërdrejtë kundër këtyre shfaqjeve të fundit në veri të vendit, po më shumë kundër kulturës së pushtuesit, ajo drejtohej objektivisht kundër gjithë pengesave të kulturave të huaja. Lufta e tij dhe e rilindësve të tjerë në

këtë terren kishte përgjithësisht një karakter antifeudal, antishovinist dhe antiimperialist, një karakter demokratik e popullor, ajo i sillte një shërbim të madh aktiv lëvizjes për çlirimin kombëtar dhe përparimin e vendit. Edhe nga kjo anë, «pavarësisht se në veprat e rilindësve ka edhe pikëpamje filozofike të ndryshme të atyre kohëve, me të cilat disa herë ne nuk jemi dakord, — shkruan shoku Enver Hoxha, — ata mbeten tanët dhe të rinj për jetë.»¹ Kështu, ndër më krysorët, Naim Frashëri

1 Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin,» f. 132.

Frashëri dhe frashërinjtë

A keni shkuar nga Përmeti në Frashër nëpër udhën që të ngjit te Bredhat e Hotovës?

Luginë e ashpër, e munduar nga erozionet, po që ende ruan gjelbërim, më shumë prej shkurresh se prej pyjesh. Tokë buke pak, pemë diçka. Pra, një vend që nuk e ka mbajtur sa duhet njeriun, por që koha jonë e re e transformon thellë edhe atë. Udhëtari përgatitet, pas orësh të gjata, të futet në një nga malësitë e veçuara të Toskërisë, siç është krahina e kësaj që thuhet Dangëlli, me qendër Frashërin.

Pamjet e maleve rretheqark të flasin vazhdimisht për ashpërsinë e vendit. Po në pyjet e Hotovës, te bредhat, rrëzë një gurre me ujë të akullt, gjithçka ndryshon për disa çaste. Ka gjelbërim shumë. Te ai krua, që quhet i Bunovës, tregojnë se vinte shpesh Naimi. Është ky një peizazh naimjan i njohur nga «Bagëti e bujqësia». Kështu, dhc kur nuk sheh veçse gérxh, — fjalë kjo që u bë e përhapur në letërsinë tonë që nga Naimi: «çuka, kodra, brinja, gérxhe dhe pyje të gjel-

bëruara!» — merr me mend stanet e tufat, në mos të zëntë veshi a syu në pyll edhe «*sharrën që bën lëndë*». Tomori është tanjatje, në horizontin jo të largët verior, që sundon lartësitë dhe që rrallë të humbet nga vështrimi. Nuk është pamja e tij si kon mallahiti, që jemi mësuar të kundrojmë nga Shqipëria e Mesme, po një masiv i téri, si një luan vigjélues, me shpatullat e kokën nga deti. Edhe në mes të verës, atij diku i zbardh një kënd dëbore.

Lë bredhat e, jo larg, nis një faqe lajthishtë, ku do të zbresësh. Peizazhi naimjan pasurohet përherë. Pasi ke zbritur në fund të një humnere, ku mbaron lajthishta, do të marrësh të përpjetën për Frashër, duke i kthyer shpinën Tomorit, nëpër një rrugë lakore. Dhitë, që ke për të hasur udhës, i japin gjallëri vendit, — kecërit që kërcejnë, «*cjapi me zile të madhe*».

Prisni që atje lart t'ju dalë një plajë e gjerë, e qarkuar nga malet, siç ua kishte paraqitur vendin një fotografi e dhjetëvjeçarëve të kaluar. Sa të gënjen disa herë këndi i të parit të një fotografi! Kur nis e del në Frashër, udhëtarë gjendet përpara një gjysmë «cirku», — le të përdorim termin e gjeologjisë, — i gdhendur si me sqepar e pra që ka marrë pamjen e një amfiteatri. Amfiteatri është vigan. Përqark, lart, male më shumë shkëmbore, — gërxhe-gërxhe, — në drejtim të Kolonjës e të Oparit, nga juglindja. Kokojka, maja e famshme në jugperëndim, është e zhveshur, por e gjelbëruar, «e butë». Është në këtë lagje një gur, — Guri i Naimit. Ulu dhe kundro një çast.

Do t'i pëlqente njeriut t'i shëtiste me pëllëmbë ato «*brinja e çuka e maja*», me ndjenjën se shkel kudo mbi gjurmët e poetit. Dhe ta përfytyronte poetin që nuk lë shkëmb e guvë, përrua e rrëke pa njojur, që ndjek tragat e dhive e të mushkave, rrugët e moçme të karvanaeve që venin e vinin kësaj ane nga shumë drejtime, — «*prej Skrapari e prej Dobreje*», si «*pe Korçe e prej Myzeqeje*», prej Përmeti zakonisht.

Naimit iu ka dashur t'i ndjekë shpesh ato rrugë, kaluar a në këmbë, me pallton krahëve a me fishkëlli-

mën në buzë, me syrin që heton tekdo bukurinë dhe, — madhështinë. Këto udhëtime i ka bërë edhe në dimër, përmes dëborave që duheshin çarë. Ka vajtur në Korçë, duke kaluar qafën e Qelqezës, — si qelqe i ka ajo shkëmbenjtë atje lart? Njerëzit i lajkëtojnë me emra malet, si dhe sendet me shpirt, — u thonë dhe Trëndafil! Në Korçë Naimi kishte njerëzit e nënës. Gjetiu, tek e ka zënë nata, e kanë pritur mik. Është nisur përmë shkollën e Janinës. Është kthyer nga Stambolli përmë marrë shëndetin e tronditur që në rini. Është nisur prapë përmë një punëzë që i kanë dhënë në Berat a në Sarandë, përmë t'u rikthyer me mallin e vendit, apo që të marrë pjesë në një kuvend të madh të atyre anëve, kur ziente çështja e shpëtimit të Shqipërisë, më 78.

Kur hyn në Frashër, të pret një lagje, lagjeja e Skënderajve, e cila ndofta s'i ka 40 shtëpi. Ato janë si gjithë shtëpitë e atyre malësive, me gur gri të skallitur trashë, me llaç gri. Mos ishin të mbuluara dhe me plloca shtëpitë? Ojhakët tymosin sadopak edhe në verë. Nga larg, me syun bujar, të fton një dritare e një tjetër. Ato kanë qenë, sigurisht, më shumë frëngji motit; tani kanë filluar të zgjerohen nga malet, t'i mbushin shtëpitë me dritë. Po «frëngji» kanë mbetur ende, — vigjéluese.

Më tej, një teqe me «hane» shumë, të cilën e kanë keqtrajtuar, — e dogjën pushtuesit shovinistë në Luftën e Parë Botërore dhe ajo ka ende rrënoja përrreth. Është një ndërtësë që ruhet si monument. Aty foli Abdyli më 78. Naimi e dëgjonte dhe ëndërronte përmë të ardhmen nga ajo e tashme lufte.

Përtej teqesë, një godinë tjetër, më e vjetëruar nga jashtë, po që brenda mbahej dhe ajo mirë, gumëzhinte nga zërat e fëmijëve, të cilët po hynin përmë nisur një tjetër orë mësimi. Njërin e thërritkëshin Kamani, si një hero të Naimit! Mendon te hoxha e te dhaskali i dikurshëm, me shufra thane në duar. Sot idealet e mëdha të diturisë u bënë jetë midis maleve.

Dhe ja shtëpia e familjes së madhe të Halid Frashërit, në kënd të Arës së Abdylit, si quhet një shesh,

Një si pallat i vërtetë, i rindërtuar mbi gërmadhat që lanë vitet e egra. Një nip i Samiut, mysafir nga Turqia, shqyen sytë. «Si eshtë e mundur!» Në mes të malësisë, një pallat si ky! Gjyshërit Dakollarë kanë jetuar larg qendrave të mëdha, po «qytetërimi» s'u paska munguar. Përmasat e ndërtesës prej guri nuk flasin vetëm pér faktin se, sado bejlerë të rënë nga vakti, Halidi me fëmijët e tij e kishin këtu një nivel jo të keq jetese pér kohën, por edhe pér prestigjin e «derës», në ato vise të thella gërxhore. Ndikimi që ata ushtronin së këtejmi dhe që u shtri pastaj mbi tërë Shqipërinë, kur djemtë morën kulturë dhe u vunë, me vullnet e trimëri e plot mend, në ballë të luftës gjimtare, ka hije që t'i ketë pasur rrënjet në këto vise.

Në rrëpirat përkundrejt, — ato janë shumë të zhveshura, — në faqen lindore të amfiteatrit, ku diktohen dhe disa copëza tokë buke, ndonjë tarracë që ka filluar të zgjatë gjurmën e saj, të tregojnë lagjen më të vjetër të Frashërit nën Qelqezë. Ajo quhet Vilë. Emri, prej origjine romake, flet pér një vend të banuar e pakta që prej 20 shekujsh. Këto malësi kanë qenë të populluara nga fiset ilire. Atintanët? Mali ishte fortesa e tyre, që i ndihmoi edhe të mos treteshin. Që Frashëri mori, — me sa duket vonë, në shek. XV dokumentet s'na e japid, — emrin e një druri të njobur e të qmuar nga punonjësit e drurit, kjo tregon se vendi ishte i veshur me të, nën brezat me ah e bredh të Kokojkës e të Zavalanit përmatanë.

Arkeologja mund të thotë nesër fjalën e saj pér stërgjyshërit e këtyre viseve në lashtësi. Sot, Frashërit nuk i njihet historia përpëra fundit të shek. XVIII. Gojëdhëna nuk i ngjitet më lart se shek. XVI.

Në «Fjalorin enciklopedik», Samiu shkruan se bejlerët e Frashërit e kishin origjinën nga Tomorica dhe vinin nga një Ajaz, i cili erdhi e u vendos në Frashër në shek. XVII, pasi familja e tij kishte bërë 80 vjet në Stanimakë të Trakës, në rrëthim e Adrianopojës, ku e kishin degdisur si të mosbindur. Kur i lejuan të kthen në Shqipëri, u dhanë dhe disa fshatra në Myzeqe.

Î Pra, vend për bagëti në bjeshkë, por edhe vërrri e tokë buke në fushë. Në kohën kur shkruan Samiu, ata ishin bërë 40-50 shtëpi. Prej tyre kishin pasë dalë në punës dhe ushtarakë të lartë, dhe kishin arritur gjer vezirë.

Kështu të parët e Ajaz beut kishin qenë të rrezikshëm nga fundi i shek. XVI. Ishte një kohë kryengritjesh të mëdha e të paprera kundër sundimit të sultانëve, kryengritje që u zhvilluan posaçërisht pas betejës që osmanët humbën në Lepanto të Greqisë kundër spanjollëve më 1571.

Nuk del që Dakollarët, siç quhen Vëllezërit Frashëri, të jenë pasardhës të Ajaz beut, po mbasë edhe më të vjetër në fisin e tyre. Një bejt i shek. XIX, ndofta i frashëriotit Tahir Nasibiu, që jetoi përpara Naimit, me Ajazin lidh vetëm dy familje të Frashërit, Sulejmanbellinjtë e Vilakët, kurse dy të tjera nga të katër familjet më të vjetra të fshatit, për të cilat flet kujtesa e breznive, ai nuk i lidh me të riatdhesuarit nga Thraka.

*Sulejmanbellinj e Vilakë,
thonë se janë oxhakë:
ata janë varfanjakë,
gjithë vin' nga Stanimakë.*

Kështu, «oxhakë», — d.m.th. të vjetër mbi të tjetrët në Frashër, zotër të vendit, — gojëdhëna njeh Dakollarët e një fis tjetër, atë të Kasollarëve.

Sidoqoftë, prej legjendës nuk dalim dot e për zanafillën e vërtetë të familjes së Naimit nuk mund të flasim: dokumente gati s'ka, po sidomos kujtime të largëta, të mjegulluara shumë. Pastaj, dyert e Frashërit nuk mbetën pa u përzier midis tyre nëpër motet e largëta.

Sot mund të thuhet me siguri se, në fillim të shek. XVIII, në vitet 1701-3, një Aliçko me qendër në Frashër i shqetësonte shumë pushtuesit aty, si dhe në Tomoricë e në krahinat përqark. U organizuan kundër tij ekspedita, u urdhëruan për ta zhdukur sanxhakët e

Shqipërisë, po nuk dimë që ta kenë zhdukur dhe as thyer. Në këtë kohë, anarkia feudale ka nisur të ndihet në viset skajore të perandorisë. Ajo do të shpjerë në dobësimin edhe më të madh të pushtetit qendror dhe do t'i bëjë aq të pushtetshëm disa bejlerë të vendit, sa ata të kthehen në zotër të fortë, ndonjëri që synon shkëputjen e plotë nga Turqia, — Ali pashë Tepelena, pas Kurt pashës së bindur të Beratit.

Sot për sot, vetëm që nga pjesa e dytë e shek. XVIII i takojmë ata që janë quajtur, por jo me kaq siguri, paraardhës të drejtpërdrejtë të Naimit. Më 1772 Voskopoja, Shipcka dhe Nikolica «*kanë hyrë në haraç*», — janë bërë timare, — të një Mehmet Mustafa pashë Frashëri. Dera kishte tanimë një pashë, pra nuk ishte cilado, përkundrazi. Pashai nga Frashëri u bë «*spahi i përhershëm i vendit*». Ai pagoi dy timariotë të mëparshëm. — njëri nga Stambolli, tjetri nga Drama, me sa kuptohet të dy turq, — për Voskopojën 27 qesera, përkusurin 16.

Ky Mehmet Mustafa, që nga Frashëri ku e ka selinë, pushtetin e shtrin rretherrotull. Le të vëmë re se i shtie në dorë ato vise pas rrënimit të madh që pësuan tre vjet më parë, kur Voskopoja aq e lulëzuar u bë shkrumb e hi në kohën e anarkisë së madhe që kishte pushtuar vendin. Voskopojarët kishin marrë arratinë tek kishin mundur, në Shqipëri dhe në viset pranë. Ishin degdisur gjer në brigjet danubiane dhe më lart, në Poloni e gjetiu. Disa u vendosën dhe në Frashër. Çfarë mund të gjëzonë Mehmet Mustafai nga pronat që shtiu në dorë, pas atij shkatërrimi? Tani për tani jo gjë të madhe. Sidoqoftë, turqit që i lanë timaret e tyre, në Shqipëri nuk e ndienin veten të sigurt nga bejlerët rivalë vendës, që forcoheshin në kurriz të pushtetit qendror.

Më 1805, në maj, gjatë një udhëtimi nëpër Shqipërinë Jugore, studiuiesi i njojur anglez Ulliam Martin Lik (Leake), në malësitë e Oparit, në fshatin e krishterë e të vogël Lavdar, na thotë se ka gjetur selinë ku qëndronte «*zakonisht*» Shemsedin beu, djali i Mehmet

Mustafa pashë Frashërit; vendi ishte i gjithë «nën autoritetin e Ali pashë Tepelenës». Mehmeti nuk duhej të jetonte, kurse «oxhaku» i tij ishte një nga dyert e dyta ose të treta të jugut shqiptar. Kulmi i pasurimit të kësaj dere ka qenë me Mehmetin. Ali Pasha dihet se ua kufizoi së tepërmi pushtetin ekonomik e politik feudalëve të jugut, edhe në viset malore. Ai nuk u bë vëtëm një autokrat, por edhe çifligari i pjesës më të madhe të pronave të viseve ku sundonte. Aliu kishte lénë kujtime jo të pëlqyera në këto anë, p.sh. në Voskopojë.

Më 1822, pikërisht kur ai prishet, ka vdekur një tjetër djalë i Mehmet Mustafait, Çerçizi. Atë, kodikët e vendit e përmendin për të mirë. Me sa duket, kjo derë e Frashërit pronat e saj mundi t'i gjëzonte, — aq sa mund t'i kishin mbetur, — gjer në kohën kur Tanzimat (1839) do të shpallte zhdukjen e regjimit të spahillëkut e të timareve.

Nga kjo derë, në fillim të shek. XIX, është folur për një Abdulla Hysni ose Dule, që është marrë për djalë i Shemsedin beut, të cilin e pamë në Lavdar.

Gjer këtu kemi gjetur të tre emrat e të tre vëllezërve më të njohur Frashëri: Mehmet (Naimi quhej Mehmet Naim), Shemsedin (ai quhej Shemsedin Samiu), Abdul (që firmonte dhe Abdyll Hysni). Ky mund të ishte një argument për t'ua ndërtuar gjeneologjinë që nga Mehmet pasha.

Po, nga disa shënimë familjare të Vëllezërve Frashëri, marrim vesh, tanë së fundi se ata rrjedhin nga një Dako (Sejfullah?) i shek. XVIII, djalë i një Begiri, me sa duket spahinj. Dakoja, që i dha emrin fisit, iu nënshtrua Ali pashë Tepelenës dhe jetoi disa vjet me familjen në Janinë. Atje i lindën Halidi (1797), babai i vëllezërve të famshëm dhe Muhtari (1800). Nuk sigurohem që Dakollarët të kenë të bëjnë me Mehmet pashën, që përmendëm. Dimë se djemtë e Dakos shërbyen «me harxhe», me rrogë — «sergjede», komandanjtë të trupave të vogla, që e fitonin ashtu jetën.

Shënimet e përmendura nuk flasin për Mehmet

Mustafanië dhe pasardhësit që njoën prej tij dhe kaq dimë ne gjer më sot për paraardhësit e familjes së poetit dhe për disa frashërinj midis shek. XVI-XVIII.

Naimi do të lindte në një qendër bejlerësh dhe në një shtëpi bejlerësh të rënë nga vakti, në një vend malor me tradita të vjetra qëndrese kundër pushtuesve, midis një populli blegtorësh të varfér, si dhe pranë një teqeje, e cila babanë e parë e kishte pasur edhe vjershëtor.

Halid Frashëri dhe familja e tij e madhe

Për të atin e Naimit është supozuar një fotografi, por që nuk mund të jetë e sigurt. E shohim midis personash të tjerë në rrugën e një qyteti, ulur përpëra një porte. Midis tyre është dhe Naimi, në këmbë, po gjithë ai djalë, burrë. Qyteti mundet të jetë Janina, kurse Naimi nuک ishte më shumë se 13 vjeç kur i vdiq i ati.

Ngajeta e Halidit, gojëdhëna tregon se ai mori pjesë «me harxhe» në rrethimin e Ali Pashës në Janinë më 1821-22. Halidi ishte një nga bejlerët e pakënaqur prej kryefeuadalit të jugut shqiptar. Ai thuhet se mori pjesë edhe në fushatën e Greqisë gjatë kohës së revolucionit. Nën komandën e Mehmet Reshid pashës, — që do të njihej më pas si zbatues me të përdhunë i Tanzimatit në Shqipëri, — Halidi ka mbrojtur Athinën të sulmuar nga kryengritësit dhe është plagosur.

Samiu tregon se i ati bashkë me të nipërit e përkrahu zbatimin e reformave në Shqipëri, gjë që nuk del shumë e qartë, se bejlerët, si klasë, qenë përgjithësisht kundër. Por ai ishte i varfëruar, reformat s'i merrnin asgjë, dhe mund të shpresonte që t'i jepnin diçka, sepse do të bëhej sipërmarrës taksash të shtetit, që ato vendosën. Nga ana tjetër, osmanët angazhonin ende trupa të parregullta e thuhet se Halidi u gjend në një fushatë në Tesali në 1854. Këtë radhë ai kishte marrë me vete dhe djalin më të madh, Abdylin, tani i zoti i pushkës, 15 vjeç.

Familja kuptohet se gjendej në ngushticë jetese. Ish-te hera e fundit që Halidi shkoi «me harxhe» dhe për Abdylin nuk thuhet të ketë vajtur herë tjetër. Babai tanë ishte në moshë të thyer, mjeshtëria e luftës iu bë e pamundshme. Ai e mbajti familjen si dhjetar e xhelepcë. Taksat duhej të sillnin njëfarë të ardhure në viset blegtore të Dangëllisë e të krahinave pranë.

Halidi vdiq më 1860 (japin dhe datat 1858 dhe 59), në Janinë, ku ai ishte vendosur që më 1887 me djalin e madh Abdylin, dhe ku merreshin sidomos me tregti. Të bijtë i la, mund të thuhet, në varfëri, me Abdylin që ishte në moshë të fitonte jetën, dhe me Sherifin 17 vjeç. Për Naimin treguan. Samiu ishte vetëm 10 vjeç e të tjerët foshnje.

Familja e varfëruar e Halid Frashërit përpiquej ta ruante, sidoqoftë, sérën e saj në Dangëlli e pérreth. Halidi kishte marrë grua në shtëpinë e Mirahorëve të Korçës, të njohur si timariotë që në shek. XV, po që tanë ishin më shumë nëpunës dhe llagapin e kishin Myteveli. Emineja, e shoqja, — kjo ishte e dyta, më parë Halidi kishte pasur një grua që nuk i dha fëmijë, kishte lindur më 1814, po nuk dimë kur u martua në Frashër. Vdiq vetëm dy vjet pas të shoqit, pra 48 vjeç. Fëmijët e shumtë që bëri, ia rrënuan shëndetin. Mos pësoi nga tuberkulozi, një sëmundje që do të rrëmbente më pas më se njërin nga fëmijët e saj, midis të cilëve dhe Naimin?

Ky është qarë me fjalë të ngashëruera për sëmun-

djen që u ishte shtruar në vatër e që i mundoi vëllazërit, — gjashtë, dhe motrat, — dy. Po nuk kuptojmë se e ka fjalën vetëm për tuberkulozin. Ata qenë përgjithësisht shëndetëliq. Abdyli e mbylli jetën 53 vjeç, por atë e hëngrën dhe burgjet e thella të sulltanit dhe syrgjyni; Sherifi 31; Naimi dhe Samiu vdiqën secili 54 vjeç; Tahsini 24. Më shumë jetoi më i vogli, Mehmeti 53 (vdiq 1918); Motrat, Nefize dhe Shenishaja, vdiqën të reja. Kjo e dyta, me sa duket, pati burrë Ibrahim Bërezeshtën, patriot i shquar.

Nuk ishte, pra, vetëm vështirësia ekonomike që nisi ta ndiqte me kohë familjen e Halid Frashërit, por edhe sëmundja. Jeta politike pas së cilës djemtë e tij u dhanë pastaj aq aktivisht, me rreziqet e saj, nën një regjim gjakatar, do të bënte që ata të vuanin, por edhe të mos i kenë parasysh vuajtjet, me një shpirt të admireshem iniciative e therorie, mençurinë që patën, diturinë që fituan. Është thënë se nga i ati fituan guxmin, (në fakt, Dakollarët e kanë çmuar arsimin dhe i quanin «halimë», të shkolluar), kurse nga nëna dëshirën që të marrin shkollë. Kur është fjala për Naimin, ai nga nëna trashëgoi edhe shumë butësi.

Rinia e Naimit në Frashër

Naimi lindi më 1846 në Frashër, më 25 maj. E éma priste fëmijën e katërt, pas Abdylit, Sherifit dhe një vajze, — i lindën dy djem binjakë. Njéri vdiq pa lindur mirë, tjetrit i vunë emrin «i fuqishmi», — kuptimi arabisht i emrit Naim, — megjithëse gojëdhëna tregon që dhe ky «i fuqishëm» luftoi në djep me vdekjen, ndërsa për shëndetin e tij të mëpastajmë u tha më lart një fjalë.

Jemi në periudhën e zbatimit me forcë nga osmanët të reformave në Shqipëri dhe të kryengritjeve fshatara që kishin përfshirë vendin. Më 1847 do të plaste në Labëri dhe Mallakastër kryengritja e madhe, së cilës i prinë Gjoleka me Rrapo Hekalin. Krisma e saj u ndie që nga Shkumbini në Çamëri. Naimi i çeli sytë në flakën e kryengritjeve dhe nuk dëgjoi vetëm ninullat e nënës Emine, por edhe vringëllimat e shpatave dhe krismat e dograve, dhe këngët trimërishte në djep.

Një muaj përpëra se të lindë Naimi, Veqilharxhi ka lëshuar «Qarkoren». Librat e tij ngjallin zell të madh që nga Korça gjer në Berat, për shkrimin e shqipes me një palë shkronja që janë *vetëm* të shqipes, për të treguar se kjo është një gjuhë më vete, që dallohet mirë nga të tjerat, që duhet të krijojë kulturën e saj të re, në ndeshje me disa kultura të tjera.

Edhe në Frashër vetë, shkrimi i shqipes kishte bërrë sadokudo përpëra. Një Tahir Nasibi Skënderasi, që përmendëm, i formuar si bektashi në Persi, kishte çelur një teqe në qytetin e tij të vogël (1815). Ai ishte përkrahës i Aliut të Tepelenës, pra dhe i përpjekjeve të këtij për t'u bërë zot më vete. Vdiq më 1834. Gjuhën Tahiri e shkruante me gërmat arabe, por e shkruante ashtu siç flitej, jo të ngarkuar nga barbarizmat me të cilat e kishin mbytur e do ta mbytnin shumë bejtexhinj.

Kishte, me sa vërtetohet, një rrymë ndër disa prej tyre, që nuk deshën ta përzienin shumë shqipen me orientalizma: këtë e diktojmë të paktën që nga berasi Sulejman Naibi; do ta njohim edhe ndër të tjerë më vonë, p.sh. më 1861, me shkodranin Daut Boriçi, i cili u afroa shumë me lëvizjen politike të Rilindjes. Pastaj, ndryshe nga shumë bejtexhinj erotikë dhe anakeontikë, po tanimë edhe të temave fetare, pa harruar temat e ditës, Tahir Nasibiu ka lënë kujtimin e një satiristi. Këtë vazhdë e kishte çelur në Berat Nezimi dhe e shpuri më tej kolonjari Hasan Zyko. Tahiri duket se u mor më shumë me një satirë mbi tema lokale, p.sh. për të thumbuar «dyert» e Frashërit e për të vënë më lojë prepotencën e ndonjërës prej tyre. Po nga bejtjet e Tahirit na ka mbetur vetëm një numër i vogël fare strofash, si njëra që përmendëm. Ai ndoqi Hasan Zykon, shumë populor në ato anë.

Me vjershërimet e tij, Tahiri pati meritën që krijojë Frashër një traditë. Dy Kasollarë, vëllezërit Dalip dhe Shahin Frashëri, përshtatën shqip dy poema të gjata fetare: i pari «Hadikanë» e lirikut osman të shek. XVI Fuzuli Bagdadiu, që e kishte shkruar në prozë e vjer-

shë pérzier, po që Dalipi e shpuri gjer mbi 50 mijë vargje (poema më e gjatë e shkruar ndonjëherë shqip); ajo datohet më 1842 nga Konica, ku Dalipi qe baba bektashi; i dyti «Muhtarnamenë», mbi 7 mijë vargje kjo, nga një tjetër poet i hershëm osman; Shahini e mbaroi së shqipëruari më 1868. Janë dy vepra që tjerrin historinë e sekit të bektashinjve, pra, vepra edukimi fetar.

Tjetër rrugë mori kështu tematika e bejtexhinjve që në Frashër bënë emër pas Tahirit, kurse gjuhën, të dy vëllezërit fetarë e mbytën shumë më shumë nga c'kishin bërë më parë bejtexhinj të tjerë, edhe Muhamet Kyçyku, p.sh., hoxhë në Çamëri (ai vdiq më 1844). Nga kjo anë, ata nuk ishin treguar praktikë, se, sa mund t'i kuptionin «myhipët» e thjeshtë shkrimet e tyre? Po, sadopak që t'i kuptionin, kjo kthesë tematike dhe kjo mënyrë e propagandimit të fesë në gjuhën amtare kishte të keqen që përhapte jo vetëm një ideologji obskurantiste. — sado opozitar të paraqitej atëherë në Turqi bektashizmi, — duke trazuar keq edhe gjuhën.

S'ka dyshim se Naimi, që i vogël nisi të njihej me këtë lloj letërsie fetare «hibride», të përpinqej të depërtonte në të dhe t'ia arrinte tepër pak. Nga disa vargje fëminishte që na kanë mbetur prej tij, ai e kujton vjershërimin si një lojë rrokjesh e fjalësh onomatopeike pa kuptim. Po kur nis e rritet do të shohim të shkruajë diçka në fryshtë e satirës së lehtë të Nasibiut. Është një vjershë, — e vëtmja që njihet prej krijimtarisë së tij të kohës, — mbi një zënkë me disa kushërinj. Naimi thuhet të ketë qenë rreth 14 vjeç.

Mund të përfundojmë se zelli për të vjershëruar iu zgjua që herët dhe se ai nisi të imitonje bejtexhinjtë, po një bejtexhi me shqipen relativisht të pastër, Baba Tahirin. Ai u familjarizua, me sa mund të bënte atë kohë, edhe me bektashizmin, prej të cilët do të ruante ndikimin dhe që do t'i shkruante dhe vetë historinë, në poemën e gjatë epike të «Qerbelasë» që ka botuar në fund të jetës.

Frashëri, i cili kishte njohur një farë begatje dhe

kishte nisur të merrte pamjen e qytetit, me një pakicë dyqanesh e me ditën e tij të pazarit, tanj kishte mbetur më shumë një qendër bejlerësh, që po shpërnguleshin kush më herët e kush më vonë, me punë të ndryshme shtetërore, disa me poste jo të vogla në Shqipëri. I gjejmë sidomos në Korçë e në Janinë, në viset bregdetare, nga Vlora në Prevezë e më tej, në Tesali, në Stamboll, po dhe më larg. Një pjesë e mirë nuk e harrjon Frashërin, ku kanë farefis, pra venë dhe vijnë.

Që në gjysmën e parë të shekullit, në Frashër kishte dy shkolla, një turqishte dhe një greqishte, sipas besimeve fetare të banorëve. Naimi vajti sigurisht në të parën, ku mësohej «ezber», — përmendësh, «Kurani», po ku jepeshin edhe pak njojhuri të aritmetikës apo të historisë, mësohej gjuha turke e shtetit dhe ajo arabe e fesë. Bejlerët e Frashërit, tregon Samiu, e kishin pasur zakon të mbanin mësues në shtëpi përfëmijët. Kështu vepruan Vëllezërit Frashëri edhe më vonë në Stamboll përfëmijët e tyre, p.sh. përt'u mësuar frëngjishten. Me një mësues hoxhë Naimi duket të ketë nisur të njihej me persishten.

Sa vend zunë tek ai mësimet në fshatin e lindjes, ku u bë 19 vjeç? Frashëri mbeti përtë një rrëth i mbyllur kulture elementare. Vërtet aty venin e vinin njerëz nga të katër anët, — vendës nga kurbetet e ndryshme, udhëtarë që gjenin strehë në shtëpinë mikpritëse të Dokollarëve, farefis e krushq që shtëpia kishte edhe jashtë fshatit, siç pamë se kishte në Korçë. Pra, vendi ishte i veçuar, por aspak i izoluar.

Sidoqoftë, Frashëri i rinisë së Naimit mund të përmendej më shumë për veçimin e tij dhe për braktisjen që po pësonte. Dhe fakti që Naimi aty i kaloi të dy dhjetëvjeçarët e parë të jetës, tregon edhe se në rini ai pak kulturë mundi të merrte, — një kulturë përgjithësisht orientale e me përbajtje mistike. Dhe nëse nisi të thurte vjersha, kjo që përtë riun më shumë një «englenxhe», se sa një shqetësim serioz, ndërsa ai do të bëhej më pas kryepoeti i Shqipërisë. Dicka e ngacmon-

te të luante me fjalët dhe kështu ushtrimi me vargjet e familjarizoi që të ri në mjeshtërinë e vjershërimit.

E marrim me mend të ketë qenë admirues i këngëve dhe i zakoneve të vendit, mik i lojnavë fshatara-ke dhe i festave, që prej tyre të ketë mësuar shumë. Kjo ishte një pasuri e madhe, që ai e vuri në moshën e re, në mënyrë të vetvetishme, dhe që do t'i shërbente shumë.

Naimit të ri, Frashëri i mësoi dy gjëra mbi të tjera: së pari, të nijitet me jetën, një jetë e ashpër dhe e varfër; së dyti, të dashurohet me natyrën.

Jeta nuk ishte bërë e vështirë vetëm për familjen e Halidit, por edhe për dyer të tjera të para të vendit. Frashëri ishte i banuar përgjithësisht prej një populësie të varfër, të cilën e mbante sidomos bagëtia. Abdyli çallëstiste sa mundte, gjer në Janinë; kështu edhe Sherifi. Naimi nuk dimë të jetë marrë me ndonjë në-punësi a gjë tjetër. Në një nga letrat e tij të viteve 70, Samiu do të shkruajë se njeriu në Turqinë e kohës sigurinë më të madhe të jetesës e ka te nëpunësia. Kuptohet, për ata që s'kanë toka, si nuk trashëgoi familja e Naimit, apo trashëgoi ndonjë gjë krejt të paktë. Përpara se familjen ta shpërngulte Abdyli e ta vendoste në Janinë më 1865, jeta e saj duhet të ketë qenë bërë me të vërtetë problematike dhe babai kishte 5 vjet që kishte vdekur.

Naimi, natyrë disi e myllur, rritej e meditonte mbi jetën. Ka qenë një meditim që, sigurisht, e çoi në përfundimin se tani «u dashka dituri», — të kesh shkollë. Po vuajtjet shoqërohen me pikëpyetje. Pastaj, një perandori që ka zënë greminën dhe ku padrejtësia e grabitja janë të çdo casti e të çdo mase, ku shtypja kombëtare është e madhe, të fut në shqetësim jo të zakonshme, të bën ta urresh. Jeta duhej ndryshuar. Gjer ku e shpuri këtë përfundim Naimi në moshën e tij të rinisë në Frashër?

Poet i lindur, ai kishte një karakter thellësisht meditativ. Bukuritë e vendit e bënин përvete, — viset vigane që e rrëthonin, Tomori kundruall, Kokojka mbi

krye, Qelqëza mbi Vilë. Jeta e tufave ishte një pjesë e peizazhit të përditshëm në lëvizje dhe e bisedës së përditshme. E kaluara gojëdhanore e vendit, me trimëritë e ushtarakëve, me tragjeditë e hasmërive dhe të kurbeteve, me ndërkyrjet kundër pushtetit qendror, ja me çfarë mund të ushqehet një shpirt shumë i ndjeshëm. Domosdo që dhe feja bënte punën e saj dhe e conte të riun të vrasë mendjen për gjithësinë. Bektashizmi ishte një dogmë e ndryshme nga ato të zakonshmet, posa ishte një besim panteistik. Ai, si të thuash, «she-njtéronte» edhe gurin e drurin, ndërsa njeriun e bënnte «seli të perëndisë». Perëndia është kudo, po «fron ka zemrën tënë», ka për të shkruar poeti.

Atë përgjërim për njeriun, atë humanizëm të përgjithshëm që do të përbajë poezia e Naimit, këtij ia kanë ushqyer që në rini rrojtja pranë njerëzve të varfër. Atë si ndjenjë të fortë kozmike, që shfaqet në mahnitjet e Naimit përpara gjithësisë dhe dukurive të saj, dashurinë e tij të thellë për natyrën, e imagjinojmë se si nis e mbruhet në atë vorbull të madhe dherash, — malesh e greminash, pyjesh e djerrinash, — që ishte Frashëri, dhe në atë vend blegtor. Bariu ka punë me yjet. Kemi përmendur lajthishtën poshtë, Bredhat e Hotovës lart, që e tërhoiqnin fort të riun, dhe gérxhet. Tani ai u bë gati burrë. Librat që lexon janë të paktë në Frashëri. Vjershët që thur, a i regjistron? Dimë se më pas ai ka qenë një gjahtar i prapë. Këtë pasion e mori në fshat, dhe pasioni i gjahut e lidhi edhe më intimisht me natyrën.

Është vënë re se në Frashëri Naimi pati mundësi të njihte më së një gjuhë. Nuk duhet tepruar. Shkolla jepet fare pak e zor se u familjarizua me osmanishten. Sa persisht arriti të kapte? Sa arabisht? Ai ishte mendjemprehtë, po nuk është lehtë të hysh në gjuhë si ato. Që persishtja ta ketë têrhequr veçanërisht me poezinë e saj dhe mistikën të afërt me atë bektashiane, ajo më shumë i njomi buzën se i shoi etjen. Nuk dimë që Naimi të shkruante persisht që në Frashëri dhe s'na duket e mundur. Më 1871, kur boton një gramatikë të

persishtes, — libri i tij i parë, — «*sipas metodës së re*», cila qe kjo metodë? Me sa duket perëndimore. Ai është 25 vjeç dhe, që e ka marrë atë guxim, nuk do të thotë se njohjen e persishtes e ka shpënë sa duhet përpara që në fshat.

A mundi ta njihte këtu sadopak edhe greqishten? Bëjlerët e jugut letërķembimin e përgjithësisht shkresat jozyrtare nuk i mbanin vetëm turqisht, por edhe greqisht. Ishte një traditë e moçme në jug. Madje, na kanë arritur tekste të «Hadikasë» e të «Muhtarnamesë» të regjistruar me germat greke. Po s'ka ndonjë të dhënë që të ketë nisur ta mësonte Naimi greqishten që në Frashër, ku në shkollën përkatëse nuk vajti.

Në fshat kishte nja dy lagje blegtoresh vllehä. Naimi mund e duhet të jetë shoqëruar edhe me ta, ai mik i bagëtisë. Mund të ketë mësuar disa fjalë nga e folmja e tyre, por aq.

Frashëri, që e burrnoi, i zhvilloi shpirtin meditues, prirjen për poezinë, e bëri të njohë jetën e mundimshme të njerëzve, fisnikérinë dhe karakterin e fortë të tyre, të gëzojë bukuritë e natyrës dhe të qenieve të gjalla. Me kulturën e re s'kemi ndonjë të dhënë që të jetë afruar; me këtë do të njihet në Janinë.

Njohja me kulturën perëndimore

Janina, ku u vendos familja e Vellezérve Frashëri (1865), pati qenë kryeqyteti i shtetit të Ali Pashës (1788-1822), që emrin ia thoshin Shqipëri, — në dokumentet që na kanë mbetur nga kancelaria e autokratit dhe në librat e shumtë që u shkruan për karrierën e bujshme të tij nga evropianë të ndryshëm, si Pukëvil, Lik, Hjus, Hobhauz etj. Janina është bërë taninjë qendër edhe më e zhvilluar e kulturës greke, se ç'pati qenë përpëra, dhe shqiptarët kanë filluar ta humbin aty epërsinë që kishin dikur, ndonëse sundojnë ende. Bejlerë shqiptarë ka shumë aty, pronarë, nëpunës, ushtarakë etj. Janina është qendër vilajeti. Ka edhe një popullsi zanatgjinjsh të ndryshëm. Shqiptarët, p.sh., ishin të dëgjuar si ndërtues, — muratorë e arkitektë, në gjithë perandorinë. Ka edhe një vegjeli tjetër shqiptare, aty e në rrethinat, qytetarë e fshatarë. Po tregtinë, si dhe më përpëra, e kanë në dorë grekët dhe tregtia, sidoqë nuk është në gjendjen e lulëzimit që ajo njoju me Ali Pashën, nuk shkon keq. Disa bejlerë kanë nisur t'ia

ndiejnë dhe ata lezeti. Ka dhe tregtarë të krishterë shqiptarë.

Kultura osmane e përgjithësisht orientale nuk kishte mundur asnjëherë në atë qytet t'i mbivihej vërtet kulturës greko-bizantine. Traditat e shkollave të Janinës në shek. XVIII e në fillim të shek. XIX, ato të Ballanos e Psalidhës, shkolla që ishin bërë të dëgjuara në Ballkan, në Janinë i kishte shpënë më përpara, tanimë prej disa dhjetëvjeçarësh, një gjimnaz i ri me emrin e themeluesve të vet, pasanikë në Rusinë cariste, Zosimeajt. Në këtë gjimnaz nuk rridhte vetëm rinia greke apo e krishterë shqiptare, po kishte filluar të dukej edhe rinia shqiptare myslimanë. Kjo nuk ka ngjarë së pari me Vëllezërit Frashëri. Ismail Qemali mësoi në «Zosimea» përpëra tyre. Idetë liberale, që po depërtonin në disa dyer bejlerësh të Shqipërisë, admirimi për zhvillimin e Evropës, reformat, të cilat sadokudo ndikuau për një fillim të ri kulturor brenda perandorisë dhe që sollën në arsimin turk pak erë evropiane, me krijimin edhe të arsimit të lartë (rektor i parë ishte shqiptari Hasan Tahsini), me jehonën e iluminizmit borgjez, tani edhe të letërsive të sentimentalizmit e të romantizmit, të gjitha këto bënë që njerëz të ndryshëm. edhe nga klasa feudale sunduese, të mendojnë në Shqipëri për të fituar kulturë moderne.

Familja e Halid Frashërit, nga e kaluara, kishte trashëguar vetëm titullin «bej», kujtimin se pati qenë dikur jo si cdo «derë». Ajo shihte tani me ankth të tashmen dhe sidomos përpjoei për një të ardhme të sigurtë. Ishte një familje hallexhie. Me një nëpunësi të vogël, Abdyli, — një si llogaritar a diçka tietër në ndonjë zyrë. — luante pak edhe tregtinë. Fëmijët e Halidit mbaheshin me bukë, po me bulmet pak. Naimi ishte 19 dhe Samiu 15 vjeç. Në mos të dy, më i madhi mund të siguronte ndonjë të ardhur, kurse për t'u ulur në bangat e para të gjimnazit, ata ishin tanimë të rritur. Po mendjegjieri Abdyl vendosi që të regjistrohen në «Zosimea», të marrin kulturë të re, le t'i duheshin sakrifica jo të vogla shtëpisë. Dhe të dy vëllezërit nuk

ngurruan. Paragjykimet fetare që kishte në shkollën greke, mbi ta nuk bënин efekt, — ata ishin «liberalë» nga kjo anë. Studiuan e mësuан shumë. Ishin ndër nxënësit e dalluar të shkollës, të dy në të njëjtën klasë, sado me një ndryshim të madh moshe.

Një fotografi e kohës, Naimin na e paraqet si një djalë shtathedhur, mjaft ezmer, me syun kundrues që do t'i njobhim pérherë, por edhe me një forcë të vëçantë vështrimi, që flet pér vullnet në radhë të parë e pér besim në mundësitetë jo të zakonshme të tij dhe të të vëllezërve.

Përpara se Naimi të mësonte në «Zosimea», aty kishte qenë drejtor një filolog i njobur grek pér kohën, Saqellari. Ndofta ishte ai i viteve 40, kur në gjimnaz mësuан Vretoja e Kristoforidhi. Tani drejton një matematikan, Manari. Në shkollat e Janinës, që në periudhën e sundimit të Ali Pashës, shkencat e quajtura «ekzakte», patën qenë çmuar, ndonëse, si atëherë, si dhe tani, ishin studimet klasike, ato të gjuhëve dhe letërsive të lashta në radhë të parë, që zinin kryet e vendit. Po vendi i fizikës e i matematikës kishte vajtur duke u rritur. Laboratori i fizikës vajti duke u pasuruar, biblioteka duke u shtuar me letërsi gjithfarësh, edhe nga këto shkenca edhe të tjerat e afërme. Zbulimet e reja shkencore pasiononin mësues e nxënës. Emrat e Galileut, Kopernikut, Njutonit ishin të adhuruar.

Po t'u hedhim një sy programeve të «Zosimesë» në gjysmë-shekullin 1828-78, do të shohim se ato përbanin letërsitë greko-latine, teologjinë (të ortodoksizmit), filozofinë, historinë, matematikën, fizikën, frëngjishten e italishten, që në vitin e parë. Dy vjet përpëra se të vinin aty Naîmi me Samiun, numri i mësuesve ishte shtuar gjer në 10, duke u shtuar dhe disa lëndë: gjuha turke, fiziologjia, kimia, vizatimi. Ishte një plotësim me të vërtetë shumë i përfitueshëm, le të përpinqeshin sun-dësít që, më anën e gjuhës së tyre, të futnin një këmbë nö gjimnaz. Gjimnazi kishte adaptuar programet zyr-tare të shkollave të shtetit helen dhe këto programe, më 1867. i dimë nö mënyrë të hollësishme.

Që në klasën e parë, nxënësit nuk duhej të njiheshin vetëm përmes antologjive me autorët e mëdhenj të lashtësisë, por edhe përmes disa veprave të tyre. Greqishtja bëhej 12 orë në javë, latiniشتja 4 orë e gjysmë. Kaq zinte dhe arimetika me gjeometrinë, ndërsa historia 3, frëngjishtja po kaq, katekizmi 2. Pra dhe nuk teprohej me mësimin e fesë, ndonëse botëkuptimi fetar ndihej në tërë atmosferën. Autorët që studioheshin më ngultas, domosdo që nisnin me Homerin e Herodotin, Platonin e Sofokliun, Virgjinin e Ciceronin, Horacin etj. Historianët antikë, bazë e formimit humanist, zinin një vend të dukshëm pranë poetëve dhe dramaturgëve. Kur vinte puna te një gjuhë si frëngjishtja, në ballë ishin oratorët fetarë të shek. XVII-XVIII, por dhe dramaturgë të rrymës klasike si Kornej e Rasin. La Fonteni duhej të zinte mirë vend nëpër antologjitet. Për Molierin nuk dimë, ai ishte një autor shumë guximtar. Nuk dimë as pér Volter e Rusionë, dy autorë këta, ndaj të cilëve Naimi do të shprehë më pas një admirim të veçantë. Po këta përpihezhen në të fshehtë, se patën përgatitur Revolucionin Demokratiko-Borgjez të Francës, pér të cilin të rinjtë tanë entuziazmoheshin. Frëngjishtja si gjuhë nuk çelte vetëm rrugën e klasicizmit: ajo, atë kohë, i çelte rrugën sidomos iluminizmit e antidogmës së shek. XVIII, pa harruar dhe krijimtarinë aktuale të Hygoje me shokë. Italishtja mund të të zbulonte humanizmin modern.

Historia studiohej në tërë periudhat e saj që nga lashtësia e gjer te krijimi i shtetit të ri helen. Nuk ishte vetëm studimi i klasikëve që bënte punën e tij pér të zhvilluar te nxënësit ndjenjat patriotike dhe krenarinë kombëtare të helenëve, por edhe historia moderne. Si reagonin kundrejt këtyre të rinjtë?

Të dy vëllezërit Frashëri ishin tanimë në moshë që të nxirrnin konkluzione atdhedashurie shqiptare, mburjeje pér heronjtë shqiptarë në Revolucionin Grek, krenarie pér lashtësinë e kombit tonë, të gjuhës dhe të kulturës së tij, por edhe të nisnin të mendonin se di-

sa gjëra duhej doemos të ndryshonin për Shqipërinë. Me xhahillëkun e hoxhallarëve më s'mund të shkohej. Të rintjtë e ushqenin mendjen e zemrën me idetë dhe idealet kombëtare dhe njerëzore në shkollë, sidomos që dhe shovinizmi në monarkinë fqinjë, megalideja, kishët lindur me kohë dhe ishte bërë kërcënues për vendin tonë. Oshëtima e përpjekjeve që bëheshin nga të mërguarit tanë në Rumani e në Stamboll, apo dhe tek arbëreshët, arrinte në Janinë dhe perpjekjet që kishin nisur të ndjeheshin ndër shqiptarë pér kulturën amtare kishin atje jehonën e tyre. Ato ishin aty të vjetra që nga koha e Ali Pashës, që rronte në kujtimet e hakërruara të shqiptarëve me qëndresën e tij të bujshme antiosmane, me përpjekjet e tij pér t'u çliruar nga Turqia e pér të krijuar një shtet të madh të shqiptarëve. Duhet menduar se ideja patriotike bënte punën e saj së thelli në të rintjtë shqiptarë.

Mund të pyesim se a shkruanin ata shqip, a kishin nisur? Për fat të keq, nuk jemi të informuar. Po përpara tyre në «Zosimea» ishte formuar Kristoforidhi, që i dha mësimë shqip Hahnit, dhe përpara tij në Janinë kishte punuar pér shqipen Evstrat Vithkuqari (para vitit 1814). Atë kohë në jug ishte shqip veçanërisht Vangjel Meksi me përkthimin e «Dhjatës së Re», që e kishte redaktuar Grigor Gjirokastriti dhe e kishte botuar në Korfuzin pranë (1824-27). Ajo bëri bujë. Veprat fetare të Kristoforidhit e të këtyre dy të fundit nuk ishin të tillë që të mos duan t'i shifletojnë djem me ndjenja tolerente fetare si të rintjtë Frashëri. Dëshmitë e kohës tregojnë se ato vepra gjëzonin simpati edhe ndër myslimanët patriotë, pikërisht sepse ishin shkruar shqip. Dhe të mos harrojmë asnjëherë se Abdyli nuk ishte vetëm një vëlla i madh, por edhe një mendje e ndritur, që jetonte shumë si me aktualitetin politik, ashtu dhe me atë kulturor, doemos shqiptar së pari.

Sa për shkencat e natyrës, le të shënojmë faktin se Naimi u bë një admirues i pasionuar e i vendosur i tyre dhe më pastaj propaganduesi i tyre kryesor ndër rilindësit, me librat shkollorë që botoi. Dihet se ai pra-

noi pa rezerva gjer darvinizmin. Samiu u bë enciklopedisti që dimë, një ndër më kryesorët në Ballkan dhe një nga nismëtarët e gjuhësisë e të letërsisë moderne turke.

Është thënë se në Janinë Naimi u thellua në gjuhën persiane. Kjo del e saktë dhe provën e kemi si te gramatika, për të cilën kemi folur, si te vjersha e tij e parë persishte e datuar që i njohim më 1873. Po nuk dimë kur ai mund t'ia ketë hyrë këtij vjershërimi që, me sa duket, e gllabëroi dhe duket se e largoi nga bejetet shqipe të rinisë së parë. Gjuhë mjeshtërore e poeziës, për njerëzit e Lindjes dhe për ata që njihnin letërsinë lindore, ishte persishtja. Bejtexhijtë që Naimi pati lexuar nuk ishin gjë përpara Firdusive dhe Rumive. Poezia osmane ishte dhe ajo nën ndikimin e madh persian. Letërsia moderne turke, që kishte lindur me Tanzimatin, nuk ishte imponuar. Sa arrinte ajo të njihej në skajet e perandorisë, sa ndihej në një qytet si Janina? Völlezërit Frashëri a ishin në kontakt me të në vitet 60? Ky kontakt është i sigurt në vitet 70 për Samiun e Tahsinin, për Naimin nuk jemi të informuar, po, larg Stambollit, për të mund të mos ketë qenë njësoj: ai duhet të ketë qenë më pak i njojur me çka niste e re në letërsinë turke.

Është thënë vazhdimi i se Naimi dhe Samiu bënë pesë vjet në «Zosimea» dhe se gjimnazin e mbaruan më 1868, kur, më 14 korrik, datohej diploma e Samiut. Nga kjo del e saktë se gjimnazi ishte katervjeçar. Mund të thuhet se Naimi dhe Samiu, pasi mbaruan studimet në Janinë, u morën aty me ndonjë punë përpara se të venë më 1871 në krveqytetin turk. I nipi pohon se Naimi bëri në Stamboll tetë muaj më 1871, dhe dokumentohet se ai atje ishte e pakta që përpara prillit të atij viti, kur ka firmuar librin e tij të parë si «nëpunës në Drejtorenë e Shtypit». Po le t'i shohim në një kapitull më vete vitet shtatëdhjetë në jetën e poetit.

Naimi në vitet 70

Vitet 70, për Vëllezërit Frashëri, qenë vite të një veprimtarie shumë të dendur e vendimtare. Qenë vitet kur ata filluan të luanin rolin e tvre në historinë e Shqipërisë të tre dhjetëvjeçarëve të fundit të shek. XIX. Ato qenë edhe vite pasigurie në jetë si edhe dhëmbkash të rënda familjare.

Samiu përpiquej të çante në Stamboll në gazetarinë. letërsinë dhe shkencën turke. Të njëjtën gjë bënte Tah-sini në kryeqytet, madje dhe në Egjipt. Abdyli qëndron-te në Janinë, me një nëpunësi që nuk e kënaqte, në zyrat e vilajetit; ai rronte nga larg edhe me telashet e të vëllezërve, i këshillonte dhe këshillohej me ta, u jepte zemër për nismat e tyre. Naimi vendoset në Stamboll, po detyrohet ta lérë punën pa mbaruar viti, se iu shfaq sëmundja e mushkërive dhe ai mori udhën e atdheut për klimë të mirë; pra, u rikthyen në Frashërin malor, po për një kohë të shkurtër.

Të gjithë ëndërronin që të bashkoheshin një ditë. që të ishte sa më e afërt, dhe të bashkoheshin në krye-

qytetin e perandorisë. Ata jo vetëm i diqte malli që të jetonin përséri pranë e pranë, por edhe e ndienin mirë se ashtu do të ishin një forcë e plotë e do të çanin pérpara më shpejt, siç e meritonin, dhe kishin besim se mund të bënин punë të mëdha.

Me sa duket, kur e ndjeu veten pak më mirë me shëndet, Naimi u vendos një mot a dy në Berat si në-punës i vogël të dhjetash. Më 1874-76 është thënë se ka qenë drejtor i doganës në Sarandë. Por aty e gjejmë, me siguri, edhe më 1877, në mos dhe më vonë.

Është çasti kur ai nis të vuajë keq nga shijatiku, që e detyron të shkojë në llixhat e Badenit të Austrisë. Atje nuk qendroi një kohë të shkurtër, si mund të kujtohet, po rrëth një gjysmë viti: u mjekua seriozisht. Reumatizmin ia shkaktoi pasioni i vjetër i gjahut. Vur-gun gjysmëkënetor duhet ta ketë përshkuar shpesh për një egërsirë e për një shpend. Qëndrimi në Baden është i viteve 1875-76.

Më vonë, në një letërkëmbim midis vëllezërve, — një pakicë letrash që kemi pasur fatin të na arrijnë, — për shëndetin e tij nuk flitet ndonjëherë me shqetësim. Por ai vetë ka një shpërthim të rëndë, se sëmundja është ngulur në familjen e tyre, dhe poeti flet me kaq zemërim kundër mjekësisë e kundër mjekëve, sa nuk përbahet edhe kundër shkencës në përgjithësi. Këtë e bën në një letër që Abdyli i dërgon Samiut në prill 1877 dhe ku poeti shton pak radhë nga fundi. Le të citojmë diçka prej këtyre radhëve, se tërheqin veçanërisht vëmendjen për gjendjen shpirtërore të Naimit në këtë kohë.

Mësojmë se Tahsini nuk është mirë. Abdyli përpipet t'ia paraqitë sëmundjen si një gië jo alarmuese Samiut në Stamboll. Tahsini ka «*ethe të vogla në mbrëmje*» dhe «*pak kollë*», po nuk është «*për t'u bërë merak*». Naimi, përkundrazi, parasheh të zezën, dhe gati sa s'e thotë shprehimisht. Samiu punon tepër, sipas tij, lo-dhet pa masë: ai duhet ta kursejë veten. «*Cdo punë je duke e bërë në mënyrë të shkëlqyer, — gëzohet Naimi, — paske nxjerrë (edhe) gazetë*», — është fjala për

gazetën e parë që Samiu ka drejtuar, «Sabah». I vëllai e këshillon: «*Merr një ndihmës me rrogë, se pérndryshe do të bëhesh armiku i trupit tënd (...)* *Tahsini është i sëmurë*», — letra është shkruar në Janinë; — «*qetësia ime është prishur. Po në dashtë djalli, shqetësimi do të largohet. Kërkoj ndihmë nga djalli, sepse besoj se djalli ekziston, pérndryshe... nuk ekziston.*» Të tria pikat këtu janë të Naimit dhe duhen zëvendësuar me fjalën «perëndi».

Kjo lidhje midis të dy parimeve, të së keqes e të së mirës, është më shumë se një shprehje dialektike: është një protestë kundër hyjnisi, që mbyll sytë ndaj qenieve të mira. Atë do ta giejmë dhe në vjershat persishtë të poetit, në vitet 70. Më saktë, pra. «*të shpresojmë më shumë të djalli se te zoti vetë*», kërkon të thotë Naimi. Po, tërthorazi, kemi protestën kundër shoqërisë së kohës, që shpërthen në mënyrën e vet më poshtë: «*Ju shikoni shëndetin, shikoni shëndetin. Trupat tanë janë të shkatërruar, të shkatërruar, të shkatërruar. Duhet t'i ruajmë me kujdes. E kupton... Mallkuar qoftë mjekësia! Edhe mjekët qofshin mallkuar! Edhe dituria u zhduk-të me binë! Edhe dijetarët (më fal që po të flas kështu) qofshin mallkuar!*»

Po t'i marrim këto shpërthime siç janë në tekst, do të nxjerrim përfundimin se poetin e ka pllakosur një dëshpërim i thellë që do ta hasim edhe te ndonjë vjershë shqipe e tij, po që prapë s'ka qenë kurrë thelbi i karakterit thellësish optimist dhe i besimit admirues që ai ka pasur ndaj shkencës. Po Sherifi vdiq tuberkuloz para tre vjetësh dhe Tahsini është duke vdekur po nga kjo sëmundje. Ky i mbylli sytë atë vit, kur dimë se edhe Samiu është lëshuar një herë në Janinë e në Frashër. Një vjershë me titull «*Vdekja e vëllait*», e botuar në përbledhien poetike «*Tehajvlat*», — «*Endërrimet*» e Naimit (1885), mban si datë krijimi vitin 1393 të Hexhirit, që i përgjigjet viti 1877.

Tahsini ishte një djalë i zgjuar, që kishte fituar kulturë, që premtonte; ai kishte shumë gjëra të përbashkëta me Samiun, — hedhjen e entuziazmin në punë

në radhë të parë, duke përjashtuar një farë nxitimi dhe naiviteti. Naimi dhe Samiu e çmonin shumë. Naimi vetë s'e ka shëndetin të stabilizuar. Po, sigurisht, nuk duhet të qëndrojmë vetëm te këto çështje dhe në hallet e përgjithshme të familjes së shpérndarë.

Jemi në prag të Luftës Russo-Turke. Sulltan Hamidi u detyrua të japë kushtetutën (dhjetor 1876), po në shtetin tanimë «kushtetues» osman, a thua se ka ndryshuar ndonjë gjë? Abdyli, që është zgjedhur deputet i vilajetit të Janinës, dhe luan role të ndjeshme politike, veçanërisht për çështjen shqiptare, Samiu që në Stamboll e njeh jetën politike mirë dhe merret aty shumë aktivisht edhe ai me çështjen shqiptare, e shohin se nuk ka ndryshuar asgjë në të vërtetë, përveç faktit që Turqia është duke thyer gërmicën. Shqiptarët janë krejt të ndërgjegjshëm se shovinistët përreth bëhen gati të zhvatin nga tokat e tyre. Ky shqetësim i rëndë nuk konkretizohet në letrën e përmendur të Naimit me ndonjë gjë ngajeta politike. Ai flet vetëm për jetën familjare. Poeti nuk shihet të jetë hedhur ende në një veprimitari politike të përcaktuar. Por ankthin e përgjithshëm e jeton, ndonëse shpërthimet i ka në atë që e prek nga më pranë, — te familja, te shëndeti. Veprimitaria e madhe e Samiut i ngjall gjëzim, sado që e shqetëson, dhe Samiu, që premton shumë për të ardhmen, nuk duhet ta pësojë si Sherifi e si Tahsini! Naimi ato fjalë i thotë dhe përvete, dhe për Abdylin, kur qahet se në trup janë «të shkatërruar».

Të mos nxitohemi të nxjerrim më shumë nga një letër si kjo. Naimi ka mbetur poeti i tërhequr në vevete, ai i «ëndërrimeve»: kënaqet me bukuritë e natyrës, e trondit e keqja në jetë, nuk është i dëshpëruar për të ardhmen, po nuk sheh dhe qartë në të. Shkencën e ka admiruar dhe e admiron, po shkenca nuk e kënaq kurdo, se ka mbetur pas, të paktën në disa degë, si në mjekësi. Poeti sheh se pranë parimit të së mirës, ai i së keqes është i thellë dhe, nga kjo anë, realiteti shoqëror nuk e gënjen, — përkundrazi, ai vërteton të keqen. Naimi s'është ende poeti i lëvizjes kombëtare, po shpresën e ka në zemër për Shqipërinë. Atë e ka ndier

fort në Vjenë, kur pak vjet përpara vajti dhe admiroi armët e Heroit të madh Kombëtar, siç e dëshmon vetë në vargjet e poemës «Parajsa», që citohen shpesh:

*«Lum ti, moj Shqipëri!» thashë,
armët e tij kur i pashë
në Belvedere, në Vjenë, —
sikur pashë Skënderbenë.*



Le të rikthehem i te letrat për të cilat folëm, te disa elemente që ato mund të na japid qoftë për jetën e Naimit vetë, qoftë për të vëllezërit, e sidomos për kujdeset kulturore të këtyre, se ato politike dalin pak, në mos aspak në to, meqë vëllezërit nuk e kishin lehtë t'i shprehnin nëpër letra, që mund të binin në duart e qeverisë.

Për jetën e Naimit zor se ato letrat na sjellin ndonjë element tjeter me interes të madh. Poeti ishte një adhurues i natyrës dhe Tahsini kujton me mall shëtitjet e tyre buzë detit në Bosfor, — është doemos fjala për vitin 1871, — meditimet mbi shkëmbinjtë, tek panë njëherë një oktapod dhe tek hanin hurma; apo kur u binin kodrave, me pushkë në supe, për gjah. Tahsini ka njobur dhe zyrën e vogël të Naimit në Sarandë, ku e kalonin kohën duke luajtur tavllë, se dogana e atyshme sa punë kish? Dhe si do të mund përfytyrojmë ndryshe doganierin Naim, veçse du ta gjetur mënyrën për të kaluar kohën në zyrë, apo për gjah, apo duke bërdhur shkëmbinjve?

Sigurisht edhe lexonte shumë: mësojmë se ai lexonte këngën III të «Eneidës». Kuptohet përsë. Aty Virgjili tregon për ardhjen e Eneut në Butrint, ku gjenden rimartuar Andromakën e trojanit Hektor me të zotin e vendit, Heleniosin. Gruas i bie të fikët kur sheh trojanët e saj dhe poeti fut shumë emocione dhe lot

në bisedën që zhvillohet, para se Eneu të rimarrë udhën pér det, këtë radhë pér brigjet italiane.

Më 1875, Samiu është kthyer nga syrgjyni i Tripolit, ku e paska shoqëruar dhe Tahsini, kurse Abdyli ka qenë i detyruar të kërkonte një tjetër punë në Janinë. Tahsini, që mendon të kthehet nga maji pranë Samiut, ka shpresë se atje do të jetë dhe Abdyli në ndonjë post më pér të qenë, dhe «*do të vinte e do të gjente punë dhe Naim beu*». Është dëshira që u njo-him vëllezërve pér t'u bashkuar sa më parë në Stamboll. Abdyli mund të bëhej lehtë «kajmekam» i ndonjë lagjeje të kryeqytetit; «edhe Naimi», shkruan Samiu në një letër që i dérgon të vëllait të madh në Janinë në fund të vitit 1875.

Aq sa e kemi vështirë ta përfytyrojmë Naimin nëpunës të dhjetash e doganier, — edhe pse qel! — aq nuk e kemi të lehtë ta shohim nënprefekt. Po siç u përmend më lart, Samiu vërente atëherë se në Turqi, «*po s'qe në punë shleti, nuk bën dot jetë më të mirë*», kurse këta vëllezër, që e kanë ende të pasigurtë jetën dhe i mundon nostalqja pér njëri-tjetrin, marrin punën që gjejnë, duke u përpjekur pér një më të mirë, ndërsa Naimi nuk është ai që e nisi nëpunësinë më me fat. Ja Abdyli ka vënë në mendje, më 1876, të mos qëndrojë më në Janinë dhe lakmon të bëhet në Stamboll kryetar i dhomës së tregtisë, por i propozojnë një kryesi «beledie», — bashkie.

Në nëntor 77, marrim vesh nga Samiu se Abdyli i ka shkruar një letër. Letra duhet të ketë qenë me interes politik, posa mendon që ta botojë në gazeten e ndaluar «Istikhal», që ka shpresë të dalë përsëri. Marrim vesh se Naimit nuk i ka shkruar, sigurohemë se poeti është përherë në Sarandë. Dhe letrat e cituara nuk japidin tjetër gjë më shumë pér të.

Por ato, si thamë, na mbajnë edhe nga një tjetër anë: na mësojnë shumë pér interesat letrare e kulturore të Vëllezërve Frashëri, e pakta të Samiut e Tahsinit, sidomos të të parit.

Dihet se në Stamboll, Samiu është tanimë i njobur

hë shoqérinë e letrarëve përparimtarë të ditës, si shoku i tij, poeti Namik Qemal, — prej nëne shqiptare, nga Konica, — si Ebuzija Teufiku, në një gazetë të te cilit Samiu ka bashkëpunuar. Po këto janë të fillimeve të tij në Stamboll dhe që i kushtuan gjysminnim e Tripolit (1874). Tani ai ka bërë të vetën një shtypshkronjë, përkthen e boton turqisht në fashikuj (1876) «Kontin e Montekristos» të Aleksandër Dymasit, te një shtypshkronjë tjetër, po pa sukses në shitje. Përkthen e boton nga i njëjtë autor edhe «Të tre musketierët» (po atë vit), kurse nga Hygoi ka përfshirë (1877) «Të mjerët» (botuar më 1881). Ndër librat që ai zë me gojë dhe, sigurisht, rekomandon, është «Manon Lesko», që i dha emër abatit Prevo në historinë e prozës franceze dhe evropiane të shek. XVIII. Admiron romanet sentimentaliste të vona të Lamartinit («Rafael», «Gjenovefa e Brabantit»), dhe të një bashkëkohësi të këtij, që kishte sukses, po që tani është harruar. Ndër leximet e tij është «Verteri» i Gëtes dhe Samiu do të deshte që ta përkthente Tahsini. Samiu ka ndërmend të shkruajë (1876) një si vazhdim të «Besës», pra tema shqiptare e bën të mendojë, se dhe te drama e tij e parë ai e ka parandierë që nuk do t'ia qasin fort vrasjen e djalit nga i ati, «për të mbajtur fjalën», dhe kjo kuptohet nga justifikimi i tij në parathënien e veprës së botuar pikërisht më 1875 e të shkruar në Tripoli motin e kaluar. Mendon të shkruajë një dramë me titullin «Fantazma», po ka gati përfshirë tragjedinë «Tiranë dhe tiranë», përfshirë cilën dyshon se a do të sigurojë lejen e botimit, që në fund ia jepin. Jemi në vitin e shpalljes së kushtetutës (1876)! Tahsini i ka çuar dorëshkrimin e një romani të vet, «Xhelati i fëmijëve». Samiu mendon ta batojë pasi ta shohin së bashku në Stamboll dhe të vëllanë e shtyn t'i bëjë edhe një parathënie «filozofiko-liberale». Të përfitojmë sa më shumë, me një fjalë, nga kjo kushtetutë që u dha, të përrapim sa më shumë ide të përparuara.

Emrat e autorëve që përmendëm dhe titujt e ve-

prave të tyre, titujt e veprave të dy vëllezërve vetë. na japin një ide mjaft të qartë të interesave letrare që këta kanë. Duan një letërsi shoqërore, me një thelb filozofik liberal, kundër tiranisë, po një letërsi gjithashu të karakterit para dhe postromantik, sentimentaliste. me efekte shumë. me drama të prekshme, me lot miaft; duan dhe një letërsi argëtuese; realizmit. Balzakut, Floberit, nuk shohim t'i ienë qasur. Sentimentalizmi e bën më drejtpërdrejt veprimin e tij mbi lexuesit e tvre të kohës. më shnoeit. Dhe të dv vëllezërit e kanë mendien të arriinë sa më shumë në gazetari. — Tahsini shpreson se do të mund të nxierërë një gazetë me ndihmën e khedivit të Egiuntit. po marrim vesh se ka dalë i zhgëniver. basi ka pritur muai të siatë (1876). është i sëmurë, thotë, se do të shkonte e të bëhej avokat në Evronë! Po Naimi?

Atë e shohim në Sarandën e largët të atdheut. në atë dhomëzën ku nuk dimë se me cilin e luan tavllën apo gien rastin të rilexojë e të këmbejë dy fialë për «Eneidën» e venra të fiera që admiron, ndofta edhe tash takohet me Hasan Tahsinin, që nuk mungon herë pas here në Shqipëri për propagandën patriotike dhe që ka emrin e një të dituri të rrallë, mik i Samiut, i cili e admironte shumë.

Nuk dimë se sa të gjera i ka Naimi interesat e reja letrare, por i përfytyrojmë të afërtë me ato të dy vëllezërve më të vegjël, të lidhur me letërsinë franceze, kurse, nga ana tjeter, poeti vazhdon të thurë vjersha persisht. Nga këto, kishte gati një përbledhje të dytë që nuk vajti në shtyp. Edhe Naimi, kur do të përkthejë dy libra nga frengjishtja dhe do t'i botojë, shohim se kemi të bëjmë sidomos me gjëra didaktike e me një novelë sentimentaliste. që hyjnë në kolonë enciklopedike të të vëllait, Samiut — «Bibliotekë xhepi». Ka për të shkruar pas disa vjetësh shqip edhe ndonjë tregim të vogël për fëmijë, të tipit sentimentalist. Po nuk shohim që Naimi të tregojë ndonjë interes të veçantë për prozën artistike, të paktën të dhëna s'kemi. Ai është i lidhur ngushtë mbas poezisë.

Nga modernët bashkëkohës, me siguri admiron Hygonë, po mbi të tjerë Lamartinin. Këtë e pëlqejnë veçanërisht në Turqi. Për gazetarinë, poeti Naim thua se nuk tregon asnje interes. Asnjë artikull nuk i njihet gjë më sot, as shqip as në ndonjë gjuhë tjeter.

Sidoqoftë, në mënyrë të përgjithshme, mund të themi se vëllezërit kanë shije mjaft të përbashkëta letrare dhe kërkesa që të përvetësojnë sa më shumë dije. Naimi është sidomos njeri i meditimit, por edhe Samiu i pëlqen meditacionet që shkruan Tahsini në Misir, — ai qan kur i lexon dhe është gati t'i botojë me entuziazëm. Dihet se pastaj ai vetë ka shkruar e bo-tuar një libër me aforizma.

* * *

Është thënë se viti 78, për Naimin, ishte ai i një tronditjeje dhe i një kthese të madhe. Po, s'ka dyshim, kjo nuk erdhi pa një përgatitje për të vëllanë e Abdylit e të Samiut, që i shohim të hedhur më përpara e me kohë në jetën politike dhe në përpjekjet për organizimin e lëvizjes patriotike shqiptare.

Ndonëse i izoluar, — si të thuash, — në Sarandë dhe larg të vëllezërve, Naimi ka qenë pérherë në kontakt të ngushtë me ta, qoftë personal, qoftë me anë lettrash, duke e njobur mirë veprimtarinë e tyre, pra, duke u njobur intimisht idetë e qëllimet. Asnjëherë, edhe në vitet përpara Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur Naimin e njobhim aq pak, nuk mundet ta ndajmë atë ngajeta e të vëllezërve, mendimet e shqetësimet e tij nga ato të tyre, sidomos të Abdylit, pranë të cilit atëherë ka qenë më shpesh. Viti 1876, që e gjeti në luftë Turqinë me Malin e Zi dhe Serbinë, do t'i trondiste shqiptarët dhe posaçërisht Abdylin me të vëllezërit, sepse këta i njihnin mirë lakmitë shoviniste të fqinjëve të veriut kundrejt tokave tona: prapa tyre ishte Rusia cariste, që donte ta ngultë fort një këmbë

në Ballkan dhe që, më 1877, do të lëshonte armatat e saj drejt e përtej Danubit.

Abdylit iu desh të lëvizte shpesh e më shpesh nga Janina, për veprimtarinë e jashtëzakonshme politike që ai ndërmori. Tani ai është deputet i vilajetit të Janinës në parlamentin osman, pra është imponuar si një personalitet ndër shqiptarë. Do ta çojë puna kështu Abdylin të gjendet për ditë të tëra dhe javë në Stamboll. Atje, që më 1877, përvata rrezikut që po u kanoset shqiptarëve me shpartallimin e afërt të ushtrisë turke, do të krijohet Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare. Dhe, nga fundi i vitit, në Stamboll nisin bisedimet shqiptaro-greke, për një veprim të përbashkët çlirimtar, po nuk dalin me sukses. Ato bisedime kishin filluar që katër muaj më parë. Prej letrës që i dërgonte Samiut në 15 prill të atij viti, mësojmë se Abdyli, bashkë me Naimin dhe Tahsinin, në mars, i ka rënë nga Korfuzi dhe është gjendur në Janinë më 29 të muajit, ndofta duke u nisur nga Saranda. Duhet menduar se kemi të bëjmë me përgatitjet e Abdylit për një takim me grekët, që do të arrinte të bëhej në Janinë asaj vere. Abdyli u deklaronte më pas grekëve në Stamboll, se «*rreziqet që po kalon kombësia shqiptare, tanimë po i parashikojmë qysh prej 30 vjetësh dhe, pas mundimesh e bisedash shumëvjeçare, kërkojmë krijimin e një principate të veçantë shqiptare».*

Abdyli na mëson kështu se ai ka mot që është hedhur në veprimtarinë politike të lëvizjes sonë kombëtare, kurse, nga ana tjetër, Naimi, që ka qëndruar pranë tij më 1876-78 e më pas, dhe oë ka takuar ato vjet edhe me Samiun, i cili ka ardhur ndonjëherë në Janinë, në mos dhe në Frashër, është i njojur thellë me qëllimet dhe takтикën e kësaj lëvizieie. së cilës po i prijnë të vellezërit: jo vetëm të shpëtohet kombi i vënë në rrezik, po dhe të arrihet domosdo sigurimi i tij me krijimin e një shteti «të veçantë», — kuptohet, autonom shqiptar.

Po le të vijmë te lëvizjet e Abdylit, që na intere-

sojnë këtu për jetën e Naimit vetë. Ai gjendet më 10 qershor në Prizren, ku themelohet Lidhja; në korrik, do të marrë udhën për të formuar me nxit degët e Lidhjes në Jug. Gjatë kësaj kohe, në Teqenë e Frashërit u organizua një mbledhje e madhe, me përfaqësues të të gjitha krahinave të Shqipërisë Jugore dhe që u drejtua nga vetë Abdyli. Teqenë e drejtonte babai patriot, Alushi, djalë i Dalip Frashërit, që u zgjodh edhe kryetar i Degës së Lidhjes aty. Kënga popullore e kujton:

*Kush do Shqipérinë, kush?
I mjeri Baba Alush.*

Në mbledhjen e Frashërit mori pjesë dhe Naimi. Abdyli, aë paraqiti programin e Lidhjes, shtroi çështjen që Greqisë të mos i lëshohej asnjë pëllëmbë nga tokat shqiptare, që Shqipëria të siguronte autonominë vërbrenda perandorisë, duke u bashkuar të gjitha krahinat tonë, — të ndara në katër vilajete të ndryshme, — në një vilajet të vetëm shqiptar.

Sigurisht, Naimi në Frashër përfaqësonte ndonië degë të Lidhies në jug. ose aktivistët e saj në Sarandë e në Breg të Detit. Dihet. p.sh., se në Porto Palermo, më 1878, nëpunës ishte një Kajmak Frashëri. i afërm i families së tij, që përndiqej nga osmanët. Duhet menduar se Naimi u vu në veprim gjallërisht vërtë të organizuar degët e Lidhies në jug. si në Janinë e në vende të ndryshme të Camërisë, në mos edhe në Berat e gjetiu. Ngjarjet e Lëkursit, të shkurtit 1878, ai i ka jetuar nga pranë, kur andartët zbritën që nga Korfuzi dhe pati luftime të ashpra, ata u thven e u detvruan të tërhiken. nor edhe e shkretuan në mënvërtë të tillë fshatin mbi Sarandë, sa ky më nuk u kthve në jetë.

Abdylit iu desh një veprimtari e dendur në vitet 1877-81 pra. ai qëndroi shpesh i larguar nga Janina. kui kishte familien dhe ishte kryellregarit i administratës së vilajetit. Për familien interesohet Naimi. Po në korrik Abdyli kishte drejtuar në Janinë një kuvend

të madh të degëve jugore të Lidhjes, ku u shpreh edhe njëherë fort vendosmëria e shqiptarëve për të ruajtur paprekshmërinë e trojeve të tyre dhe për nië vilajet të tyre autonom. Kjo mbledhje e re e madhe, ku duhet besuar se ka marrë pjesë edhe Naimi, i përforconte vendimet e Frashërit, si një mbledhje edhe më përfaqësuese e Lidhjes Shqiptare në jug.

Një mbledhje e dytë do të mbahej në Janinë në janar 1879 dhe një tjetër në Prevezë në fund të atij muaji nga degët vendëse të Lidhjes, për të përsëritur edhe më me forcë se shqiptarët, me cdo kusht, do t'i mbrojnë trojet amtare. Ushtarët shqiptarë të batalionit të vilajetit në Janinë ishin gati të kalonin me armë nga ana e Lidhjes. Naimi s'ka si të jetë i huaj për këto ngjarje, përkundrazi. Ai, tanimë, duhet menduar se jeton aktivisht me ngjarjet, përkrah të vëllait. Ka mundësi që edhe familjen e vet ta ketë shpërngulur në qendrën e vilajetit dhe të ketë hequr dorë prej nëpunësisë së doganës, apo të mos merret më praktikisht me të.

Në fillim të prillit, bashkë me Mehmet Ali Vrionin, Abdyli do të nisej për në Evropë, që të bënin përqapjet e njobura pranë Fuqive të Mëdha, për të mbrojtur çështjen shqiptare. Ata denoncuan paudhësinë e vendimeve të Fuqive të Mëdha ndaj Shqipërisë, këtij vendi me një popull që «*ka ruajtur atdheun e vet, kombësinë e tij, duke prapsur në kohët barbare sulmet e romakëve, të bizantinëve dhe të venedikasve*», dhe jo të mund «*të lejohet sot*» që «*të sakrifikohet*» «*pa asnjë arsyе të ligjshme*». Evropës i tregohej barbaria e dikurshme kundër nesh, për t'i kujtar të tashmen.

Këto do të gjenin jehonë të gjitha në poemën e parë shqipe që i njobhim Naimit një mot më pas:

*S'duan fare të na shohin,
Shqipërinë sot s'e njobin.
Shqipëria rron si ropi,
mejtohet për të Evropi.*

Nuk është e vështirë të zbulosh në vargun e fundit jo një kompliment për Fuqitë e Mëdha, të cilave më

kot u qenë drejtuar që në qershori 1878 Abdyli, Samiu, Pashko Vasa, Zija Prishtina etj. që nga Stambollit, po një zhgënjam e një ironi të hidhur të shqiptarëve ndaj së quajturës «botë të qytetëruar». Shqiptarët ishin të qartë për egërsinë e Fuqive. Samiu, që më 1875, në një vepër të tij arabisht mbi islamin, fiste hapur për krimet e tyre kolonialiste, p.sh. në Amerikë e Oqeani, për paratë që ata derdhnin me «*shoqata të posaçme për përhapjen e fesë së tyre*», «*që të shtien në dorë dhe të pushtojnë vendet (...), madje dhe të zhdukin krejtësisht*» popuj «*të mjerë*». Misionarët e tyre i pasojnë «*vaporet e tyre me ushtarë dhe me topa*».

A ishte Naimi në Kuvendin e madh të përfaqësuesve të degëve të Lidhjes që u mbajt në Gjirokastër në mbarim të korrikut 1880 dhe që drejtoi përsëri Abdyli? Aty ishin përfaqësuar të gjitha krahinat e Shqipërisë, ndonëse delegatët s'mundën të vinin të gjithë. Edhe një herë, çështja e madhe ishte ajo e autonomisë, dhe kërkesat tona kombëtare kishin avancuar shpejt: Shqipëria autonome do të kishte qeverinë dhe kryeqytetin e saj, në zemër të vendit, — dihet që Samiu ka menduar për krijimin e një kryeqyteti në qendrën e bukur të Belshit të Elbasanit, po kjo mund të ishte një ide e Abdylit, që e kishte vizituar tanimë Shqipërinë e Mesme. Administrata e vendit do të ishte vetëm në duart e shqiptarëve dhe autoritetet turke duhej të largoheshin; shqiptarët do të kishin ushtrinë e tyre në atdhe, etj. Sulltani mbante të drejtën të emëronte guvernatorin e Shqipërisë, po çfarë fuqie mund të kishte ky guvernator, kur qdo gjë të ishte në duart e shqiptarëve? Kuvendi i Gjirokastrës kërkonte që Shqipëria të zhvillohej në shembullin e vendeve të përparuara. Gjendja po acarohej me Turqinë. Në tetor të atij viti, Abdyli deklaronte në Dibër: «*Porta nuk do të bëjë asgjë për Shqipërinë (...) Le të mendojmë dhe le të punojmë për vete (...), të krijojmë një Shqipëri të bashkuar*». Janë fjalët që do t'i shkruajë Samiu De Radës mbas pak muajsh. Ideja e lirisë së plotë e të shpejtë kishte lindur te shqiptarët.

Naimi, i cili i jetonte me ethe ngjarjet, nuk la pa i pasqyruar në poemën «Shqipëria», që u përgjigjej pikërisht këtyre çasteve të mëdha që rronte kombi dhe ku të vellezërit ishin në ballë, ku poeti vetë, s'ka dyshim, vepronte nëpër jug. Shqipëria, pyeste ai me ankth e protestë,

*duke pasur burra trima,
të humbet si vetëtima?*

Dhe fill pas këtyre vargjeve, Naimi përbetohej se kjo nuk do të ngjiste, duke iu bërë thirrje shqiptarëve që të bashkohen për të drejtat e tyre, duke pasur parasysh se ka njerëz që nuk janë zgjuar ende dhe se çasti më nuk pret, ai që më lart kishte shkruar:

*E ç'e dua trimërinë,
kur s'm'u ndodh për Shqipërinë? —*

Këtë trimëri ne e kemi treguar që «*të rrojë Turqia*», që «*të bëjmë Greqinë*», kur turqit nuk na duan, kur grekët nuk na e dinë, — i vinte poeti në sedër shqiptarët, të gatshëm tanë 50 mijë me armë në jug, kurse në veri, atje praktikisht Shqipërinë kishin nisur ta grabisin!

Në fillim të vitit 1881, Abdyli do të qëndronte 3 muaj në Dibër, ku u vendos dëbimi i qeveritarëve osmanë; gojëdhëna thotë se ai i kaloi ata muaj me rreziqe jete. Nëpër Kosovë vendimi i Dibrës nisi të zbatohet. Në Janinë, turqit filluan nga arrestimet dhe disa krerë të Lidhjes i syrgjynosën për Çanakala. Nazif dhe Gani Frashëri, që do të pësonin pastaj burgun dhe syrgjynin, i shkruanin nga Saranda Abdylit, se «*e gjithë Toskëria, shumica e të krishterëve të Himarës e të Bregdetit, kanë lidhur besën dhe janë në pritje të urdhrit tuaj*». Ndjejmë, në këto fjalë të bashkëpunëtorëve dhe kushërinjve të Abdylit e të tij vetë, Naimin që i drejtohet të vëllait.

Është një nga ato letra për të cilat Dervish Pasha

ka dijeni se Naimi këmben me të vëllanë për veprimtarinë e Lidhjes: letra e mësipërme është e marsit 1881, një telegram i mareshalit turk, që kërkon të merrin masa kundër të vëllait të Abdylit në Janinë, është i majit. Tani Abdyli ka një muaj që dergjet në birucat e kalasë së Prizrenit. Një i afërti i familjes së tij, që i ka jetuar ngjarjet, na mëson se Naimi gjendej nën mbikqyrjen e policisë në Janinë. Pra, sigurohemë se poeti e ka lënë Sarandën dhe në qendrën e vilajetit ai nuk është i nevojshëm vetëm për familjen, por edhe ka shumë më shumë mundësi të veprojë për Lidhjen. Abdyli njeri më të besimit por edhe më të zot, cilin mund të kishte në jug?

Më 1882, Naimi ishte i detyruar të shpërndalej nga Janina, me gjithë njerëzit e tij dhe të Abdylit, dhe të vendosej në Stamboll, për të bashkuar Samiun e Mehmetin. Ata ia arritën, së fundi, po në çaste të tilla të rënda për veten e Shqipërinë, bashkimit të familjes së tyre të madhe në kryeqytet. Abdyli ishte në burg.

Naimi nuk do të lëvizte më nga Stambolli gjer në fund të jetës, 18 vjet. Këto do të janë vitet e mëdha të kësaj jete.

* * *

Në këtë mbarim kapitulli le të shënojmë se Naimi duket të jetë martuar aty nga pjesa e dytë e viteve 70. Për të shoqen dimë vetëm se ishte vajza e një berberi, — shkodran? — në Janinë, njeri i varfër. Një i afërm i poetit, që e ka njojur më 1897, na mësoi se dhe ajo ishte shëndetpakë, — «afife», — se duhej të qe atëherë mbi 40 vjeç dhe se nuk rroi më shumë se dy-tre vjet pas të shoqit. Pra gruaja, e quajnë Hexhe (Hatixhe), së cilës nuk i dimë emrin e families, duhej të kishte lindur rrëth mesit të viteve 50, duke qenë kështu disa vjet më e vogël se i shoqi.

Patën dy vajza, nga të cilat njëra nuk jetoi. Kjo,

e quajtur Nerqese, ka vdekur më 1881, sipas një vjershe të datuar e me titull «Mbi kufomën e bijës së vetme», që Naimi botoi në «Tehajylat». Dhimbja ka qenë e madhe.

Vajza e dytë, Nevrezi, u ka lindur në Stamboll.

Në përbledhjen persishte gjejmë edhe një vjershë të vitit 1873, «Në varrin e motrës», më e vjetra e librit; një tjeter, prapë të datuar, «Mbi vdekjen e vëllait» (është Tahsini, 1877), dhe një të padatuar, «Në varrin e motrave dhe të vëllezërve».

Naimi është tani një poet që fut shumë nga jeta e vet e dhëmshur intime në vargjet që shkruan. Këtë do ta bëjë rrallë më vonë.

Kemi dhe një vjershë, «Motra e përkëdhelur». Kjo mund të ketë qenë Asija, vajza e Sherifit, që e rriti Abdyli e pastaj Naimi. Për të flitet shpesh në letrat që kemi përmendur, ku ajo paraqitet si një gjësim i veçantë i shtëpisë, e një natyre që të bënte ta doje domosdo. Vjet më vonë, atë e mori për grua Murad Toptani. Muradit, Vellezërit Frashëri do t'i merrnin të motrën për më të voglin e tyre, Mehmetin.

Vajzën e Naimit, Nevrezin, e mori më pas publicisti i njohur Shahin Kolonja.

Ashtu u mbyllën vitet 70 për Naimin dhe do të çeleshin vitet 80, — duke mos harruar brengat e tij të vijueshme familjare, po duke pasur parasysh këtu, në radhë të parë, se në zjarrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe pranë Abdylit u shfaq poeti i madh kombëtar. Ai tani e tutje do të jepej me mish e me shpirt, i tëri, pas zgjimit e forcimit të lëvizjes kombëtare, — për gjuhën, letërsinë, shkollën e kulturën shqipe, për organizimin e lëvizjes së çlirimit, punë që dimë ta ketë nisur në Sarandë, Frashër e Janinë, në fund të viteve 70.

Vitet e mëdha: vitet 80 (I).

Naimi u shpërngul në Stamboll si njeri i dyshimtë për veprimtarinë e tij në lëvizjen kombëtare shqiptare, pas masave që u morën në jug dhe Janinë e Çamëri. Një dënim si ai ose ndonjë më të rëndë, pamë se e kishte kërkuar vetë komandanti i trupave repressive osmane në Shqipëri, Dervish Pasha.

Ardhja e Naimit në Stamboll ishte një e keqe, e cila pati edhe të mirën e saj: vëllezërit i bashkoi, siç synonin, në kryeqytet, ndonëse në rrrethana të vështira për ta.

Nuk jemi shumë kohë pas arrestimit të Abdylit, sidoqoftë disa muaj kanë kaluar. Masa nuk u mor menjëherë për Naimin. Me sa kuptohet. Porta nuk pëlqeu që t'i acaronte gjithë Vëllezërit Frashëri, në mos u mendua për Naimin, se nuk ishte «kaq i rrezikshëm» ky poet. Për Samiun, nuk dimë të jetë marrë ndonjë masë e veçantë. Ai disa vjet më parë kishte bërë një si gjysmë internimi në ishullin Rodi (1877). Me dënimin e Abdylit, u shpresua ndofta se të vëllezërit «do

të venë mend», tani që osmanëve u dukej se e kishin situatën në dorë, pasi thyen forcat e Lidhjes dhe pas një fushate barbare në Shqipëri.

Në kryeqytet, edhe këtë herë, Naimi gjeti punë në zyrat e shtypit, pranë Ministrisë së Arsimit, po një punë pak të ndryshme. Era «liberale» e shpalljes së kushtetutës, nisi të fashitej. Sapo ishte krijuar në Stamboll një sektor i censurës dhe aty lypsej një këshilltar për veprat greqishte, që, si për çdo tjetër gjuhë, duhej të kérkonin lejen e detyrueshme për botim. Samiu kishte krijuar tanimë disa miqësi në shkallët e larta të shtetit. Ai iu drejtua vetë ministrit të atëherëshëm të arsimit, që e afronte, siç tregon një njeri i familjes, dhe i rekomandon poetin, të vëllanë, i cili greqishten e njihte mirë, po njihte edhe mjaft gjuhë të tjera. Osmanët e gjetën të arsyeshme që ta largojnë me një mënyrë të tillë të vëllanë e dyshimtë të Abdyl Frashërit nga Shqipëria, të mos marrin kundër tij një masë të fortë. Në Stamboll mund ta kishin në mbikqyrje dhe më mirë se në Janinë, bashkë me të vëllezërit e tjerë, kurse në censurë, për greqishten, mund të mos kenë dashur të kenë një helen.

Nuk dimë se në ç'muaj u shpërngul Naimi për Stamboll. Dokumente të firmuara prej tij si censor njihen vetëm nga dy. I pari është i 14 gushtit 1882, kur ai ka nënshkruar lejen për botimin e «Gramatikës» së Kristoforidhit.

Na pëlqen që ta ketë firmuar ai këtë leje. Është koha kur Vëllezërit Frashëri janë në marrëdhënie të mira me gjuhëtarin. Shoqëria e Shkronjave kishte vendosur që më përpara, në verë të po atij viti, që t'i botonte «Fjalorin», me anë të degës së saj të Bukureshit, gjë që s'u bë dhe që, më pas, shkaktoi një prishje të padëshirueshme të Kristoforidhit me ta. Samiu kishte rënë në kontakt me përfaqësuesin e Shoqërisë së Biblës në Stamboll, Aleksandër Thomsonin, për botime shqipe, — kuptohet, për tekste mësimi të gjuhës në radhë të parë, — dhe kjo duhet të jetë bërë me ndërmjetësinë e Kristoforidhit. Përgjigjja ishte negative.

Edhe Mitkoja më parë kishte shpresuar që ajo shqëri ta ndihmonte për botimin e «Bletës». Thomsoni, në fakt, ishte dashamirës i përpjekjes shqiptare për gjuhën dhe me shpenzimet e veta e botoi «Gramatiken» e Kristoforidhit. Po qendra e tij në Londër ishte kundër.

Që mundi të botohej «Gramatika» e shqipes, kjo trigon se edhe Porta nisi të bënte ndonjë lëshim ndaj shqiptarëve aq të zemëruar kundër saj. Po dimë edhe se kishte qenë anuluar leja e nxjerrë nga Vretoja, si-gurisht me vendimin e Shoqërisë së Shkronjave, për botimin e një organi kulturor shqip në Stamboll. Revisa do të mund të dilte pas dy vjetësh dhe leja u dha me ndërmjetësinë e Naimit. Veçse tani (1884), ishte marrë një vendim amnistie kundër të përndjekurve shqiptarë të kohës së Lidhjes.

Naimi nuk gjeti në Stamboll atë situatën e viteve 1878-80, kur shqiptarët mundën të vepronin aq gjallërisht, me Komitetin e tyre Politik dhe me Shoqërinë e Shkronjave, me një mjet shtypi që Samiu kishte në dorë, gazetën e përditshme «Terxhuman-i shark», — «Interpreti i Lindjes». Naimi nuk gjeti atje as atmosferën e një dhjetëvjetëshi më parë, atë të kohës së «liberalit» Ali Pasha, të viteve 70, e të paraardhësit të tij Reshid. Vërtet mbas Tanzimatit një erë «liberalizmi» kishte fryrë nëpër Bosfor e Gallatë. Xhonturqit e kishin krijuar organizatën e tyre që në mes të viteve 60 dhe kjo lëvizje pati në krye disa nga iluministët osmanë më të shquar të kohës, si shkrimitarët Shinasi i Namik Kemal.

Shinasiu kishte admiruar në Paris Revolucionin e vitit 1848, bashkë me shqiptarin Sermedin Said Top-tanin, të atin e patriotit Murad. Ai i kishte kushtuar një himn të bujshëm dhe tërë shpresa të reja sadrazemit tanzimatas Reshid. Namik Kemali, kishte shkruar një himn për lirinë, po, si dhe xhonturqit e tjere, e kuptonte këtë liri si një liberalizim të gjendjes shtetërore dhe shoqërore në Turqi, me krijimin e shtetit kushtetues, — gjithmonë me sultantanin në krye, — dhe, nga ana tjetër, ruajtjen e perandorisë në tërësinë e saj,

edhe pse deshi «*të drejta të njëjta për të gjithë shtetasit*», «*osmanët*», siç i quante ai të gjithë, të çdo kom-bësie të aqenë. Protagonisti i dramës së tij të parë (më 1873, dy vjet përpara «Besës» së Samiut) ishte një shqiptar, por që luftoi në Silistra kundër rusëve si një «*fidai osman*» i bindur. Ideali i Namikut ishte ngritja lart e traditave osmane dhe krijimi i nië letërsie dhe kulture të re, në shembullin e atyre borgjeze të Perëndimit.

Dhe ja që sultani e dha kushtetutën. Ajo ishte një dinakéri, që s'i kushtoi gjë të madhe. Parlamentarizmi hyri në jetën e perandorisë. Kjo ngiau nië vit përvpara se ushtritë cariste të arrinin në portat e Stambollit. Kur u mblodh Kuvendi i Berlinit, në qershor 1878, domosdo që «e këshilluan» sultanin «të mbante fjalën» për liberalizimin e gjendjes. Po në Stamboll më shumë mbylleshin se celeshin gazeta, burgjet më nuk i nxinin të arrestuarit, në internim të degdisnin për hiçmosgië. Kishte nisur ai që është quajtur regjimi i «*zullumit*», që Turqinë do ta konte në shkallën e fundit fare të kalbëzimit. Sultan Hamidi do të bënte emrin e një Neroni, që veçse nuk i vuri zjarrin Stambollit, për të kënaqur histerinë e tij prej krimineli. Çajupi e ka quajtur bishë «*me fytyrë njeriu*». Grabitja, ryshfeti, spiunimi, tortura, shtypja kombëtare, çdo mynxyrë, — Çajupi ka folur edhe për gjenocidin kundër armenëve, që sultan Hamidi urdhëroi në fund të shekullit, — varfëria e madhe lëndore dhe shpirtërore, zvetënim i që mori sokakun fare, ja cila ishtejeta në Stamboll në vitin 1882, kur atje u vendos Naim Frashëri.

Stambolli ishte një qytet kozmopolit tipik. Atje «*rrëmuja e rrëmeti*» mund t'ia kalonin çdo përfytyrimi. S'është për t'u çuditur se aty, ndonëse u bashkua me të vellezërit, gjeti një punë dhe nisi të ketë një mirëqenie sado të vogël materiale, u afroa me njerëz që ia vlenë shumë, sidomos me plot patriotë shqiptarë, — Kristoforidhi, Vreto, Koto Hoxhi, Pashko Vasa, Ismail Qemali, Zija Prishtina, Hoxha Tahsini, dr. Ibrahim Temo, ndër të tjerë, — u njoh dhe me turq përparimtarë, — si të

dy miqtë e Samiut, me të cilët ky bashkëpunoj, Namik Kemali dhe Ebuzija Teufiku, — apo me përfaqësues të shquar të kombësive të ndryshme, — s'është për t'u çuditur që një ndër krijimet e para më të çmuara të Naimit në atë Stamboll të qe «Bagëti e bujqësia» (1886). Kjo poemë, temën e madhe të atdheut e trajtoi me ndjenjën e zhuritjes për vendlindjen, që ishte një «parajë», në krahasim me jetën në Stamboll, le të vuante Shqipëria të zëstë e ullirit nën zgjedhë e varfëri. «*Mendje, merr fushat e male! Jashtë, jashtë nga qyteti! Nga brenga, nga thashethemet, nga rrëmuja, nga rrëmeti!*» ishin vargje të buruara jo vetëm nga malli i madh për atdheun, jo vetëm nga ajo ndjenjë për natyrën e fshatit, që i karakterizoi romantikët dhe që Naimi e pati të zhvilluar shumë, por edhe nga një mundim i përditshëm, që poeti ndiente në shpirt në atë katrahurë të kryeqytetit të sulltan Hamid-Khanit, le të kishte krijuar aty dhe plot miqësi të qmueshme. Stambolli osman i linte pas edhe kohët më të errëta të Bizantit.

Idealet e bukura të Shinasiut e Namikut kishin dalë të zhgënjiyera, ato po zhgënjejeshin përditë e më keq. Në vitet 80 kishte ende përpjekje përparimtare politike, por idealet e borgjezisë liberale turke, — ato të mirat, — po e pësonin shpejt. Do të vinte fundi i viteve 80 me dëshpërimin, që ato vjet i pllakoste çdo çast e më rëndë një shumicë intelektualësh osmanë. Ata që përpara kishin pasur admirim për iluminizmin dhe revolucionin francez e për Volterin apo Hygonë, tani kthejeshin nga Bodleri dhe simbolizmi, në mos nga një lloj indiferençimi apo asnjanësie politike, që, në fushën e letërsisë, i bënte të admirojnë parnasanët.¹ Ata do të mblidheshin së fundi rrëth revistës së Teufik Fikretit, «*Servet-i funun*», — «*Thesari i shkencës*» (1891), ku gjenin ende jehonë idetë iluministe të viteve 60-70 të inteligjencies turke, ku vazhdonte sentimentalizmi pasromantik, po ku tingëllonte më fort pesimizmi dhe ku flitej për «artpur».


1 Parnasanë, — përfaqësues të një rryme poetike me tendencë formaliste në shek. XIX në Francë.

Abdul Frashëri

Naim Frashëri

Naim Frashëri

Firmat e Vellezërve Frashëri



Shkrimtarët që e nxirrin revistën, filluan të bëhen, tani pas akshami, edhe një herë ashikë arabizmash e persizmash, në një kohë kur ato i luftonte dhe kërkonte të shkruhej turqishtja popullore, Sami Frashëri.

Fjalët kushtetutë, liri, patriotizëm, tirani, por edhe hero, dhe të tjera si këto, që mbushnin shkrimet e tyre më parë, tanimë turqit përparimtarë nuk mund jo më t'i shkruanin, por as t'i shqiptonin, se kishin edhe muret veshë. Librat e Volterit, të Rusoit, Shilerit, Bajronit, Tolstoit me shokë, nisën të ndalohen. Nuk vihej më në skenë «Hamleti» apo «Tregtari i Venedikut». Si të mund të botonte Samiu një «Besë» të dytë? Prapë ai botoi një «Fjalor enciklopedik», që ishte një akt trimërie. Po, paskëtaj, më s'e lanë të dilte nga shtëpia, ku ishte në arrest. Vepra ishte veçanërisht e mbushur me artikuj të një vlere dhe guximi të veçantë për shqiptarët dhe Shqipërinë, për filozofinë përvaryimtare, për shkencat shoqërore.

Turqit, si popull, zhvilloheshin edhe më pak se popujt e tjerë të Ballkanit. Namik Kemali, që pati kënduar: «*liri, ç'është ajo magjia jote, që ne, të revoltuarit, na bën rob të tu?*» — do t'i conte dhjetë vjetët e fundit të jetës syrgjyn, le ta kishin graduar e bërë guvernator poetin, në ishujt e Rodit e të Kios, ku do të vdiste tuberkuloz pa mbushur 50 vjetët. Xhelati sultan kishte gjithë mënyrat e vrasjes. Samiu ka vdekur për shkak se nuk e kuroi dot reumatizmin që e mbërtheu. Naimi mund të thoshte jo vetëm «të keqen e Frashërit!», por edhe «të keqen e Sarandës!», ku punonte e luante tavillë në një zyrë birucë, ku kishte a s'kishte gjithsej 50 shtëpi.

Po në bibliotekën e pasur të të vëllait, le t'i kishte lexuar edhe më parë ndofta, në origjinal apo turqisht, Naimi do të gjente «Aventurat e Telemakut» të Fënelonit, «Robinsonin Kryzo» të De Fosë, «Burgjet e mia» të Pelikos, «Të mjerët» e Hygosë, «Vajzën fatkeqe» të Namikut (roman, ku një e re e bukur merrte për burrë një pasha plak, që të shpëtonte prindët nga mjerimi), dramën «Tiraní dhe tiraní» të të vëllait, botuar më 1877

dhe që e shpuri edhe atë për pak kohë «me punë» në Rodi, vend syrgivnesh. Samiu vazhdonte ta botonte atë serinë e tij të «Bibliotekës së xhepit», me broshura mbi shkencat, sidomos shoqërore. — mbi qvtetërimin, gruan, gjuhët eti. — dhe ku, më 1881, pa ardhur ende në Stamboll. Naimi vetë kishte nxierrë turqisht librin mbi «Shpikjet e zbulimet», që na zbulon ne shumë nga niohjet dhe bindjet e tii përparimitare, filozofike dhe shkençore, të asaj kohe dhe të mëvonshme, na tregon shaetësimet e mëdha të mendimtarit e të poetit, i cili po linte «ëndërrimet» persiane.

Dëshpërimit që nisi të mbretëronte buzë Bosforit. Naimi i ishte përgjigjur nga Shaipëria e luftës vër liri me shpresë e me ngazëllim. Pesimizmi që do të pushtonte kaq e kaq të zhgëniver borgjezë të rini osmanë, ai i kishte kundërvënë optimizmin e militantit vër shnëtimin e nië kombi. Mefshtësisë dhe têrheqies në «kullën» e vet, që ngjiste ndër shumë intelektualë osmanë, ai i bënte karshi me guximin e njeriut që e kuptonte jetën intelektuale si jetë therorie.

Naimi shpallte në librin e përmendur: «*Ati i qytetërimit eshtë liria*», dhe pohonte «*plot besim*», «*se e ardhmia do të bëhet shkallë-shkallë shumë më e ndritur*». Këto nuk i pohonte vetëm me guximin që kërkonte casti, kur Shaipëria ishte kallur në flakë e tëra, kur të vëllanë e kishte në zinxhira, kur kishte pas këpuce në Janinë afijet e sultantit të quaitur «*kushtetues*», no dhe me një vështrim realist e dialektik të gjërave: «*Ne nuk presim*. — shkruante Naimi. — *as si filozofi i lashtë, Platoni, as si të rinitë, si bie fiala Kondorseja*. që nieriut të këmbehet në engjëll ose të arrihet një botë e hegatisë dhe e lumtërisë së përfuturuar jashtë arsues. Po (...) përparimin e nierëzisë e shohim me të njëtin shikim që shohim rrötullimin e botës». Dhe shpallte lart: «*Qytetërimi i tanishëm (...) nuk eshtë mbarimi i qëllimit*»: duhet «*siguruar e ardhmja!*»

Me këtë përgatitje vërtet të celnikosur shpirtërore dhe mendore shkeli poeti në Stamboll më 1882, i nisur nga Shqipëria që sapo kaloi nëpër një përpjekje të

madhe heroizmi e vetëmohimi patriotik. Ashtu e pa Naimi Stambolli, kujeta dukej vërtet se kishte nisur të normalizohej, pas tërë atyre telasheve që pati perandoria në vitet 76-78, po ky normalizim ishte një ngarendje drejt greminës. Mendimi dhe letërsia turke e kohës këtë po e pasqyronte përditë e më shumë me humbje shprese, më tepër se me besim në të ardhmen, apo intelektualët e rinj turq i mbante në masë ende ideja «të ruajmë perandorinë», e cila nisi t'u ronitet sy më sy, dhe jo të luftojnë për të cliruar popullin turk vetë, përkrah bashkëvuajtësve të tij të kombësive të robëruara, që luftonin për clirimin kombëtar. Atyre u dukej se «po vinte kijameti» që po prishej perandoria; — shqiptarët këtë «kijamet» e prisnin me padurim dhe e përgatisnin, po duke vepruar me zell të ri e të rritur për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit të tyre, dhe për organizimin e tyre, që i pashmangshmi «kijamet» të mos shkaktonte, në asnjë farë mënyre, edhe gremisjen e Shqipërisë «nën gërmadhat e Turqisë», siç ka për të shkruar Samiu.

Më 1881, Naimi shkruante jo vetëm se «*ati i qytetërimit* është liria», po edhe se «*ati i lirisë (është) arsimi*». Ishte parulla e madhe shqiptare e ditës: o burra! ta zgjerojmë e ta rritim sa më shumë aksionin tonë kulturor, që ta përgatisim më mirë e ta bëjmë të sigurtë aksionin tonë përfundimtar politik, i cili s'ka për të mënuar, — clirimin!

Naimi kishte ardhur në strofkën e ujkut. Se çfarë kujdesi e maturie iu desh tani atij e Samiut, si dhe patriotëve shqiptarë në përgjithësi, për të vepruar në Stamboll, kjo kuptohet prej vetiu. Dhe nuk ishte vetëm armiku i madh osman që duhej përballuar. Patrikana e Fanarit dhe njerëzit e megaliidesë atje tërboheshin kundër lëvizjes kombëtare shqiptare. Shtypi i tyre në Stamboll nuk ishte i paktë dhe lufta me të kishte qenë e ashpër në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Letë përmendim vetëm «Apologjinë» e Jani Vretos për të mbrojtur Abdyl Frashërin kundër atij shtypi (1879) dhe jo më shumë. Naimi ishte vërtet censor për botimet e

fqinjëve dhe shovinistët duhej t'i druheshin ose të përpinqeshin ta merrnin me të mirë, por ata mbeteshin përherë ata që kishin qenë. Lufta me propagandën anti-shqiptare të megalidesë dhe me intrigat më të pabesueshme të këtij shovinizmi qëndronte vazhdimisht në rend të ditës.

Tërheq vëmendjen një gazetë shoviniste greke e Bukureshit e quajtur «Iris», që përpiquej t'i mashtronte me truket e saj shqiptarët e ku, gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e më pas, një patriot përmetar, Nikolla Çako, mundi të botonte vjersha shqip të fryshtimit kombëtar. Aty do të shohim edhe Naimin vetë, në dhjetor 1884, të botojë një nga vjershat e para të tij që pa dritën e shtypit, vjershën e njojur gjer dje vetëm nga botimi i vitit 1897 te revista «Albania» e Brukselit (që në fakt kishte qenë një ribotim), nën titullin «Pellazgët, — Shqiptarët», dhe që niste me vargjet:

*Ishte një ditë,
që pellasgjité
posi një dritë
mbuluan dhenë... —*

dhe që vazhdonte me pohimet se ishin ata pellazgë që «bënë elinët», se një tjetër «farë» e tyre «bëri llatinët», po pellazgët janë «prindërtë tanë». Dhe pikërisht vjersha kishte qenë botuar te «Irisi» me titullin «Nga dolli shqiptari», kurse poeti firmoste me pseudonimin që i njohim vetëm këtë herë: «Biri i Shqipërisë».

Vjersha e tij, në një gazetë të tyre, kërkon t'u kujtojë megalidenjve, së pari se Shqipëria është prej gjaku të stërlashtë pellasgjik, dhe së dyti, se edhe origjinat e lashta duhet të na nxitin të kuptohemi si të barabartë për çështjen e përbashkët të çlirimt kombëtar. Ne jemi popujt e Ballkanit që qëndruam që nga lashtra, ruajtëm gjuhën etj. Dhe ai kujton Dodonën mbi Tomor, Aleksandrin e Maqedonisë, Pirron e Epirit, që

janë mburrje për shqiptarët, për të përmendur së fundi se shqiptarët ishin ata që,

*me Skënderbenë,
turqve sa qenë
u dhanë dhenë, —*

ata që dhe «ngjallnë Greqinë», tanë së voni (Boçarët, Miaulët e Bubulinat me shokë).

I bëhej nga gazeta një lëshim censorit, që mund të rrezikonte në Stamboll botimet greke, apo ishte një dinakëri më shumë për t'i mashtruar shqiptarët? Fakti është se Naimi, që në këtë botim të guximshëm, sado në shtypin e mërgimit dhe me pseudonim, diti se si të punonte, që vepra e tij të çante rrugë e të përhapej. «Irisin» e lexonin të mërguarit shqiptarë në Rumania. Tek ata synonte së pari poeti.

Sidoqoftë, në gojën e ujkut, në Stamboll, ishte i vështirë veprimi. Po Naimi kishte përvojën e të vëllait, Samiut, i cili, gjë atëherë, sado me rreziqe, e kishte hedhur hendekun. Ai, prej natyre, ishte edhe tipi i njeriut të tërhequr nga veprimitaria e dukshme e përditshmë, tipi i njeriut që nuk binte, si të thuash, në sy. Një i kushëriri, që e ka njojur në vitet e tij të fundit, na ka treguar se Naimi bënte një jetë më të veçuar nga Samiu. Jo se tek ai nuk hynin e dilnin njerëz, po shumë më pak se te i vëllai. Këtë, dëshmuesi nuk e shpjegonte me sëmundjen që po i rëndohej atëherë shkrimtarit, por edhe me natyrën e tij. Po, siç thotë populli, «fjala bren gurin». Naimi këtë e kishte kuptuar mirë në ata vjet epikë që kishin kapërcyer. Nga shtëpiza e tij e Këzëll Toprakut, në anën aziatike të Bosforit, ku poeti do të kalonte pjesën më të madhe të jetës në Stamboll, kundër pushtetit osman nisën të hidhen «gjyle më zinxhirë», si nga një grykë topi që nuk pushoi së godituri 18 vjet. Ishin librat e tij.

Një djalë elbasanas, më 1895, vajti në Stamboll për të ndjekur mësimet e larta të mjekësisë, i rekomanduar nga Mahmud pashë Biçaku, që pati drejtuar degën e Lidhjes shqiptare në Elbasan, i ati i Aqif pashës, krye-

tarit të ardhshëm të Kuvendit të Lushnjës. Kërkonte një bursë dhe iu drejtua për ndihmë patriotit elbasanas, kryepeshkopit të Durrësit, Visar Theoharit, i njojur si Visar Plaku. Plaku ishte mik me Naimin dhe e mori me vete atë djalë që të këshillohej me poetin. Këshilla ishte kjo: «*Këtu, more bir, ti duhet të mësosh turçen, arabishten, persishten, dhe kështu, pas 15 vjetësh, të nisësh e të mësosh në një shkollë të lartë.*» Djali shpëtoi, — vajti e i bëri studimet gjetiu. Pra, shtëpia e Naimit, që frekuentohej më pak se ajo e më të hedhurit Sami, dukej nga jashtë e qetë, por ajo ziente përbrenda.

Pikërisht në ato vjet, prej aty doli Çajupi i magjepsur prej poetit të madh e, sigurisht, me vendimin që të shkruante shqip, — ai kishte nisur të shkruante, po frëngjisht, — me vendimin që të bëhej shpejt një poet i denjë i vazhdimësisë së Naimit. Aty jo vetëm shkruheshin veprat e shquara të dy dhjetëvjeçarëve të fundit të shek. XIX për letërsinë tonë kombëtare, vepra që bënë epokë në këtë letërsi, po shqiptarët gjenin frymëzime të reja për veprimet e tyre të mëtejshme patriotike, si ka shkruar një bashkëkohës: «*I varfër vinja tek Naimi, i pasur shkonja; pa shpresë vinja, kur shkonja, ndjenja vetëhenë të gjallë e me shpirt; fjalët që na thoshte, na shëronin zemrën..*»

E përmendëm këtu ndonjë kujtim që na ka arritur prej viteve të fundit të jetës së rilindësit të madh, për të theksuar se të tillë e njoën shqiptarët, që kur ai shkeli në Stamboll, — që kush e afronte, merrte prej tij zjarr, dhe se ata që e afronin kanë qenë të shumtë, të rinj apo të moshuar.

Është vënë re drejt, se rigjallërimi i vërtetë i intelektualëve shqiptarë patriotë në Stamboll takon me vendosjen aty të Naim Frashërit. Ai kishte dërguar me kohë nga atdheu poemën «Shqipëria», që i ndezi shqiptarët, duke bërë, më 1880, që të mërguarit tanë të Bukureshtit edhe më me nxit ta formojnë degën e tyre të Shqërisë së Shkronjave. Fjala e tij kishte nisur të bëhej mobilizuese që në Shqipëri. Shqiptarët panë se u kishte lindur një poet. E megjithatë, vlerat artistike të vjer-

shës ishin ende modeste. Po vargjet e tij ishin një sfidë për armiqjtë e çështjes shqiptare, dhe më shumë se vjersha tjetër që përmendëm më lart e që është e disa viteve më pas. Poema niste me thirrjen që i bëhej krenarisë kombëtare kështu, inatçë, si të thuash:

*Bota, që kur është zënë,
Shqipëria gjall' ka qenë!
Pellazg' u thoshin më parë,
më së fundi shqipëtarë...
Mos durofsh, i madhi zot,
të jetë në zgjedhë sot!*

S'ishte vetëm një paraqitje e historisë së një populli të lashtë mbi të tjerët, në mënyrën e kohës, me patosin romantik të saj, por ishte një kushtrim i vërtetë për të fituar lirinë. Ja se si ishte paraqitur shkrimtari në Stamboll, kur erdhi aty.

Më 1884, Naimi mundi të nxirrte lejen e një reviste shqipe që do të botehej në kryeqytet. Kjo është «Drita», që e nxori numrin e saj të parë atë 12 gusht. Në numrin e tretë, ajo do të këmbente emër, do të quhej «Dituria». Ç'kishte ngjarë? Drejtori, Petro Poga, ishte frikur. Fjala ka ardhur sikur ai nuk shkoi me Vreton, po me Vreton nuk ka shkuar se u frik. Naimit iu desh të nxirri te një leje mbi emrin e një drejtori tjetër: kështu e shpjegojmë këmbimin e titullit.

Drejtori i ri ishte Pandeli Sotiri, i cili vinte nga mërgimi i Rumanisë. Ai, pas tre vjetësh, do të bëhej drejtori i parë i së parës shkollë shqipe, që do të hapej në Korçë. Këto guxime i pagoi me jetë: Pandeliu është një nga dëshmorët e arsimit shqiptar e të shqipes. Shovinistët grekë të Stambollit futën vetë të shoqen e tij aë ta zhdukte dhe kjo e bëri të rrëzohej nga ballkonii i drunjëtë i shtëpisë së vietër ku ata banonin atje. Është një temë nga më tragjiket për letërsinë që frysmezohet nga e kaluara patriotike shqiptare.

Revista doli një herë në muaj dhe vetëm 12 herë. Në krye të motit u mbyll. Është nxituar, sigurisht, nipi Lumo kur shkruan se ajo nuk pati jetën të gjatë «nga

shkaku i mefshtësisë së shqiptarëve, sesa nga shtrëngimi i qeverisë». Ato qenë vite kur shqiptarët nuk u kur-syen, siç do ta shohim më poshtë, gjer të mblidhnin të holla e të themelonin një shtypshkronjë shqipe në Bu-kuresht, e jo të mos mbanin dot një revistë mujore. Po revista, ndonëse ishte një organ kulturor e çelte numrin e saj të parë me «Fjalët e qiririt» dhe vazhdonte me «Shkëndijën e diellit ndaj manushaques», që s'ishin ve-tëm përbetime të zjarra për atdheun shqiptar, por edhe të mbushura me vargjet më ngashëryese që mund të dill-nin nga zemrat shqiptare për gjendjen e atdheut, e që i ngrinin peshë bashkatdhatarët për veprimet patrio-tike të tyre, kulturore dhe jokulturore. Në Bukuresht po themelonin shtypshkronjë, po në Kosovë pushka e Lidhjes kërciste përsëri më 1885, ndërsa Shqipëria e tërë ishte si një kazan gati për të valuar.

Revista e Stambollit doli me shkrimet e Naimit, të Samiut, Vretos, Pandeli Sotirit vetë e të ndonjë tjetri. Pandeliu nisi të përkthente «Aventurat e Telemakut». Vretoja botonte mësimë të moralit, «Mirëvetinë» e tij. Samiu u mësonte shqiptarëve, ndër të tjera, gjeografinë, — «Dheshkronjën». Ai u tregonte aty konkretisht, si dhe P. Vasa etj., se cilat ishin tokat e tyre në të katër vilajetet, ku i kishte ndarë, — për t'i përcarë, osman-llia. Cilat ishin qytetet, — nga Tivari e Prizreni gier në Prevezë e Artë; cilët lumenjtë, — Drini, Vjosa e më poshtë, Vardari në kufi. Cilët malet, — Sharret, Tomoret. Formulimi ishte marrë nga humanistët tanë të vjetër, Barleti me shokë. Por ai përdorej në mënyrë mjeshtërore për këtë kohë, kur policia e Hamid-Khanit kishte katër palë sy. A mund ta kishte të gjatë jetën revista e pa-triotëve tanë, që i binin po në atë vend çekanit, — të krijohet Shqipëria autonome me tokat e saj të bashkuara të gjitha?

Këto pak të dhëna mbi revistën e Stambollit tre-gojnë se patriotët, përmes njohurive shkencore që botonin, por edhe përmes vjershave etj., përgatisnin me ngut terrenin për të hapur shkollat e para shqipe, të cilat nuk duhej t'i hapnin pa tekste mësimore të gat-

shme. Naimi shkruante, p.sh., mbi historinë, — atë të përgjithshmen, ku do të kishte vendin e saj të dukshëm edhe historia e Shqipërisë. Ai përkthente fabula nga La Fonteni, duke i zgjedhur si për moralin e shëndoshë, si për tingullin patriotik që mund të kishin për atë kohë. Ai botonte «Fjalët e t'urtet», që ishin këshilla të shumta për jetën, për edukimin shpirtëror, veçanërisht patriotik, të njeriut. Dhe tërë këto nuk ishin të përshtatshme vetëm për të vegjëlit, që do të uleshin në bangat e shkollave shqipe, por edhe për të mëdhenjtë, që duhej edhe ata të fitonin kulturën elementare. I tërë populli duhej futur në rrugën e të mësuarit, — të shqipes së shkruar dhe të diturisë.

Ja disa nga titujt e shkrimeve diturore të Naimit, që botonte me radhë revista: «Njeritregonjë» (antropologji), «Qiellshkronjë» (astronomi), «Fiziqi», «Dituritë» (në vjershë), «Histori e përgjithshme», e cila mbeti pa u mbaruar, se revista u mbyll. Kurse nga fabulat, «Ujku dhe qengji», — Turqia dhe Shqipëria, me fjalë të tjera; «Dhelpra dhe lejleku», — tregoi vendin mashtruesit; «Gjinkalla dhe miz' e dheut», — puno, që të mos lypësh! Dhe midis lirikave, disa nga kryeveprat e Naimit, si ato dy që u përmendën, si «Zemëra», — «Ç'ke moj zemër, që psherëtin,/ duke nxjerrë flak' e rënkon,/ posi moti vetëtin/ dhe hedh rrufe e gjëmon?» Dhe përshtataja e tij e rrallë e «Fyellit», që tingëllonte, atë kohë, edhe me dufin njerëzor që e mbushte poetin, edhe me dufin patriotik. Ishte sikur fliste për veten, kur ai shkruante për «fyellin»:

*I ra qiellit, e ndriti,
i ra zemrës, e përvloj,
i ra verës, e buçiti,
i ra shpirtit e lartoi! —*

Kurse më lart:

*Njerëzit me mua rrinë,
unë qanj edhe rrëfenj,
po dufn' e pshehtë s'ma dinë,
andaj kurrë përdëllim s'gjenj!*

Šikundër shihet, vjershat nuk ishin, në ndonjë varg e strofë, ashtu siç kemi për t'i njojur të përpunuara më 1890 te «Lulet e verës». Por ai «duf i pshehtë» ishte dhimbja e poetit, që donte ta kuptonin sa më shumë njerëz, sa më shumë; kurse ende dhe ende duhej zgjuar e lartësuar ndërgjegjja kombëtare. Dhe shqiptarët mund të thoshin jo vetëm se u kishte lindur një poet, po një poet i madh. Ja përsë u mbyll revista e Stambollit, — jo nga «mefshtësia e shqiptarëve», po nga përgjimi i qeverisë.

Ky poet, si kishte mundur të kërcejë me një hop nga vargjet, që le t'i quajmë «mëngjarashe» të poemës «Shqipëria», te vargjet e «Fjalëve të qiririt» e të »Fyellit», vetëm për katér-pesë vjet? Prentimin mund ta kishim ndier që te «Endërrimet», por ato ishin persisht dhe në këtë «gjuhë të poezisë» Naimi nuk e pati lehtë të derdhë talent sa kishte, sepse ishte një gjuhë e huaj, që, sado ta admironte, ai s'mund ta ndiente si gjuhë mëmë. Shembull klasik është kapercimi i poetit të madh Petrarka prej latinishtes tek italishtja. Po kryesorja që se poeti ynë kishte kapercyer në tematikën patriotike dhe revolucionare, që do t'i jepte hovet shpirtërore, i mbushur siç ishte ai me buçimén e viteve 1878-81, me dhëmbka të mëdha për kombin, me urrejtje të papërmabajtur për pushtuesit.

Sigurisht, Naimi ishte një poet i lindur, por edhe një poet i përgatitur, që ishte formuar së lexuari Homerin e Firdusiun, Danten e Hygonë e shumë të tjera. Ai dinte kaq gjuhë, që ishin kaq burime për të shuar etin përpoezi dhe dituri, — greqishten e vjetër e të re, latinishken, turqishten, arabishten e persishten, frëngjishten e italishten; duhet të ketë nisur, sadopak, të depërtojë edhe në fjalën gjermane.

Dhe shqiptarët nuk admiruan shpejt vetëm poetin, por edhe mendimtarin humanist, edhe njeriun që e përqafonte shkencën me gjithë arritjet më revolucionare të saj. Në faqet e revistës së Stambollit ai, me guxim të rrallë antidormatik, do t'i shkruante dhe do t'i thoshte shumë më shkoqur shqip disa të vërteta që kishte

nisur t'i thotë nënë zë turqisht tre vjet më parë, — se «*njeriu është pemë e natyrës*»; se ai ka lindur «*në dherat* (epokat gjeologjike, Dh. Sh.) *e katërtë*» të zhvillimit të botës etj. Ishte një e goditur për vdekje që i jepte darvinizmi, — teoria e zhvillimit të qenieve të gjalla, — teologjisë. Në «*Ludvig Fojabah*», Engelsi e quante darvinizmin «*një nga tre zbulimet e mëdha*» të shkencës së kohës, «*që e bënë të përparojë me hapa viganë njohjen tonë të proceseve natyrore*» (1888). Shkelmin dhe efektin që mund të bënte e ndien gjer në kryeqytetin e «mexhelesë». Po këto pozita të Naimit i gjejmë edhe në veprën turqishtë të Samiut, «*Njeriu*», — «*Insan*», 1886.

Idetë, kur janë të drejta, kur janë revolucionare, sado t'i futësh në burg, shpërthejnë gjithë muret. Ato «i dëgjojnë edhe shurdhët», ka thënë i urti motit. Po në Stamboll jetonin njerëz me mendje të ndritur, si Vellezërit tanë Frashëri, p.sh. Atje, njerëz me mendje të tillë, kishin folur me admirim për darvinizmin edhe më parë. Tani po e dëgjonin edhe shqiptarët në gjuhën e tyre dhe kjo ngjiste në kohën kur kalifi tiran, sulltani, përgjonte çdo gjest e çdo fjalë, çdo përpjekje për çlirimin e mendjes, ndërsa zgjyra teologjike kishte kapulluar tërë perandorinë dhe kleri xhahil e fanatik shqiptar ishte i shumtë gjithashtu. Po vrulli që merrte shkenca nëpër botë, shkrimitarin tonë, i cili, fundi i fundit, ishte një besimtar, e rrëmbente me vete dhe e bënte të papërbajtur.

Kishin përsë të entuziazmoheshin shqiptarët për cilërsinë e mendjes së këtij të dituri të shquar që u kishte lindur dhe për guximin e tij. Domosdo, revista ku ai botonte, nuk kishte për t'i pasur të gjata ditët. Që te faqet e «*Drita*» — «*Diturisë*», shqiptarët diktuan shkrimitarin e plotë qhe frymëzuesin e pazakonshëm të idealeve të mëdha e të ideve të ndritura, fill pas viteve të Lidhjes së tyre, që e kishte hedhur Shqipërinë me aq vrull në luftën për çlirim,

Vitet e mëdha: vitet 80 (II)

Viti që do të vinte, ai 1886, kishte për të qenë një vit i shënuar për lëvizjen kombëtare shqiptare dhe për Naim Frashërin vetë. Dega e Bukureshtit nuk i kishte pasur fillimet sa duhej të mbara, ndonëse Vretoja e bëri punën mirë që në krye në Rumani, ku e dërgoi Shoqëria e Stambollit për të organizuar shqiptarët.

Atje, shqiptarët u përçanë. Pareja që kishte në krye pasanikun e madh Anastas Lakçe, nuk shkoi me parenë tjetër, që krijoi i posaardhuri nga Misiri, Nikolla Naçoja. Naçoja ishte zemërak, edhe pse më i afruar me masat e mërgimtarëve të thjeshtë, gjë që ka qenë një meritë e veçantë e tij. Në parantezë, le të shënojmë se, me gjithë admirimin që ka treguar së hershmi për Naimin, — më 1889, ai e niste vitin e gazetës së vet «Shqiptari» me botimin e «Fjalëve të qiririt», — Naçon do ta shohim më pas ta përgojojë poetin në letërķembimin e tij, ku rrëmbehet dhe jo pak. Po nuk është këtu rasti për ta gjykuar. Fakt është se kundërshtarët e tij u çorientuan, duke nisur nga Lakçeja, që ishte i lëkundshëm.

Më 1886, dega e Shoqërisë së Shkronjave në Bukuresht u desh të riorganizohet e të forcohet. Ky riorganizim pati një rezultat të madh mbi të gjitha: realizoi vendimin e dy viteve më parë, krijoit shtypshkronjën, që do të bëhej një bazë kryesore materiale, si për letërsinë tonë të re, ashtu edhe për shkollën shqipe që u vendos të hapet. Mitkoja i shkruante De Radës në dhjetor 1886: «*Turqia (...) dha leje shenjërisht¹ ndër shkolla të Shqipërisë të këllitet pahir gëluha shqype dhe turqishte e jo elenishte. Vulosi edhe libratë që u shqyposnë në Bukuresht, të cilat u dërguan në Shqypëri. Klira elene ndë Konstantinopojë po shërben e përpinqet, sa të mos marr' udhë ky urdhë; po atje ësht' Abdyl Frashëri, i cili ndih fort qëmoti kësaj peme, jan' edhe shumë të tjerë shqyptarë të munçimë».*

E dhamë këtë citat, për të treguar se si viti 1886 mbaroi me një fitore të shquar për lëvizjen kombëtare shqiptare, por edhe për të shënuar se Abdyli, që kishte përfituar nga amnistia e dy viteve më parë, me të dalë nga burgu ishte hedhur përkrah të vëllezërve në lëvizjen për kulturën shqiptare, që duhej të merrte hov, siç mori. Visar Dodani, i cili ato kohë ishte në lidhje me Samiun dhe Naimin, na mëson se letërkëmbimin e ka nisur më 1884 dhe flet për nxitjen që patriotët e Bukureshit marrin nga Naimi, që të veprojnë për botimet shqipe, se «*në Stamboll as që mund të punohet, as që mund të niset një pun' e tillë, e cila, po q'u nis, duhet mbaruar».*

10 libra botoi më 1886 Dega e Bukureshit. Nga ato, 6 ishin të Naimit, 2 të Samiut, 2 të Vretos. Samiu botonte abetaren dhe gramatikën («shkronjëtoren») e tij, Vretoja moralin dhe një aritmetikë, Naimi përmblidhte në 4 vëllime shkrimet e tij diturore të revistës së Stambollit, botonte edhe dy poema. Pra, — synimi i parë, shkollat e para shqipe, që do të hapeshin marsin e ardhshëm. Mitkoja pati shpresuar shumë shkolla, — këto qenë

1 Ekspresivisht; më poshtë: «pahir» (doemos); «vulosi» (lejoi zyrtarisht); «klira» (kleri); «të munçimë» (të fortë).

vetëm katër a pesë! Por ishin një gjë e madhe, me libra të tillë dhe me mësues si Pandeli Sotiri e Petro Nini Luarasi, që kishin marrë përsipër çdo flijim; edhe të jetës, me të cilën vërtet e paguan detyrën që i vunë vetes. Naimi ishte ndër patriotët oë luajtën një rol të veçantë për lejen që u mor për arsimin shqip. Që të celej sa më parë shkolla në Korçë, rol luajti miku i tij Nazuf efendi, një kolonjar nepunës në Manastir.

Librat e Naimit për shkollat ishin: dy bleje «Këndimesh», «Histori e përgjithëshme», «Vjersha». — «për mësonjëtoret të para». Poemat e tij qenë: «Bagëti e bujqësia», që i kushtohej Lakçes, për ta mbajtur në lëvizjen kombëtare, dhe, gregisht, «Dëshira e vërtetë e shqiptarit». Naimi do të botonte edhe një libër tietër më 1888, më të trashë se shokët, «Dituritë», — shkencat, kur Samiu nxirrte «Dheshkronjën». Kjo përpjekje për shkollat do të vazhdonte me ribitime, kurse poemat e vitit 1886 Naimit i dhanë emrin e madh si poet i shqiptarëve.

«Bagëti e Bujqësia», që, përmes emrit të Lakçes, s'ka dvshim se kërkonte t'u kushtohej shqiptarëve patriotë të Rumanisë, tani që ata e morën me ngulm rrugën për botimet shqip dhe vër çështjen e shkollës shqipe, kërkonte t'u ringjallte në art, atvre dhe gjithë mërgimtarëve, atdheun me tërë bukuritë, duke i kënduar sidomos popullit të thjeshtë shqiptar. bariut, bujkut, që ruante fort vëtitë e kombit dhe që ishte vër poetin, — dhe këtë poeti deshi t'ua bënte të qartë Iakçeve, — shpresë e madhe e shpëtimit të Shaipërisë dhe e begatimit të saj. Popullit i duhej dreituar vër të shpëtuar Shqipërinë, — ky ishte një kuptim i thellë i poemës. Për këtë atdhe të lashtë trimërie dhe urtësie, vune me diersë, shqiptarët duhej të ishin krenarë, le të ishte i varfër e i robëruar, — «*të Shqipërinë më eo nderë. më eo emërin shqipëtar!*», moto nga të mëdhatë e ditës dhe e Rilindjes.

«Dëshira e vërtetë» u drejtohei grekëve në gjuhën e tvre dhe, përmes kësaj gjuhe të kulturës krvesore të Ballkanit prej shekujsh, ballkanasve të tjerë. Ajo i fton-

te fqinjët në luftë të përbashkët kundër sunduesit të përbashkët, u kujtonte edhe një herë peshën e madhe që kishin mbajtur, po dhe që përsëri po mbanin shqiptarët pér të luftuar Turqinë e sulltanëve dhe pér çirimin e përbashkët; u kujtonte të drejtat e seclit, që secili duhet t'i respektojë, se, ashtu siç e kanë nisur megalidenjtë dhe shovinistët që janë në fuqi te fqinjët, shqiptarët nuk kanë pér të duruar dhe, «*po të jetë se humbasim ne atdheun e dashur tonin,/ qielli le të përmbyset, me të edhe perëndite!* (...) Se shqipëtari atdhenë s'ia dorëzon askujt e kurrë.»

Naimi, si censor, ishte në kontakt me shumë grekë në Stamboll, që ia kishin nevojën. Ai i njihte me rrënje veprimet e tyre armiqësore ndaj çështjes shqiptare. Po kishte sigurisht midis tyre edhe njerëz me ide të hapura dhe që çështjen shqiptare e kuptionin. Kishte të tjerë, të cilëve u duheshin çelur sytë, se veprimitaria antishqiptare ishte në dëm të Greqisë vetë. Më 1895, Naimi do të botonte një përbledhje lirikash me titullin «Dashuria» (<«O eros»), të cilën ia kushtonte mikut grek I. Karolidhi, me sa duket njeri i afërm i historianit të njojur, që ka shkruar me admirim pér Skënderbeun. Nga vepra e Naimit ndonjë pjesë u botua edhe në shtypin grek të Stambollit e të Athinës, me fjalët më të mira pér poetin, i cili, duke u shprehur në gjuhën e stërnipërve të Homerit, bënte një gjest të vërtetë nderimi, u nderte përsëri dorën grekëve pér bashkëveprim në ato vite 80-90, pas dëshimit të mëparshëm të përpjekjeve shqiptare pér atrim.

«Dëshira e vërtetë» lexohej jo vetëm nga grekë, por edhe nga ata shqiptarë të arsimuar në shkollat greke dhe që mësonin se cili duhej të ishte qëndrimi dashamirës, por edhe i prerë, i shqiptarëve ndaj fqinjëve, se si Naimi ishte një atdhetar që shquhej pér ndjenjat e tij të mëdha humane të respektit pér popujt e tjerë. Ata që midis shqiptarëve pengoheshin nga paragjykimet fetare, shikonin tanë edhe një herë açik se si një mysliman shqiptar vinte atdhenë mbi fenë, ashtu siç kishin

parë më 1880 se si një «bej» shqiptar mund të ngrihej kundër Turqisë feudale, për lirinë e Shqipërisë.

Ndërsa më 1888, Naimi, me «Dituritë», u paraqitej përsëri shqiptarëve si njeri me ide nga më të guximshmet shkencore për rilindësit tanë, më 1890, me «Lulet e verës» nuk i këndonte vetëm atdheut, por edhe natyrës, jetës së njeriut, dashurisë, shpallte në vjersha botëkuptimin e tij filozofik. Kjo vepër e plotësonte mirë diapazonin poetik që shqiptarët i njihnin Naimit.

Kristoforidhi ishte atë kohë i vendosur në Elbasan prej disa vjetësh e përbledhja i ra në duar sapo doli. Një ditë, miku i tij i ngushtë, Loshi i Bardhë, e gjeti me të në duar, tek ishte zhytur në kulltukun e tij të vjetër e tek po qante. Loshi u tremb. Kristoforidhi i zgjati libërthin e i tha në lot: «A, more Losh! Unë qeshë gonxhe, u bëra trëndafil, tani gjethet po më tha-hen. Këtij, këtij gjethet s'kanë për t'i tharë kurrë! Këndoje, këndoje, Losh!» dhe e kënduan edhe një herë të dy. Një admirim të tillë ka treguar edhe Pashko Vasa në Liban: ai u vu t'i përkthente vjershat frëngjisht.

Këto dëshmi prej kohëtarëve flasin shumë për admirimin që ngjallte poezia e Naimit.



Naum Veqilharxi



Kostandin Kristoforidhi



Hasan Tahsini



Jani Vreto



Koto Hoxhi



Jeronim De Rada



Çajupi



Josif Bagëri

Vitet e mëdha : vitet 90

Dhjetëvjeçari i dytë dhe i fundit i jetës së Naimit në Stamboll thua se nuk ndryshon nga paraqitja dhe përbajtja me të parin.

Po ajo jetë nëpunësi, veç që ai, tanimë, e pakta që nga viti 1888, është drejtor i censurës. Një nëpunës pak i përzier me jetën tërë zhurmë zullumi, një zullum që shtohet, si një lumë që tërheq me vete fëlliqësirë shumë dhe zezeron, që duket se s'ka për t'u pastruar e kthjelluar kurrë. Jetë shtëpie, më shumë, ajo e Naimit, midis librave, në një dhomë të katit poshtë të një ndërtese dykatëshe, gjithmonë nga ana lindore e Bosforit, shumë më e qetë se ana perëndimore. Në atë dhomë ai pret përditë patriotë shqiptarë të Stambollit, apo nga atdheu i largët e nga kolonitë e mërgimit; pret intelektualë përparimtarë turq e grekë që e çmojnë; pret studentë shqiptarë, që janë kënaqësia e veçantë e tij: ai gjëzon se një rini me dije ka nisur të shtohet për atdhenë. Të gjithë bëhen përherë e më fort merak për shëndetin e tij, që s'po i merr për mbarë, po veç për më keq.

Jetë poeti me pendë në dorë, që ka zakon të krijojë duke bërë ecejake nëpër dhomë, t'i ndërtojë vargjet në mend, t'i murmurisë dhe, kur t'i ketë sajuar, të ulet në një nim a në një kolktuk, që t'i regjistrojë. Tavolinë pune s'përdor.

Eshtë dëshmuar se, pas vitit 1895, Naimi e la pendën: fuqitë iu prenë edhe për të shkruar, ndonëse mendja i mbeti e kthjellët dhe dufi poetik e përvëlonë; fjalën e kishte gjithnjë melhem, kur s'e kishte të pasionuar. Q'ka të re në këtë jetë, veç faktit se ditët po i shkurtohen si tepër shpejt dhe poeti e ndjen e s'qahet? Meditimi duket se i është bërë më i thellë, syri i përhumb më shpesh, një hidhëtirë i shquan te cepi i buzëve të fryra, ai ka nisur të thinjet, — thinjat i erdhën pak si vonë dhe të rralla. Shihni fotografinë e tij më të njojur; ajo është e vitit 1896: Naimi është 50 vjeç. Veprat që boton, ja e reja, në kuptimin se bota presin se ç'do të botojë këtë vit «I madhi», — kështu kanë nisur t'i thërrasin dhe jo vetëm se ai numërohet tanë më i moshuari i shtëpisë, pas vdekjes së Abdylit (1893).

Tituj të rind do t'i shtohen raftit të krijimeve të tij dhe kuptohet se ai ka punuar me një intensitet të rrallë gjer në mes të viteve 90, kur i kishte shkruar gjithë veprat që i njohim e prej të cilave nuk dimë t'i ketë mbetur gjë pa u botuar me gjallje. Po të marrim parasysh vetëm të 20 mijë vargjet e «Historisë së Skënderbeut» e të «Qerbelasë», që do të botonte më 1898, e kuptojmë se ç'qe ajo punë. Më 1896, Naimi botonte përkthimin shqip të këngës I të «Iliadës», pasi e kishte botuar dhjetë vjet më parë turqisht, — ai ka qenë i pari që provoi të përkthente diçka edhe turqisht nga Homeri. Atë vit ka botuar dhe «Fletoren e bektashinjet». Më 1894 kishte botuar «Mësimet», bashkë me «Fjalën fluturake», lirika e fabula, dhe «Parajsën», poemë mbi Shqipërinë. Më 1895, «Gjithësinë», një ribotim, me ndonjë përpunim të vogël, i «Diturive». Botimet e tij do të mbylleshin më 1899 me «Historinë e Shqipërisë», që ishte një kapitull i «Historisë së përgjithshme» të vitit 1886 është shtuar me pak ndryshime dhe ndonjë shtojcë.

«Gjithësia» botohej pa emër autorit, «Historia e Skënderbeut» edhe pa emër vendit. E para e kishte tanimë vështirë ta shpallte autorin e saj, me idetë revolucionare shkencore që ajo përhapte; e dyta e kishte të pamundur, me kushtimin që lëshonte për luftë të armatosur kundër robëruesve shekullorë. Në fakt, edhe «Dëshirë e vërtetë», më 1886, kishte dalë pa emër autorit, aq të hapët e kishte ajo synimin politik, kurse theksat kushtimore i kishte të shumtë. Dhe Naimi librat e tij shqip nuk i firmoi asnjëherë me emër, po me siglat N.F. ose N.H.F. I vetmi libër që është firmuar me emrin e tij të plotë, është përbledhja lirike greqisht «Dashuria». E ka firmuar si kryetar i Këshillit të lartë të Arsimit pranë Ministrisë së Arsimit të Turqisë.

Nuk dimë se kur ai u ngjit në këtë post. Miqësitetë e shumta të Naimit e të Samiut bënë që ata të mund të jetojnë në Stamboll, të kenë atë veprimitari të dendur patriotike, të ngjiten edhe në gradë, duke ditur se si të manovrojnë në të gjitha situatat, gjer duke botuar shqip pa firmë ose me sigla, duke mos u hedhur në shtyp drejtpërdrejt kundër personit të sulltanit, — porse emri i Muratit, të cilit «*i duhej pirë gjaku*» aludonte qartë në emrin e Abdyl Hamidit, të cilit njësoj «*i duhej pirë gjaku*». Naimi i kishte vënë njënofkë dhe me të e thërrisin midis tyre shqiptarët: Qerosi!

Është e vështirë të thuash gjë tjetër për dhjetëvjeçarin e fundit të jetës së Naimit në Stamboll, po s'u more me librat e tij, kaq pak jemi të informuar. Ai nuk ishte publicist, që të na ndihmojnë artikujt. Letërkëmbimi i tij nuk na ka arritur. Në arkivat turke nuk është kërkuar p.sh. për jetën zyrtare të tij. Po këtë poet të madh të shqiptarëve hafijet osmane domosdo e kanë gjurmuar dhe ky gjurmim duhet të ketë lënë shenja.

Ka rrezik që duke u marrë me jetën e Naimit në këtë dhjetëvjeçar, si dhe në të mëvarshmin, të merresh më shumë me bibliografinë se me biografinë e tij. Po disa dëshmi ndihmojnë.

Naimi ishte vazhdimisht në ballë të lëvizjes kombëtare jo vetëm me librat, por edhe me kontaktet e tij, me

udhëzimet që u jepte bashkatzhetarëve të Stambollit e të Shqipërisë, atyre të Bukureshit e të Sofjes, të Misi-rit, të Italisë e gjetiu. Këshillat e tij ishin të çmuara dhe dëshmuesit flasin sidomos për to. Ndërhyrjet me miqësitë e tij qenë të shpeshta në favor të lëvizjes kombëtare. Kështu, herë e shohim të interesohet për t'u çelur një shkollë shqipe në Përmet, si më 1890, herë për t'u emëruar një shqiptar si drejtor i arsimit në qendrën e vilajetit, në Manastir, ku më 1891 u emërua një i ri nga Frashëri. Vasil Tërpos, njërit prej udhëheqësve të lëvizjes shqiptare të Rumanisë, i shkruan më 1896 fjalë të mira për rigjallërimin e shoqërisë «Dituria» dhe e këshillon të jenë të kujdesur, ai dhe shokët, se «këndesi», — reaksioni, — «mori fuqi dhe atje dhe këtu». Ai interesohet gjer për «librat e meshës» e për një katkizëm (e Kristoforidhit?), për të cilin punon dhe që i kërkojnë shqiptarët në Bukuresht, sigurisht që ta futin shqipen në shërbesat fetare, për të lidhur edhe më ngushtë besimtarët me lëvizjen patriotike. Ai i ndihmon pa u kursyer miqtë për punët e tyre private që mund të kenë në Stamboll, siç del nga letra e përmendor e nga ndonjë tjetër.

Thamë se e vizitojnë shumë të rinj. Ata që kanë mbaruar studimet, venë e takohen për herë të fundit me të, që t'i japid lamtumirën, por edhe t'i kërkojnë këshilla për jetën, në mos edhe ndonjë shërbim.

Është i njojur rasti i Sevasti Qiriazit, që kreu në Stamboll studimet e mesme anglisht dhe që do të nisej për Shqipëri. Ajo pati nevojë që Naimi, si nëpunës i lartë në Ministrinë e Arsimit, ta ndihmonte për të vërtetuar diplomën e për të çelur shkollën shqipe për vajza në Korçë, bashkë me të vëllanë, Gjerasimin. Mësuesja shikruan se e ka njojur Naimin në festën që u bë, kur të rejat morën diplomat. I vëllai e shkëputi nga shoqet dhe e çoi te një tok njerëz, që dukej se po e prisin. «*Para se të afrohemë, disa nga këta heqin vërejtjen, po më tepër njëri prej syresh*». Ai «*ishte me shtat të mesmë edhe i imët*», — Naimi ka qenë shtatlartë në fakt, po ndofta sëmundja e kishte atë kohë drobitur; — «*kishte*

një fytyrë fort të qetë» dhe «sytë e tija plot zjarr», «një pamje intelektuali të shquar. Ishte një magnet dashurie!»

I dhamë këto fjalë, duke e ndërprerë vende-vende frazën e afektuar, për të parë se si vërtet i tërhiqte fort Naimi njerëzit, dhe sa i afruar ai ishte, po veçanërisht për të parë adhurimin që poeti ngjallte në të rintjtë. Midis fjalëve që i tha maturantes, le të shënojmë këto: «*Të gjitha ato çupa e gra që do të vijnë nën hijen tënde, i frymëzo me ideale të larta e të vërteta, që të arrijmë një qytetërim të vërtetë, edhe kështu ta bëjmë brezin tonë të pushtonjë gjithë ato virtyte dashurie, vëllazerie, atdhedashurie dhe bashkimi që karakterizon kohërat e Skënderbeut.*» Naimi kishte besim të madh te roli i arsimtareje. Ishte një ngjarje e jashtëzakonshme atëherë dalja në jetë e një femre shqiptare, që do të jepte mësim një shkollë. Ishte e para shqiptare që do të çelte një shkollë shqipe në atdhe, dhe një shkollë përvajza. Jemi më 1892.

Naimi, tregon mësuesja, «*vitin e parë kur u çel shkoilla Qiriaz, nuk harroi të na shkruajë, duke na uruar edhe duke na këshilluar me këshilla të urta, edhe duke na angazhuar të punojmë për të ndritur e për të lartësuar motrat tonë.*» Ishte zakoni i tij, të ndiqte edhe nga larg me vëmendje veprimtarinë e miqve dhe t'i ndihmonte. Këtë e shohim në ato pak letra që na kanë mbetur nga Naimi. Miqtë e rinj që ai bënte, i kishte veçanërisht kujdes.

Sic e pamë, takimet me Naimin ishin frymëzime. Ai i nxiste veçanërisht talentet e reja. Zbuloi Çajupin me sa duket përpëra se ky t'i zbulonte vetes aftësitë për të shkruar shqip. Çajupi kishte nisur të shkruante frëngjisht, se kështu bënин shumë njerëz në Lindjen e Afërmë, po me sa duket qe takimi me Naimin që i dha zemër të shkruante në gjuhën amtare. Ky takim historik për letërsinë e Rilindjes sonë është i viteve 1896-97.

Ato vjet, Naimi interesohej posaçërisht për botimet shqipe. Bie fjala, për ato të Shoqërisë së Biblës. Në fund

të viteve 80, kjo shoqëri nxori dy botime, — përkthime të Kristoforidhit, të redaktuar nga Gjerasim Qiriazi, — me alfabetin e Stambollit, me kërkesën e patriotëve tanë të Korçës e të Bukureshtit. po sidomos me nxitjen e Naimit. Naimi nuk arriti t'ia impononte përfundimisht atë alfabet Aleksandër Thomsonit. që drejtonte degën e shqërisë protestante londineze në Stamboll. Thomsoni u rikthyenë shkroniat greke më 1895, me ribotimin e «Psalltirit» në dialektin iugor. Poeti u zemërua jo vetëm për shkronjat, por edhe për brendinë e veprës. Dimë se ai nuk kishte dashur më 1889 që Thomsoni ta ribotonte atë vepër. që sipas misionarit mund të tertiqatë edhe myslimanët shqiptarë. Naimi i tha: «*Oh, mos shtypni «Psallmet» kuit i duhen ato?*» Dhe ai i rekomandoi nië libër leximi me pjesë të ndrvshme, për shkollat. Po shqëria botonte vetëm libra të fesë. Thomsoni ia bëri të ditur qendrës propozimin e Naimit; Londra nuk pranoi. doemos. Nuk duhet menduar se poeti ishte kundër psalmeve, se toleranca fetare e tij është e njerohur. Ai donte një botim më të gjerë dhe aktual në përbaitie dhe jo se nuk i pëlcante përkthimet e Kristoforidhit, nga të cilat mësoi shumë. Po dhe alfabet të huaj nuk donte.

Naimi, kuqtohet. luftonte për alfabetin e Stambollit. — «të Frashërit». sic është quajtur ndrvshe. meqë i atribuohei jo pa të drejtë kryesisht Samiut. Pravë, nuk do arrihej që ai alfabet të bëhei i përbashkët: botimet e De Radës e të Kristoforidhit. p.sh., nuk e përdorin. Më 1908. në Kongresin e Manastirit. alfabeti i Stambollit bëri çëndresën e fundit dhe u adoptua dhe ai. po me të përdhunë. përkrah nië alfabeti tjetër. atii të sotmit. që u imponua pastaj në nië kohë krejt të shkurtër. Pas vdekies së Naimit, me gjithë punën e luttën aë u bë, shokët e tij nuk dolën të fituar. Alfabeti i tvre ishte shkencor, po paraqiste vështirësi shtypshkrimi.

Që më 1891 nisim të marrim vesh për shqetësimet e reja fizike të shkrimittarit. Influencia. — nië lloji sëmundje virale e rrezikshme, — atë e ka mbajtur nja dy

muaj në shtrat dhe nuk do të vonojë që «sëmundja e mushkërive» dhe pastaj «gryka» t'i shfaqen. Megjithatë, në verë të vitit 1895, sipas atyre që e kanë vizituar, ai ishte me shëndet mirë, ndonëse «afif». Studenti elbasanas, për të cilin kemi folur, na thoshte: «*Atëherë duket se s'i kishte rënë ende laringjiti. Zërin e kishte të plotë dhe nuk kollitej kur fliste.*» Ky mjek i ardhshëm ka vëzhguar mirë. Sëmundja iu shfaq nga mesi i atij viti. Në shtator, Naimi vetë na mëson në një letër të tij, se ka bërë tre muaj sëmurë, «*po tani kam zënë e marrë vetëhenë*». Në nëntor, shpresat ishin përsëri pér mirë. Një dr. Shaban i shkruante dr. Ibrahim Temos: «*I madhi qe keq nga laringjiti tuberkular, po na kishte dashur shumëjeta që po na shërohet.*» Pra njerëzit s'e kishin humbur shpresën.

Po Naimi kishte hequr një laringjit të fortë që në fund të viteve 70 në Janinë: kishte qenë detyruar të fliste pak ose të mos fliste fare, pér disa muaj. Tani sëmundja iu rikthye tjetërsoj dhe poeti e kuptonte rrezikun fatal, ndonëse nuk e bënte veten. Më 1898, një patriot shqiptar që deshi të takohej me të në Stamboll, nuk e gjeti në shtëpi; Naimi, që sëmundjen e mbajti më shumë në këmbë, guxonë e shëtiste me orë. Ai kthehej kështu në vitet e djalërisë, kur bridhët shumë anës së detit e kodrave, si ka rrëfyer Tahsini. Aso-kohe, këto qenë çaste dëfrimi dhe diskutimesh e planesh; tani, poeti ngutet t'i shijojë natyrës bukuritë, i pangopur, dhe meditimi përcillet me mjaft zymti. Mbasse viteve të fundit edhe misticizmi iu shhta.

Këtë e shohim që te «Mësimet», ku vërtet lexojmë proza të admirueshme patriotike, si ajo «Liga e përjetshm' e shqipëtarët», po libri ka shumë moralizim, në të cilin gjemjë hyjnинë si një gjykatës e arbitër suprem. Kështu më 1894. Më 1896, Naimi do të botojë «Fletoren e bekta-shinjet», këtë si «kanonizmë» (rregullore) të sektit. Libri mban kushtimin: «Dhuruarë më emërit të të ndyerit Abdyl bez Frashërit, prej të rinjve shqipëtarë». Dy vjet më vonë Naimi do të botojë poemën e vëllimshme të «Qerbelasë», histori e vjershëruar e sektit.

Eshtë thënë më se një herë se Naimi pati një iluzion: shqiptarët ishin fetarë, po të ndarë në tri fe; ata kishin nevojë për një fe që t'i bashkonte. Këtë bashkim «mund ta bënte» bektashizmi, tolerant nga disa anë! Të tjerë patën menduar që këtë ta bënte protestantizmi! Me të drejtë, Noli i ri eshtë ngritur kundër iluzioneve të tilla, po me një tjetër iluzion edhe ai, që kryefetarët patriotë do të mund të luanin një rol vendimtar në lëvizjen kombëtare, pranë parësisë patriote; atyre këshillonte ai t'u drejtoheshim më parë, duke mos pasur ende një besim të mjaftueshëm në masat, të cilave efektivisht ai po u drejtohej. Pashko Vasa kishte hedhur parullën «*feja e shqyptarit asht shqyptaria*» dhe ndër ata që luftuan më shumë për këtë parullë qenë Naimi dhe Noli. Po ja që Naimi kërkonte dhe ndihmën e një «feje të mirë», e cila të débonte dy të tjerat, të mos ishte e ngatërruar me interesat e tyre të huaja politike, përkundrazi, të ishte kundër tyre, patriotike, si përpiquej ai ta bënte të tijën.

Sidoqoftë, në këto të mos ngulim këmbë, se dëshmi të qarta s'kemi. Ata që e kanë njojur Naimin në fund të jetës, të gjithë, kur eshtë puna për fenë e për fetarët, tregojnë se si poeti u fliste vazhdimisht kundër bestytnive dhe vazhdimisht për shkencën e arritjet e të ardhmen e saj, që do t'i ndërronte faqen njerëzimit. Le të përmendim edhe një herë vizitën e të riut elbasanas të vitit 1895, bashkë me mikun e Naimit, klerikun e lartë ortodoks. Sa pa u ulur mirë, pa nisur ende të përshëndeten, Naimi e priti Visar Plakun me vargjet që nisi të recitonë nga poema «Parajsa»:

*Dhe ju hoxh' e ju dervishë,
mos shihni xhami dhe kishë... —*

Me fjalë të tjera, «të jemi tolerantë në punë feje; unë këtë predikoj; dhe ti këtë u prediko këtyre të rinxve, dhespot».

Një tjetër ka dëshmuar se shkoi te poeti me disa shokë dhe atje gjetën një baba bektashi, që nisi t'i mo-

lloiste për «mrekullirat e imamëve»; të rinjtë vunë buzën më gaz e gati sa s'u kukurisën. Babai u zemërua dhe i bëri rezil. Naimi ia uli nervat e i tha: «*Nazar i mirë, ato që tregon zotrote, ca si unë dhe i dëgjojnë, po ca si këta s'i dëgjojnë e mos ua trego. Përrallat e kanë humbur fuqinë.*»

Edhe nëse Naimi, në fund të jetës, pati disa shfaqje misticizmi më shumë, prapë kjo nuk ndikoi, sadopak, që të prekej vija e tij e përgjithshme shkencore iluministe. Jetën e tij e mbushte Shqipëria. Veprat e fundit që botoi ishin «Histori e Skënderbeut» dhe «Histori e Shqipërisë»; e para, «*testamenti i tij politik*», e dyta, një mësim atdhedashurie. Ka të dhëna që poemën e madhe epike ai nuk e përshtati vetë për shtyp, por ia përgatiti Samiu, ndonëse vetë i bëri korrekturat. Me kujdesjet e këtij libri e ka pritur Andon Zakon. Me të në dorë e priti Josif Bagerin.

Bageri, patriot e demokrat revolucionar nga malësitë e Rekës së Dibrës, — sot në Maqedoni, — i kushtoi më pas një nga shkrimet e tij më të bucura asaj vizite te Naimi. Ai shkruan: «*Në vitin 1898, më 12 të vjeshtës së parë, patëm fatin e mirë të ndeshemi me shpirrndriturin e të paharruarin kurrë, Naim bej Frashërin, i cili atë kohë ishte i sëmurë, po na priti si fëmijën e vet dhe u morëm vesh fort mirë, duke u marrë vetëm me çështjen kombëtare. D.m.th. kuvendi ynë ishte vetëm për çështjen kombëtare.*»¹ Të krijuhet përshtypja se Bageri me qëllim e theksion dy herë faktin se ata folën *vetëm për çështjen e madhe*. Ai ka dashur t'u kundërvihet pikërisht atyre që, në mos me shkrim, me gojë, flisnin për kujdeset mistike të Naimit dhe, sigurisht, e tepronin, duke i pasur këto kujdese shpesh të vetat.

Patrioti i ri na flet për kujdeset gjuhësore të poetit, që sulmonte Faik Konicën se tek «Albania» botonte

1 Bageri shkruante në të folmen e vet; tekstin e vumë në shqipen e sotme letrare. Kështu kemi vepruar edhe me ndonjë citim nga autorë të tjera.

edhe artikuj shqip me alfabetin arab, — me «shkronjat e merimangës», siç i quante Naimi. Ky rekomandonte që shqipja të shkruhej në dialektet e saj, që të dilnin në shesh thesaret e gjuhës. Poeti i ka gjetur zemrën të riut, i cili mendonte se duhej shkruar, në mënyrën besnike, po të ngushtë dialektore, si fliste populli, duke mos e kuptuar Bageri sa duhet se ku qëllonte poeti.

Naimi, sigurisht, duke kërkuar një gjuhë sa më të kuptueshme për gjithë shqiptarët, nuk ua priste hovin atyre që shkruanin në dialekt. Ideali i një gjuhe të përbashkët ishte ende një lakmi që nuk arrihej dhe shkrimtari nuk kishte iluzione për këtë çështje, siç kishte fjala vjen De Rada për gjuhën e vet. dhe as rekomandime, p.sh., për një të folme gjeografikisht të mesme, si Jubani me shumë të tjerë.

Bageri na dëshmon: «Nxorëm librin «Lulet e verës» prej xhepit dhe lëçitëm në faqen 43 vjershën «Gjuha jonë», për të cilën na pyeti se a e marrim vesh mirë». Shoku që ishte me rekasin nuk mori vesh nja dy fjalë, — gjë që na duket sot vërtet fort e çuditshme, kur lexojmë vjershën, — dhe Naimi ia shpjegoi, duke thënë: «A e shihni se kemi nevojë për shkronjës prej të cilëve do të dalin në shesh fjalët?» Mësojmë jo vetëm «tolerancën» gjuhësore të Naimit, por edhe mënyrën e tij të punës për pasurimin e fjalorit: ai shënoi dy fjalë të panjohura që dëgjoi nga të rinjtë.

Josif Bageri, duke pasur parasysh çka mund të kishte dëgjuar andej-këndej nga ndonjë shqiptar i nxituar, thekson pastaj fort se Naimi «nuk ishte egoist, as monopolizues, por ishte burrë vendi», që dëshironte të shihinte sa më shumë shqiptarë të lëronin gjuhën, që «i bindet së vërtetës dhe i jepte dorën atij që mundte». Thua se këto fjalë i përgjigjeshin Konicës, i cili, duke i shkruar më 1902 Asdrenit për artikullin e këtij kundër «oxhakësisë» (feudalëve), shpifte kundër Vëllezërve Frashëri dhe rrëthit të tyre familjar: «Po lemë të të thom që këtu, se ay njeri që të foli aq lart për Abdyl benë, — i cili u dërgua në Shqipëri më 1878 naa sulltani. — s'di ç'thotë», kurse në një letër tjeter: «Shahini e Sho-

qëria kanë një tjatërë programë: për ata duhet të unjësh kokën përparrë Naimit. Për ata Naimi është kryeja e jundi i Shqipërisë; Naimi krijoi gjuhën e të tjera». Sha-hin Kolonja pamë se ishte dhëndër i Naimit.

Bageri i njihte ato opinione, që poetin po e për-ndiqnin edhe pas vdekjes. Pra, vitet e fundit të Naimit qenë edhe vite të një lufte të pandërprerë. Këtë e dëshmon ajo pak gjë që na ka mbetur nga letërkëmbimi i Vëllezërvë Frashëri, e dëshmojnë edhe letërkëmbimet e tjera të kohës.

Konica i sulmonte Naimin e Samiun se me «gje-pura», me abetare, do ta çlironin Shqipërinë! Këtë e bënte pikërisht në fillim të vitit 1897, kur poeti gatitej të shtypte «Historinë e Skënderbeut», gjë që dihej. Po pasi botoi tri numra të fortë të «Albanisë» dhe dr. Temos me shokë u shkruante se duheshin aksione «revo-lucionare», — fjalë është e tij, — Konica e bënte menjëherë revistën organ të një politike tepër të matur kundër Turqisë, lypte përulësish hirët e sulltanit, s'kërkonte vegse disa liri kulturore, shkruante për t'u bërë qejfin turqve dhe turkofilëve gjer me alfabetin e push-tuesit, priste që Shqipërinë ta ndihmonin miliarderët amerikanë Rotçildë! Zbatonte me tërë zellin Faiku politikën e Austro-Hungarisë imperialiste që e subvencioni.

Është tanimë e njojur një letër që Naimi dhe Samiu i dërgonin më 1898 Murad Toptanit, ku ata për këto flisnin kundër Faikut, që i riu Murad të kishte mendjen. Po nga letërkëmbimet del se mosmarrëveshja Naim-Faik kishte plasur përparrë numrit të katërt të «Albanisë». Që në shkurt, Naçoja priste që Faiku t'i sulmonte në organin e tij të dy vëllezërit Frashëri. Kurse Naimi, për t'i dalë borxhit kundërshtarit, të cilit sigurisht ia çmonte aftësitë, botoi tek «Albania» tri vjersha më 1897, duke nisur nga numri 3 i revistës dhe duke vazhduar gjer te numri 5. Ato mund t'i kishte botuar në çdo tjetër organ të shtypit shqiptar, i cili jo vetëm shkruante me admirim të veçantë për të, po riprodhonë dhe pjesë të tij përherë e më shumë, tani që ky shtyp u fuqizua, ri-

prodhonte nga «Mësimet», nga «Parajsa», «Histori e Skënderbeut» dhe vjersha të ndryshme.

Vjersha e parë tek «Albania» ishte poema «Shqipëria», e vitit 1880, aq revolucionare në tingull dhe që Naimi s'e kishte botuar ende. Ai vazhdonte me «Pellazgët», duke përpunuar sadokudo vjershën që kishte dalë më 1884 në Bukuresht dhe që s'e kishte përmbledhur në ndonjë libër. Vjersha e tretë, «Feja», dëshmon për çastin mistik të autorit.

Po lufta ishte ndezur, ndonëse nuk dukej fort botërisht. Samiu dhe Naimi i shkruanin saktë Murad Toptanit se Faiku «përherë prish punë», ata godisnin mbështetjet që ai kërkonte gjer te Rodçildi, kurse ata kërkonin që «shqiptarët vetë» ta bëjnë Shqipërinë; domosdo e sulmonin edhe për çështjen e alfabeteve. Më 1899, Samiu botonte «Shqipëria çka qenë, ç'është edhe çdo të bëhet», pasi kishte botuar përpara një viti Naimi «Historinë e Skënderbeut». Ja cilët ishin revolucionarët. Patriotët mund të gjykonin.

Më 1896, Naimi kishte hyrë në fazën e rëndë të sëmundjeve të tij. Përmirësimi i përkohshëm që pati atëherë në grykë, u dha shpresë të afërmve dhe patriotëve. Revistar që dolën më 1897, përpinqeshin të kishin secila ndonjë vjershë, poemë ose fragment poeme, prej botimeve të tij ose të pabotuara më parë. Visar Dodani i «Shqipërisë» priste ndonjë artikull, po treguan se Naimi nuk u mor asnjëherë me publicistikën. Edhe sëmundja tani e kishte reshtur shumë nga puna krijuar. Botimet që i bënин të tjerët, sigurisht, ishin gëzime të veçanta për të, por edhe plagët që nuk po shkruante gjë të re, duhej ta kishte të madhe.

Për vitin 1900, që ishte edhe ai i keqësimit përfundimtar të sëmuridjes, nuk dimë gati asgjë, ndonëse ata që e kanë vizituar qenë të shumtë. Dimë se Bajo Topulli, i cili sapo kishte mbaruar studimet e larta pedagogjike në Stamboll, vajti dhe e vizitoi në tetor, sigurisht me përgjërimin e nderin e madh që ushqente rinia shqiptare për poetin, dhe që ta shohë për herë të fundit e të këshillohet me të, që t'i premtojë edhe, siç i ka prem-

tuar, se do të punojë pa kursyer asgjë për qëllimin e vendit.

Naimi i mbylli shtë më 19 të atij muaji tetor, një të shtune në mëngjes. Vizita e Bajos ruan tërë kuptimin dhe hijen e një simboli. Poetin e varrosën në Merdy-venqoj, pranë varrit të Abdylit.

Përfytyrojmë se, në ato grahma të fundit, autor i «Historisë së Skënderbeut» dhe i «Dëshirës së vërtetë të shqiptarëve», të riut Bajo Topulli aksione revolucionare do t'i ketë frymëzuar. Më 1897, kur ishte i sëmurë dhe rrallë ngrihej, një ditë që mori vesh se ushtria greke ishte shtyrë thellë në Çamëri, gjatë luftës me Turqinë, Naimi thirri gjithë të afërmit e i ftoi të niseshin, se ai vetë do t'u printe me armë për të mbrojtur vendin. Kristo Luarasi, fill pas vdekjes së poetit, i drejtohej Nikolla Naços me letër në Bukuresht dhe, duke i folur për shkollat shqipe të Kolonjës e për Petro Ninin, që ishte gati të punonte edhe pa shpërbirim, e përfundonte: «*Mos dëgjoni se ç'ju thonë, — kështu ka thënë vjershëtori i madh që na la shpejt, — po vini re se ç'gjë punojnë..*»

Naimi vdiq si mësues i kombit dhe patriotët shqiptarë e mbajtën veprën e tij si një porosi të madhe.

Jehona të vdekjes së Naimit dhe e kujtimit të tij

Pas atyre që kemi shkruar, lexuesi, pa dyshim, e merr me mend se kush detyrohej ta quante humbjen e Naimit një humbje kombëtare, — «një zi për kombin tonë». Pikërisht Faik beu tek «Albania», ai që në leturat e tij private çfarë s'e quante, aq sa të duket e pasueshme po të mos i kesh lexuar. Por «Albania» si mund të mbante emrin që mbante dhe si mund të prishte që të shkruanin shqiptarët në faqet e saj, — Gura-kuqi, Gjeçovi, Çajupi, Asdreni etj. — si mund të qarkullonte më tej në duart e shqiptarëve, nëse nuk luante atë rol dyfyrësh? Faik beu nuk kishte asnjë fytyrë.

Nuk i shënuam këto në krye të këtij kapitulli mbi jehonën e vdekjes dhe të kujtimit të shkrimittarit të madh Naim për t'i dhënë lexuesit një shembull nga ajo që thuhet «ironi e kohës», po për të treguar se figura e Naimit ishte imponuar në të tillë mënyrë, që dhe kundërshtarët më brutalë të tij s'kishin si të mos pranonin,

se ai ishte një ndër përfaqësuesit më kryesorë, në mos më kryesori, i lëvizjes së Rilindjes Kombëtare. Po çka shkroi më 1900, Faik beu do ta profanonte disa herë më pas dhe sidomos në ditën kur erdhën eshtrat e Naimit në Atdhe. Beu që s'e kishte për gjë të pohonte më 1900 çka mohonte në shpirt, për poemën «Histori e Skënderbeut», dy vjet më parë, kishte premtuar se do të shkruante «në numër që vjen» të «Albanisë», pasi kishte dhënë shkurt lajmin e vlerësimin e saj, po s'shkroi as në numrin që erdhi e as në katër dhjetëvjeçarët e tjerë që do të vinin. Ai e gieti më për mbarë të botonte më frëngjisht (1898) «Fletoren e begtashinjet», që mund të interesonte disa studiues të huaj. Për humbje të mëdha si Naimi, një Konicë mund të kishte thënë «vdis të të dua»; ai tha «vdis të të urrej edhe më keq».

Po dhimbjen e ndjeu kombi. Le t'i rikujojmë ligjet me të cilat e tha gjëmën Çajupi, që e ndjeu aq fort:

*Vdiq Naimi, vdiq Naimi,
moj e mjera Shqipëri!
Mendielarti, zemërtrimi,
vjershëtori si ai...*

*Vdiq Naimi, po ç'të gjeti,
o moj Shqipëri e mjerë!
Vdia Naimi, po kush mbeti?
Si Naimi s'ka të tjerë.*

Vdia Naimi, po kush mbeti! Po ia, kishte lindur Çajupi dhe po lindte Noli e do të lindnin të tjerë, ndonëse talentet unike, siç ka qenë Naimi, kur vdesin para kohe, duken të pazëvendësueshme. Në humbjen e tvre ka një të vërtetë të tillë tragjike. Naimi vdiq ende i ri. Ai kishte punuar vetëm 15 vjet për letërsinë shqipe; shëndeti nuk i premtoi të punonte edhe 30 të tiera. E tillë qe humbja. Humbje të tillë s'janë të zëvendësueshme.

Naimi do të kishte parë lirinë, do ta kishte kënduar me zjarr. Por edhe do të kishte derdhur tërë

zemëratën e do të kishte qarë me lot gjaku për atë gjysmë Shqipëri që u çlirua. Dhe Shqipëria kaloi shpejt nga duart e Ismail Qemalit e të shokëve të tij, të atyre që mund ta çonin përpëra, në duart e të tillëve si Esad Pasha dhe Turhan Pasha, që për pak sa nuk i bënë varrin; të atyre që e lanë pas shumë, në mënxyrë, si Zogollli që e shiti dhe e pëershiti dhe i përgatiti puhimin mizor italian.

Naimi, realist në jetë, e dinte qëkuri se s'mund të priste nga e ardhmja e afërt shpëtimin e vërtetë shoqëror, por edhe prapambetjen që s'u shkul s'mund ta pandehte se do të qëndronte e tillë. Ai nga çlirimini priste shumë. Ai do të kishte ndier brengat më të rënda dhe, si pasardhësit e tij, Çajupi, Noli e Migjeni me të tjerë, do të kishte parë nevojën e të tjera luftërave të mëdha për popullin e vet. Këtë, gjithë veprë e patriotit dhe iluministit na bën ta përfytyrojmë. Prandaj që dhe kombi e qau me lot ngashëryes, këtë e kuptojmë sot dhe e ndiejmë plotësisht.

Kush poet e kush patriot që zinte pendën me dorë nuk u lëndua atëherë rëndë nga humbja? Shtjefën Gjeçovi e Jani Vruho, Asdreni e Filip Shiroka, Spiro Dine e Thanas Tashko, Visar Dodani e Andon Shkaba, Thoma Avrami, Milo Duçi e kaq e kaq patriotë, nga Shqipëria vetë e nga mërgimeti shqiptare dhe arbëreshe. Dhe kështu jo vetëm muajt pas vdekjes, po për vite me radhë, e pakta për dhjetë vjet. Kurse jehona e veprës së tij vetëm rritej.

S'kishte gazetë e revistë shqiptare, kalendar e libër leximi, që të mos botonte diçka prej tij, — që nga «Shkëndij» e diellit ndaj manushaqes» te «Lig» e përjetshm' e shqiptaret», që nga «Dëshira e vërtetë e shqiptarëve», te «Shqipëria» që dilte si broshurë. Më 1902, më 1905, më 1908, më 1915, më 1918, më 1920. Jo rast e pa rast, po në çastet e mëdha të jetës së kombit ato vjet, çaste revolucionare, kryengritjesh popullore, ndeshjesh për liri, çelje shkollash e klubesh, themelime gazetash e revistash të reja, shpallje pavarsie, kongresesh kombëtare, luftërash me armiq të

vjetër e të rinj, kur fjala e tij ishte ngado aq e kërkuar. Shkruanin tani për të zelltarë të rinj të publicistikës e të kulturës, si Muço Qulli e Kostaq Cipo, paravësish se ndonjë Gjergj Çako e bënte «filoitalian» poetin, kur italianët mbanin nën thundër Vlorën. E përkujtonte më 1921 rinia te varri i tij në Stamboll, duke shprehur dëshirën që eshtrat e poetit t'i kthente në «*qytetin e tij historik*» ku lindi, kurse studentët shqiptarë të Austrisë, në përvjetorin e 25-të të vdekjes, botonin një përbledhje poezish të tij, poezish të tyre, kujtimesh e studimesh.

Aty, një poet që tanimë zinte një vend të shquar në poezinë shqiptare pasnaimjane, Lazgush Poradeci, botonte dy vjersha nga më të fryshtuarat e krijimtarisë së vet. Njëra prej tyre ishte në vargun aq të plotë dhe melodioz, — vargu naimjan i «*Bagëti e bujqësisë*»:

*Në çetële të kujtimit, që dhëmkoset pak nga pak,
ia shënova kohës sonë fluturimin vraparak...*


Ishte hedhur parulla e kthimit të eshtrave të Naim Frashërit në atdhe. Çështja shkoi gjer atje, sa të ngrihej në parlamentin shqiptar më 1925, kur Zogu ishte kthyer në fuqi me kundërrrevolucionin e dhjetorit 1924. Një ndër deputetët, duke e përkrahur propozimin, nuk ndenji pa rrëfyer «*gjendjen e ngushtë financiare për pagimin e rrogave, sidomos të xhandarëve*». Cinizmi nuk ka fund. Kurse një deputet tjetër vërente se «*s'kemi akoma një plan të kryeqytetit dhe pra është e kotë të ngrejmë monumente*». Një i tretë «shqetësohej» për disa patriotë të tjerë, që kërkonin edhe ata ato ndere... Nga të fillonin më parë zotërinjtë parlamentarë? S'e gjenin dot fillin deputetët e Ahmet Zogut. Kështu na informon «*Gazeta e Korçës*». Përfundimi: «*U shty për tjetër herë*». Priti satrapi vitin e 25-vjetorit të paravësisë që të mund të lezetonte veten në sy të popullit, duke sjellë eshtrat e poetit në atdhe, — dhe Faiku priti ditën që t'i përsëndyente popullit poetin

dhe ditën, me një artikull që nga Uashingtoni. Cinizmat s'kanë fund.

Më 1930, dr. Temoja, mik i Vellezërve Frashëri, që pati vizituar atëherë Stambollin, — ai jetonte në Dobruxha, — ishte kthyer së andejmi i pikëlluar dhe kishte shkruar në shtypin e mërgimit: «*Në teqenë e bektashinjve Merdyven, në një kodër të vogël afër udhës, dergjen varret e Abdyl Frashërit dhe të Naim Frashërit... Dervishi më tha se, në kohë të operacionit, anglezët kërkuan armë edhe nëpër varret. Kështu u profanuan vërtet. Një tjetër më tha se mbi një pllakë ishte shkruar kështu: «Hybdyl vatan, minel yman», d.m.th. «dashuria e atdheut vjen plot besim», dhe nga ky shkak shovinistët, të zemëruar, i rrishën varret». Dhe për dëshmi, dr. Temoja botonte fotografinë e tyre. Sigurisht, ndërgjegjija kombëtare shtrëngonte grushtet e shtrëngonte dhëmbët. Nxënësit e Shkollës Normale të Elbasanit do të viheshin të mbledhin ndihma për t'i sjellë domosdo eshtrat e poetit në atdhe...*

Duhej të vinte populli në fuqi që t'i vinte të gjitha në vend, që sot të kishim vërmendoren e Vellezërve Frashëri në kryeqytetin e Shaipërisë. «*Dashuria e atdheut vjen plot besim.*» Populli që ruan dashurinë, e ruan atë besim në çdo furtunë, në këngët e tii të reja, ai i këndon sot Naimit pikërisht ashtu siç i pati kënduar Çajupi më 1900, — «*Naim Frashëri mendjetrimi!*»

VEPRA



Mendimtari dhe ideologu

Duke folur për traditat e pasura të popullit shqiptar në fushën e kulturës, për vlerësimin e tyre shkencor, për vënien e tyre në shërbim të së tashmes, shoku Enver Hoxha është ndalur më se një herë në traditat progresiste të Rilindjes sonë Kombëtare. Ai ka theksuar se «...rilindësit *ishin njerëz të shquar me ide përparrimtare*», «*iluministë revolucionarë, të guximshëm dhe me një atdhedashuri të madhe e të zjarrtë*». Po, nga ana tjetër, «*rilindësit tanë duhet të vihen drejt në epokën kur kanë jetuar, punuar dhe luftuar, duhet të vihen në dukje idetë e tyre, të cilat *ishin prodhimi i zhvillimit të shoqërisë së asaj epoke, duhet të vihen në dukje qëllimet e tyre, ku synonin imediatisht dhe në perspektivë*. Rilindësit «*kanë anën e tyre negative, që duhet t'i nënshtronhen kritikës sonë marksiste-leniniste. Këto dobësi qëndrojnë në botëkuptimet e tyre filozofike, të cilat janë idealiste.*»¹*

1 Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», Tiranë, 1977, f.276.

Këto vlerësime mbi rilindësit dhe këto parime metodologjike mbi studimin dhe njohjen e së kaluarës së jetës sonë mendore, janë të një rëndësie të madhe për shkencën tonë mbi letërsinë dhe na ndihmojnë për depërtimin e saktë në veprën e Naim Frashërit.

Një ndër mendimtarët më kryesorë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare është Naim Frashëri, përkrah të vëllait të tij, Samiut, përkrah të vëllait tjetër Abdylit, apo të Zef Jubanit, Pashko Vasës, Jani Vretos, Jeronim de Radës, Vinçenco Dorsës dhe të tjera personalitetet nga më të shquarat e kohës së vet.

Historia e mendimit shqiptar, që nga Marin Barletti (fillim i shek. XVI) e këndej, d.m.th. që nga koha fill pas Skënderbeut, mbetet për të përvjuar. Burimet e patriotizmit shqiptar, në fushën e mendimit, i gjemë te Barleti dhe bashkëkohësit e tij, dhe i njohim që nga Skënderbeu dhe njerëzit e ditur që e rrrethojnë, p.sh. një Pal Engjëll, humanist e këshilltar i tij. Le të rikujtojmë letrën e famshme të Skënderbeut dërguar pricinct të Tarantos më 1460.

Temat e mëdha të dashurisë për atdheun, të sakrificës për të, të krenarisë për të kaluarën e lashtë të popullit tonë, — të cilin humanistët, me të drejtë, e shihnin të prejardhur nga popujt jogrekë të Ballkanit, dhe shumë njerëz tanët, p.sh. prizrenasi i ditur Pjetër Mazrreku, e quanin me të drejtë autokton në trojet ku ai banonte (1633); — temat e ndihmesës së shqiptarëve për mbrojtjen e qytetërimit evropian, në periudhën e Skënderbeut, por edhe më pas, me kryengritjet e tij të vazhdueshme, që, p.sh. në shek. XVI-XVIII, gozhdonin në Shqipëri armatat turke dhe bënin të dështojnë synimet e sulltanëve për të hedhur detin e për të sulmuar Italinë; temat e meritave të veçanta të shqiptarëve dhe të stërgjyshërve të tyre në artin ushtarak, të meritave të larta të karakterit të tyre, — p.sh. besa, për të cilën flet aq krenarisht Barleti; — këto tema, që do të jenë në qendër të letërsisë, të artit dhe të mendimit shqiptar të Rilindjes sonë Kombëtare, i kanë shtjelluar, përpunuuar e argumentuar, sipas kohës, Pjetër

Budi e Frang Bardhi, Pjetër Bogdani e Nikollë Keta (arbëresh i shek. XVIII) me shumë të tjerë.

Duke ngritur lart karakterin e shqiptarëve, një patriot i mesit të shek. XVII, Mark Kryeziu, shkruante: «*Shqipëria, sikundër ae e fundit që u vu nën zgjedhë prej barbarëve, nuk ka ndryshuar zakonet e veta nga ato që kishte kur jetonte i paepuri princi i saj Skënderbej.*» Thua se na flet një rilindës i dy shekujve më vonë.

Koha e re, ajo e lëvizjes kombëtare shqiptare, përmes veprave të Veqilharxhit dhe të pasuesve të tij, dijetarë e ideologë që përmendëm, njerëz të veprimit politik e letrar, kjo kohë atyre temave do t'u pasurojë përbajtjen, do t'ua aktualizoië atë, do ta vëré atë në shërbim të lëvizjes për një Shqipëri jo vetëm të lirë, por edhe të përparuar e demokratike. Besimi që pati karakterizuar përherë patriotizmin shqiptar në masat e popullit, besimi në vetvete, — në forcat e veta, — ja një fill i kuq, i cili ndërlidh mendimin patriotik shqiptar të atyre shekujve që prunë te Rilindja Kombëtare dhe te poeti i saj, Naim Frashëri.

Më lart pamë se si shoku Enver Hoxha rilindësit i karakterizon si «*iluministë*». Iluminizmi, kjo lëvizje e madhe mendore që pushtoi shek. XVIII të përgatitjes së borgjezisë për revolucionin që ajo do të bënte atëherë në Francë, nisi t'i përhapte idetë në Shaipëri që asohere. Një filozof, si Theodhor Kavalioti, i cili jetoi e dha mësimë në Voskopojë, ishte edhe një iluminist me disa ide progresiste për kohën. Përmetari Kos-tandin Duka, këshilltar i Aliut të Tepelenës, kishte qenë në Paris mik i enciklopedistëve. Në Janinë, ku do të studionte Naimi, në kohën e tij dhe më parë, idetë iluministe dhe progresiste zienin që nga dhjetëvjeçarët e mesit të shek. XVIII.

Përbysja që pësoi feudalizmi në Evropë, aspirata që morën zhvillim në një shumicë popujsh të roberuar nga sultani, — edhe në popullin turk vetë, — për të dalë një ditë ose një tjetër, dhe sa më shpeit, në një jetë më të denjë, për liri kombëtare, për dije

dhe përparim shoqëror, fituan një gjallërim shumë të madh. Racionalizmi, materializmi borgjez, zhvillimi i shpejtë i shkencave, hovi industrial e tekniko-shkencor, zhvillimi i përgjithshëm që mori shoqëria kapitaliste midis të dy shekujve të fundit, u bënë ide dhe ideale edhe të intelijgencies së kombësive që vuanin nën zgjedhën mesjetare anadollake. Zhvillimi i tregtisë, i zejeve dhe i një farë industrie, krijoj një borgjezi të vendit, e cila, ku më pak e ku më shumë, i bëri të vetat ato ide dhe ideale, dhe kështu shpërthyen lëvizje kombëtare ku më pak e ku më shumë të fuqishme, përpjekje kulturore të shënuara dhe veprime revolucionare patriotike të mëdha.

~~B~~ Ende e njohim pak procesin e zhvillimit të mendimit patriotik e filozofik shqiptar që solli te Naim Frashëri. Po ky vetë dhe i vëllai, Samiu, kështu edhe Vretoja e ndonjë tjetër, p.sh. Hoxha Tahsini, na habisin ndonjëherë me guximin e mendimit të tyre, pa harruar, domosdo, kufizimet e tyre. Kufizimet ishin të kohës, që i shpjegon. Dhe, nëse do të kërkonim një mendim konsekuent shkencor tek ideologët e Rilindjes sonë, ka rrezik të binim në anakronizëm, duke harruar se kjo është periudha kur, në Shqipëri, kanë filluar të shthuren vërtet marrëdhëniet feudale, po këto marrëdhënie mbahen ende fort. Ato qenë të tilla, sa, gjer në çlirimin e plotë të Shqipërisë nga populli i saj, i udhëhequr prej partisë së proletariatit, më 1944, shoqëria shqiptare mbeti një shoqëri, që e cilësojmë feudal-borgjeze; shteti i saj mbeti një shtet i këtillë, ku borgjezia e ndante sundimin me feudalët.

Është folur shpesh për panteizmin e Naimit. Është treguar se si shprehja themelore e konceptit të tij filozofik është një panteizëm me një thelb mistik. Panteizmi nuk e ndan idenë nga materia dhe këto, për të, kanë qenë përfjetësisht. Ai thelb i filozofisë së poetit tonë qëndron në faktin se Naimi idenë inherente te materia e quan «perëndi». Në vjershën e tij më të njojur filozofike, «Perëndia», kjo vihet re që në titull. Dhe Naimi shkroi edhe vepra me karakter fetar, si, bie fjala, poema e gjatë «Qerbelaja». Ai ishte një besimtar bekt-

shi dhe bektashizmi është një besim fetar panteistik.

Sidoqoftë, ky lloj idealizmi, që është panteizmi i Naimit, i lehtësonte udhën rilindësit tonë drejt racionalizmit. Në filozofinë mesjetare të Lindjes, me poetë si Nizamiu, Omar Khajami etj., panteizmi pati luajtur rolin e tij përparimtar, i veshur, kuptohet, me rroben fetare, sipas kohës. Në filozofinë e re evropiane, me filozofë si italianni Xhiordano Bruno dhe holandezi Baruh Spinoza, në shek. XVI-XVII, panteizmi luajti një rol të madh progresist. Panteizmi ishte atëherë një mjet i përshtatshëm i përhapjes së ideve materialiste. Brunon kisha e dogji të gjallë si heretik.

Engelsi, te «Ludvig Fojerbah», thotë se sistemet idealiste, duke marrë elemente materialiste, «*kërkonin ta kapërcenin kontrastin midis shpirtit dhe materies në mënyrë panteistike*». Sot kërkimi i pajtimit midis shpirtit dhe materies, perëndisë dhe shkencës, është reaksionar. Në kohën e racionalizmit evropian, si dhe në kohën e Naimit, kur sundonte feudalizmi dhe feja, kjo ishte një mënyrë përparimtare e afrit me shkencën, e pasurimit me këtë.

Naimi e përmend Spinozën në shkrimet e tij, po nuk dimë sa e ka lexuar. S'ka dyshim se panteizmi i tij nuk ka një burim perëndimor, po lindor. Sidoqoftë, duke kthyer sytë nga racionalizmi i shek. XVII, nga Dekarti etj., racionalizëm ku bënte pjesë edhe Spinoza, Naimi i kthente sytë, mund të thuash, gati vetëm nga natyra dhe nga njeriu, kur merrej me shkencën. Poeti mendonte se njeriu është në gjendje, me forcën e arsyes, të depërtojë në «të fshehtë» e natyrës, të njoħë ligjet e saj, t'i shpjegojë dukuritë e saj, ta përdorë natyrën pér nevojat e tij. Térëjeta e njeriut dhe e shoqërisë, pér Naimin, është një përpjekje pér t'u bërë dita me ditë edhe më shumë «*zot i natyrës*» me anë të shkencës.

Kështu Naimi e ngrinte lart filozofinë racionaliste në sy të lexuesve të tij, duke marrë, nga ana tjetër, një pozitë të qartë kundër iracionalizmit dhe teologjisë, kur shkruante te «Historia e përgjithshme» kundër «filozo-

fëve të vjetërë, që dojnë të merreshinë shumë herë më gjérëra të patrupta», p.sh. latini Seneka. «*Eshtë m'e vjejturë fjal' e Dekarit, — thoshte ai, — që është një nga filozofët e rinj, që thotë: pse të merremi me punëra që s'na sjellënë ndonjë të mirë? (...) Të marrëm vesh ç'janë gjërat që na sheh syri, (...) të mësojmë ç'janë, e me këtë mënyrë njeriu të bënë zot i naturës.*»

Edhe Samiu pati shkruar që në 1879, në librin e tij turqisht «*Qielli*», se *nuk ka asnjë të fshehtë në të cilën njeriu nuk duhet të përzihet, s'ka asgjë të cilën ai nuk mundet ta zbulojë.*» Dhe ai godiste haptazi bestytnitë, në thelb teologjinë, duke folur mbi zbulimet e mëdha shkençore të Galileut, Njutonit, Kantit, Laplasit etj.

Kemi aty më lart, sikundër shihet, një qëndrim për shkencën dhe mundësitë e pashtershme të saj. Kështu mendimtari ynë Naim përqafoi rezultatet më revolucionare të shkencës moderne, gjer edhe teoritë mbi origjinën planetare të botës dhe mbi zhvillimin e saj dhe të qenieve të gjalla, teorinë e Kant-Laplasit dhe atë të Darvinit. Çdo shpjegim tjetër i botës, për Naimin, bën pjesë në «*përrallat*», si shprehet ai. Në mendimin e tij shkencor s'ka gjetur vend shpjegimi i botës sipas «*Ungjive*» dhe «*Kuranit*». Ai ka besuar vetëm te kjo botë e te gjithësia «*pa anë e fund*»; «*parajsën e skëterrën*» i ka gjetur mbi tokë dhe s'ka shpresuar në një botë apo jetë të përtejme, «*siç besojnë ata që s'dinë*», polemizon hapur poeti. Dhe nëse një a dy herë në poezinë e tij hasim besimin metempsikik,¹ këtë e kuptojmë si shprehje ekstreme të panteizmit të tij.

Bën përshtypje dhe bie menjëherë në sy, kur lexojmë tërësinë e veprave të Naimit, se ka një ndryshim midis paraqitjes së botëkuptimit të autorit në veprat poetikë dhe në ato me karakter fetar ose etik, dhe paraqitjes së atij botëkuptimi në veprat «*diturake*», që shkrimitari hartoi për shkollat. Rrallë i gjejmë në këto të fundit konceptet mistike. Po gjejmë një përpjekje të

¹ *Metempsikoza* — doktrinë sipas së cilës shpirti mund të kalojë nga një trup në tjetrin.

ndërgjegjshme për shpjegimin shkencor, antiteologjik, të zhvillimit të gjithësisë, të botës, e së fundi, të qenieve të gjalla. Dheu ynë është një «*drudhësë*» materie, e shkëputur nga dielli; ai u zhvillua përmes katër epokash gjeologjike; gjatë këtij zhvillimi lindi edhe materia organike prej asaj inorganike; në epokën e fundit lindi njeriu, i cili prejardhjen e ka «*nga një farë majmuni*»; vetë njeriu mori zhvillim dhe shoqëria njerëzore ka vajtur e vete në rrugën e «*mbrothësisë*» etj. Njeriu është «*një pjellë e natyrës*», thotë Naimi. Nëpër shekujt e gjatë, kjo pjellë e natyrës, — pra, jo e perëndisë, — vjen nga gjendja e «*kafshërisë*» në giendjen e «*qytetërisë*», kurse qytetëria, shkrimitari nuk thotë konkretisht se përmes çfarë procesi do të shkojë përpara e ku do të shkojë; por ai ka besim se me anë të shkencës. Duke besuar në progresin shoqëror të pandalshëm. Hasan Tahsini e lidhte atë me «*procesin e njohjes*», që përtë, si «*dhe e vërteta, s'ka fund*».

Naimi s'e kishte konceptin e luftës së klasave. Në konceptin e tij mbi zhvillimin e shoqërisë, si dhe rilindësít e tierë, ai mbeti një idealist. Mendimtari ynë është i bindur se rruga e progresit s'ka marrë fund. Kjo rrugë, përtë, është rruga e zhvillimit të pandërprerë në kohë, siç mendonin dhe iluministët e shek. XVIII. Në fakt, ky do të ishte zhvillimi i pandërprerë i sistemit borgjez vetë dhe Naimi, si edhe Samiu, nuk është patakim me filozofinë pozitiviste borgjeze të kohës së tij, që këtë predikonte. Ajo filozofi ishte e njohur në qarqet e reja intelektuale të Turqisë dhe kishte ndikimin e sai mbi to. Po, ndërsa tek ideologët e borgjezisë në fuai në Evropë e gjetiu, kishim të bënim me nië orvaitje reaksionare përtë përijetësuar rendin kapitalist, në kohën kur lëviziet e proletariatit kërkonin përbalsien e atij rendi, te Naimi dhe Samiu kishim nië kërkesë përaparimtare të kohës në Shqipëri: ishte pikërisht kërkesa e borgjezisë përaparimtare përtë kaluar Shqipëria nga feudalizmi në nië shoqëri më të avancuar, sic është, e krahasuar me të, shoqëria kapitaliste. Kjo kërkesë mbështetej dhe e kishte burimin në vetë rrugën, sado ende

Naim Frashëri

jo të shtyrë shumë përpara, që kishte marrë zhvillimi i marrëdhënieve kapitaliste në vendin tonë.

Këto janë ndër vetitë kryesore të botëkuptimit të mendimtarit Naim, botëkuptim që, nga njëra anë, është për një shpjegim shkencor të gjithësisë e të botës, kurse, nga ana tjetër, nuk vete përtej një përfytyrimi të progresit njerëzor në ftyrën e zhvillimit borgjez të shqërisë.

Sado që në themel të botëkuptimit të tij të përgjithshëm Naim Frashëri ishte një idealist, në kohën kur në perandorinë e sultaneve dhe në Shqipëri sundonte feudalizmi dhe botëkuptimi fetar, përpjekja që botën dhe qeniet e gjalla, vetë dukjen e njeriut në tokë, t'i shpjegojë me anë të shkencës, braktisja e shpjegimeve etare, besimi në progresin shoqëror dhe vështrimi i progresit sipas ftyrës së shoqërisë së përparuar të kohës, ishin pozita dhe pikëpamje me karakter revolucionar të theksuar.

Në këto pozita ishin edhe përfaqësuesit më të avancuar të mendimit shqiptar të kohës, secili, kuptohet, me origjinalitetin e vet të shtrimit të kësaj apo asaj çështjeje.

Mospajtimi është vërtet i dukshëm, siç thamë, midis, nga njëra anë, koncepteve që Naimi shpreh në «Dituritë» e tij dhe në libra të tjera shkollorë, dhe, nga ana tjetër, koncepteve fetare, që gjemë në panteizmin e tij, duke vazhduar edhe me shfaqje të koncepteve të monoteizmit, sidomos në veprat poetike. Janë, pastaj, edhe shkrimet dhe veprat fetare të tij, si «Fletore e bektashinjve» apo «Qerbelaja», disa proza të «Mësimeve» të tij, etj, Këto luhatje nga njëra kategori veprash te tjetra marrin një karakter kaq të hapët, sa, edhe duke ditur se Naimi nuk i organizoi mendimet e tij në një vepër të vetme a në një sistem filozofik, ato na bëjnë përshtypje me atë mospajtim flagrant, si mund të thuhet.

Shpjegimi se kështu poeti mund të arrinte më shpejt e më drejtpërsëdrejti me propagandën e tij patriotike dhe me mendimin e tij përparimtar te masat e besimtarëve, siç ishin lexuesit e kohës ndër ne, është sigurisht një

pjesë e së vërtetës. Në fakt, poezia, gjatë historisë së saj, u m.brujt me figurat e mitologjisë, të legjendave, të fesë, të të mrekullueshmit në përgjithësi. Koha kur jetoi poeti ynë, nuk e ndihmonte që të shkëputet nga ato figura e procedime. Dhe, nëse në vjershat e tij Naimi do të flasë për një botë «të krijuar» e për një «krijestar», pavarësisht se kjo bie në kundërshtim me konceptin e tij themelor filozofik, panteizmin, nëse ai do të flasë për një «botë të shpirtrave», ashtu si idealisti i lashtësisë greke, Platoni, fliste për një «botë të ideve», — le të kujtohet kënga XII e «Historisë së Skënderbeut», — kjo tregon, pikërisht, se poeti ynë s'ka mundur të mos pasqyronte ndikimin e fesë mbi botëkuptimin e kohës dhe s'ka mundur të mos e pësonte vetë atë ndikim.

Sidoqoftë, kjo nuk shpjegohet thjeshtësisht me «takin» ndaj lexuesit bashkëkohës, apo me traditën poetike në përgjithësi. Kjo shpjegohet, në themel, me kufizimet që koha vetë impononte, me kontradiktat e kohës, të cilat Naimi s'i kapërceu dot, — kontradikta shoqërore, d.m.th. edhe botëkuptimore.

Naimi, si idealist, nuk u shkëput dot nga feja. Përkundrazi. Kjo duket veçanërisht kur është çështja për etikën, moralin.

Ndërsa progresin poeti e sheh në fytyrën e progresit që erdhi me borgjezinë, — për Evropën përpara Revolucionit Francez Naimi shkruan se «*priste Ruson' e Volterë ta zgjuarën ng'ajy gjumë*», nga «*gjumi*» i mesjetës, i feudalizmit, — për marrëdhëniet midis njerëzve dhe sjelljen e njeriut në shoqëri, humanizmi i Naimit, që spikat aq fort, p.sh., në besimin se rruga për të lehtësuar vuajtjet e të varfërve është «*mëshira*», — ndikim fetar ky, — ai humanizëm nuk i cenon marrëdhëniet klasore të kohës. Për të, «*më i vogli duhet ta nderojë më të madhin e më i madhi të përkujdesnjë më të voglin*»; kurse dhunës në shoqëri, predikon të mos i përgjigjemi me dhunë, sipas parimit kristian të mosqëndresës ndaj së keqes, «*të bien në një faqe, kthe dhe tjetrën*», — natyrisht jo kur është fjala për detyrën ndaj atdheut: për atë luftojmë

me pushkë në dorë, armikun e vrasim, japim dhe jetën! Po kur është fjala për marrëdhëni midis njerëzve, poeti bën arbitër hyjninë, — si të punoni «këtu», do të keni edhe shpërblimin «atje», «në atë jetë».

Sado me qëllim të mirë, që njerëzit të veprojnë drejt ndaj njëri-tjetrit, të ruhen mos veprojnë keq, Naimi është në pozitat fetare. Pozita të njoitura këto të një humanizmi mbiklasor.

E megjithatë, është e madhe dashuria e poetit me njerëzit e thjeshtë, më popullin punonjës, besimi i plotë tek aftësitë e tij, mbështetja që ai dhe rilindës të tjerë kërkonin te masat.

Për Naimin, Shqipëria ishte, në radhë të parë, populli punonjës, Samiu kishte shkruar më 1876: «*Populli është themeli i shtetit; sa më i fortë të jetë ai themel, aq më shumë qëndron godina*». Tërë synimi i vëllezërve patriotë iluministë ka qenë që shqiptarit t'i jepte kulturen, ta fuste në rrugën e dijes e të qytetërimit, të këmbente gjendjen e tij të mjerimit ekonomik e shoqëror. Këto ideale ai i kushtëzonte me krijimin e Shqipërisë së lirë, po gjithashtu përpiquej që diçka të realizohej edhe në kushtet e robërisë.

Përpjekja e Naimit për çeljen e shkollave shqipe, për themelimin e arsimit shqiptar, ishte e lidhur me përpjekjen çlirimitare, por i përgjigjej edhe idealit për një të ardhme më të mirë për popullin e vet. Dhe bie menjëherë në sy se ai që mund të quhet sistem i edukatës që kërkon Naimi, dhe që e përvijon edhe më qartë Samiu, me shkollat për të gjithë e në tërë shkallët pa dallim kamjeje dhe seksi, me shkencën në themel, me shkëputjen nga kisha, ai ishte një sistem shumë përparimtar për Shqipërinë e kohës.

Iluminizmi i Naimit ishte një iluminizëm që synonte «*ndriçimin e gjithë kombit*». Këtë, pa dyshim, Naimi e kërkonte si një ideolog borgjez, po tek ai, si te rilindësít demokratë, kjo merrte një karakter të gjerë popullor dhe karakterin e një idealit të flaktë, që i kushtohet popullit punonjës, me besimin se ai ideal mundet e duhet të realizohet, se aty është i pritmi vetë i Shqipërisë.

Në fakt, ky i pritëm nuk do të vinte me Rilindjen, po Naimi aspironte për shumë më shumë nga ç'mund të sillte koha e tij, dhe këtu qëndron një nga bukuritë e veprës së tij dhe e zemrës së tij të gjerë.

Kur ishte puna për emancipimin e gruas, Naimi nuk shkonte më larg se rritja e rolit të saj në familje, porse zëri që ai ngrinte për zhvillimin e saj kulturor baras me burrin, në vetvete supozonte shumë më shumë. Çimi i lartë që ai kishte për rolin e gruas në formimin e brezave të rinj, të cilët do të siguronin progresin shoqëror, nuk ishte thjeshtësish ngritja e prestigjit të nënës brenda shoqërisë feudale dhe patriarchale, që atë e ndrydhë dhe e shtypte si mos më keq, po, drejtpërsëdrejti, pohimi se gruaja mundet dhe është e domosdoshme të marrë pjesë në përmirësimin e gjendjes shoqërore, se pa rolin e saj nuk mund të arrihet përparimi i vërtetë në shoqëri. Samiu shkruante se «*gratë janë në gjendje t'i kryejnë gati të gjitha punët sikurse burrat*». Pra, sipas Naimit dhe Samiut, edhe duhet ta përgatisim gruan përkëtë, duke nisur nga respekti që ajo kërkon në familje. Dhe ashtu si për shkollën, ashtu edhe për emancipimin e gruas, poeti nuk i zgjat dorën fesë. Rolin ia jep diturisë, kulturës, tek e cila e ka besimin e madh për emancipimin jo vetëm të femrës, po të njeriut, të shoqërisë në përgjithësi.

Këto dalin qartë kryesisht nëpër faqet e librave të Naimit për shkollat, si «Këndimet» etj., dalin edhe te «Mësimet»; i gjejmë, ku më pak e ku më shumë, në tërë veprën e shkrimittarit dhe mendimtarit. Këto janë të lidhura ngushtë me mendimin e tij patriotik, po gjithashtu edhe me një humanizëm të gjerë, i cili, ndonëse në thelb mbiklasor, është humanizmi i një zemre të madhe, që beson dhe aspiron për një të ardhme më të mirë përnjerëzimin. Ai i do të barabartë popujt e racat, do lumi-të rartë për të gjithë ata që s'e kanë, ushqen respektin më të lartë për qenien njerëzore, ai që shpall: «*dhe falëtore kemi njerinë*».

Për Naimin, si dhe për rilindës të tjerë, duke mos haruar idealizmin apo dhe fetarizmin e tyre, duhet

shënuar se ata filluan të ndeshen me fenë, apo u përpqën ta pajisin shqiptarin me botëkuptimin shkencor. Ata u përpqën t'i largonin njerëzit nga dogmat obskuratoriste, sadopak ta kenë bërë këtë gjë. Kështu, p.sh., kryeideja e «Qerbelasë», si një legjendë islamike-bektashiane, është ajo e ndeshjes së të mirës me të keqen, triumfi i të parës mbi të dytën. Është e qartë, nga ana tjetër, se Naimi e shkroi atë poemë të gjatë fetare për ta térhequr lexuesin besimtar në lëvizjen kombëtare. E kuptojmë edhe më mirë synimin patriotik të autorit, po të vëmë re se poema e tij qe edhe kundërveprim ndaj «Hadikasë» së Dalip Frashërit të krijuar gjysmë shekulli më parë. Kjo vepër mbi dogmën bektashiane, ishte e mbetur edhe nga leksiku osman e përgjithësish oriental. «Qerbelaja», ku Naimi është i lidhur më shumë se kudo me fenë, apo bën «historinë e shenjtë» të një sekti, ndoqi rrugën e përkthimeve fetare të Kristoforidhit, po duke e çuar edhe më tej këtë rrugë, me një farë shkarimi të asaj historie nga dogma.

Lufta edhe në platformën fetare qe e natyrshme të bëhej gjatë Rilindjes sonë, në një kohë kur masat popullore ishin besimtare dhe kur dasia fetare luante një rold të rrezikshëm, pasi atë e nxiste jo vetëm pushtuesi, por e nxisnin edhe shovinistët fqinjë, edhe fuqitë imperialiste. Dhe kështu, një pjesë e madhe e klerit të besimeve të ndryshme, e klasës feudale, por edhe një pjesë e borgjezisë, veçanërisht më të pasurit, bëheshin vegla të të huajve. Merita e madhe e Naimit dhe e rilindësve të tjerë qe se ata përmbi fenë vunë atdhenë. Me një parullë të tillë ata luftuan fort për unititetin e popullit, luftuan klerin reaksionar dhe përçarjen fetare ngado që vinte.

Po, nga ana tjetër, kjo supozonte dhe kërkonte edhe tolerancën fetare, sikundër supozonte akoma luftën përritin shqip dhe për libra fetarë në gjuhë të pastër shqipe, luftë për të cilën u anguazhua pjesërisht edhe Naimi, si qe angazhuar Kristoforidhi e do të vepronë më pas Noli. Dhe kjo ndihmon për të shpjeguar më se një kufizim, por edhe koncesion të rilindësve më përparimtarë në

botëkuptimin e përgjithshëm të tyre; kjo ndihmon për të shpjeguar aspekte të ndryshme të idealizmit, që tek ata mbisundoj si botëkuptim.

Duke predikuar tolerancën fetare, Naimi nuk ngu-rroi të ngrihej me rreptësi të madhe kundër klerit dhe dëmeve shekulllore të tij. Te «Historia e përgjithshme», ai sulej në mënyrë të tillë kundër Vatikanit: «*Në këto kohëra, papa dhe gjithë priftëria kishinë fuqi të madhe në Evropë; bota ishte pas syresh si bagëtia. Papa Grigor' i shqatë i përzjeu kaqë mbretërëtë, saqë më 850 gjer më 1100 pas K., 250 vjet, s'pushoi luftha e trazimi.*»

Idealet shoqërore të rilindësve ishin përparimtare, por edhe të kufizuara. Koha, që shtonte detyrën e madhe të qirimit kombëtar, nuk shtonte ende detyrën e revolucionit shoqëror, me atë borgjezi tepër pak të zhviluar si klasë, që Shqipëria kishte. Borgjezia shqiptare jo vetëm që nuk e ndiente veten të fortë që të përbyste feudalizmin, bashkë me shporrjen e pushtuesit, por e kërkonte aleancën me klasën sunduese në luftën që ajo bënte kundër pushtuesit. Ca më shumë, në projektkushtetutën e Sami Frashërit, te «*Shqipëria ç'ka qenë, çështë e ç'do të bëhet*» (1899), «*parësia*», d.m.th. në radhë të parë klasa feudale, mbetej në fuqi. Po patrioti demokrat kishte besim, — sigurisht, kjo ishte më shumë një dëshirë e para-realizueshme dhe e ardhmja e aférme këtë vërtetoi, — se vetë parësia, me dashjen e saj, «*do të merrte udhën e qytetërimit*», pra, do të borgjezohej, dhe kështu Shqipëria vetë do të merrte po atë udhë, si shtet autonom apo i lirë. Vëllezërit Frashëri ishin antifeudalë të vendosur. Samiu p.sh. shkruante më 1881: «*Ndryshimi në mes një feudali dhe atij prerësit të rrugës me kusarin e natës* eshtë *në forcën e tyre të shumtë ose të paktë*.»

Këto ishin, gati pikë për pikë, edhe idetë e Naimit për të nesërmen politike të Shqipërisë, që do të vinte përmes evoluimit të brendshëm të saj dhe me iniciativën e parësisë së «ndriçuar», sado që, nga ana tjetër, të dy vëllezërit e kanë shpallur haptazi dhe pa druajtje, se janë kundër monarkisë, gjë, që, tek ata, nënkuptonte se janë edhe kundër përfjetësimit të feudalizmit, pa harruar se

Naim Frashëri

godasin personin e sulltanit vetë. Naimi shkruante te vëllimi i dytë i veprës së tij shkollore «E këndimit të çunavet»: «*Plekësi a dhimokrati thuhetë kur nukë ka mbret, po të zgjedhurit venë vetë për një kohë një të parë, si është Franca sot*». Dhe te «*Historia e përgjithshme*»: «*Dhimokratia (ajo e vitit 1789, Dh. Sh.) dhe liria e madhoi Francën së gjithash (...)* Më 1804, Bonaparti u bë mbret i Francësë e *dhimokratia*, q'u ble me shumë gjakëra, humbi përnjëherë». Dhe prapë po aty: «*Më 1870, Franca humbi luftën e Alsasnë Lorenë, po fitoi dhimokratinë*». Samiu shkruante (1881): «*Revolucioni i viteve 1789 dhe 1793 (...) i hapi sytë krejt Evropës me një dritë të jashtëzakonshme dhe kjo lëkundje vazhdoi deri më 1848, madje deri më 1871.*».

Këto që cituam dhe pohime të tjera, e zbulojnë mirë qartë mendimin antimonarkik dhe antifeudal të Vëllezërve Frashëri dhe idealin e tyre demokratik të përparuar.

Duke folur për rilindësit tanë si mendimtarë, shoku Enver Hoxha thotë se ata «...ishin iluministë dhe kanë genë frysmauar nga revolucioni klasik demokratiko-borgjez i Francës Për këta dijetarë dhe njerëz të aksionit të popullit shqiptar, filozofët dhe mendimtarët që përgatitën revolucionin francez, si Didëroi, D'Alamberi, Volteri, Rusoi e të tjera, ishin të njobur jo në mënyrë të përciptë... Por, pavarësisht se ishin të frysmauar nga ky revolucion, si dhe nga revolucionet e tjera që u zhvilluan më vonë, më 1848, në gjithë Evropën..., mendimtarët e mëdhenj të popullit shqiptar ishin më të përparuar. Kjo shpjegohet me faktin se koha, zhvillimi dialektik materialist i historisë, i bëri këta ta shikoinin situatën e kombit shqiptar, të atdheut të tyre, dhe zhvillimin e politikën e Fuqive të Mëdha, me një sy tjetër nga sa e kishin parë revolucionarët francezë të revolucionit demokratiko-borgjez dhe të revolucioneve të tjera të vitit 1848 e më vonë që u zhvilluan në shumë shtete të Evropës.»¹

1. Enver Hoxha. «Disa mendime për rilindësit», në Studime politiko-shoqërore, T 1982/2 f. 12-13.

Në ballë të këtyre mendimtarëve ishin Vëllezërit Frashëri. Shoku Enver Hoxha e quan «*program madhështor*» atë «*të rilindësve të Shqipërisë, me epiqendër Sami dhe Naim Frashërin*». Ai u rekomandon historianëve që shkrimet e Leninit dhe atë program të kenë parasysh, «*në interpretimin e fakteve historike të kësaj periudhe*». Dhe shton: «*Që të mos gabohemi për vlerësimin e ngjarjeve të kësaj periudhe, sipas mendimit tim, një bazë për orientim janë pikëpamjet filozofike, teoreke, moralo-politike dhe organizative të Samiut e të Naimit, të cilët në përgjithësi ishin revolucionarë, progresistë, patriotë, demokratë-borgjezë, liberalë, të përshtatshëm për kohën*»¹.

Programi dhe taktika e Naimit dhe e shokëve të tij qenë realiste dhe ata i dhanë një drejtësim të përshtatshëm, të drejtë e të hovshëm, lëvizjes kombëtare, së cilës i prinë në kushtet e zhvillimit të shoqërisë shqiptare të kohës, kushte që paqyroheshin si në veprimtarinë, ashtu edhe në mendimin e rilindësve.

Naim Frashëri Naim Frashëri

¹ Enver Hoxha, Vepra, vell., 23. f. 134.

Naim Frashëri

Fillimet poetike shqip të Naimit

Më 1880, kur njohim të parin poemth shqip të Naim Frashërit, nuk mund të thuhet se ai hiqte dorë nga vargjet persiane, që shkruante që në vitet kur ishte në Janinë, kur thellohej në mësimin e kësaj gjuhe, pasionohej pas autorëve të saj, duke pasur ndër poetët më të preferuar Sadiun, Nizamiun, Xhelaledin Rumiun, turk ky, po që shkruante persisht. Ata i zbuluan tërë një botë poetike dhe atëherë ai, me sa duket, u dha më shumë pas tyre se pas Dantes e Miltonit, Hygosë e Lamartininit, që disa i kishte pasur edhe në programet e shkollës. Kjo shpjegohet jo vetëm me vlerat estetike të poezisë së tyre, por edhe me një përmbajtje të afërt panteistike të botëkuptimit që ata kishin pasur dhe që afrohej me botëkuptimin e Naimit.

Duke shkruar për poezinë e Lindjes e të Perëndimit, më 1896, Naimi ka për të pohuar, në parathënien me të cilën e përcjell përkthimin e tij shqip të «Iliadës» së

Homerit (këngë I): «*Vjersh' e Azisë ka bukuri të madhe, shije të shumë, rrjeshtë të mirë, masë të pëlqyer, fjalë të xgjedhura e lodra të ndryshme*. Po *vjersh' e Europës ka mejtëm më të lartë*. Eni të gjithë kanë vlefte më vetë-he.»¹ Tani jemi në një kohë, kur Naimi ka vjet që e ka kthyer vështrimin sidomos nga poezia evropiane, po prapë Sadiun nuk e kujton vetëm si poet, por edhe si një «*nga të mirëtë*», d.m.th. nga të shenjtët. Dhe vjershëtorëve të Persisë, midis të cilëve «*m'i mirë e m'i madh i tyre është Firdevsiu*», «*shoku i Omirit dhe i Virgililit*», ai do t'u vejë pranë edhe lirikun osman Fuzuliun, i shek. XV, të cilin e quan «*mbret të vjershëtorëve*», dhe që ka për t'i përshtatur shqip «*Hadikanë*», duke e quajtur «*Qerbera*».

Çka cituam, na jep një ide të kulturës poetike të Naimit dhe të parapëlqimeve të tij. Ai ndalet në disa emra të mëdhenj dhe givkon saktë. Sidoqoftë, duke u kthyer nga Evropa dhe poezia e saj, romantiku Naim ka për të vështruar sidomos në kohën e tij dhe, në mes të bashkëkohësve, për të, «*ngjan të mbajë kryenë përpjetë Lamartini*». Edhe këto janë shprehur në parathënen që i bëri Naimi përkthimit të vet shqip nga «*Iliada*».

Jemi në fund të krijimtarisë së tij poetike dhe, në e pastë bërë atë përkthim me kohë, — një përkthim turqisht pamë se Naimi e botoi që më 1886, — poeti ka përligjur pikërisht veten, jo vetëm si adhurues mbi të gjithë i Homerit, pa harruar dhe Virgilin, po veçanërisht edhe pse çmonte tani vjershën e Perëndimit mbi atë të Lindjes, për «*mendimin më të lartë*» të saj.

Domosdo që poetit tonë, romantizmi i Evropës do të fillonte një ditë ta afronte e ta mbante më shumë, pikërisht me frymën e kohës. Po, nëse tregoi një admirim të veçantë për Lamartinin, ndonëse Evropa kishte romantikë shumë më të përparuar në mendimin e tyre, ar-

1 Me fjalën *rrjeshtë* Naimi kupton vargun dhe me atë *masë-metrin*; me *lodra* — shkathtësinë në të kombinuarit e vargjeve, të rimave etj.

syet mund tē kenë qenë nē radhë tē parë dy. Njëherë se Lamartini, ndonëse pati shprehur për shqiptarët edhe ndonjë gjykim tē ngutur, ishte treguar, fundi i fundit, një gjykues i drejtë i tyre, kur nē veprën e tij «Histori e Turqisë» ai thoshte se lufta e shqiptarëve nën Skënderbenë «*ishte më pak fetare dhe më shumë kombëtare*». Kur më 1825, Lamartini kishte provuar të shkruante vazhdimin e poemës së Bajronit, «*Cajlld Harolld*», ku admirohej Shqipëria dhe karakteri shqiptar, ai u jep-te nē këtë mënyrë hakën shqiptarëve: «*Nuk ka pendë as penel që mund tē shprehë sakrificën heroike tē banorëve (tē Shqipërisë) nē luftërat që kanë bërë kohëve tē fundit, më shumë se askush tjetër, për çlirimin e Greqisë.*» Ishte një e vërtetë që rilindësit, nē ndeshje me shovinizmin grek, detyroheshin ta përsërisnin dhe që u vinte veçanërisht mirë ta dëgjonin prej gojës së një autori tē njohur evropian.

Arsyeja tjetër e admirimit tē Naimit për këtë poet është , se kur autori ynë po duket nē letërsinë shqipe, Lamartini ka bërë emër nē Turqi, dhe jo vetëm sepse i kushtoi Turqisë një vepër vëllimore, por edhe se romantizmi i tij, nē poezi dhe nē prozë, kishte doza tē një sentimentalizmi që do tē karakterizonte fillimet e letërsisë moderne turke nē pjesën e dytë tē shekullit, si dhe letërsitë e disa vendeve tē sunduara nga Turqia. Këtij sentimentalizmi nuk i shpëtoi as letërsia jonë, jo kaq nē poezinë e saj, që, duke u lidhur fort me idealet e çlirimt kombëtar, fiton tiparin e saj kushtrees, sa nē ato fillime tē dramës e tē romanit artistik që shkruan ndonjë autor yni nē gjuhë tē huaj, — p.sh. «*Besa*» e Samiut turqisht (1875), «*Bardha e Temalit*» e Pashko Vasës frëngjisht (1890), — gjer te prozat e vogla tregimtare tē Samiut e tē Naimit vetë, gjer te ndonjë përkthim i Naimit turqisht nga sentimentalizmi i vonuar, pasromantik francez, si «*Të katër stinët*» (1881). Leximet e preferuara tē Vëllezërve Frashëri, siç e pamë, ishin krijime tē llojit dhe pamë se si iu vu punës Samiu për tē kthyer turqisht një vepër shumë tē njohur tē llojit, romanin «*Të mjerët*» nga Hygoi,

Më 1880, Naimi, me anë të Vretos, dërgonte në Bukeq kuresht poemthin e tij të parë në gjuhën amtare, «Shqipëria». Nuk kemi ndonjë të dhënë që ta ketë dërguar për botim në ndonjë organ shtypi të Rumanisë, si bie fjala në gazetën «Iris», që dilte greqisht dhe ku botonte një vjershëtor shqiptar gjer dje i panjohur, që i këndoi Lidhjet e Shqiptare të Prizrenit, Nikolla Çakoja, një nga themeluesit e degës së Shoqërisë së Shkronjave në Bukuresht. Treguan se në atë gazetë Naimi do të botonte më 1884 vjershën e tij «Pellazgët», po që atëherë mbante emrin «Nga vjen shqiptari», — cila është origjina e tij.

Sidoqoftë, poemthin duhet t'ia ketë dhënë Samiu Vretos, se atë kohë Naimi jetonte në Janinë. Dëshmitë e kohës flasin për admirimin që ngjalli vepërza me buçitjen shqiptare të saj, — krenarinë për të kaluarën, dhimbjen për të tashmen, besimin e thirrjen për të ardhmen. Patriotët tanë të viseve danubiane s'do të kishin besuar që një «bej» shqiptar të ngrihej në të tillë mënyrë kundër sunduesve turq. dhe për çlirim nga Turqia. Ata i bëri për vete ky poet që u lindi. Poemthi i Naimit nuk është në lartësinë e shkrimeve të mira që bashkatdhëtarët kishin për të njojur së shpejti nga pena e tij, po nëpër vargjet e tij. kishte depërtuar një frysëzim autentik dhe, domosdo, Nikolla Çakoja u duk i zbehtë përpëra këtij poeti.

Vjersha e Naimit niste siç e kemi përmendur me ato vargjet e famshme, të skanduara, ashtu inatçë, dhe që ishin tërë një program për kohën:

*Bota që kur është zënë,
Shqipëria gjall'ka qënë!
Pellazgj u thoshin më parë,
më së fundi shqipëtarë.*

Ishte ky popull, që me emrin legjendar, paraqitej si më i vjetri në Evropë, popull për të cilin Homeri ishte shprehur me admirim shumë të madh, për të cilin kishte shkruar Herodoti. Në kohët moderne, me Kastriotin, pastaj me «Shkodranin» (Karamahmud Bushatin), me

«*Marko Sulin*» (Boçarin), shqiptarët «i dhanë dërmën Tyrgisë». Po, kthehej poeti me dhimbje dhe për të prekur sedrën kombëtare, çfarë fitoi Shqipëria «nga gjithë trimëria e saj»? Fajin që atdheu është në këtë ditë e kanë osmanët, kurse Evropa, «mejtohet për të», d.m.th. s'bën farëgjëje. Po të mos kishim mbetur në padituri, siç jemi, ne do të kishim pasur Aristotelët e Strabonët tanë, Homerët e Eskilët, Virgilët e Dantët. Po kurrë nuk është vonë. Dituria do të sjellë një të ardhme të lumtur për Shqipërinë, hidhet iluministi. Pa dituri në kohën tonë më s'bëhet; pa të, Shqipëria «do të humbet». Pra, vëllezër shqiptarë, «ejani të mbledhim mentë!» Ky është vargu me të cilin e mylli poemthin autorë.

Në Shqipëri luftohet për të mbrojtur vendin nga copëtimi që duan t'i bëjnë të huajtë, po Naimi notën e fundit e ka për diturinë; jo se nënçmon luftën, po se u drejtohet shqiptarëve të Rumanisë, që t'i nxitë të ngrejnë shpejt degën e Shoqërisë së Shkronjave, të themeluar një vit më parë në Stamboll. Dhe ata e ngritën, me vajtjen atje të Vretos. Synimi politik i shoqërisë kulturore ishte i qartë dhe, nëpër vargjet e Naimit, patriotët nuk e kishin të vështirë të zbulonin flamurin që u printe në betejën për gjuhën, pishën që duhej t'i vinin sundimtarit shekullor.

Ky debutim, me përbajtjen e vet, ishte një premtim. Poeti, vëlla i të dy vëllezërve tanimë shumë të dëgjuar Frashëri, ishte aq i mençur dhe aq i guximshëm sa edhe ata, — dhe shkruante atë shqipe! Vjersha, sado modeste, premtonte në fakt shumë dhe ajo shpejt do ta mbante fjalën.

Një vit shumë më i rëndësishëm debutimi për Naim Frashërin ka qenë 1884.

Castet e mëdha të lëvizjes kombëtare nuk vonuan t'i japin fletë talentit që u lindi shqiptarëve në zjarrin e luftës. Naimi, me Samiun, Vreton, Koto Hoxhin, Pandeli Sotirin e ndonjë tjetër, ia kishin hyrë punës përiorganizimin e lëvizjes kulturore shqiptare në Stamboll e pastaj në Aleksandri të Misirit e në Bukuresht, kishin nisur ti koordinonin veprimet me arbëreshët e Greqisë

dhe me ata të Italisë, edhe pse pak e aspak i kishin shfry-tëzuar organet e tyre të shtypit. — të Anastas Kulluriotit e të De Radës. Ata krijuan kështu në Stamboll organin e tyre, revistën «Drita» — «Dituria»¹, me ndërhyrjen, siç e dimë, të Naimit vetë. Ja tek ishte krijuar edhe tribuna që i duhej poetit. Ajo shtypei me alfabetin e krijuar në Stamboll më 1879 dhe ndofta ishte çështja e alfabetit që i bënte patriotët e atyshëm gati të mos bashkëpunojnë në organet arbëreshe, siç mund të kuptohet nga një letër e Naimit, ku ai nuk e pëlqen fare alfabetin e De Radës.

Vepрimtaria e gjerë botuese e Naimit, — me shkrimme «diturake» dhe me viersha të shumta, në të dymbë-dhjetë numrat mujorë në të cilët doli revista, sigurisht nuk shpjegohet me kaq kohë punë. Naimi, s'ka dvshim se ka punuar si rrallëherë në jetën e vet në vitet 1880-85, që puna i kishte aq dukë. Dhe disa arritje të nivelit të lartë është do të tregojnë disa viersha të tii, disa shqipërimë gjithashstu, ajo prozë e shkrimeve të tii për shkollat e ardhme shqipe, prozë që, gjer atëherë, zor se ishte shkruar më e bukur në Shaipëri, të gjitha këto flasin për nië piekuri të meniëhershme të talentit e për një shpërthim të gjithanshëm të shkrimtarit.

Sigurisht, këtë talent e dëshmuani se kishte nisur të pëiae me kohë disa viersha të tii persishtë, që dimë se ai kishte nisur të shkruante që nga fillimi i viteve 70 e aë do t'i vërmblidhë e botonte në librin «Tehajvat», më 1885. Po ndonëse talenti shquante, ai i ndiente verigat e gjuhës që nuk ishte e mëmës, si dhe ndikimet e thella, mund të thuhet, të nië poezie që i ishte imponuar fort. Prej verigave ai do të clirohei mirë vetëm kur të shkruante në gjuhën e tii. Kur Naimi ato nisi t'i këpushtë më 1880, ai ndjeu, s'do mend, gjithë lirinë e shpreh-

1 Tetë muaj përpëra se të dilte kjo revistë, Vretoja, Naimi dhe Samiu e ngushëllonin De Radën për vdekjen e djalit të tij Zefit, me një vjershë të pafirmuar, po që mund të jetë një improvizim i Naimit. De Rada e botoi te «Fjamuri Arbit», shkurt 1884, me titullin «Vaj mbi shtëpin' e Radhanjet». Ajo mban datën 13.I. të atij viti.

jes, të cilën e ndiejmë dhe ne, në më se një nga vargjet e «Shqipërisë». Por ai është ende pak i stërvitur në shkrimin e shqipes. Shpërthimi do të duket më 1884-85, me krijime si «Fjalët e qiririt», me «Shkëndijën e diellit ndaj manushaqes», me një rikrijim që të mahniste shqip, si «Fyelli» i Xhelaledin Rumiut, me njëzet e pak fabula të La Fontenit, që përshtaste, etj., botuar te revista e Stambollit.

Lexuesi të na lejojë që ta nisim citimin me një strofë fabule, për zhdërvjellësinë e vargut, për bukurinë e gjuhës, për saktësinë e detalit, për dialogun e mprehtë:

*Pendë këndesi
kunadhja vënë,
ndrruar dhe zënë,
pulave u erdh;
tha: — Mirëmëngjesi!
Çbëni, si jini?
U ngrit' a flini? —
dhe në mest u derdhë.*

(Kunadhja e veshur si këndes)

Ja një strofë nga «Fyelli», ku, le ta përsërisim, poeti duket sikur flet për veten:

*Gjithë bota më dëgjojnë,
po së jashtësmi më shohin,
dëshirën s'ma kupëtojnë,
zjarr' e brendësmë s'ma njohin.*

A është kështu? Po të polemizonim me vetë poetin Naim, do të thoshim jo me plot gojën.

Mos Naimi ka ende një besim të pamjaftueshëm, të paktë, në efektin e artit të tij, me ato debutime? Mos është një modesti prej artisti, që njeh krijimtarinë e madhe të kontinenteve dhe druhet të çmojë çfarë krijon ai vetë? Mos druhet se mendimi që është duke shfaqur në një gjuhë jo të zakonshme për popullin, në një vjershë si kjo, ka për të qenë e vështirë që

të kuptohet? Sidoqoftë, Naimi, që i kishte afruar aq menjëherë shqiptarët me një «sprovë» poetike, — si mund ta quanin vjershën e tij të gjatë të vilit 1880, — do t'i lërë gojëhapur me krijimet e tanishme, që nisin të dalin te «Drita». Dhe kjo nisje e rrallë merrete gjithë kuptimin e vlerat e saj me vjershën «Fjalët e qiririt», që, nga më se një anë, shpjegonte edhe «Fyellin», që ishte një rikrijim i vërtetë.

Misionin e tij të shkrimtarit patriot, që e vë menjëherë veten në rreshtat e parë të luftëtarëve për ndriçimin dhe qëllimin e vendit, Naimi do ta shprehë përmes vargjesh të tilla, që u drejton tani lexuesve, kombit vetë:

*Në mes tuaj kam qëndruar
e jam duke përvëluar,
që t'u ap pakëzë dritë,
natënë t'ua bënj dité.
Do të tretem të kullohem,
të digjem, të përvëlohem,
që t'u ndrinj mir' e të shihni,
njëri-jatërin të njihni.*

Ky «qiri» kërkon, në fakt, të jetë një pishtar, — të ndriçojë ndërgjegjen kombëtare, e cila ka nevojë ende të ndriçohet, që ta çelë gjer në fund shpejt rrugën drejt lirisë. Poeti është i gatshëm të njohë holaukostin, — të flijohet i téri. S'do të kursejë, për misionin me të cilin e ka ngarkuar veten, asgjë nga mendja dhe zemra, nga frymëzimi dhe dijet e tij. Mushkëritë kanë nisur me kohë t'i preken, por ai, që «digjet për njerinë», humanisti patriot, «digjet si trimi» dhe «djeg mushkërinë», «tretet për njerinë». Një merak ka, se vallë a

*shkruhenë në kartë
fjalët e gjuhës së zjarrtë? —*

Ai i shkroi! Premtimin e mbajti, si vjershëtor i kombit, me térë gjestin e flijimit.

S'ka dyshim se viti 1884, bashkë me vitet pranë, ka genë nga më të mbarët, — në mos më i mbari, — në historinë e poezisë shqiptare të shekullit të kaluar shqiptar dhe të Rilindjes sonë. Vetëm le të përmendim se atë vit Da Rada batoi vëllimin e fundit, të gjashtin, të poemës së tij «Skënderbeu i pafat» (1872-84), ndërsa Mjeda atë vit niste dhe i shtronte në kartë strofat e tij aq të skalitura. Dy vjet më parë, Serembeja kishte botuar, — përfat të keq vetëm në një përkthim italisht, dhe që ishte i dobët, — vjershat e tij. Më 1885, kur edhe vdiq, Dara i Ri firmoste «Këngën e sprasme të Ballës». Serembeja, siç dihet, i goditur nga një sëmundje fatale, rrallë e tek do të gjente tani një çast të vërtetë frymëzimi. Mjeda, qoftë nga pengesat e eprorëve jezuitë, qoftë nga një skrupull artisti që nuk e zë të mbaruar shpejt pünën e tij me vargjet e strofat, rrallë ka për të botuar ndonjë gjë deri në fund të shekullit. De Rada dhe Naimi do t'i përgjigjen lëvizjes patriotike me botime të pareshtura. Jeta e gjatë, — prej gati 90 vjetësh, — De Radës i premtoi t'u kthehet e t'u rikthehet temave dhe poemave të tij mbi shekullin skënderbegian, — «Një pasqyrë e jetës njerëzore», e vitit 1898, ishte prova e tretë, gjatë 59 vjetësh, e trajtimit të poemës së «Serafina Topias». Më 1898, kur Nami 52-vjeçar botonte «Historinë e Skënderbeut», ai kishte mbaruar së krijuari e pakta që tre vjet më parë, ndërsa për të jetuar s'i mbeteshin më shumë se dy vjet.

«Endërrimet» persishte

Viti 1885, kur do të mbyllte botimin revista e Stambollit, tani «Dituria», është dhe viti i botimit të përmbledhjes me vjersha në persishtë të Naimit, «Tehajylat». Ky botim vlen të shihet veç dhe përpara se Naimi të bopotjë librat e tij të parë shqip më 1886. «Endërrimet» tanimë i kemi shqip prej disa vjetësh, në një përkthim të denjë,¹ që na lehtëson punën. Kjo ndalesë duhet bërrë edhe për të kuptuar më mirë se nga vinte poeti dhe se si një talent i tillë arriti aq shpejt rezultatin e një viti më parë dhe rezultatin e një viti më pas. Kështu dhe do të mund ta njohim krijimtarinë e Naimit në tërë kompleksitetin e saj.

Ai i quajti «Endërrime» vjershët e tij persishtë dhenuk lajthiti. Naimi ishte për disa vjet, — e pakta që nga viti 1873, kur kemi të parën vjershë të datuar të për-

¹ Përkthyer nga V. Buharaja. Botuar së pari në «Studime filologjike» 2/1971; 26 vjersha. Ribotuar, pjesërisht, te N. Frashëri, *Vepra*, vëll. I, Tiranë, 1980.

mbledhjes,¹ — ai ishte gjatë një dhjetëvjeçari një poetëndërrimtar, që shqetësohej shumë për jetën, si meditues e filozof, që mendonte shumë për dashurinç, si i ri, që fatkeqësítë familjare, vellezërit dhe fëmijët e vdekur, i gelën plagë mbas plage, po që në lirikat persishtë u shpreh pak për çështjen kombëtare, e cila po merrte dhe mori flakë. Edhe nëse më 1880 ai shkroi shqip poemthin «Shqipëria» dhe, që nga ai vit e gjer më 1885, u bë plotësisht shkrimitar i momentit rilindës, ai vazhdoi të ndiqte zanën e vet persishtë e pakta gjer më 1883, kur kemi vjershën e fundit të datuar² në «Tehajylat».

Disa tituj vjershash na flasin vetë për to: «Pranvera», «Vera», «Dimri», «Hëna», «Lulja», «Bilbili», me temat e tyre të përgjithshme, «të përjetshme», siç thuhet; «Në breg të detit», «Durimi e shpresë», «Filozofi», të karakterit meditativ; «Bota e njeriut», prapë e këtij karakteri, po që shkasin e merr nga jeta, duke kapërcyer në përgjithësimë, të cilat pak e lidhin autorin me realitetin e hidhur, të errët shumë, të një shoqërie që përpinqet të bëjë hapat e parë për të dalë nga mesjeta.

Ai sidoqoftë do t'i këndoje «Atdheut» plot përgjërim, nuk dimë në cilin vit, — vjersha nuk është e datuar, — me hallet e atdheut shqiptar, që dimë se nga mesi i viteve 70 e kanë shqetësuar shumë. Vargjet e para,

*O atdhe, më je i dashur sa më s'ka,
më je nënë, më je motër, më je vlla.
Nga ç'ka rrötull më i shtrenjti ti më je,
je m'i miri nga çdo gjë që mba ky dhe, —*

këto vargje ndërpriten nga kujtimi i dhëmshëruar i nënës së vdekur, veç kur shpérthen gati papritur nga fundi:

*Hi u bëfshin kurdoher' armiqt' e tij!
Gaz për jetë paçin zotërit e tij! —*

1 «Në vdekjen e vëllait».

2 «Zemra e pikëlluar dhe e brengosur».

apo në një distik më parë, që na kujton mbarimin e «Bagëti e bujqësisë»:

*Begatoje, o imzot, ti këtë vend!
Falu njerzve mbrothësi e falu shend!*

Në këtë mënyrë, poeti lidhet me të tashmen dhe «nënë», kush mund t'i bëhet më mirë se toka e tij e dashur? Mund të themi se hymë në notat e poemshit «Shqipëria».

Po shpejt, autori kalon te vjershat mbi brengat e tij familjare, të shkruara në kohë të ndryshme, — 1877-82, ato të datuarat, se ka që s'mbajnë datë. Ndiejmë dhimbje shumë për Naimin e vrarë në zemër, ai që dhe më pas, shqip, nuk ka për të heshtur krejt për familjen dhe vetveten, po që do të mbahet stoik, ndonëse vetes ia sheh përditë e më shumë fundin e shpejtë, me shëndetin që ka.¹

Sidoqoftë, liriku, me tërë të dhënrat e cilësitë e tij, tek «Endërrimet» ishte, pavarësisht se Naimi nuk shkroi në gjuhën e vet. Pranvera ka për t'i kujtuar atij gjithë bukurinë e jetës «bërë krejt trëndafilishtë», «vashën e brishtë, dhe ftyrëzëargjendë», po dhe me trishtim «varrin e mikes», «nga savani» i së cilës «shpërthejnë trëndafil e narcis», po dhe vdekjen e tij, mbi të cilin «cullufuzeza e gjatë» «lotët do t'i shpjerë si vesë», që dhe prej tij «trëndafil e zymbyl» të mbijë.

Jemi më 1875, Naimit s'i ka marrë për mbarë shëndeti, përkundrazi. Bukuritë e gjithësisë e gllabërojnë, — dielli si dhe hëna, ftyra e mikes si dhe deti, lulet si dhe kroi. Le të përmendim vjershën «Në breg të detit», shkruar më 1876, pra në Sarandë, ku poeti njoju një magjepsje të re nga natyra.

Deti për të është «fladitje dhe gëzim» dhe tek ai zemra dhe shpirti i gjejnë gaz. Ai e bën të meditojë

1 Le të përmendim vjersha «E Zonj' e Fatit» (vdekja) dhe «Të vdekurit» (botuar së pari te «Dituria», janar 1885), që do të hynin te «Lulet e verës».

shumë për jetën, — «ç'më fsheh zemra e dëgjoj në të-nden valë, të shoh ty dhe nyjen time zgjidh ngadalë», — kuptoj ngadalë më mirë veten, do të na thotë poeti. Dhe i përtërihen kujtimet nga rinia e tij në mal, pranë bagëtisë që kullot, blegërimat e shqerrave, pllajat, majat e larta, dhe e entuzias «toka jonë dhe të sajat begati». Pas dhjetë vjetësh, ky poet na premton që tanë poemën e «Bagëti e bujqësisë», që dhe atë pranë detit e shkroi, po në mërgim.

Pranë natyrës së vendlindjes, si të mos ia thotë këngës bilbili? — te vjersha me këtë titull, e datuar më 1880. Bilbilin ai e quan «këngëtor zemërdlirë», dhe shton:

*Se ç'na mori zemrën ky vajtimi yt,
ky rënkim, ky ah, përvëlimi yt.
Zemra brenda më dridhmohet kaqë shumë,
shok i zemrës ja t'u bëra tanë unë... —*

dhe ai dëgjon i mahnitur, siç dëgjon natyra gjithë.

Binjaken e kësaj vjershe, autori ka për ta shkruar edhe shqip, për ta botuar pikërisht më 1885 te «Dituria», — dhe më 1890 te «Lulet e verës». Le t'i kujtojmë kësaj vjershe shqipe disa vargje, pikërisht për të parë se si Naimi rishkel në gjurmat e krijimeve të tij të mëparshme persishte:

*Qiej, yj e dhe, pushoni!
Tani juve kush u dëgjon?
Vini veshn' edhe dëgjoni,
bilbili, bilbili këndon.
O bilbil, e di se ç'thua,
andaj zëri bukur yt
më dogji shpirtinë mua,
edhe gjumë s'më hyn në syt.*

Në këto vargje kemi më shumë një mrekullim ndaj këngës, — poezisë, — kurse në vjershën persishte, romantiku, ndonëse jo pesimist, vuan nga dhëmbka që s'e

arriti dashurinë, si ç'kemi për ta parë edhe te poema «Bukuria» e «Luleve të verës». Prapë, na duket, kemi më shumë këtu reminishencat e poezisë lindore, — «bil-bilin që vuan për trëndafilen», — ndonëse jetën e tij intime Naimit nuk ia njohim, që të mos mendojmë edhe për ndonjë dështim dashuror real, që poeti mund të ketë pasur në rini.

Sidoqoftë, atij i është dhënë «Durimi dhe shpresa», — titull i një vjershe të përbledhjes, — dhe, fundi i fundit, stoiku e di se, në shoqerinë ku jeton. «cili vallë rroi pa brenga e andrallë»? Atë botë, — në fakt poeti përgjithëson, flet në përgjithësi për botën, — ai e quan «zuzare» dhe «rrëmallë», «det me brenga dhe me vuajtje plot», ndërsa «shpresën si mirazh përpara». Janë ende reminishenca, nuk duhet pasur dyshim, por janë edhe akuza që nuk përbahen. Nga koha e kaluar ai s'kujton «veç lëngatë» dhe arrin gjer në dëshpërim kur thotë: «Kopshti zemrës s'më ka më trëndafil». Janë dufet më të rënda që ka shprehur ndonjëherë Naimi.

A duhet t'i lidhim ato drejtëpërdrejt me ngjarjet e mëdha të lëvizjes kombëtare shqiptare të vitit 1879, kur u shkrua vjersha? Aludim në to nuk shohim. Arsyë dëshpërimi nuk ka ende për gjendien e Shqipërisë. ndonëse rreziqet paraqiten shumë serioze dhe poeti i njeh, duke i jetuar edhe ai me ankth, si veprimitar i kohës, si të vellezërít, pranë Abdylit. Kjo atmosferë mund të nxiste për ato dufe. Po ne prapë mendojmë se nuk është domosdo atmosfera e ndezur e kohës që do kërkuar në to, po një brengë ndaj jetës në përgjithësi, në përgjithësi ndaj shoqërisë; dhe pastaj prapë ndikimet e poezisë persishte, por edhe të romantikëve të zhgënjyer nga re-aliteti i shekullit.

Është «Filozofi», — tjetër titull vjershe, — që «*ndon veten me aq pyetje*», së fundi për vetë gjithësinë: «*Kush? Pse? Çfarë? Ku e kur? E si e sa?*» pyet e s'merr përgjigje, dhe i duket «*se nga çdo anë tallje ka*». Meditimi ka shkuar larg. «*Ç'është bota, që s'ka krye, fund e anë?*» «*Zogu i mendjes*» mbetet «*i topitur*» dhe «*i ne-*

*mitur», «i pazoti», *Thelbin*» e natyrës «*njeriu nuk e di*», sado që «*ka hyrë thellë*» në njohjen e saj.*

Ndikimet e tij mistike, Naimin e bëjnë pra skeptik. Nuk gjejmë ende tek ai atë sigurinë e madhe që ka shprehur në shkrimet e tij të revistës së viteve 1884-85, mbi mundësitet e njeriut për ta njohur botën dhe për tu bërë «*zot i natyrës*». E, megjithatë, te vjersha «*Lulja*», e padatuar edhe kjo, autori ka nisur të flasë për bindjet e tij, të sakta shkencore, që formuloi në vitet e përmendura. Ai shkruan:

*Dhe nga Dielli na u ndanë Tok' e Hënë...,
dhe u shfaq pastaj ky Dhë që vuri korë,
që u mbush me ujë, bim' e plot frysorë.*

Edhe pse ka përqafuar shkencën moderne, Naimi ka mbetur e do të mbesë panteisti, me *thelbin* mistik të botëkuptimit të tij, ai që përpinqet të pajtojë idealizmin me shkencën materialiste dhe nuk do të mund të dalë prej kësaj kontradikte. Po duke u hedhur në luftë për çështjen kombëtare, poeti ka për t'i dhënë drejtimet revolucionare krijimtarisë së tij, që do të ketë përmision të zgjojë dhe të mobilizojë ndërgjegjen kombëtare, të përgatisë, — në mos ta gëzojë dhe vetë, — lirinë e atdheut, të cilit i uron «*një të ardhme plot lumtëri*» që në vjershëni ku u ndalëm më lart.

«Endërrimet» janë vjersha të viteve 1873-83, po më 1880 poeti kishte nisur të shkëputet mirë prej tyre. Ndonëse më 1885 ai do t'i botojë të përbledhura, gjë që tregon se ruan lidhjet shpirtërore me to. «*Bagëti e bujqësia*» më 1886 ka për të na folur sidomos për atë shkëputje, «*Lulet e verës*» më 1890 do të na flasin si për shkëputjen ashtu edhe për lidhjen, për një kontradiktë krijuar që Naimi nuk e kapërcente dot plotësisht. 1886-a ishte viti i madh naimjan i botimeve: 1890-a do të jetë një vit, në të cilin arti i tij ka për të fituar më shumë përsosuri forme.

«Bagëti e bujqësia»

Më 1886, shtypshkronja e themeluar nga dega e Shqërisë së Stambollit në Bukuresht, që mbante emrin «Drita» dhe që, pas dy vjetësh, do të mbante atë »Dituria», botonte 10 libra, kryesisht për të përgatitur çeljen e të parave shkolla shqipe, që patriotët tanë në Stamboll, në Korçë e në Bukuresht vetë, po përpinqeshin me të madhe t'i bënin realitet, por edhe për t'i dhënë lexuesit shqiptar disa nga krijimet e para të poetit Naim. Nga ato 10 libra 6 ishin të Naimit: «Bagëti e bujqësia», «Dëshirë e vërtetë e shqiptarit» (greqisht), «Vjershat përmendur për atë vit edhe botimin në Stamboll të përkthimit prej tij turqisht të këngës I të «Iliadës». Viti 1886 ishte viti i madh i debutimit të Naim Frashërit si shkrimtar i Rilindjes shqiptare.

Le të flasim së pari për «Bagëti e bujqësinë», me të cilën konsakrohet edhe më mirë arti i poetit, por edhe që duket të jetë botimi i tij i parë i atij viti.

Ajo datohet më 5 maj. Është një krijim pranveror, i një fryshtimi ronor vërtet, le të jetë tanë poeti plot 40 vjeç.

Ai gjendet në mes të «rrëmujës e të rrëmetit» të Stambollit, kjo katrahurë nga të gjitha, — si kryeqendër e një perandorie të madhe, po në gradën e fundit të kalbëzimit; si një rrrokopujë njerëzish prej Azie dhe Evrope e Afrike, memurë të çdo lloji, pashallarë e bejlerë të llangosur së tèrash në krye të pushtetit; turma të varfërish të kombësive më të ndryshme, që të këputin shpirtin, kanë ardhur aty me shpresën se mos sigurojnë një krodhe bukë. Përfaqësues të popujve të shtypur nga një shtet mizor, që nga Kaukazi në Tripoli, që nga Bosnja në Liban, midis të cilëve mjaft intelektualë. Të ndikuar prej ideve të reja të çlirimt të kombeve dhe të përparimit shoqëror, ata përpiken me të gjitha mënyrat, legale dhe ilegale, shpesh me rrezik koke, për të mbrojtur të drejtat e popujve të tyre, për të siguruar kush liri kulturore, kush autonomi politike dhe kush pavarësinë e plotë. Ata janë zakonisht përfaqësues të borgjezisë së re të vendeve të tyre. Po në disa vende, si p.sh. te fqinjët e Shqipërisë, kanë nisur të bëhen të papërbajtura edhe orekset shoviniste. Ndeshjet midis shovinistëve dhe patriotëve janë të ditës në Stamboll. Zënkat midis kombësive qeveria osmane i nxit për t'i shfrytëzuar në favorin e saj. Ka edhe përfaqësues të feudalëve liberalë të kombësive të ndryshme, të cilët marrin anën e borgjezisë dhe luajnë rol të dukshëm nga kjo anë, po prej vetë prejardhjes së tyre klasore, kuptohet edhe lëkundja apo pavendosmëria e tyre shumë shpesh, për t'u shkëputur nga perandoria. Xhonturqit, nga ana e tyre, s'e kuptojnë se nuk e mbajnë dot perandorinë gjallë, as me reforma kushtetuese. Dembellëku, si në atë vakt. Kafehanet e çajhanet përplot. Nargjiletë tymosin më shumë hashash se dûhan. Përdaljen s'e fsheh dot çarçafi. Ryshfeti kudo. Hajdutëria është ngritur në sistem. Xhahillëku ka zënë tre gisht zgjyrë mbi spaletat e pashallarëve dhe mbi çall-

mat e hoxhallarëve. Abdyl Hamid-Khani është bërë simbol i zvetenimit në téré shfaqjet e tij, dhe i krimit.

Stambolli ka një vendosje nga më të rrallat përbimi ngushtica detesh. Pitoresku i tij, që nga brigjet e Ysqydarit, ku banon Naimi, nuk është i paktë, me Ajo Sofinë dhe Sulejmanien, — vepër e një arkitekti shqiptar kjo xhami, e Sinanit, — me pallatet e Dollmabahçesë dhe Topkapisë e të tjera, që duan të konkurrojnë me Luvrët e Sanssusitë, me ato kodrina të panumërtë, ku, pér së gjati Bosforit, ngjiten shtëpi prej druri, sikur ngjit pati patin dhe dritarja dritaren, radhë-radhë e sërë-sërë, sikur çel çardaku çardakun. Nuk është e jashtëzakonshme që, midis tyre, të plasë zjarri dhe të shkretojë lagje të tëra, flaka të përskuqë Bosforin e Bririn e Artë, si lumenj gjaku pér një poet, i cili vuan në atë hapsanë popujsh, që në fakt është kryeqendra e perandorisë së sulltanëve prej më shumë se katër shekujsh dhe e Bizantit prej katërmëdhjetë të tjerësh... Poitet «mendja i merr fushat e malet», — larg prej atysh!

Nuk është romantiku i mërzitur nga kjo jetë, atë që pamë se qahej prej saj e prej botës tek «Endërrimet», ku lëshonte edhe ndonjë klithmë dëshpërimi. Atij mendja i merr tani arratinë në atdhe, në Shqipëri, në Frashër. E kujton djalërinë me theksat më të thekshëm. Djalëria ikën «si qen i qetë», ka pér të shkruar ai gjetiu, jo pa brengë. Po tani kemi të bëjmë me një tjetër mall, që e ka pushtuar të tërin, — malli i madh i Shqipërisë, i përzier me melankolinë e romantikut që nis e thyhet në moshë. Dhe pikërisht është rinia që do t'i japë fletët e saj të fantazisë:

*Të paskësha vrapn' e veriut, të kisha krahë pëllumbi,
nxitimn' e lumit me valë, q'ikën me vërtik si plumbi,
e të vinja në gjit tuaj, nj'u jë të ftohtë të pinja,
edhe nëpër ato hije një copëherë të rrinja,
syt' e ballit t'i xbavitnje, zemërënë ta dëfrenje,
gazë, që paçë njëherë, prap' aty ndër ju ja gjenje.
Opopo! kshu pse më vini përpëra syve pa pushim,
o ditët e djalërisë, o moj kohëz' e të rit tim?*

Shumë është folur, me të drejtë, mbi mallin për atdheun e vendlindjen, që e mbrujti poemën «Bagëti e bujqësia». Nuk është treguar sa duhet se e gjithë poema është e mbushur me përshtypje dhe kujtime të kthjellëta rinie. Naimi u bë 19 vjeç në fshat dhe ai atje u kthye jo rrallë, kur mësonte në Janinë e kur punonte në Sarandë, për t'u çmallur me vendin e dashur, për t'u përtërirë në gjurmat e fëminisë e të jetës djaloshare, me shpresë se po përtërin edhe shëndetin.

Frashëri, — vend i bagëtisë, i kopeve të buta të dhenve, i tufave levarashe të dhive, — vetëm sa Naimi ta kujtonte, i ringjallte atij, i përtërinte kaq gjëra. Syskat bukuriza, manaret lozonjare, deshtë inatçorë, cjetë madhështorë, të gjitha janë nota realiste, që vijnë nga kujtimet konkrete të poetit. E kështu jeta e bagëtisë, lëvizja e saj «nëpër sheshe e nëpër brinja», lodrimet e të vegjelëve tanë në pranverë, që shkruan Naimi, kur bagëtia është shumuar e gjallëruar; xhuraja që ia thotë majë një çuke, rrëzë një ahu e pishe, ndanë një lajthishë; baliku ruan berrat nga ujku dëmëtar përgjonijs. Baresha vjen «me llérët përveshur», «me zemërë të défryer e me buzëzë të qeshur», «me dy shqerrazë në duar, të bukura si dhe vetë», — skena është ekzakte dhe e përshkuar nga një patos i buruar jete. Dhe poeti, sikur të ishte atje, midis gjësë e midis gjethit, rijeton me ndjenjat djaloshare, që i sjellin entuziazmin: «Në sythit tënd e shoh gazë, që s'e kam gjetur në jetë».

Ahà! ai ka njobur gëzime shumë, po gëzime të tilla kaq të dlira a ka njobur? Na thotë se jo. Mendja, që i arratiset nga Bosfori në Frashër, i ngjet atij «larashit, që ngrihet përpjetë» në kupë të qiellit, mbushur me «gëzimt të gjithësisë». Zemrën ia kanë shpënë tanë një atdhe ata «krahë pëllumbi»; apo ia kanë thirrur «lumi, q'ikën me vërtik si plumbi», «bilbili që këndon me èmbëlsirë», «qyqeja që qesh», «trëndafili tek hapet», «ble-gërima e bagëtisë», bujku tek shtrëngon par mendën, «kalliu i plottë i kërrusurë nga barra», një vatër që e pret udhëtarin «me njerëzi, me të madh nder». Një majë mal i nga kundron Arbërinë.

Skenat zhvillohen në mes të një natyre madhështore, — Tomori vigan përballë, që bën të mendosh te lashtësia e lashtësisë së popullit tënd («*bota që kur është zënë, / Shqipëria gjall' ka qënë!*»), të mendosh për historinë, trimërore mbi të tjera, të prezave pa numër e të paepur, që, ashtu si malet, qëndrojnë me «*kryet përpjete*». Këndeja, Mali Plak, — emri flet më bukur e më saktë, do të thoshe, se emri Kokojkë, që sikur luan me rrokjet. Dhe vjersha, pikërisht me këtë krenari të vendit të lashtë dhe të historisë së tij të lashtë e të re, që do ta quanim «malore», duke i kënduar bagëtisë, që ato vise «*mbajnë dhe ushqejnë*», gufon përmes vargjesh, aë, me tu botuar, u bënë pjesë e kujtesës poetike të shqiptarëve:

*Ti Shqipëri më ep nderë, më ep emërin shqipëtar,
zemërnë ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.
Shqipëri! O mëma ime! ndonëse jam i mërguar,
dashurinë tënde kurrë zemëra s'e ka harruar.*

Poeti e krahason veten me atë qengjin e butë dhe lodërtar, që,

*kur dëgjon zëthin e s'ëmës le kopenë,
blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë;
edhe në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë,
e ta trembin, ajo s'kthehet, po shkon në mest si
shigjetë.*

(Në parantezë, — është, sigurisht, një figurë klasicke, shumë e njojur edhe në letërsinë frëngje, të cilën Naimi mund të besohet se e ka rigjetur te një tingëllimë e famshme antologjike e poetit të kohës së humanizmit, Joakim de Belej, mbi atdheun e tij).

Është folur përherë për disa përsëritje dhe për një ndërtim të brendshëm «*jo kaq të kujdesur*», që vihet re te «*Bagëti e bujqësia*». Po s'është thënë se ajo zemër aq e mbushur me mall dhe aq e mallëngjyer e poetit, që ia merr këngës e kredhur në kujtime, e ka vështirë, e ka të pamundur, të mos kthehet e të mos

rikthehet në kaq detale dhe në kaq imazhe të dashura, të përsëritet kështu, që të përtëritet. Dhe, ç'është e vërteta, atë që kritiku e vë re me gjykim, ai gati s'e ndjen se i cenon veshin në shijim, porse kalon përmes përsëritjeve, që i tingëllojnë shpesh si refrene, refrene jete dhe përjetimesh. Dhe kështu do të dëgjojmë shpesh nëpër vargjet e vjershës, si zëthin blegëritës, si zilet e këmborët, si xhuranë. Dhe jeta e stanit nuk do të na dalë veç një herë përparrë sysh.

Të paharrueshme mbeten në mendje jo vetëm ato bukuriza të butëza, por edhe ashpërsia e jetës, p.sh. ajo skena e bariut, natën në pyjet e thellë, kur

*mblidhen ret' e hapësira bënëtë e zezë sterrë,
vetëtimat e gjëmimet nisin e shiu zë të bjerë,
bariu vë gunën në kokë, z'eshkën më herët të parë,
ndez shkarpat sakaqëherë, a lisnë fyl, dhe bën zjarrë;
fishëllen e thërret qenët, sicilën me emër vecan,
pa, kur derdhetë baliku, ujkun e zë edh' e përlan.*

Dhe pasuria e përjetimeve shkon duke u shtuar. Dëgjojmë «nga mes' i pyllit krismën e sëpatës së druvatit», apo «të sharrësë që bën lëndë», bashkë me «fyellin e shtëparit», që s'i trembet ujkut as kusarit, që «gogolëtë s'e hanë», që «ka shok e vëlla armëtë», dhe, përsëri, «ziletë, këmborëtë». Kini parasysh pyjet e Hotovës.

Gjahtari që shkon nëpër male, kush mund të jetë veçse Naimi i rinisë? Udhëtari, që e zë nata në udhë, që e presin me «mish e me bukëvale», kush mund të jetë veçse Naimi? Ai, që Tomorin përkarshi, në mënyrën e poeziës klasike, e invokon si «fron të lartë që rrrij zoti,/ pas fesë vjetrë që kishin shqiptarëtë qëmoti», është Naimi, që merrte në rini kulturën klasike.

*O malet e Shqipërisë, që mbani kryet përpjetë,
tëmerr e frikë përhapni, përpini qiejt e retë!
Të patundurë përjetë jini...*

S'ka dyshim se Naimi i ka lexuar kronistët osmanë që shkruajnë për këta male dhe pér tmerrin që kanë parë jeniçerët e akinxhinjtë, kur janë futur nëpër ta me bylyqe dhe kanë dalë të firosur e të sakatosur. Përherë krenaria e birit të këtij vendi, e përzier me mallengjimet e mëdha, me dashurinë pér popullin, me besimin në forcat e tij, që u bënë ballë shekujve, që do të gjejë vendin të përsëritet në poemë.

Naim Frashëri, ky malësor i rritur pranë bagëtisë, duket se e ka pak të vështirë t'i këndojet po me aq frymëzim edhe bujqësisë. Ka jetuar Naimi edhe pranë Myzeqesë, në Berat, edhe midis Çamërisë, e ka njohur jetën e fushave. Dhe Frashëri i tij nuk qe pa një misërishte, pa një thekërishte. Po në qoftë se poema vërtet «bie» në pjesën e saj të dytë, ku i këndohet jetës së arave, jo se poetit i meket zëri se u lodh, po, më mirë të themi, se përjetimet e rinisë së parë ai i ka shumë më të gjalla, shumë më të plota, dhe ato i përkasin jetës së kullotave.

Do të ketë vargje të arrira «*kalorësi*» poet, që shpesh ka shkuar fushave dhe ka admiruar plugimet e korrjet, që ka uruar bujquit «*puna e mbarë*» rrëzë një «*lumi të kulluar*», «*që ikën me ligjërimë*». «*Me zemërë të gëzuar*», djali, që «*këndon, fishëllen a vete ngadale, duke mejtuar*», është Naimi. Ai është lektisur pér «*vashëzatë bukuroshe, posa shqerratë mitare*», «*me këmbëzat' e kërthnjta*», me «*pulpëzatë bukuroshe*»; ato «*përveshin llërët e bardha e të majm' e të pérndjita*», kur «*venë të lajnë në lumë, gjithë tok duke kënduar*», tek dallëndyshja «*u afrohetë si mike e u thotë fjalë shumë*», — edhe nga poeti i ri! — tek «*vjen të pijë ujë*» mëshqerra, apo «*të prehetë në hije, a të bënje gjë rrëmujë*».

Janë të gjalla e gjithë freski edhe këto detale të jetës së fushës e këto dridhërima ndjenjash rimore. Dhe kjo jetë, domosdo, nuk është pa anë të përbashkëta dhe bukuri me atë të maleve, — janë të pandara bagëti e bujqësia. Këto të gjitha, poetit i ringjallin dhe ai i përsërit meditimët e tij të njohura mbi «*gjithësinë, që s'ka anë*», mbi jetën kozmike, që njeriut i japin shembullin

jo thjesht të lëvizjes, por edhe të punës, — ide mistike dhe figurë e lashtësive poetike, — mbi vlagën e punës, që njeriut i sjell gazin e lumtërinë, që s'e le duarthatë. Dhe pastaj, ato këshilla të shumta që kemi nëpër vjershat e Naimit predikues të një morali të shëndoshë:

*Ki dëshirë për të mirë dhe në zemërë mëshirë,
ji i but', i urt', i vyer, e mos u bëj kurrë makut,
i egër e i mërzitur dhe i mahnitur e ladut,
mos iu afro dhëlpërisë, po së drejtësë iu nis pas;
në dëgjofsh fjalët e mijë, do të jesh gjithënjë më gaz.*

Po mund të vërehet, sidoqoftë, se këto meditime dhe këshilla nuk e mbajnë sa duhet frymëzimin, Naimi nis përsëri e spekulon mbi atë «krijestarın» që «*parnajsën e vërtetë ka çfaqurë nëpër ara*», dhe numëron, — gjë që nuk bie në sy vetëm në këtë vepër të poetit, po që këtu përsëritet pak si shpesh, p.sh. kur flitet për punët e bujkut («*njëri mih, jatëri lëron, njëri mbjell, jatëri prashit, kush tharr, kush korri, kush mbledh, kush shin, kush sharton, kush krasit*», etj.).

Mund të thuhet se, më së fundi, poeti e ndjen se frymëzimi nuk po e ndihmon më në mënyrë të mjaf-tueshme. Ai e këput këngën në atë skenën e dhimbshme të një motre që ka humbur motrëzën, — «*O! është mbuluarë në dhe vashëza fytyrëhënë!*» — thua se poema nuk mund të mbyllej ndryshe, veçse me një notë pikëllimi, që i vjen natyrshëm poetit.

Po prapë, zemërthyeri për atdheun e largët e të mjerë, Naimi, që është duke kënduar atje në Stamboll, le të ketë buçitur për bukurinë e madhështinë e atdheut, ky «jetim», e ndjen se, me atë notë, nuk mund ta mbylli «Bagëti e bujqësinë», pra apostrofon dhe i ngre menjëherë tonet. Flet përsëri mbi punën dhe gjëzimet e saj, mbi njeriun, që duhet të lartësojë vetëdijën me të cilën është pajisur, të luftojë për «*të mirën*» e për «*të madhen dritën*». Vjen pastaj urimi final, që zbulon

1 Lexo: t'harr.

edhe një herë përgjërimin e madh të patriotit dhe besimin e tij të plotë për të pritmin e Shqipërisë:

Tregomu dhe shqipëtaret udhën e punës së mbarë bashkomi, bëmi vëllezër edhe fjeshtë shqipëtarë, falmi, falmi Shqipërisë ditën e bardh' e lirisë, udhën e vëllazërisë, vahn' e gjithë mirësisë. Nxirr të vërtetënë në shesh, paskëtaj të mbretëronjë, errësira të përndahet, gënjeshtëra të pushonjë.

Është një thirrje që besimtari poet i drejton hyjni-së, duke e ditur se kështu do ta prekë edhe më drejtpërsëdrejti lexuesin besimtar të kohës, dhe urimi tingëllon edhe si për poetin vetë, ai që është betuar e lufton përtë gjitha këto, — për vëllazërimin e shqiptarëve, që do të sjellë «*dritën e bardhë të lirisë*».

Është vénë re se në ato qindra vargje të poemës «*Bagëti e bujqësia*», s'ka asnë fjale tjetër veçse përpullin punëtor. Poeti i drejtohet vetëm blegtorit e bujkut, që përbënë mbi 90 për qind të shqiptarëve. Atje, te populli, i gjen ai vetitë stërgjyshore shqiptare të trimërisë, të besnikërisë, të zemrës së bardhë e bujarisë, të punës, që lulëzon e begaton atdheun dhe e mban gjallë, të shpresës së fundit për çlirimin nga zgjedha e huaj dhe për një përparim të shpejtë. Anastas Lakçes, që ia kushtoi veprën, i dha në këtë mënyrë një këshillë të madhe, dhe, përmes tij, edhe patriotëve të tjerë të kamur, klasave të larta të shoqërisë në përgjithësi, — se, në e duan me zemër atdheun e tyre, duhet të çmojnë popullin e tij kaq të virtytshëm, të fortë dhe të talentuar, të dinë të mobilizojnë vegjelinë. Tjetër udhë shpëtimi nga zgjedha e prapambetja shekullore s'ka.

Ishte përpjekur demokratizmi shqiptar, që gjeti vendin e vet në vargjet e De Radës, — p.sh. tek poema e «*Milosaos*», — porse shkrimitari arbëresh, që i këndoi Motit të Madh të Skënderbeut, i këndoi më shumë me idenë e bashkimit të klasave të larta për t'i qëndruar fort në ballë Luftës kundër vërshimit otoman, p.sh. te poema «*Serafina Topia*». Po këtë bëri edhe demokra-

ti tjetër në jetë, Gavril Dara i Ri, me «Këngën e spras-me të Balës». Naimi çështjen kombëtare e shtroi shesh në stanet e Shqipërisë dhe në kasollet e bujqve të saj.

Ka një pasazh të tërë dhe që te «Bagëti e bujqësia» zë një vend qendror, ku poeti, përmes evokimit drejt-përsëdrejti të krahinave shqiptare, por edhe përmes tingujve të gjuhës dialektore, që nga Çamëria në Elbasan e që nga Durrësi në Prishtinë e Tetovë, me Krujën e Skënderbeut «*q'i ka pas dhan ner Shqypnisë, / tue bam me trimni luftë e me mund mren' e Tyrgisë*», me kujtimin edhe të ngjarjeve të atymëparshme të kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që karakterizoheshin nga pjesëmarrja aq e gjerë e popullit në mbrojtjen e trojeve të veta dhe përliritë kombëtare, poeti së fundi përbetohet:

*Burrat tuaj¹ aqë trima do ta lënë vall'Ylqynë
edhe gjithë shqipëtarët ta mbanjë armiku ynë?
Nukë më ngjan e s'e besonj, kam te zoti shumë shpresë,
Shqipëria këtej-tutje kshu po nukë do të jesë.*

Zemra e poetit i «është thier, bërë milë copë, posnjë pasqirë» për hallet e mëmëdheut. Mendjen ai e ka te «*gjithë shqiptarët*», tek ata «*që ven' e vinë në punë*», tek «*burrat trima me besë dhe shpirtmir' e punëtorë*» të «*maleve me dëborë*» të Shqipërisë, «*të fushave pëllorre që m'ushqejnë Shqipërinë*», së cilës ai i këndoi «*bagëti*» dhe «*bujqësinë*». Këtij populli ai i uron lumtërinë në liri dhe begati.

Demokratizmi shqiptar zor se kishte tingëlluar ndonjëherë kaq i qartë dhe kaq i zjarrtë në vargjet e ndonjë poeti rilindës. Dhe kuptohet përse poema «*Bagëti e bujqësia*» njozu atë suksesin e menjëhershëm e të rrallë, duke u bërë pastaj, për brezat shqiptarë që erdhën, më i afërmi krijim i Naim Frashërit.

Është shpjeguar më se një herë se, duke mos u marrë poeti me paraqitjen e anës së mjerë shoqërore të masave popullore shqiptare, duke e idilizuar, si të thuash,

1 Të krahinave shqiptare.

jetën e blegtoreve dhe të bujqve të Shqipërisë, që vuanin nga një shfrytëzim dhe shtypje e egër dyfishe, e push-tuesve dhe e klasave të pasura të vendit, poeti ka dashur këtu të paraqitë bukuritë dhe begatimin e jetës shqiptare, për t'ua kujtar e bërë më të dashur mërgimtarëve, pa harruar se, në mërgimin e tij, ai përmallohet pikërisht për Shqipërinë në bukurinë dhe madhështinë e saj, pa harruar se çasti historik shtronte problemin e zgjimit të ndërgjegjes kombëtare për çlirimin e vendit dhe jo ende probleme të çlirimit shoqëror.

Lirizmi i Naimit, me tone shumë të ngrohta, ndërthurur edhe me tone të forta e madhore, — herë «zëthi i shqerrës» edhe herë gjëmimi «oshëtitës» i një Tomori, herë fluturimi i «fluturës kahëshkruar» dhe herë kushtrimi për liri, — është këtu zëri i Naimit që u bë njësh me atë të popullit të vet punëtor, me dëshirat e tij për çlirim e përparim.

Vargut popullor, në këtë vepër, poeti i ka dhënë masën e pashit, — ishte tetërrokësh, e dyfishoi, e bëri gjashtëmbëdhjetërrokësh, i dha frymëmarrjen e gjithë krahërorit të tij të gjerë, duke i dhënë madhështinë, pa ia humbur atë larmi tingëllore, që tetërrokëshi e ka pasur dhe e ruan çuditërisht të pasur në shqipen.

«Dëshira e vërtetë e shqiptarëve»

Nuk na mbetet qejfi që Naimi, këtë tjetër vepër të tij të rëndësishme poetike, që batoi më 1886, e shkroi greqisht. Ia kuptojmë synimin dhe e shohim sa larg arrin e qëllon.

E shkroi greqisht për disa arsyen. E para, se kërkonte t'u drejtohej të huajve, po njëherë grekëve dhe ballkanasve të tjerë, për të cilët greqishtja, me hir ose pahir, gjer atë kohë, kishte mbetur një gjuhë e dytë kulture. E dyta, se ishin shumë edhe shqiptarët që, duke mos pasur mundësinë të shkolloheshin në gjuhën amtare, ndoqën arsimin grek në atdhe ose gjetiu. Kultura e huaj e pengonte më se njërin prej tyre t'i trokiste fort në gji ndërgjegjja e shqiptarësisë, pa harruar se pat edhe grekomani dhe, bile, të rrezikshëm. E treta, se duke i jetuar aktivisht në jug të Shqipërisë ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Naimi njoihu nga pranë, përkrah Abdylit, gjithë politikën e gabuar të qarqeve sunduese të monarkisë fqinjë të asaj kohe dhe urdisjet

e megaliidejve kundër Shqipërisë dhe lëvizjes sonë kombëtare.

Stambolli kishte shumë grekë, të cilët përbënë një pjesë jo të vogël të popullatës, tregtarë, klerikë, por edhe nëpunës. Ata atje, në qendrën e Patrikanës fanariote, kishin një veprimtari të gjerë propagandistike, veçanërisht antishqiptare, me shoqëri të ndryshme kulturore, me shtyp të pasur, me kler agresiv, me intelektualë të zot, po dhe jo rrallë shovinistë, që s'e patën pér gjë të falsifikonin historinë e popujve të Ballkanit pér hesap të megaliidesë së tyre. Patrikana kishte rrjetin e saj shumë të gjerë kishtar thuajse kudo në Ballkan. Shkollat greke kontrolloheshin prej dhespotlerëve të Fanarit në viset jashtë Greqisë, le të qenë ndonjëherë edhe shqiptarë nga kombësia.

Dhespoti shqiptar Anthimi, treguam se si nuk nguorroi të mallkonte alfabetin dhe shkrimin e shqipes më 1880, pas formimit të Shoqërisë sonë të Shkronjave në Stamboll dhe botimit të «Allfabetares» së saj. Kristaq Zografi, pas grekomanicët mëparshëm Vangjel Zhapa dhe krahas të kushërit të këtij Kostandinit, të tre milionerë, ishin hedhur kundër çështjes shqiptare, ose duke sjellë pérçarje në të ose duke dalë hapur kundër saj.

Kësaj veprimitarie dhe propagande i duhej kundër-vënë veprimitaria dhe propaganda jonë patriotike. Ky ishte qëllimi më i rëndësishëm i Naimit: t'i drejtohej asaj propagande në gjuhën e saj, fqinjëve t'u thuhej botërisht mendimi shqiptar, dëshira e shqiptarëve pér të jetuar të lirë, si fqinjë të dashur, pér të bashkëpunuar pér lirinë e përbashkët, dhe jo pér të luftuar midis tyre, në dëm të njëri-tjetrit.

Naimi e dinte me rrënjen gjuhën e bukur greke dhe shkroi një poemë që ishte në lartësinë e krijimtarisë së tij më të mirë dhe të dellit qytetar më të mirë të asaj gjuhe.

Tezat e mëdha të Naimit në poemën e tij janë ato që kemi parë: shqiptarët, një popull nga më të vjetrit e Evropës, stërnipér të pellazgëve, gjatë një historie mijërvjeçare u kanë qëndruar rrebesheve, edhe kundër

tri perandorive, romake, bizantine dhe osmane; ata kanë gjuhën e tyre dhe kulturën e tyre; janë një popull me veti të larta karakteri, trima dhe të besës mbi të tjera; ndjenjat e lirisë dhe të përparimit i kanë të zjarra; mundësitet për t'u çliruar e për të vajtur shpejt përpëra tanimë s'ua mohon dot kush, pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Shoqërisë së Stambollit. Të drejtat e shqiptarëve janë të drejtat e çdo populli që kërkon të ndërtotojë jetén e tij të lirë. Për të drejta të tilla ka luftuar dhe lufton edhe populli grek. Shqiptarët i respektojnë këto të drejta te fqinjët dhe kanë derdhur dhe gjakun që fqinjët t'i fitojnë. Ç'kërkojnë të huajtë në tokat tonë? Mos kanë pandehur, bie fjala sllavët, se gjetën shesh e do të bëjnë përshtesh? Ata gabohen rëndë, ngre zërin fort poeti dhe shkruan:

Poshtë duart, ju o sllavë, larg ju, larg nga Shqipëria!

«Fanariotët dhelparakë dhe kalemxhinjtë e tyre të ulët», vë re poeti, duan të provojnë të paprovueshmen. Por, «ashtu si fjala grek për ta është e shtrenjtë», ashtu dhe «fjala shqiptar është e shenjtë dhe e çmuar» për ne. Se jemi pjesërisht të krishterë, mos vallë për këtë s'jemi më shqiptarë? «Evropianët, që të gjithë, dihet, të krishterë» janë, po secili është i kombësisë së vet. Jemi pjesërisht ortodoksë, po ortodoksë janë «dhe rusët dhe të gjithë sllavët rrrotull». Stërnipët e Homerit «nuk janë asfare sllavë» sepse janë ortodoksë. Ata me të drejtë druhen shumë nga sllavomëdhenjtë, që duan t'i përpignë, siç duan të na përpignë edhe ne, këta armiq tanë të përbashkët pas osmanllisë.

Shqiptarët duan vetëm miqësinë me gjithë fqinjët e tyre dhe ky është interesni i tyre i përbashkët, të cilin të mos e harrojmë. Pra, «të hijet dorë nga sofizmat»; «miqësia e vërtetë mund të lidhet» vetëm kur secili të respektojë secilin. Miqësi do të thotë fqinjësi e mirë dhe fqinjësi e mirë do të thotë forcë për të dy palët; dhe nëse shqiptarët kishin për detyrë të çliroheshin nga

sundimi osman, edhe shumë toka greke a nuk ishin ende
në atë sundim?

*Ne me sllavët e me grekët, me të gjithë fqinjët tanë,
duam të rrojmë ngaherë me harmoni, si vëllezër,
veç e drejta e secilit gjithënë të respektohet.*

*Sot tiranin e pret vdekja, pra nuk duhet të luftojmë
si armiq me njëri-tjetrin; miq të jemi, në një mendje.
Mjaft kaq vuajtje që shkuan, mjaft kaq tirani e zezë,
pa të marrimë sot frysë dhe lirinë të gëzojmë!*

Në të tillë ményrë të hapur u drejtohet poeti fqinjëve në tërësi, duke i njojur mirë interesat, koniunkturat, mundësitë.

Shqiptarët s'e harrojnë Ulqinin, shkruante Naimi te «Bagëti e bujqësia» atë vit. Ata janë tanimë të qartë për kriminalitetin e «diplomacisë dinake» të Evropës. Po shovinistët ballkanas dhe fuqitë evropiane të mos harrojnë se te shqiptarët kanë të bëjnë me një popull, të cilin prapësitë e shekujve nuk e zhdukën dot, pra, që s'ka përpire t'i përpire edhe koha e re.

*O sa kombe janë zhdukur si të qenë gjethë vjeshte,
dhe sa kombe kanë lindur prej të tyreve rrënoja!
Kurr' në shekuj kombi ynë s'ka ndryshuar dhe siç qenë
ashtu mbetënë vetijat, gjuhha, doket e zakonet...
Kurre dyndjet e të huajve s'arriten të shkatërrojnë
kömbin ton' as gjuhën tonë...*

*Baballarët tanë trima kundër dyndjeve barbare
ranë dëshmorë në luftë, ata burra të vërtetë,
për mëmëdhethin e dashur, për lirin' edhe për nderë.
U mbyt në gjak mëmëdheu, armiqte na e shkretuan,
porse Shqipëria kurre s'e duroi robërinë.*

*Askush nuk ka mundur kurre që ta vëré nënë këmbë
shqipëtarin e dëgjuar, këtë heroin e botës.*

*Në kohë paqe i butë, si qengj është shqipëtari,
po në luftrat e betejat si luan i tmerrshëm bëhet.*

Me një të tillë duf dhe patetikë Naimi mbron të drejtat stërgjyshore, duke luftuar një propagandë të tërë të huaj që e shfiguron emrin shqiptar, e nisur nga shfigurimi vetë i historisë së shqiptarëve. Dhe si vërsulet hapur jo vetëm kundër shovinistëve ballkanas, po veçanërisht edhe kundër sunduesve të vendit, osmanëve, për të vërejtur edhe se «bizantinët fanatikë, frikacakë, të pazotë», nuk i kundërshtuan «*bishat e egra*», «*nuk u kundërshtuan fare*»; «*asnjeri nuk pati guxim t'i luttonte*» gjer në fund; «*të gjithë ulën qafën nën zgjedhën e zezë*».

I rrëmbyer nga krenaria për luftën e popullit të vet, Naimi vazhdon:

Një komb vetëm i guximshëm, një komb trim, i papërkulur, u rreshtua para tyre edhe më t'u kalli dërmën, përsëri duke shpëtuar nga rreziqe të llahtarshme Perëndimin që s'ia diti, të pabesënë Evropë.

Dhe poeti, duke çmuar patriotizmin e ri mbi çka pati më me emër lashtësia me heronjtë e saj, buçet:

Ti, o muzë gojëartë, që njeh mirë të vërtetën..., léri mitet e Homerit për Akilin këmbëshpejtë,¹ lër Eneun adhuronjës dhe përrallat e Virgjilit, se heroi i vërtetë tani njihet nga të gjithë, éshtë prijsi i shqiptarve, éshtë Skënderbeu i madh! Lumthi ti, shpirt i pamort! Lumja ti, zemër hyjnore! Ti, o emër shumë i dashur, emër hyjnor, aq i èmbël, ti je shembull dashurie, ti je monument virtuti, monument patriotizmi, trimërie dhe lavdie!... Kur do vijë vallë dita të të ngrejmë monumentin!

¹ Rilindësit fjalën e Homerit «aspotos» (i shpejtë) e nxirrin të vetën, prej etimologje stërgjyshore.

Ky vrull patriotik, kjo lirikë e zjarrtë politike, s'ka dyshim se bëri përshtypje te lexuesit të cilëve u drejtotej, ballkanas e shqiptarë vetë, por edhe turq, dhe gjithashtu tek ata njerëz nga Evropa që mund ta lexonin, se të tillë kishte plot në Stamboll, që merreshin me diplomaci, me tregti e me të tjera.

Kuptohet se Naimi s'mund t'i firmoste këto vargje të një guximi të pashoq për kohën: ai i botoi pa emër autorit.

Poeti u kthehet dhe një herë shqiptarëve, popullit të vet, që «*të kujdesemi për nesër*», «*për gjuhën, për mësimin, mbrothësinë*», se «*kemi një komb të zgjuar, trim e që vështron përpara*». Po në ato kohë që janë karakterizuar përgjithësisht «të qeta», thirrjet, sikundër shihet, ishin plot vringëllima armësh në poemën «Dëshira e vërtetë e shqiptarëve», e shpallur botës si një manifest politik. Sot «*që jemi në një mendje*» për të mirën dhe «*lavdinë e Shqipërisë*», është, si kurdoherë, «*e shenjtë të luftojmë për atdhenë*», u drejtohet Naimi bashkatdhetarëve.

Fetë s'kanë për të na përcarë dot. rikthehet poeti në këtë rrezik, apo u drejtohet shovinistëve dhe osmanëve, të cilët me këtë mjet përcarjeje, vërhojnë kundër nesh. Fetë «*ushtonin nië ndikim të madh në mesjetë*», sillnin «*barbarinë*», sillnin «*errësirën*», po «*çështjeve siç është feja, sot me sot i kaloi koha*», proklamon ai. Sot, «*meshar është shkenca*», «*libër i shenjtë natyra*», i fton patrioti me forcë argumenti shqiptarët në rrugën e kulturës, pa të cilën, për iluministin revolucionar, ç'të ardhme mund të kishte Shqipëria? Ai të përgjigjej: as liri, as përparim. Bota mbarë flet për «*besën dhe për nderin e shqiptarëve*», por edhe «*u njeh prirjen për liri, dituri, dritë*». Pra,

*Poshtë armiq't e tiranët! Poshtë grindja. errësira!
Rroftë besa dhe liria! Rroftë drita. dituria!*

Është thirrja me të cilën mbyllet poema. Ajo i përmban të tëra, — idenë e bashkimit, luftën për liri, luftën

për kulturë, që përgatit një liri të shëndoshë dhe një përparim të vërtetë, siç mendon poeti.

Mbyllja e poemës me vetë fjalën dituri nuk është vetëm një theksim i kërkesës së madhe, pas humbjes ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në këtë veprë ku bëhen edhe thirrje të hapëta për të rrëmbyer armët çlirimtare; është dhe një fjalë që u thuhet fort keqdashësve të Shqipërisë dhe njerëzve që gjenjehen prej tyre, se shqiptarët, pikërisht ashtu siç e pohon poeti, nuk kanë vetëm prirjen e luftës, por edhe «*prirjen e diturisë, të dritës*». Dhe e tërë Rilindja Kombëtare nuk qe vetëm një lëvizje e madhe për çlirim, përmes luftë-rash që u rritën me valë dhe që mobilizuan masat e gjera, por edhe një përpjekje me rezultate të habitshme në fushën e kulturës, sidomos të letërsisë shqipe, ku mbi të tjerë shkëlqeu emri i Naim Frashërit vetë.

Një patos i tillë e ka pëershkuar përherë lirikën patriotike të Naimit. Një lirizëm me ton tirtean ka tingëlluar përherë nëpër vargjet eëmbla të tij. Vargjet e buta, — e pamë te «*Bagëti e bujqësia*», — ai i ndërthur me të fortat, pshëretimat me britmat, përgjërimet me thirrjet, meditimin me kushtimin.

Një mik grek, i cili nuk duhej të kishte paragjykime ndaj shqiptarëve, që e çmonte veçanërisht Naimin sepse e përdorte në mënyrë të tillë gjuhën greke, duke arritur lartësi poetike të shquara me kulturën e tij të gjerë klasike, i pati uruar me kohë që dhe një herë t'i ngacmojë telat e lirës eolike. Dhe, siç dihet Naimi, te cikli i tij greqisht «*Dashuria*» («O eros», 1895), e provoi me sukses lirizmin e butë nën ndikimin e klasikëve.

Pa hijen e shovinizmit në shpirt, Naim Frashëri, humanist sa dhe patriot, i jepte Sokratit atë që i përkiste Sokratit, — mund ta formulonim kështu thënien latine për Qesarin. Ai kishte admirim të thellë për kulturën e vjetër të fqinjëve tanë, që i kishte sjellë shërbime të pakrahasueshme kulturës evropiane, poeti që lakmonte edhe për popullin e vet një rilindje kulturore, e cila vërtet erdhi e që bota as duheshin dhe as mun-

deshin ta injoronin më, veçanërisht ballkanasit në luftë me feudalizmin e falimentuar osman, si dhe me kulturën e mexhelesë dhe të kalifatit. Dhe që t'i bënte shqiptarët të shijojnë kulturën greke, — dhe jo vetëm shqiptarët, por edhe turqit, — ai vuri shqip e turqisht këngë I të «Iliadës» të kryepoetit të lashtësisë.¹

1 Poema e Naimit u përkthye dhe u botua së pari shqip nga K. Floqi, Sofje 1904. Autori i kishte bërë ndonjë përpunim, kur ishte gjallë. Ajo pati një botim të dytë të përmirësuar më 1912. Ne citojmë përkthimin e ri dhe shumë më të qëlluar të P. Çukës, botuar te vëll. I i Veprade të Naimit, 1980. Cikli «Dashuria» i shqipëruar mjeshtërisht nga S. Çomora, është botuar po aty.

«Vjershat për mësonjëtore t e para»

Duket sikur, domosdo, do të biem në një tingull «minor», po të merremi tanë me librat për shkollat, që botoi Naimi që nga viti 1886, si «Vjershat», «Këndimet» e më pas të tjera, derisa mbylli sytë. Poezia e ka vështirë ta ruajë frymëzimin në gjinin didaskalike, si p.sh. te një vjershë e quajtur «Gjithësia», që është një ritregim në vargje i historisë së tokës, apo një tjetër mbi «Të vërtetët», e po atij qerthulli, dhe të tjera.

Po «Fjalët e qiririt», po «Shkëndijën e diellit ndaj manushaqes» Naimi i futi në përbledhjen e tij për shkollat dhe nuk priti «Lulet e verës», aq të mbushura me lirizmin e tij. Ai s'mundi të mos u thoshte fëmijëve të «mësonjëtoreve të para shqipe», që ishin gati të hapnin dyert, por edhe lexuesve në përgjithësi, se arti, se poezia, kanë një mision të madh, misionin e të ndriçuarit të vetëdijës së kombit dhe të formimit të asaj vetëdije, sikundër kanë edhe misionin që të prijnë ndër beteja për liri dhe kulturë.

Samiu, duke folur për misionin e letërsisë, ka shkru-

ar: «*Kudo që më është dhënë rasti, gjithmonë kam thënë dhe ja përsëri po e them. Letërsia, e sidomos poezia, duhet të shfaqë ndjenjat dhe mendimet e popullit, të paraqitura me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për cilindo. Këto ndjenja dhe ideale, sado të larta të jenë, sado që të jetë e lartë dhe e gdhendur ajo gjuhë, prapë baza e tyre, fryma e tyre, pasionet e tyre, duhet të merren nga gjuha, mjedisi dhe zemra e popullit. Ndjenjat dhe idealet kombëtare, të shprehura me një gjuhë kombëtare, kjo është letërsi».*

S'kishte se si Samiu të na formulonte më mirë pikërisht konceptin e të vëllait të vet mbi artin, që shprehej figurshëm te «Fjalët e qiririt».

Shqipërinë Naimi do ta paraqiste, në mënyrë shumë origjinale dhe përmes një dëlërësie të veçantë frymëzimi, të përvuejtë e të brishtë si një lulezë e parfumuar, — si një «*manushaqe*». Atij atdheu të vështruar nga një kënd liriko-epik te poemthi «*Shqipëria*», do t'i përgjigjej tani atdheu i kqyrur nga një kënd liriko-elegjiak, i asaj luleje që çel midis «*ferrave*» dhe «*gjëmbave*», që i kanë marrë frymën, i «*kanë zënë dritën*». Është «*rilindja*» e Shqipërisë ky lulëzim, që nis e bëhet në ato kushte. Naimi ka gjetur një imazh kaq përgjérues, sa dhe të saktë, në pasurinë figurative me të cilën tek ai paraqitet e pëershkruhet atdheu në robëri dhe shprehet shpresa për ditë më të mira, për një lulëzim të pa-përbajtshëm, që tani, kërkon të na thotë ai, nuk është vegse në fillimet e veta, — po ç'ka për të qenë! ëndërron larg poeti.

Do të zgjateshim po të qëmtonim te vjershat didaskalike. Le të shënojmë se ato janë gatuar përherë me atë shqipen e Naimit, model natyrësie e pastërtie, ku thua jse nuk mungon asnjëherë një korent i nënüşhëm i ngrohtë, ku hasim distike e strofa të një bukurie të vërtetë. Le të citojmë sadopak:

*Dielli 'shtë nj'yll i zjarrtë,
që ndrin posa lëmsh i arte.*

(Dituritë)

*Dheu 'shtë një yll i qiellit,
që lëvrin në hapësirë,
i vjen rrretherrotull diellit,
merr të ngrysur e të gdhirë.*

(Gjithësia)

*Shiu bje dhe ujit dhenë,
dhe rrëketë bëhen lumë,
e lumenjtë në det venë.
duke thënë fjalë shumë.*

(Po aty)

Është si një «medium» gjuha e Naimit, që atje ku nuk është frymëzimi, ajo prapë, me hieshinë e natyrshme të saj, na sjell tinguj, kadanca, dritë, ngjyra.

Nuk mungon në këto vjersha edhe ndonjë për stinët, si bie fjala «Dimëri», me atë strofën e fillimit, që dallohet ndër të tjera:

*Qjelli është bërë sterrë,
hapësira mbushur me re,
dëbora bij' e paprerë,
dheu i bër' i bardh' pos i ve;
moti është egërsuar,
drurëtë janë ngarkuar.*

Doemos në vjersha të tilla vjen edhe dhimbja për njeriun e varfér, që ka mbetur lakuriq e për të cilin zemërmadhi poet lyp ngaherë «mëshirë», po nuk ndjen ende sa duhet se, pikërisht atëherë, duhet të ngrejë zérin kundër padrejtësisë shoqërore, që pamë se ai e ndien. A thua se do t'i shpëtojë të varférit vera, tek e cila «*e kanë shpresën*»? Kjo s'është shpresë, po, tepër-tepër, një farë rënje e furisë, që ka për të shpërthyer dimrin tjetër. Cikël i mbyllur, — shpëtimi s'duket në horizont, — poeti ka për të kërkuar prapë dhe prapë «mëshirë» për të varférit! Zemra e dhëmshur e tij, që nuk e gjen rrugëdaljen, vuan, gjer edhe pshon ndonjëherë; pra, nis e bën majë protesta shoqërore, që gati s'u shpreh te «Bagëti e bujqësia».

* * *

«Fjalët e t'urtet» zënë faqe të tëra në «Vjershat» e në «Këndimet» e Naimit. Edhe ato nuk u drejtohen vetëm shkollarëve, po cilitdo lexuesi. Naimi i ka vënë përmision vetes të jetë edukator i kombit dhe etika e tij shprehet gati gjithkund, ai i kushton asaj distike e strofa të shumta te «Fjalët», proza te «Mësimet», siç kemi për ta parë. Pamë se si «Bagëti e bujqësia» kishte plot nga to.

Moralizimi është një karakteristikë nga më të dalluarat e poezisë së Naimit dhe e tërë veprës së tij. Kur ai bëhet me takt, kur vargu e proza gjijnë theksa e ritme të qëlluara, kuptohet se efektin e ka të plotë. Dhe nëse mbi lexuesin e sotëm, qoftë me përbajtje disaherë të vjetruar dhe me kufizime konceptesh, qoftë me rëndimin që sjell në vepër, ai moralizim nuk e bën dot efektin që do, — në mos bën të kundërtën, — te lexuesi i viteve të Rilindjes, por edhe tek ai i dhjetëvjeçarëve të tjerë që erdhën, moralizimi i letërsisë është zakonisht i mirëpritur e i efektshëm. Ai formon, në përgjithësi, ndërgjegjen patriotike e shoqërore, dhe Naimi, ky poet i frymëzimeve sublime, nuk e pati nënçmuar, me të drejtë për kohën, didaskalizmin.

Shembujt mund t'i jepnim të shumtë nga «Fjalët e t'urtet», të qëlluara në përbajtje dhe formë. Le të përmendim disa pak për t'u rikujtuar vlerat e tingëllimin.

*Mos ji me dy faqe kurrë,
ji i drejt' i mir' e burrë.*

*Miku njihet q'është mik
në të keq e në rrezik.*

*Mos dëgjo tjetërin ç'thotë,
po shiko se ç'bën në botë.*

*Dhe të të falin kamjen e jetës,
mos thuaj kurrë veç së vërtetës.*

«Fjalët e t'urtet» nuk janë meditime dhe përherë nuk i shërbejnë domosdo ngritjes shpirtërore. Mund të jenë edhe këshilla praktike për jetën. Në këto këshilla praktike ose jo, lexuesi mëson se duhet të ketë masë gati në të gjitha, të mos jetë i rrëmbyer në asgjë, të jetë punëtor, të mos bëhet shkak për të keqen, — se dhe atë që bën gjen, — të jetë i urtë, modest, i dhëmshur, zemërgjerë, i dashur, të lakmojë shumë diturinë. Dashuri mbi të gjitha është ajo për njeriun e prindërit, po mbi të qëndron dashuria për atdheun.

Janë këto fjalë të urta një tok maksimash mbi sjelljen në jetë dhe mbi vetitë e mira. Rrjedh nëpër to një mirësi e një dliresi, fjalë të rënda gati nuk dëgjojmë, — veç kur përmendet tradhtia, — dhe shpesh ka në to një prani të ndjenjës mistike dhe të hyjnisë, që paraqitet si arbitër mbi të mirën e të keqen. Zotëron mendimi dialektik, sipas së cilit e mira dhe e keqja janë të pandara në jetë, po njerëzimi drejt së mirës shkon dhe njeriut vetëm për të mirën duhet t'i jepet. Gjykatës ai ka hyjninë, po së pari duhet të ketë ndërgjegjen e tij: duhet ta vrasë ndërgjegjja, kur bën keq; kur bën mirë, ajo ç'mund të ketë tjetër, veçse gaz?

Ka përsëritje të shpeshta te «Fjalët e t'urtet». Kuptojmë se autori i ka shkruar herë e pa kohë, duke riformuluar më se një maksimë, dhe, pasi i ka botuar në revistën e Stambollit sipas radhës që i shkroi, i ka përbledhur pastaj, pa i herrur, një tog këtu e një tog më tej, në librat e tij për shkollat, duke i vendosur përmes vjershave dhe prozave të ndryshme të këtyre librave. I ka pëlqyer që një maksimë ta ketë formuluar kështu dhe në mënyrë tjetër. Nuk ka treguar parapëqim për këtë ose atë.

* * *

Të vijmë te «Fabulat».

Duhet të përsëritim, së pari, se dhe ato janë ndër botimet e tij të revistës «Dituria» (1885), që pastaj Naimi i përmblodhi në «Vjershat» për shkollat e viti të ardhshëm, dhe që nuk bëheshin më shumë se 23 të gjitha sa përshtati nga La Fonteni. Këtyre u duhen shtuar pesë a gjashtë të tjera të përmbledhjes tjetër poetike «Fjalët fluturake» (1894), dhe që u përshtatën nga autorët e Lindjes, si «Guguçeja» e Xhelaledin Rumit, që dallohet midis shoqeve. Ndonjëra fabul mund të jetë origjinale. Ndonjëra është më shumë e tipit anekdotik nastradinian.

Përshtatjet nga La Fonteni janë të lira, sado që u qëndrojnë pranë subjekteve. Po Naimi, me moralin e tij, nuk mund ta dënonte e ta linte pa lëmoshë e që të vdiste urie gjinkallén, e cila tërë verës këndoi, pa menduar se ka dhe dimër e s'ka për të pasur q'të hajë. Çajupi, si dhe La Fonteni, realist, do t'i përbahet moralit të rreptë, po të drejtë: ai s'ka mëshirë, — kush s'punon, nuk ha.

Naimi është i pari fabulist që bëhet i njojur në letërsinë shqipe. Një tog i madh fabulash, të përshtatura me shije nga arbëreshi Anton Santori, kanë mbetur gjer më sot të pabotuara. Na kanë tepruar që shumë më së hershmi një a dy të Ezopit, të përkthyera, po literarisht, nga Dhaskal Todhri dhe që shërbyen për mësimin e greqishtes së vjetër e të re në shkollat e kohës, me tekstet paralel. Sidoqoftë, me Çajupin kemi për të pasur fabulistin më të rëndësishëm të shqipes, me një libër të tërë fabulash të përshtatura mjeshtërisht nga La Fonteni (1921). Ai mësoi nga Naimi, si pér zgjedhjen e lëndës që i shkonte më mirë momentit rilindës, — nga kjo anë, Çajupi u tregua edhe më tendencioz me temat që mund të aludonin në përpjekjen patriotike, — si pér temat kundër padrejtësisë shoqërore.

Naimi, përshtatës shumë i shkathët, u përbajt

në disa prej krijimeve më të njoitura të La Fontenit, — p.sh. «Korbi e dhëlpëra», «Gomari dhe kafshët e cgra», «Ujku dhc qengji», «Të dy qetë dhe ujku», «Qeni dhe hij' e tij», etj. Morali? Le t'i marrim me radhë këto fabula: ki mendjen nga lajkatari; i urti, po të mos jetë dhe i mençur, ka rrezik t'ia hanë kokën lehtë të tjerët, se ka egërsi shumë në botë; i forti nuk njeh ligj, po vetëm përdhunën; të ndarë, armiku na përlan, të bashkuar ai s'do të kishte ç'të na bënte; mos lakmo tepër, se humb edhe atë që ke.

Nuk mungon, sikundër shihet, një sy realist mbi jetën. Jeta nuk është shesh me lule. Njeriu duhet të dijë t'u bëjë ballë rreziqeve. Shqiptarët të kenë mendjen kur i lajkëtojnë (osmanët), mos gënjen prej dinakërisë (së shovinistëve ballkanas). Nuk gjejmë në këto vjersha moralin e luftës kundër së keqes, të cilën edhe La Fontenit nuk e pati predikuar, po moralin e një veprimi të mençur, që të mund të shhangë të keqen që kanoset shpesh. Kemi një refleks të kontradiktës shoqërore në luftën e kllave, porse jo njojhen e kësaj lufte. Për këtë njojje, kur vjen çështja e çlirimit të Shqipërisë, duhet thënë se Naimi do ta ketë në thelb të predikimit të tij, që armikut t'i biem pa mëshirë dhe për atdheun s'ka fli që s'duhet bërë, ndonëse, ashtu si thotë dhe fjala popullore, duhet një trimëri e dhjetë mençuri. Domosdo, Naimi do të këmbëngulte në idenë e bashkimit, se ai bie forcën, dhe me bashkim kupton gjithë pjesëtarët e kombit. Të dy qetë, kur arriți t'i ndajë, ujku i çau; mund të kërkoni një aluzion të drejtpërdrejtë në kohën e të dy shteteve feudale shqiptare të kreut të shek. XIX. Kështu do të mbetemi edhe sot? — mund të pyeste patrioti. Do të na ndajnë krahinat, do të na ndajnë fetë, do të na përcajnjë armiqjtë, që të na përlajnjë? Na duhet një unitet i fortë dhe më i fortë. S'ishim pak të bashkuar në vitet e Lidhjes Shqiptare, po prapë na zhvatën një pjesë të atdheut. Forca e bashkimit qëndron te vetëdija kombëtare, pra ta forcojmë këtë vetëdije.

Ka në këto fabula një koncizon, të cilin, sigurisht, e kërkon vetë gjinia, — tregim i shkurtër në vargje, i

ngjeshur shumë, që nuk e qas zgjatjen, — dhe Naimi kishte përpara një model klasik të përkryer. Pastaj, ai përshtat La Fontenin, po njeh edhe Ezopin dhe Fedrin, që ishin lakonikë. Naimi, që njihet si një poet edhe proliks, këtu i është përbajtur mirë masës. Të rikujtojmë citimin që kemi bërë më sipër:

*Pendë këndesi
kunadhja vënë... —*

Portretizimit, dhënes së veprimit me notat më të shpejta, me vargjet nga më të shkurtrat, — pesërrokësh, — i përgjigjet dialogu tërë nxitim i dinakes që kërkon t'u marrë mendtë dhe t'i rrëmbejë në befasi, ashtu si «*pu-lave u erdh*».

Po fabulat mund të nisin të tregohen edhe «vendshe»:

*Korbi në një degë na kishte qëndruar
edhe një brek djathi e kishte kafshuar,
dhelpra fort e urët i shkoi atje pranë..., —*

prapë, vjersha mbetet e shkurtër, aksioni nuk tirret, gjithçka qëndron më shumë te dialogu: dhelpra e tororit me llogo korbin që të lëshojë djathin, se mendjeshkurtërini e lektisi më shumë lëvdata.

Edhe kur vargu shkurtohet, tregimi mund të rrjedhë shtruar, si te «Përçollaku edhe breshka»: e kërkon veprimi.

*Përçollaku la fëmijën,
atë kohë ra shi shumë,
vija u bë porsi lumë;
dha e dha e s'hidhet dot,
se viaj qe mbushur plot.
— Bobo! — tha, — i mjeri unë!
C'më gjet kjo e madhe punë,
qysh u ndodhçë i mahnitur
e dola për të zbavitur?
Përçollaku po mendohej,*

*po dridhej e rrotullohej,
breshka më një dasmë vinte...*

Naimi, si dhe modeli i tij, tregohet mjeshtër në përzierjen e vargjeve, p.sh. te fabula «Plaku dhe vdekja». Të mos harrojmë se kjo është një nga provat e para të përzierjes së vargjeve dhe të atyre të rimuara në poezinë tonë, po të lëmë mënjanë arbëreshët, si De Rada, i cili nuk rimonte. Kështu edhe Dara i Ri. Modeli më i afërt i Naimit është poezia popullore, së cilës prapë nuk i mbetet skllav, po rison, p.sh., duke përzier edhe ndonjë varg tek me çiftet, gjë që Çajupi ka për ta bërë sistem, po që te populli e hasim rrallë.

*Një plak i thinjur, me dru ngarkuar,
buzë një rripe kishte qëndruar;
fort ishte lodhur, këputur ishte,
dhe që shumë mërzitur.
e fare zverëtitur,
se gjë në jetë i gjori s'kishte...*

Ishin, sikundër thamë, këto shqipërime, një bazë e shëndoshë dhe me cilësi të veçanta gjuhe, stili, shkathësie në të treguar, për fabulistikën shqiptare. Naimi mbej po ai përshtatës i shquar, rikrijues, që u bë i njojur mbi të tjera me «Fyellin» e që do të bëhej po aq i njojur edhe me «Iliadën».



Që të mbetemi te didaskalizmi i autorit, le të flasim këtu edhe për prozat e «Mësimeve» (1894).

Duhet thënë së pari se, kur është fjala për art të prozës shqipe gjatë Rilindjes, «Mësimet» e Naimit, me koncizonin dhe harmoninë e stilit, zor se mund të krahasohen me gjë tjetër. Ato kanë një rrjedhshmëri gjuhe, që ia kalon asaj të Bogdanit apo të Kristoforidhit, mjeshtrit e mëdhenj të mëparshëm, që matet me Samiun

e Pashko Vasën, ndonëse stilet janë të ndryshme: këta kanë një stil publicistik të vërtetë, njëri më me vrull, tjetri më i matur, kurse Naimi ka stilin e predikuesit me zemër në dorë, me buzëqeshjen e pashlyer, me tingullin e unjët e të ëmbël të zërit.

Prozat e tij të llojit kanë cilësinë e madhe që e afrojnë shumë lexuesin, të cilin predikuesi e bën vëlla e bir, i flet me tërë afshin e zemrës. Ato kanë atë lirizmin e gjerë e të ngrohtë, që kanë edhe vjershat e tij. S'kanë fraza kushtruese, zemërnatën e përligjshme të udhëheqësit të lëvizjes kombëtare që ka dalë nga përvoja e viteve 78-81, kur vringëlluan shpatat, ndonëse autori tani shkruan, sigurisht, dhe është duke e mbaruar «Historinë e Skënderbeut», plot shungullima luftërash.

Te «Mësimet», Naimi është një këshillues në ato «ditët e qeta», kur, pa e harruar luftën që i pret shqiptarët me armët gati, mendon se atyre u duhet dhe shumë urtësi pér atdheun e përgjithësisht pér jetën. Është autori që ka shkruar maksimën: «*Kohën në çdo pun' e ndaj, / çdo punë ka kohën e saj.*»

Na duket se ky meditues, në këto çaste të jetës, kur po i afrohet dergjaja, po e thekson edhe notën misticke. «Mësimet» kanë pér të nisur me një pohim të tillë: «*Dashuria e zotit është krej i urtësisë*». Doemos, nuk duhet të kuptojmë këtu me hyjnинë atë personazh që konceptuan kisha dhe xhamia në librat e tyre. Pér panteistin, ai mbetet «e vërteta», që njeriu ka përmision të zbulojë, por edhe të ndjekë në jetë, si thotë Naimi dy fraza më tej: «*Mësoni diturinë e gjithësisë, (se) aherë do të kuptoni fuqin' e mirësinë e zotit.*» Në predikimet e tij, si zakonisht, autori përpinqet t'i qëndrojë larg dogmës me bestytnitë e saj. Prapë, është mistiku që moralizon.

Morali i tij është një humanizëm i tipit kristian, që shkon gjer atje: «*Në të rënçin në një faqe, këthe dhe tjatrënë; duaj mëknë, duaj edhe armiknë.*» Le të kuptohemi: me armik nuk e ka në asnje mënyrë fjalën pér armikun e atdheut. Është fjala këtu pér një «paqe» shoqërorë brendapër'brenda njerëzve të kolektivit komb,

kur nevaja e unitetit është e madhe kundër pushtuesit, fuqive të mëdha e shovinistëve të huaj.

Po prapë, Naimi predikon me këtë rast një «paqe», e cila edhe s'mund të arrihet, se klasat antagoniste, sado ta ulin për një periudhë luftën midis tyre, atë s'e kanë pushuar dhe s'kanë për ta pushuar kurrë. Ajo është në natyrën e marrëdhënieve midis tyre. I varfëri përherë do të jetë nën sundimin dhe shfrytëzimin e të pasurit, se i pasuri do të jetë përherë edhe më i pangopur e më i pashpirt; pra, lufta është e pashmangshme në këto marrëdhënie. Le të predikojë Naimi, te «Lig' e përjetshm' e shqiptaret», — pjesë e «Mësimeve», — që «*m'i madhi ta doj'* e *ta nderonjë dhe ta përkujdesnjë më të vogëlinë*», kurse «*m'i vogëli prapë ta njohë radhën' e kufin'* e *tij dhe të dojë më të madh' e t'i bënjet nder*.» Jeta ka treguar se ku është vërtet «radha e kufiri» i të voglit dhe ku «përkujdesja» e të madhit në shoqërinë me klasa.

Naimi, demokrat e humanist, në shpirt, nuk e ka përdorur titullin «bej», që trashëgoi në fis, dhe kjo trengon se ai ka ndier e kuptuar që ky titull nuk i bënte nder. Bejlerët, si klasë, ishin gjakpirës. Naimi, që me idetë e tij të reja është diferencuar e përpinqet me ndërgjegje të diferencohej prej bejlerëve, siç e pamë, nuk e shtroi çështjen e përbysjes së regjimit shoqëror: koha kishte vënë në radhë të parë çështjen kombëtare dhe borgjezia nuk e ndiente veten të fortë për të ngritur zërin kundër një regjimi shoqëror që më s'kishte të ardhme, që kishte marrë tatëpjetën. Naimi ruan kufizimet e kohës dhe humanizmi i tij mbiklasor është një dukuri karakteristike e intelektualit demokrat-borgjez të kohës.

S'ka dyshim se lexuesi bashkohet me predikuesin e një morali të zjarrtë patriotik dhe disaherë me humanistin e gjerë Naim: «*M'i mir' i gjithë njerëzisë ësht' ajo që do të mirën e njerëzisë, m'i ligu është ajo që do të ligënë*»; «*një njeri, sado të mira të ketë përvetëhen' e tija, s'mund të jetë fatbardhë, po të ketë kombin e mëmëdhen' e vet fatzi, se mendja dhe shpirti e vetëdija nukë prehen kurrë*.» Po ka pasur edhe «Efial-

të», tradhtarë përmbi tradhtarë. A thua se i mundonte ata vetëdija e tyre? Naimi, në «Historinë e Skënderbeut», ka një çast dobësie, kur do të donte ta shpjegonte tradhtinë e Mojsiut me një dinakëri që ai paska bërë për të dëmtuar armikun osman; prapëseprapë, ai s'qëndron aty, por e damkos si tradhtar.

Morali i tij është ky: «*Gjithë ne shqipëtarëtë duhet të përpinqemi gjithënë për Shqipérinë, për shqipenë e për shqipëtarët, se ndryshe nukë rrojmë dot me nder në jetë*»; se «*dashuri e Shqipërisë dh'e shqipes edh'e shqipëtarit mund t'u zbresë të tëra mirësitë gjithë shqipëtarëvet*»; se «*gjithë jemi një fis e një farë, kemi një gjak e një gjuhë*; se «*bashkimi bie fuqinë*»; kurse «*ajy njeri, që s'ka dashurin' e mëmëdheut dhe të mëmëdhetarëvet, është një farë kafshe, p'ajy që vuan për të huajtë është fare i humburë dhe i pabesë*.» Dhe një nga konkluzionet e mëdha të këtyre këshillave tingëllon kështu: «*Një komb, ç'vjeftë t'i vërë vetëhesë, atë i vënë dhe të huajtë*».

Të njohim, pra, dhe të çmojmë gjithçka është jona, shqiptare, të bëhem i plotësish të vetëdijshëm të vetijave të larta të popullit tonë, të jemi krenarë për to, t'i ruajmë e t'i zhvillojmë, se kështu do të punojmë edhe më mirë për të shpëtuar Shqipérinë dhe bota do të dinë edhe më mirë se me cilët kanë të bëjnë.

Ka pastaj te «Mësimet» këshilla të shumta jo vetëm të karakterit të ngritur kombëtar e njerëzor, por edhe mbi praktikën jetësore të përditshme. Bie fjala, për martesat që duhen bërë me kohë, as herët as vonë; kundër teprimeve në dasma; kundër vajtimit të të vdekurve me klithma e sidomos me gjeste; kundër zisë, së tepruar; për rritjen e fëmijës me anë të shembullit të mirë të prindit, për kujdesin e gjithanshëm në edukimin e tyre, se kështu përgatisim të ardhmen: «*Mësojini, kanë thënë t'urtëtë, fëmijët tuaj të dinë më shumë se ju, se ata janë për një kohë më tej nga koha juaj*.» Detyrë të madhe e rol të veçantë ka për këtë nëna, dhe Naimi ndalet te figura e saj, te dashuria e saj për fëmijët e te dashuria e fëmijëve për të dhe prindërit në përgjithësi: «*Parajsa*

është nën këmbët e nënave tuaja», i shkon gjer në fund përgjérimit, ai që nënën e tij e pati kujtar aq dhembshurisht tek «Endërrimet».

Naimi godet edhe vese të tjera shoqërore dhe ngre lart veti të tjera, ngre lart edhe një herë punën, në ato kohë feudalizmi dhe dembellëku oriental: «*Nuk është turp të punojë njeriu, po turp është të përtojë.*»

M'i shquari nga kapitujt e «Mësimeve», mbetet, pa dyshim, ai me titullin e përmendur, «*Lig' e përjetshm' e shqipëtaret*», ku gjemjë të përbledhur mendimin e tij patriotik dhe tek kemi një nga shfaqjet më të shquara të këtij mendimi në veprat e Naimit, domosdo me kufizimet klasore për disa nga të cilat u fol më sipër.

«Lulet e verës»

Kemi treguar admirimin që shprehu Konstandin Kristoforidhi në Elbasan për «Lulet e verës», kur ato u botuan më 1890, apo të Pashko Vasës në Liban. E pra, te kjo përmbledhje kishte disa nga vjershat më të shquara të poetit dhe që të dy rilindësit sigurisht i njihnin, se kishin qenë botuar së pari te «Drita» — «Dituria» e Stambollit. P.sh. «Fyelli», «Zemëra» («Retë kur bënënenë sterrë...»), «Bibili», «Një lul’ e fishkurë a një vashëz e vdekurë», dhe ndonjë vjershë tjetër. Të tjera vjersha, nga më të shquarat e Naimit, si «Fjalët e qiririt» dhe «Shkëndij’ e diellit ndaj manushaqes», që kemi përmendur, ata i kishin lexuar po në atë revistë së pari e pastaj rilexuar te «Vjershat» për shkollat. «Bagëti e bujqësia», katër vjet më parë, i kishte dhënë famën poetit. Le të shënojmë se poema nuk ishte pa ndonjë ndikim të P. Vasës të librit «E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët», kur autori fliste gjithë emocion për bukuritë e atdheut e gjithë shpresë për begatimin e tij. «Lulet e verës» ia kurorëzuan edhe një herë famën Naimit.

Përshtypje të madhe bëri kjo përbledhje prej jo më shumë se 25 vjershash, jo vetëm me lirikat e reja që aty ishin, jo vetëm sepse cilësitë e poezisë së tij Naimi i afirmonte sërisht, dhe, në më se një krijim, i conte edhe më tej, — ato arrinin, mund të thuhet, një kulm të veçantë te «Bukuria», — por edhe se autori paraqitej tanë edhe më i plotë si poet, duke përjashtuar epikën, së cilës i ishte vënë me siguri ta trajtonte në poemat e gjata që do t'i botonte në fund të jetës.

Naimi kishte botuar dy poemat që e bënë vjershëtorin e madh të patriotizmit shqiptar, «Bagëti e bujqësinë» dhe «Dëshirën e vërtetë të shqipetarëve». Ai kishte derdhur në to gjithë krenarinë e shqiptarësise dhe gjithë besimin për një të ardhme të ndritur për popullin e vet. Më 1890, «Lulet e verës» vetëm pjesërisht nuk ishin në këto tone. Jo se Naimi, si poet i lëvizjes kombëtare, nisi t'i ulte tonet e lirikës së tij qytetare pas vitit 1886. Po sepse, në këtë përbledhje të re vjershë, vend nuk zënë vetëm ato të motivit patriotik. Ndonjë, si vjersha «Shpreh», e paraqiste të afërt çlirimini, posa Naimi, tanimë i prekur seriozisht në shëndetin e tij, guxon ta presë që ta gjëzojë lirinë edhe vetë.

*Për Shqipérinë
ditët e mira
paskëtaj vinë,
shkoi errësira!

Lum kush të rronjë
ta shohë zonjë! —*

Kurse, te vjersha «Përse», poeti shkruan ankthshëm e më hapur;

*Pse, s'vjen, o dit' e mirë?
Pse vallë nukë vjen?
Gjer kur në errësirë?
Mos zoti të pëlqen?*¹

¹ Mos ai këtë pëlqen, këtë do.

*As hidhe gardhë
dhe shpejto pakë,
o dit' e bardhë,
dhe jakë, jakë,
se të pres,
nukë vdes!*

*Jak', o dit' e uruar,
që lind nga perëndon!*

Naimi jo vetëm është i paduruar, po do ta mbajë shpirtin me dhëmbë, që ta gëzojë lirinë.

Lirinë s'e koncepton pa progresin. «Errësirës» analollake duhet t'i zërë vendin «qytetëria», që, kuptohet, ai e pret të tillë, siç është «*nga perëndon*», — në Evropën, që ka për model borgjezia e re shqiptare e hedhur në lëvizjen për çlirim, që ka për model intelektuali ynë poet.

Herë tjetër, në këto «Lule të verës», Naimi do t'i këndoja me epitetet dhe figurat që ka më për zemër, ditës që shpreson se s'ka për të mënuar. Do ta quajë, «ditë e rezë», do ta krahasojë me ditën e parë të pranverës.

*Është dit' e dashurisë, ditë e vëllazërisë,
dit' e mbarë e gjëzimit, dit' e bardh' e miqësisë.*

Fjala «verë» ka kuptimin e «pranverës», dhe «Lulet e verës», ja një simbol i së resë që lindi. Lidhja Shqiptare, shoqëritë patriotike, librat, shtypi, shkollat e para shqipe, ja «e reja», që do të realizohet e plotë dhe shpejt, që poeti e pret i paduruar, — liria.

Kur botoheshin në Stamboll «Lulet e verës», ndër intelektualët xhonturq, që do të botonin më 1891 revistën «Servet-i i funun», po admiroheshin «Lulet e së keqes» të Bodlerit, që nisën edhe të imitoheshin. Më 1894, Tefik Fikreti përkthente vjersha prej tij dhe prej simbolistëve. Samiu dhe Naimi ishin kundër kësaj lloj letërsie me përbajtje antipopullore ose jokombëtare. Kundërvënien e titullit të përbledhjes së re të liri-

kave të Naimit me atë të vjershavë të Bodlerit ka më shumë arsyë ta marrim si një koïncidencë, se, në botën letrare shqiptare të shëndoshë rilindëse, ajo nuk kishte ndonjë tingëllim. Por e pamë se me çfarë mënyre fliste Samiu për letërsinë. Fjalët që cituam prej tij janë të vitit 1897 dhe të një artikulli turqisht. Ato tingëllojnë si një polemikë me letërsinë turke të ditës, që po bën rrugë në simbolizëm, duke u kthyer nga ana tjetër, te ndikimi i thellë i gjuhëve persiane dhe arabe.

Përkundrazi, poeti kombëtar shqiptar ka interesa të kundërtat, Naimi ka gjëzimin që jo vetëm ndërgjegjja kombëtare shqiptare mori zjarr, se shqiptarët tundën Evropën aty më parë, po pikërisht edhe pse puna për ndriçimin e kombit, me lërimin e gjuhës, mori përmbrë brenda në Shqipëri, gjithkund nëpër perandori, gjithkund ku rrojnë shqiptarë mërgimeve dhe kurbeteve. Ky është gjëzimi i parë e më i madhi i tij. Dhe kështu, më 1887, me tërë entuziazmin, Naimi, që ishte përpjekur aq fort përfshirë këtë ditë, i ngrinte himnin shkollës së parë shqipe, që hapi dyert në mars në Korçë. Ishte pikërisht kjo ajo «ditë e rezë», që vumë «gur' e parë», ditë me të cilën «niset një tjetër jetë», — e entuziazmon ky fillim arsimi kombëtar njëriun e dijes. Dhe Korgës ai i këndon i ngashëryer, me tërë mirën johjen e admirimin;

*Lumja ti, moj Korç' o lule,
q'i le pas shoqet e tua!
Si trimi në ball' u sule,
ta paçim përjetë hua! —*

Ndërsa gjuhës, — gjuhës, që u bë gjuhë shkolle, ai do t'i drejtojë vargjet e famshme:

*Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e èmblë, sa e gjerë!
Sa e lehtë, sa e lirë!
Sa e bukur, sa e vlerë!*

Janë treguar aty vetitë e një gjuhe që i ka tërë mudësitë e shprehjes, si mjet i kulturës, i artit, i shken-

cës. Këtë e ka provuar e po e provon vepra e Naimit. vetë, siç e provojnë dhe miqtë e shokët e vëllezërët e tij, siç e kanë provuar edhe të tjerë përpara tij.

Naimi i gëzon shqipesëmbëlsinë dhe lirinë, si lirik i lindur që është; gjerësinë si shkrimtar i shumanshëm; vlerën, si mjet i madh i zhvillimit dhe shenjë e parë e kombit: «*E par' e gjithë mbrothësisë është gjuha*», ka shkruar patrioti iluminist. Dhe ai përsërit Veqilharxhin, që pati shkruar se një popull mund ta marrë kulturen, pra të shkojë përpara, vetëm duke u kulturuar në gjuhën e tij.

*Pa shihni ç'gjuhë' e mirë!
Sa shije ka e hije,
ç'e bukur edh'e dliрë,
si gjuhë perëndie, —*

këndon Naimi përsëri në vjershën që i kushton shqipes, «Gjuha jonë», sigurisht e vitit 1887 edhe kjo lirikë hareje e «Luleve të verës», me rastin prapë të çeljes së shkollës në Korçë, se më tej ai vijon:

*Shum' e bardhë kjo ditë
për gjithë shqiptarët,
do na sjellë një dritë,
që s'e kishin të parët.*

Ishin sigurisht vjersha si këto, që e entuziazmonin gjer në lot autorin e «Fjalorit» të shqipes në Elbasan dhe e nxitnin Pashko Vasén t'i përkthente frëngjisht, pér krenarinë që u ngrit lart letërsia kombëtare, po ndofta edhe pér t'iu kundërvënë modernizimit të kohës. Po s'ka dyshim se u tingëllonin fort edhe përbetimet, që ngriheshin në formë mallkimesh, kundër atyre shqiptarëve të pabesë, që kjo ditë sigurisht i tërbon, ata që «mëmëdheut i bëjnë varrë», po që «do të bienë vetë» brenda.

*Buk' e mëmëdheut zëntë
tradhëtarët e pabesë! —*

derdhet kundër tyre poeti në vjershën që u drejton.

Naimi, te «Lulet e verës», i përzien motivet, i larmen shumë. Kujdeset e tij filozofike, që i hasim shpesh në vjershat persishte të viteve 1873-83, po që nuk kanë për të munguar edhe në vjershat e tij shqipe të mesit të viteve 80, meditimet, do të zënë një vend të dukshëm edhe në këtë përbledhje të re. E po kështu edhe natyra,jeta intime e poetit dhe e të afërmvë të tij, erotika. Erotikën mund të themi se ai po e trajton për herë të parë shqip dhe gjerë. Tek «Endërrimet» ajo zinte një vend sado-kudo të kufizuar.

Janë pikërisht disa vjersha të «Luleve të verës», që na kanë dhënë formulimin më të plotë të konceptit të shkrimtarit mendimtar mbi botën, mbi qenien, — panteizmin e tij. Dhe sidomos poemthi i tij «Perëndia», që i kushtohet kësaj teme. Pranë këtij krijimi, vjersha si «Abaz Aliu» dhe të tjera sjellin elemente dhe ngjyrime të përcaktuara jo vetëm mistike, por edhe rituale, mund të themi, në besojmën e Naimit. Sidoqoftë, këtu dhe në vjersha dhe poema të tjera, do të vëmë re gjithmonë atë shkarkimin që Naimi i bën dogmës nga «përrallat», dhe gjithmonë atë synimin e tij që, edhe me këtë tematikë, të bëjë gjerësisht e hapur propagandën patriotike. Edhe kjo i afron posaçërisht njerëz si K. Kristoforidhi e P. Vasa.

Me poemthin e përmendur e me ndonjë tjetër vjershë të llojit, Naimi inauguron në letërsinë e Rilindjes poezinë filozofike, ku, bashkë me arsyetimet mbi qenien, shfaqet dhe humanizmi i tij, domosdo përherë i veshur me mistikën ose i mbrujtur me të. Poeti filozof, pa dyshim, ngjallte një admirim të veçantë tek të diturit rilindës, pavarësisht pikëpamjeve filozofike që mund të mos i kishin të njëlljota, siç është e kuptueshme.

Ka te «Lulet e verës», siç e shënuam, edhe ndonjë vjershë të karakterit autobiografik, ku rigjejmë atë theksin sentimentalist të «Endërrimeve», me pikëllimin e

gjer dëshpërimin se jeta është e shkurtër shumë, se pak e gëzojmë, se ajo shpesh na vret. «Të vdekurit», — titull i njërsës nga vjershat, — kanë qenë disa në familjen e tij dhe ai s'mund të mos i kujtojë pa ngashërimë të thella, sado stoik qoftë zakonisht, Si të bëjë pa e kujtar të kaluarën? Dhe si të mos i lëndohet zemra nga kaq kujtime, kur shumë shokë e shumë të dashur më s'janë?

*O moj koh' e shkuar,
kurdo që të kujtonj,
përsëri e lëndonj
zemërn' e lënduar.*

Dhe vijnë pastaj gjithato mallëngjime,, pshime mbi jetën, ngushëllimi mistik se «*lulet q'u thanë shpirtin gjall' e kanë*». Naimi, që nuk beson në «*një tjetër jetë*», kërkon një ngushëllim, qoftë dhe të rremë: «*zemëra ia do*», rrëfehet ai. Pra, në këtë rast, le të heshtë, le të «*pushojë mendja*», arsyeha. Sidoqoftë, këto çaste janë më se të rralla tani në poezinë e Naimit. Në vjershën «*E Zonj' e fatit*», ai do t'i vërsulet me zemërim vdekjes, se e ndjen që «*po i qaset prapë e po i tfaqet*».

A mund të thoshim, sic është dëgjuar ndonjëherë, se në disa nga vjershat e përmendura paskemi të bëjmë, në mos me rimishanca nga poezia e Llindjes, apo dhe nga romantizmi perëndimor, — ta zëmë ne nga Lamartini, — me tema të konsakruara dhe pak a shumë konvencionale, sado të trajtuar shqip me art të shquar? Do të ishte gabim, sikundër është gabim të mohonim edhe ndikimet nga gjithë ajo poezi botërore, klasike dhe moderne, që Naimi ka lexuar, të mohonim dhe riminishencat. Po vjersha «*Fyelli*» nuk është një reminishencë; ajo është një rikrijim, që s'e ndan dot nga vjershat origjinale të Naimit, aq e tij është bërë. Ajo i përket botës së tij poetike, botëkuptimit vetë që ai ka krijuar.

Te «*Lulet e verës*» kemi edhe ndonjë përshtatje, po krejt të lirë, nga V. Hygoi, si vjersha «*Të varfërit*». Aty vetëm shenja ka mbetur nga origjinali. Kjo nuk do të

thotë se Naimi nuk është dhe pa reminishenca. Ama t'i kërkosh këto nëpër vargjet e strofat e tij në mënyrë të tillë, që të arrish e të thuash, bie fjala, se te «Bagëti e bujqësia» ai «ka imituar» «Bukoliket» apo «Gjeorgjiket» e Virgjilit, kur ata i ndajnë dy mijëvjeçarë, tri epoka historike, formimi shpirtëror e artistik, vetë konceptimi dhe ndërtimi i veprave etj., dhe kur, fundi i fundit, i aftron gati vetëm titulli në mos edhe ndonjë varg, kjo është e kotë, dhe është një mënyrë formaliste e të gjykuarit mbi artin e mbi artistët, mbi ndikimet e mbi reminishencat vetë. Është «zbuluar» se dy vargje si këto të «Bagëti e bujqësisë», janë përkthyer nga V. Hygoi:

*Opopo! kshu pse më vini përpara syve pa pushim,
o ditët e djalërisë, o moj kohëz' e të rit tim?*¹ —

Po, kjo është e vërtetë. Veçse te «Bagëti e bujqësia» ato janë shkrirë në të tillë mënyrë, që s'na kujtojnë fare reminishencën hygoliane, po të mos na e qëmtojë një rëmues, e përsë? Fundi i fundit, për atë që e dinim: se Naimi ka një formim shumë të gjërë poetik dhe, si çdo poet, si çdo krijues, «*e merr edhe ai gjérin e tij tek e gjen*», siç pati thënë Molieri, — po ky është «*gjéri i tij*»! Ai s'imiton, ai krijon.

Naimi, në këtë përbledhje të rëndësishme lirikash, «Lulet e verës», është po ai poet gjeniun shqiptar që kemi njojur e do të njohim në veprat e tij, këtë radhë i një gjerësie edhe më të dukshme diapazoni.



Një nga veprat më të shquara të gjithë krijimtarisë poetike të Naim Frashërit, është, s'ka dyshim, «Bukuria». Po e quajmë poemë këtë krimj që u botua te «Lulet e verës» dhe të përbërë nga 16 vjersha të shkurtra. Dhe

1 «Pourquoi devant mes yeux revenez-vous sans cesse,
6 jours de mon enfance et de mon allegresse?»

e quajmë poemë, jo thjeshtësisht sepse autor i ka rreshthuar këto vjersha nën një titull, meqë janë të së njëjtës tematikë, po se aty kemi një farë organiciteti të ndërtimit, sado jo me penelata të shtrira dhe nuanca të shkrira. Është një si mozaik i lirë dhe jo fort i kompozuar në dukje. Ka mundësi që vjershat e shkurtërë u krijuan në çaste të ndryshme dhe autori mendoi një ditë t'i rreshtonte të gjitha në një të tërë, duke i vënë secilës një numër. Por ato s'i lidhte vetëm tema, sigurisht, po një atmosferë e gjithë, që është në vettvetë ajo çka e bën vërtet organike poemën.

Kur nis vjersha me një evokim të bukurisë, që për poetin është si shfaqja vetë e hyjnisë në botë, bukuria «*q'i dha shijë gjithësisë*», dhe kur poeti bukurinë mbi gjithçka e gjen te femra, te «pëllumbesa», «*zonja përkëdheloshe*», siç këndon ai në vjershën e parë, që ne po e quajmë kënga 1 e poemës, domosdo do të vijë pastaj pëershkrimi që ai i bën së dashurës me syrin e tij më shumë se të mahnitur në këngën 2 dhe në të tjerat. Përzihen në vargjet e tij e në mahnitjen, vuajtja për një dashuri që ngjan se nuk u realizua, mundimi që i ka sjellë të riut një e bukur që s'iu afrua. Këto, mënyrëmënyrë, këtu më nurshëm se atje, atje më hijshëm se këtu, me vargje e strofa të një larmie të madhe, me ritme nga më të pasurat, me tinguj e kumbime magjepsëse. Nuk janë më pak tingujt se ngjyrat që ia sjellin atë harmoni «mozaikut». Aliteracionet, aq karakteristike në vjershat e Naimit, këtu shkëlqejnë («zemra ime zjen. / se ty më s'të gjen»; «vera vate, shkoi»; «soje ndritte gjithë jeta»).

Na duket se në këtë poemë është një fill i vetëm, gati i pakapshëm, i një dashurie të vërtetë, tek e cila mund të besohet se poeti rreh, dhe që, sado që ai është përpjekur ta bëjë të paidentifikueshëm faktin, prapë, duke i kënduar me aq zjarr ndjenje, i ka pohuar ekzistencën. Edhe përbledhja e tij në gjuhën greke, «Dashuria», që kemi përmendur, nuk na ndihmon të zbulojmë te «Bukuria» një kënd jete intime të autorit. Përkundrazi, na largon më tej në të panjohurën. Biografia e rinisë

së tij nuk na është e njohur veçanërisht nga kjo anë. Dimë se ai deshi një vajzë të varfër dhe e mori për grua. Mos kemi këtu gjithë «shastisjen» e tij pas asaj bukurie përpëra martesës? Rrethanat e martesës nuk i dimë.

Theksi platonik, që i përshkon vargjet e «Bukurisë», a të kujton domosdo një dashuri që nuk u realizua? Ai është, sidoqoftë, tipik i fillimeve të Rilindjes Evropiane, — ka diçka nga Petrarka e nga Danteja, pa harruar dhe poezinë e Lindjes, — me atë vuajtjen e përzier me lektisje, që kemi për ta rigjetur te Lazgush Poradeci disa dhjetëvjeçarë më pas. Ai ishte tipik i një shqërie feudale, po dhe gjysmëfeudale. Poeti edhe «pluhur» do të bëhej, «që ta shkelte këmb' e saj» («Do të shkrihem, /të venitem,/, si kandili kur s'ka vaj», ... «E të prehem/ duke puthur/ atë këmbë pasandaj».... «Haj, e zeza jetë, haj!»).

Këto janë theksa të një përgjërimi, do të thoshim të afektuar, të një ekzalimi të pazakonshëm në poezinë e Naimit, me ndonjë notë sensuale nga rrëmbimet «rinore», emocione që kanë gjetur trajta të përsosura shprehjeje. Dhe për këtë përsosuri ka ndihmuar në mënyrë të posaçme një afrim, këtu më i dukshëm se asgjëkundi në krijimtarinë e Naimit, me poezinë popullore.

Strofa dhe vargje të tëra tingëllojnë si të mbrujtura nga vetë poeti popullor.

Të keqen e këmbës sate,
të iu bëfsha ati syri,
e leshravet si tërtërë,
e qepallës si gërshtërë,
që në zemërë më hyri!
C'pate që më vrave, ç'pate?

Apo:

O Veri, pa hiq i thua
sorkadhesë qafëgjatë:
më ka dhënë pyllë mua,

*s'mblidhem dot as dit' as natë,
Pyete vallë përse,
pastaj jak' e më rrëfe.*

Dhe gjetiu:

*Mos i hap leshratë n'erë
të m'arratiç mendjen time,
mos më shiko dhe një herë,
se m'u bë zemra thërrime...*

Dhe mund të vazhdonim.

Pjesa më e madhe e figuracionit, kur s'është marrë drejtpërdrejt nga gjuha e nga poezia popullore, është krijuar në këtë fryshtë. Po janë edhe çaste kur autori vete më përtet, kur ai luan me vargun e me figurën, në mënyrë që zor ta gjesh te poeti popullor. Psh:

*Nga qepallat jam qarë,
po të vërtetën e gjeta:
vetullat më paskan vrarë.
më vau harku, jo shigjeta.*

Kemi, tepër-tepër, në këto vargje, një afrim me poezinë e linđur nëpër qytete, siç e gjemë në këngë erotike, p.sh., të Përmetit apo të Beratit. Dhe nuk do të zbulonim asgjë, po të thoshim se në dy vargjet e fundit kemi një figurë të njojur të poeziës së Lindjes, pikërisht edhe të Fuzuliut, që Naimi admironte.¹

Po shihni se si asimilon një poet i madh: duke rikrijuar, jo duke huajtur.

«Bukuria» mbetet një ndër kulmet e poeziës dhe ^{pl.} veçanërisht të lirikës erotike shqiptare. Naimi është aty në pozitën e dashnorit soditës e filozof, shumë i ndryshëm nga Gajupi i poemës «Dashuria», e ndërtuar në të njëjtën mënyrë si poema e Naimit, por e një tingë-

¹ Edhe te Gevheriut, poet i njojur osman i shek. XVII.

Ilimi realist dhe e një përbajtjeje të tillë, gjithashtu, sado në kuadrin e përgjithshëm romantik. S'është përt'u çuditur që Naimi të tillë ka për ta paraqitur edhe vetë Skënderbeun, në tërë një këngë të poemës epike, ku heroi shastis pas bukurisë së Donikës së tij në kohën e martesës.

Është një tipar i romantizmit karakteri kundrues e soditës, gjer edhe në shtangie. «Bukuria» e Naimit është më shumë një vjershë e mrekullimit para së bukurës, se e erotizmit të vërtetë, le të ketë edhe ndonjë notë sensuale, vjershë ku meditimit i shtohet ekzaltime shumë:

*Pashë pjeshkëtë nér fletë,
pa m'u mejtua gjiri yt,...
dhe në mejtim të madh rashë,
më ra në det mendja, m'u mbyt...*

* * *

Pas «Luleve të verës», Naimi do të botonte edhe një përbledhje tjetër poetike, «Fjala fluturake» (1894), me lirika të ndryshme, — patriotike (vjersha «Gjuha jonë»), mbi natyrën («Qershori»), të ndryshme («Të vegjilitë»), disa fabula, siç e kemi përmendur. Do të ketë në to vargje të bucura, strofa e piesë të ardhura mirë, po nuk do t'i gjejmë lartësitë e «Luleve të verës» apo të «Bagëti e bujqësisë».

Naimi do të botojë një poemë patriotike «Parajsa» (1894), po të zvargur pak si tepër. Do të batojë disa vjersha te «Fletore e bektashinjet» (1896) dhe, të përpunuuar, vjershën «Pellazgët, — Shqipëtarët» (1897), që kishëte dalë trembëdhjetë vjet të shkuara te një gazetë greqishte e Bukureshtit, me vlera, po jo me pjekurinë e vërtetë të artit të tij. Të tilla kanë për të aenë edhe dy vjersha të gjata (prapë më 1897, tek «Albania» e Brukselit të dyja, si dhe e mëparshmja), po asnjëra nuk i shtonte gjë me vlerë të shquar artit të tij.

Mos janë këto që nga «Fjala fluturake,» — veç dy ve, «Shqipëria», e vitit 1880 dhe «Pellazgët», — kriime të një periudhe kapitjeje dhe shëndeti të tronditur keq, kur autori shkruante dhe poemat e tij të gjata epike, që do të dilnin më 1898? Apo janë kriime rinie, kur ai s'ishte argasur ende sa duhet me vargjet shqipe? S'e themi dot, po ka të ngjarë që kështu është. Prapë, ai «mediumi» gjuhësor, për të cilin folëm, na bën që shkrimet e Naimit, vargjet e tij, edhe kur s'janë të frymëzuara, t'i lexojmë për të shijuar atë bukuri shqipeje.

Me «Këndimet» dhe «Historinë e përgjithshme», apo me «Dituritë», nuk po merremi, sepse disa nga idetë kryesore të tyre i kemi dhënë në kapitujt e ndryshëm. Le të shënojmë edhe një herë rolin e tyre të madh për krijimin e shkollave të para shqipe dhe për të përhapur disa nga njojuritë më të nevojshme historike dhe shkencore në masat e lexuesve.


«Dituritë», të botuara më 1888 (pas botimit pjesë-pjesë te revista e Stambollit, katër dhe tre vjet më parë), njohen siç e kemi përmendur një ribotim aty-këtu të përpunuar më 1895 në Bukuresht, me titullin «Gjithësia», po pa emër autori. Tanimë, në kohën kur në perandorinë osmane është shtuar «zullumi» njojuritë shkencore që përhapte një libër si ai, ishin të rrezikshme shumë për kalifatin, sepse flaknin poshtë, në një mënyrë ose në një tjetër, dogmat e fesë. Ishte pikërisht koha kur, edhe në letërsinë e re turke, po nisin të mbisundonin rrymat e ndikuara nga simbolizmi dhe misticizmi, me të cilat pamë se luftonte drejtpërdrejt letrari dhe enciklopedisti Sami.

«Histori e Skënderbeut»

Nëse i mbahemi pohimit që, pas vitit 1895, Naim Frashëri u sëmur rëndë dhe shëndeti i mori përditë e përmë keq, duhet të mendojmë edhe se, pas atij viti, ai shkroi pak, në mos aspak, ndonëse vijoi së botuari edhe më shumë se përpara.

Botoi sidomos të dy veprat e tij të gjata epike, prej gati 20 mijë vargjesh, «Historinë e Skënderbeut» dhe «Qerbelanë» (1898), por edhe «Iliadën» e Homerit, «Fletoren e bektashinjet» (1896), disa vjersha të gjata tek «Albania» (1897), për ta mbyllur me «Historinë e Shqipërisë» (1899). Janë sigurisht, që të gjitha, krijime të përpara vitit 1896.

Ndonjë veçori e drejtshkrimit të Samiut, që bie në sy te «Historia e Skënderbeut», tregon se i vëllai ka ndihmuar të vëllanë, të paktën për të hedhur në të pastër veprën e tij të gjatë, për ta bërë gati për shtyp. Ato karakteristika nuk i gjemjë në botimet e viteve 1895-96 të Naimit. Ka arsyë të mendohet se vepra mbi Heroin Kombëtar u shkrua në vitet 1890-95, krahas



DITURIA

ÇKRORE MESIMI E HERBERGLME.

ÇKRUHETE HREJ DISA VETAC.

1863 është prj.

VARDELLI ISTITUTI

me lejet te Kuvernesse.

فەرمۇرى ئەلمۇنچى جاپانىت ۱۰ مەئىمەن ۱۳۰۰ تاریخلى و ۲۲ مۇرسۇلۇ
و خەنچەنە دەسپۇنچى مەچ اوڭىزىدە

FLETORE E 9th.

TE ÇKRUARA OBENDA

Ber te vertitene rûc per Çkropon e se Veritese — Samogito-
re (vazde) — litorf e pergâdesme (vazde) — Te Pârat e Tidemakul
(vazde) — Vjrrsa — Djeitim' e te Laditursvet.

NB KONSTANTINUHOLI
Ndo stypeskrifit te Margarifit (M. V. Andon Maksutit
mbi
1863.

Leja e botimit të
«Gramatikës» së
Kristoforidhit
(firmuar turqisht
nga Naimi 1882)

Revista «Dituria», 1885

VJERGA

"Vjershat për mësonjëtoret e para", 1886

LLA

MESONJETORET TE HARA

DRUJ

N. G. F.

OTVHURË HREJ COOPERISË "DRUJË"

BUKURESTI
NE OTVHURËT TE COOPERISË
1886

BAGËTI E BUJQËSIA

N. H. F.

OTVHURË HREJ COOPERISË "BAGËTI"

"Bagëti e bujqësia", 1886

BUKURESTI
OTVHURËT TE COOPERISË
1886

LULETË

ε

VERPSP

N. H. F.



nde Grypeekrojet te Cooperise „Ditaria“
nde Nakureat
1890

„Lulet e verës“ 1890

MESIME

peri 34-8.

Lulet e verës

MESIME
1894

„Mësimet“, 1894

Ο ΕΡΩΣ

ΠΟΙΗΜΑΤΑ ΠΡΩΤΟΤΥΠΑ

ΕΙΣ ΑΣΜΑΤΑ ΟΚΤΑ

ΜΕΤΑΒΙΚΟΝΙΝ



ΕΝ ΚΩΝΣΤΑΝΤΙΝΟΠΟΛΕΙ

Α. Κ. ΓΕΡΑΡΔΟΣ κατ ΣΑ.
Επικήνιον της Μάγδης
1895

ΤΥΠΟΣ Ε. ΠΑΛΛΑΝΙΑΣ

„Dashuria“ (eoeros), 1895

ILIADE OMIRIT

EDIMB E HARR

DUKEV DHEA

R. H. F.

GJYTHUR DHE GJYTHUR DITI REN

BUKUREBOT

DHE OTYRISHORBOT TE GJYTHUR

14. — Skender Pashalidet. — 14.

1896

«Iliadë e Omerit», 1896

ISTORI'E SKENDERBEUT

Stender bin J
Keran, qen, kartane,
d'ido mireste.
Stender bin i krimene,
q'ida tigjene e arte.

Te lund gjegj, bordja,
me fshët e cettle e u jale
Stender bin i mad tigjene,
kunja tige, qitë i nall.

Të lindet e që ka puro
Rendësia i vërtet,
Lëviz e gëzuar ka la nall me
Të lindet e që ka puro
me qen, fshët e tigjene
pa nall e që ka puro
lëviz e që ka puro
q'ido q'ido i lëviz

Fillimi i «Historisë së Skënderbeut»
(dotëshk. in)

1896
Tirana e Prizrenit
1896

«Histori e Skënderbeut»

ndofta me shqipërimin e këngës I të poemës homeriike, krahas ose pas «Qerbelasë», që u botua në të njëjtin vit me «Historinë e Skënderbeut», porse kjo më përpara se tjetra. Procesverbalet e shoqërisë «Dituria» të Bukureshit tregojnë se vendimi për botimin e poemës u mor më 24 shkurt 1898 dhe letërkëmbimi i rilindësve tanë të atyshëm tregon se ajo kishte nisur të qarkullojë në fund të marsit. Me të tillë hov entuziast u botua vepra mbi Kastriotin.

Që të dyja poemat e vëllimshme u botuan vetëm tanë, kjo shpjegohet me faktin se tanë shoqëria «Dituria» mundi të sigurojë fonde të mjaftueshme për t'i dërguar në shtyp.

Vitet 1890-95 nuk ndryshuan fort nga vitet fill pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe thyerjes ushtarake të saj. Lëvizja jonë kombëtare, për arsyet e gjendjes politike të jashtme dhe të brendshme, vazhdoi punën e vet për zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare, me organizimin dhe riorganizimin e shoqërive kulturore nëpër kolonitë e mërgimit (si në Sofje, Aleksandri të Misirit, tek arbëreshët, me mbajtjen e atyre të pakave shkolla shqipe që kishte toleruar sulltani (Korçë, Kolonjë, Prizren e gjetiu), me botimin e librave për shkollat dhe të letërsisë në gjuhën amtare (Naimi, De Rada, Sqiroi), me shtypin, që ori një hov të menjëhershëm më 1897. Fuqitë Imperialiste përpinqeshin të ruanin me çdo kusht e për interesat e tyre «statu-kuonë» në Ballkan. Monarkitë ballkanase fqinje do të kishin dashur që shqiptarët të hidheshin në lëvizjen e armatosur, që të dobësoheshin dhe, kështu, të mos u bënin dot ballë atyre monarkive, të cilat mprihnin thika e hanxharë për ta copëtuar Shqipërinë.

Në këto çaste të ashtuquajtura «qetësie», osmanët kishin duart më të lira. Rilindësit nuk e gjenin vlinë për lëvizje të mëdha të armatosura. Kjo nuk do të thotë se pushka nuk kristë askundi në viset tonë, aq se era e barutit nuk i ngacmonte shqiptarët përu' çliruar përgjithmonë. Nga ana tjetër, rilindësit vazh-

donin t'i riformulonin kërkesat e tyre për autono-minë e vendit, gjë që e bënë tri herë brenda viteve 1896-97.

Është koha kur nis të ziejë «çështja maqedone». Ajo rrezikonte jo vetëm «statu-kuonë» dhe vinte në lëvizje fuqitë imperialiste, sidomos ato që kishin rivalitetë më të theksuara në Ballkan, si Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia, po nga ana tjetër rishtronë edhe më me forcë përpara shqiptarëve çështjen e tyre. Në Maqedoni banonin disa qindra mijë shqiptarë, kurse monarkitë përreth rrezikonin rëndë njësinë tokësore të Shqipërisë, krahinat e së cilës, në një pjesë të madhe, ishin ndarë në vilajetet e Shkupit e të Manastirit. Shkëputja e këtyre vilajeteve, në çdo formë që të bëhej, pjesërisht apo tërësisht, mund t'i shkëpuste Shqipërisë gjer më dy të tretat e saj. Një e treta që mbetej, nëse nuk do të arrinin ta ndanin midis tyre lukunëtë shoviniste, do të ishte një vend fort i vogël, edhe më i vogël se sot. Populli shqiptar duhej t'u bënte ballë disa rreziqeve shumë të mëdha, për të cilat lëvizja kombëtare duhej të përgatitej më fort e shpejt.

Në këto rrethana u shkrua dhe u botua vepra më kushtruese e letërsisë së gjeratëherdhme të Rilindjes, poema «Histori e Skënderbeut» e Naimit, e frysmezuar nga ideali i madh i çlirimt, përmes mobilizimit më të plotë të forcave kombëtare dhe përmes qëndresës që atyre u duhej të bënин kundër Turqisë, kundër shovinistëve rrethues, kundër synimeve grabitqare të Austrisë dhe Italisë, kundër politikës antishqiptare të fuqive të tjera imperialiste, sidomos Rusisë cariste. Ashtu si dikur, në kohën e Skënderbeut, shqiptarët duhej fort të ruanin atdheun dhe «*t'u jepnin dërmën*» osmanëve dhe cilitdo armiku. Ata duhej ta fitonin përfundimisht këtë radhë lirinë e humbur. Kushtrimi ishte i dyfishtë: atdheu duhej mbrojtur, atdheu duhej çliruar. Dhe kjo mund të arrihej nën një udhëheqje të fortë kombëtare.

Vëllezërit Frashëri ishin përherë syçelë, që t'u përgjigjeshin kërkesave të ditës, që shtronë lëvizja kombëtare.

Në kohën kur do të botohej poema e Naimit ishin bërë përpjekjet për ripërtëritjen e Lidhjes Shqiptare dhe rol të dukshëm në ato përpjekje luante vetë Samiu, i cili do të botonte, vitin e ardhshëm, manifestin më të rëndësishëm të lëvizjes sonë kombëtare, librin «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e qdo të bëhet» (1899). Ndeshjet e armatosura kishin filluar në Kosovë, pikërisht rreth Prizrenit, ndërsa në qarqet e Shkupit, të Dibrës, të Shkodrës e gjetiu, lëvizja kryengritëse po bëhej kërcënuese për pushtuesit. Në kaq qytetë të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut, patriotët e kishin syun të shpërthenin burgjet apo të lironin të internuarit, kurse Himara rrëmbeu armët për të mbrojtur «venomet» (privilegjet) e saj.

Kush më mirë se shembulli i luftërave të Skënderbeut do ta frymëzonte popullin tonë në këto rrethana të ngrities së lëvizies së çlirimt? Simboli i madh, emri i Skënderbeut, i kishte mobilizuar dhe u kishte prirë nsamot shaiptarëve në luftërat për liri kundër osmanllinive, p.sh. në kryengritjet e mëdha popullore të shek. XVI-XVII. v.sh. në kohën e Karamahmud Bushatit, eti.

Koha heroike e Skënderbeut, figura e fatosit, e kishte frvmëzuar letërsinë shqiptare që në fillimet e Rilindjes, na harruar të kaluarën, — Barletin, Bardhin, vaskoboiarin Kostë Cekani, arbëreshët Pombil Rodotà dhe Nikollë Keta, këta të katër të shek. XVIII: nië Anonim verior i fundit të atii shëkulli, shkroi nië viershë shumë të fortë mbi Skënderbeun. e bërë kënsë dhe e kënduar nga populli; nië iugor, Jani Vaila, botoi në Moskë, qëndrisht, nië histori të Skënderbeut, nikërisht në kohën e aendresës kundër fushatës së Napoleon Bonapartit në Rusi më 1812. eti.

Rilindësi Jani Vreto ka shkruar nië poemth më 1847, kur studionte në Janinë. Gati e törë vëdra poetike e De Radës, vër më se givsmë shekulli, vecanërisht te venra e gjatë «Skënderbeu i pafat», asai kohe i ishte kushtuar, duke nisur që vërej vitit 1836. Po kështu edhe poema e Darës së Ri. Po kështu edhe kaq viersha e vargje të poetëve të ndryshëm, si Mitkoja e Serembeja.

P. Doçi me të tjerë. Pashko Vasa, për herë të parë shqip, duke botuar tek «Alfabetarja» e Stambollit (1879) një sprovë të shkurtër të historisë së Shqipërisë, u ndal sidomos te Gjergj Kastrioti. Jubani dhe patrioti ynë i Misirit, Thimi Krej, me origjinë nga Krushova, bënë përpjekje të rëndësishme për t'u dhënë shqiptarëve historinë e Heroit Kombëtar në gjuhën e tyre. Të parin s'e la vdekja që ta mbaronte veprën (1880), i dyti s'e botoi dot. Dorëshkrimet ruhen.

Kjo ishte me kohë, pra, një temë e madhe e letërsisë shqiptare gjatë shekujve dhe mbeti një temë e madhe e letërsisë së Rilindjes Kombëtare, temë që priste një trajtim të ri dhe tërësor, jo më në gjuhën arkaike të arbëreshëve, që nuk preku veçse pak intelektualë shqiptarë të kohës, po në gjuhën e gjallë të popullit të Shqipërisë, siç e provoi Pashko Vasa me shokë dhe do t'ia arrinte përfundimisht Naim Frashëri.

Burimet ishin të njoitura. «Historia» monumentale e Barletit kishte qenë botuar e ribotuar disa herë në origjinalin latin dhe përkthyer e përshtatur vazhdimesh gjuhë pas gjuhe të Evropës, që nga gjermanishtja në portugalisht, që nga frëngjishtja në greqisht, që nga suedishtja në polonisht etj. Atij burimi të madh, Barletit vetë ose përshtatësve të tij, iu drejtua Naimi.

Kemi përshtypjen, nga disa të dhëna, se ai u mbështet sidomos te autori francez Kamil Paganel (1855), i cili, siç e vlerëson Noli, shkroi «në një frëngjishte të shkëlqyer» dhe që pati sukses të veçantë në Evropë, se u përkthye gati menjëherë gjermanisht (1856) e pastaj greqisht (1861). Përshtypjen na e forcon edhe artikulli mbi Skënderbeun që Samiu ka botuar në «Enciklopedinë» e tij. Ai artikull ka gjëra të njëjta me veprën e Naimit. Ai dëshmon se Samiu njeh më se një autor mbi Skënderbeun, ndonëse përmend vetëm Barletin. Ai mund të thuhet se njeh edhe Paganelin.

* Vepra e këtij autori është tipike e historiografisë romantike, që rilindësit e kanë lexuar me dëshirë. Ajo e ruan mirë fryshten barletiane, aq e përshtatshme për kohën e romantizmit revolucionar. Përkthimin greqisht

të veprës e kishte, fjala vjen, ndër librat e tij Kristoforidihi. Më 24 maj 1880, Anastas Kullurioti lajmëronte se do ta botojë përkthimin greqisht të Paganelit në gazeten e tij «Zëri i Shqipërisë». Çasti ishte i gjetur: në Shqipëri luftohej për të mos i dorëzuar Malit të Zi Hotin e Grudën.

^ Besojmë se Naimi ka njojur edhe një shkurtore të historisë së Skënderbeut, të bazuar te Barleti, që shkroi humanisti tjeter shqiptar, Dhimitër Frëngu, dhe që u botua së pari më 1539, duke pasur një numër të madh ribotimesh italisht, e përkthyer edhe në ndonjë gjuhë tjeter, si frëngjishtja dhe anglishtja. Ajo u përhap mirë ndër shqiptarë. S'duhet dyshuar së Naimi ka njojur edhe një vepër me shumë sukses mbi Skënderbeun, atë të italianit Xhamaria Biemi (1742); duhet menduar së ka njojur edhe të tjera. Biblioteka e tij, po sidomos ajo e Samiut, kanë qenë të pasura me vepra mbi Shqipërinë e posaçërisht mbi Heroin Kombëtar, kurse Naimi njihte disa gjuhë të vjetra dhe të reja të Evropës. Sidoqoftë, mbeten ende për t'i përcaktuar më nga pranë burimet e tij.

Naimi e njihte përpjekjen e Pashko Vasës, porse jo punën e Jubanit e të Krejit. Ai i njihte veprat e De Radës dhe ndonië farë ndikimi e ka prei tij. Kështu, personazhin e Bozdar Strezit nga Narta, historikisht i panjohur, ai e mori nga «Skënderbeu i pafat» (në mos dhe nga «Serafina Topia»). (Një tjetër personazh i Naimit, Milushi, të kuiton personazhin Miloshini të De Radës, që vetë e mori nga folklori i arbëreshëve. Më shumë se kaq: nxitjen për të shkruar këngën XII të «Historisë së Skënderbeut», atë këngë që po e quajmë «kontemplative» dhe ku heroi shëstis pas gruas së tij, Naimi duket ta ketë marrë nga një këngë e ngjashme në disa anë te «Skënderbeu i pafat» i poetit arbëresh. Në këngën III të Librit IV të «Skënderbeut të pafat», De Rada bën çë hia e të vëllait të vdekur t'i shtiret Skënderbeut çë lufton në Azi, dhe e këshillon të braktisë ushtrinë osmane e të kthehet në atdhe: te vepra e Naimit do të jetë babai i heroit, Gjon Kastrioti.

♪ Përsa u takon burimeve popullore, duhet thënë se legjenda mbi Skënderbeun jetonte dhe jeton kryesishët në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, si dhe ndër arbëreshët e Italisë, po Naimi nuk dimë të ketë jetuar në ato vise, ndërsa gati asgjë nuk ishte mbledhur prej asaj legjende, përveç disa rapsodive arbëreshe që botoi më 1866 De Rada dhe aty-këtu ndonjë tjetër bashkë-kombas i yni andej detit. Por është e sigurt se Naimi diçka dëgjoi nga i dhëndëri, Ibrahim Bërzeshta, apo nga miku i tij i ngushtë, Halit Bërzeshta, patriot i çmuar, mbi legjendën e Skënderbeut dhe të shokëve të tij në viset e Quksit e të Librazhdit. Shenja të kësaj legjende i hasim në veprën e poetit Sidoqoftë, kaq, është tepër pak.

Për burime të tjera, tani për tanin, zor të flitet, po mund të shënohet ndonjë takim dhe së pari me veprën e Homerit. Është i ditur admirimi i poetit tonë për epikët e mëdhenj të lashtësisë. Naimi e shkroi «Historinë e Skënderbeut» duke rilexuar «Iliadën» ose duke iu vënë edhe përkthimit të një kënge të saj. Vepra e tij është larg nga një koncept homerik i epikës: ndikimi i Homerit aty është krejt i sipërfaqshëm. Naimi është nië poet i Rilindies Shqiptare dhe i fundit të shek. XIX evropian, me idealet e reja të borgjezisë, larg së tepërmëi në kohë dhe botëkuptim nga Greqia e lashtë. Cdo imitim ishte i kotë dhe cdo ndikim nuk mund të ishte thelbësor. Vecse Homeri, si dhe Virgilii, qe për të një model i admiruar, i cili, sadokudo, Naimit ia nxiti dëshirën që t'i vihei nië poeme të gjatë epike dhe që ta merrte si shembull. Dhe kështu na mbeti ai evokim i «engjëllit», me të cilin fillon «Historia e Skënderbeut», ashtu si fillon «Iliada» me evokimin e «perëndeshës muzë», sikundër na mbeti dhe nië si Nestor naimian, Pepë Tanushi, ndonië përpjekje në pëershkrimin e ndonjë beteje dhe disa vogëlima.

Naimi shkroi një histori të vjershëruar. Histori të tillë, ndonëse edhe me vulën e eposeve të lashta, ai kishte lexuar disa persisht dhe kishte admiruar më se njëren, duke nisur nga «Shahnameja» e Firdusiut e kën-

dej. Ai, sigurisht, nuk mund të mos kujtonte provat që kishin bërë shqip bashkëfshatarët e vet, bejtexhinjtë Dalip dhe Shahin Frashëri, me poemat e gjata tregimtare, që kishin përshtatur shqip, «Hadikaja» (1842) dhe «Muhtarnameja» (1856). Ato i kishte parasysh sidomos për t'iu kundërvënë te «Qerbelaja», me shkarkimin e madh që i bëri dogmës, apo te «Historia e Skënderbeut», me temën kombëtare aq të ditës pér lëvizjen patriotike, apo te të dyja, me atë shqipe të kulluar, që mohonte çdo përpjekje letrare të bërë në gjuhën tonë nën ndikimin e gjuhës së pushtuesit.

Këto mund të jenë disa nga burimet, ndikimet apo takimet e Naimit, që duhen përmendur pér ta vendosur edhe më mirë veprën e tij madhore në kohën kur u shkrua dhe në mjeshterin letrar me të cilin pati të bënte poeti.

*
* *

X «Historia e Skënderbeut» mbeti kryesisht një histori në vargje, një ritregim në vargje.

Protagonisti, heroi Skënderbe, si dhe te Barleti, nuk i eklipson të tjerët vetëm me madhështinë e veprimit e të karakterit, por edhe me vetë praninë e tij fizike. Jeta e tij tregohet vit pas vitesh e betejë pas betejash, kronologjikisht, që nga lindja e gjer në vdekje, me hollësitë që njohim nga Barleti dhe pasuesit e këtij. Poeti pak ndryshon dhe pak shton: ndonjë ngjarje që s'i vjen pér mbarë qëllimit të tij patriotik, ai gati sa e prek, kur nuk e harron; ndonjë personazh që ia sjell frymëzimi, e krijon vetiu, duke mos dashur kështu të mbetet vetëm te ritregimi i jetës e i bëmave të heroit, po të na japë edhe një vepër arti, ta aktivizojë më shumë imagjinatën, të na japë një vepër krijimi. Dhe ai i bën kështu thirrje frymëzimit, — muzës:

*Engjëll i bukur, po xbritmë,
dhe me dritët të uruar,*

*shko përpara mej' e ndritmë,
të shoh gjithë ç'kanë shkuar.*

✗ Poema do të përshkohet kështu fund e krye nga invokimet e pasionuara të romantikut dhe patriotit, nga gjëzimet e helmet që i ngjallnin atij ngjarjet, nga mallëngjimet e përbetimet, admirimet e përbuzjet, nga krenaria e thirrmat e tij kushtruese. Ai bëhet njësh me historinë, e rijeton atë, duke e ritreguar, e vesh me tërë pasionet e mendimet e veta dhe të bashkatdhatarëve në ndeshjet e tyre të fundit me armiqtë osmanë ✗ Kështu, që në këngën I, kur ai fillon me paraqitjen e së kaluarës së lashtë të Shqipërisë, të cilën romantiku domosdo e idealizon: «*Ishte vënt' i perëndisë/ që së pari Shqipëria/ mëmëdheth i urtësisë,/ që del soje mirësia*», — me «*Aleksandrin e madh e burrë*», me «*Pirro trimin e të tjerë*», «*që dhe sot s'janë harruar*»; — e «*kë të zësh ngoje më parë,/ nga burratë e vërtetë,/ q'ishin gjithë shqiptarë/ e s'u erdhi shok në jetë!*» Kështu edhe në çdo këngë.

✗ Skënderbeu është simboli i kësaj Shqipërie dhe poeti do t'ia trajtojë çposin me qëllim që:

*T'i ap dritë Shqipërisë
nga shpirt i ndritshëm i tija.* ✗

✗ Skënderbeu përfaqëson në mënyrë të përsosur vetëtë shqiptare që ngre lart Naimi, ai është ideali i atyre veticive.

*Ish burr' i gjall' e i gjatë
e në shpatulla i gjerë;
s'ish i ligur e i thatë,
po ish si lulja në verë...
Ishte mbret i bukurisë,
si dielli epte dritë...
Fytyrën e kish të mirë,
zënë t'ëmbëlë si mjaltë,
zemërënë plot mëshirë,
vetëdijënë të naltë...*

*Lufia posa zij të ndizej,
ajy s'duronte aspakë,
i hipën kalit e hidhej
përmbi armikët si flakë.*

«Atë me gisht e tregonin», jo vetëm si njeri që «dinte të luftonte,/ dhe kishte fuqi shumë», «që trimëria s'i kish gjumë», «kur merrte kordhën në dorë», po sepse edhe «mënt shum' e urtësi kishte», se «në zemrë kish mirësitë/ e ndë mendje diturinë,/ në shpirt kish të më dhe dritë», që «mirësin' e ligësinël s'i përzjen, t'i bënë kllirë», Skënderbeu që «ish së gjithash i zoti».

Ky portret, i dhënë gjatë pasazheve të ndryshme të këngës III, në të cilën Kastrioti paraqitet ende pa ardhur në Shqipëri dhe lufton në ushtritë osmane andej nga Azia, përsëritet me vargje dhe pasazhe të tjera të po këtij lloji, që na jepin po këto karakteristika përgjithësisht, që konkretizojnë ndonjë prej tyre, që ngrejnë herë më lart njérën e herë më lart tjetrën. Fatosi atëherë kishte në dhe të huaj «aqë një mall të shumë/ për Shqipërit nat' e ditë», sa thoshte «s'kam as prëhje, as gjumë», kur i rrëfehej plakut shqiptar Hasan, njeri «me besë», që mbante gjithënjë pranë» atje në mërgimin e largët.

¶ Kështu, sipas shembullit të Barletit, Naimi krijoi te Skënderbeu një personazh të përkryer pozitiv, me tërë cilësitë e humanizmit evropian, me tërë cilësitë që admironte dhe humanisti romantik Naim te njeriu. Poeti e paraqit Skënderbeun populor, të thjeshtë, aq krye-lartë përballë armikut, sa dhe modest në jetë, aq të ashpër në betejë kundër osmanëve apo cilët të jenë sa dhe të butë e zemiërgjerë për të gabuarit, njeri që jep fjalën e nuk luan, mik për kokë (ai që hidhet përtëj detit dhe shkon të shpëtojë të birin e aleatit të tij, Alfonxit të Napolit, Ferdinandin, që është në rrezik të humbë froni), prijës dhe edukues të pashoq të ushtrisë, strateg të rrallë e burrë shteti, veçanërisht të ndërgjegjshëm për rolin e madh historik që është duke luajtur në Evropë, duke mbrojtur, bashkë me atdheun, edhe qy-

tetërimin nga vërshimi osman. Atë e çmojnë miqtë dhe armiqtë.

Personazhi është konceptuar në madhështinë e vet epokale. Në fytyrën e tij personifikohet shpirti heroik i popullit të vet, tek i cili Naimi ka besimin e patundur se do ta tregojë edhe një herë veten e patjetër do të çlirohet nga Turqia, dhe shpejt, siç është duke e pritur poeti me ankth. Vepra ka për t'u mbyllur me vargjet e famshme:

*Skënderbeu ësht'i gjallë,
rron e mbretëron përjetë:
kjo fjalë s'është përrallë,
ndaj t'urtit ësht' e vërtetë.*

Me fjalë të tjera, populli i pamposhtur shqiptar do t'i japë dërmën shpejt dhe një herë e përngaherë push-tuesit, do t'ia punojë si Skënderbeu qëmoti. Armiqtë nuk janë vetëm pushtuesit, por edhe të tjerë, dhe Naimi duke shkruar se si i theu venedikasit heroï, se si ai e pësoi nga Brankoviçi i Serbisë, i vjehrri i sultani Muratit, që i nxori çarravi dhe iu tregua i pabesë, Naimi rreh te çastet aktuale që kalon Shqipëria midis pabesisë së Fuqive të Mëdha e të shovinistëve që nuk lënë gjë pa kurdisur kundër saj, pas shpine dhe haptazi. Thua jse kemi përpëra jo vetëm skenat e luftërave të kohës së Skënderbeut, por edhe ato të rejat e viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dhe ato që kanë për të krisur së afërmi dhe që poeti i pret, kur ai shkruan:

*Kur nj'e madhe kërcëllimë
e tundi të tërë dhenë
dhe ndriti si vetëtimë:
turqit të mahnitur mbenë!
Një rrëmet unjej nga bregu,
tymi sa vinte po shtohej:
— Popo! — thanë, — Skënderbegu!*

Me fjalë të tjera, — prisni se me një kërcëllimë si kjo ka për t'u sulur populli shqiptar së shpejti. Dhe me të vërtetë një epizëm të tillë përtëriti kryengritja e përgjithshme shqiptare e viteve 1911-1912 dhe që të vjen aq keq që Naimi s'jetoi ta shihte.

Është e kuptueshme përsë «Historinë» e tij, poeti nuk do të mund ta botonte veçse pa emër autorit dhe pa emër vendi. Po të gjithë e dinin se e kujt ishte vepra dhe të gjithë e prisnin me padurim botimin e saj, p.sh. Çajupi, siç del nga letërkëmbimi i tij.

Naimi e pati vënë atë duf çlirimtar dhe një grishje për hakmarrje në gojën e Gjon Kastriotit, kur e paraqiste t'i shfaqej të birit në Azi, në sheshin e betejës, si një personazh virgjilian apo dhe shekspirian: «*U ngrit fat' i Shqipërisë/ si i vdekuri nga varri,/ mori udhën e Azisë,/ duke rendur si i marri./ me një rrrobëzë të çyner,/ me fytyrë të tmerruar./ dhe me gjak lyer e ngjeri,/ e me sy të zgurdulluar;/ posa hije mori dhenë...» — «Murati po të bën varrë!» «Muratit i pinja gjaknë!»*

*Gjakn' e gjithë Shqipërisë
tani ti je nënë barër
t'ia nxjerrç nga hundët Tyrqisë!*

Në fytyrën e Muratit, qdo shqiptar shihte Abdyl Hamidin, të cilin me të drejtë rilindësit e paraqitën si përbindësh (ku toni vjershënn e Çajupit «Sultani»).

Personazhet e tjera kryesore të kohës, sipas rastit, trajtohen zakonisht shpejt e shkurt. Poeti ndalet te një personazh që krijoi vetë, Kamani, trim i ri, tek i cili Naimi ka dashur të simbolizojë vetë trimërinë e popullit dhe ka shprehur shumë vetveten. Është ai që jep i pari kushtimin e zjarrtë për t'i bërë ballë Turqisë, kur Gjon Kastrioti detyrohej t'i dërgonte djemtë e tij peng te sulltani. Portreti i tij ka ndonjë tipar të përbashkët me atë të Skënderbeut, që pamë më lart:

*I holl' isht' e pak i gjatë,
nukë kish shumë mustaqe,*

Naim Frashëri'

Naim Frashëri

*vij si i zeshk' e i thatë,
 e s'kish fare mish mbi faqe...
 Mori kordhënë në duar
 e qëndroi në mes si burrë,
 me fytyrë t'ashpëruar,
 ngriti gishtin dhe tha: — Kurre!
 Kurre s'trembet Shqipëria,
 nukë vdiq, po është gjallë!
 Tjatër përgjegje Tyrqia
 nukë do, pérveç me pallë!*

Si edhe te Barleti, por edhe më shkurt, Naimi personazhet e njohura të kohës i karakterizon me fare pak fjalë, ndonjëherë vetëm me një epitet: Arianiti është «mendjegjerë», Kont Urani «lule e trimërisë». Një farë vendi u jep në poemë Gjon Kastriotit dhe Vojsavës, e cila është nëna shembullore, po patriotja mbi nënën, — «djemtë si shpirti i dua,/ po më shumë Shqipërinë», thotë ajo kur ata shkojnë rob te sulltani. Te Donika poeti është ndalur më gjatë: ajo është gruaja e gjithvirtitshme, aq mbretëreshë, sa dhe nikoqire e thjeshtë shtëpie, dhe bukuria vetë. Ai e ka dhënë me penelatat e poeziës popullore: i kishte «vetullat si hark», ishte «bardhush' e symëshqerrë».

Sa për armiqtë, si Murati ashtu dhe i biri, Mehmeti, të dy sultanët që Skënderbeu i theu keq, janë aq bisha sa dhe të pabesë, kanë tërë të ligat mbi vete. Poeti i karikaturon shpesh dhe ky është një qëndrim jo nën-vleftësues i forcës që ata kanë, po pikërisht sepse kanë tërë atë forcë, të cilën një popull i vogël me Skënderbeun në krye ua hodhi përtokë kaq e kaq vjet. Ai kishte mundur të tallej me ta ashtu siç u tall edhe me pashën e tyre, Karaxhanë, «që vriste shumë të trasha». Kjo është në fakt karikatura e sultani Hamidit vetë dhe e pashallarëve myflizër të tij, karikatura e perandorisë osmane të fundit të shek. XIX, që shqiptarët s'duhet t'i druhen, po t'i vërsulen, sulltanit «t'i pinë gjakun».

Një farë kujdesi ka treguar autori në përpunimin e personazhit të Ballaban pashë Baderës, tek i cili kemi

tradhtarin, ambiciozin, dinakun, po që Skënderbeu e merr me kcmbet e para, e perburz, e sikteros. Ai gjen vdekjen prej dore shqiptari të thjeshtë, ashtu siç e meritonte.

Kuptohet se s'ishte rasti pér të treguar se në kohën e Skënderbeut jemi në kohën e feudalizmit, kur, me gjithë dorën e hekurt të prijësit, rivalitetet e krerëve ishin te natyrshme dhe sillnin dëme. Naimi, siç e pamë, do të dësnironte që Mojsiu të mos ketë tradhtuar me gjithë mend; kështu edhe Hamzai. Ai i bie borisë së fortë të kushtimit dhe, në thirrjen që u bën bashkatdhetarëve pér luftën e fundit kundër Turqisë, mendjen e ka të ngrejë lart e më lart bashkimin, domosdonë e tij, pér fitoren. Ai nuk do t'i paraqisë të çarat ose i paraqit sa më pak. Barleti nuk bëri ndryshë, që dhe ai i ftonte shqiptarët të mos e reshtin luftën pér t'u cliruar.

Kur është fjala pér fuqitë e mëdha të kohës së Skënderbeut dhe pér aleatët e këtij, Naimi do të jetë pak a shumë i matur, duke qëndruar edhe këtu në pozitat përgjithësisht të Barletit, se dhe poetit ia do koha e vet, siç ia donte historianit të parë të Skënderbeut. S'ka dyshim se Huniadi e Vladislavi, që ishin në luftë të hapët me Turqinë, poetit do t'i frymëzojnë vetëm fjalë të mira. Po kështu edhe Alfonsi i Napolit me të birin, Ferdinandin, që ishin aleatë të Skënderbeut, edhe në mos i paçin ardhur ndihmë sa duhet. Naimi i njeh ata sipas Barletit dhe nuk njeh dokumentet që Ferdinandin e trajognë dhe të pabesë. Ai nuk duket ta njohë historiografinë kritike të shekullit kur jeton. Autori nuk thotë gjë kundër mefshtësisë apo kopracisë së papëve, të cilët pamë se nuk i ka kursyer gjetiu në veprat e veta.

Sa pér Venedikun, me gjithëse e tregon të thyer nga Skënderbeu, poeti mban përgjithësisht qëndrimin simpatizues të Barletit, sepse jemi edhe në çastin kur, pér qëllimet e saj ekspansioniste në Shqipëri, Italia imperialiste e fundit të shek. XIX, i nxit nganjëherë tendencat pér kryengritje të shqiptarëve. Është pikërisht koha, kur poeti arbëresh Zef Sqiroi, i cili mbajti anën e politikës italiane ndaj vendit tonë, boton «Këngët e luftës», me thirrje të hapëta pér të rrëmbyer armët. Naimi këto i

di dhe, që mban atë qëndrim ndaj Venedikut, nuk është fjala për ndonjë «filoitalianizëm», siç janë përpjekur t'ia veshin njerëzit e imperializmit dhe të fashizmit italian në Shqipëri.

Më se një herë, megjithatë, poeti nuk le pa përmendur se Skënderbeu i shpartallonte armatat e sulltanëve në një kohë kur «*Evropa e tërë dridhej*» nga Turqia dhe shumë pak bënte kundër saj. Pra, në fund të fundit, që Skënderbeu ai që i dha shumë më shumë dorën Evropës, se Evropa atij. Këto dy ndihma s'mund të qëndrojnë në balancë. Populli shqiptar, kryesisht me forcat e veta dhe me flajime të parrëfyeshme, ua doli mbanë 25 vjetëve sulumesh të pareshtura, 50 armatare që lëshuan mbi të Murati dhe Mehmeti.

Samiu, te «Shqipëria g'ka qenë, g'është e ç'do të bëhet», do të tregohej edhe ai i matur ndaj Fuqive të Mëdha, ndonëse me mosbesim për ndihmën e tyre ndaj çështjes shqiptare. Me përvojën e viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit sidomos, kur Evropa u soll aq kriminalisht me Shqipérinë, ai deklaronte që shqiptarët duhej t'i mbështesnin shpresat në vetvete, po të donin çlirimin. I tillë qe edhe qëndrimi i Naimit, në një kohë kur rrëthanat ndërkombëtare nuk ishin në favorin tonë dhe kur rilindësit përpinqeshin të shfrytëzonin kontradiktat midis fuqive imperialiste, veçanërisht midis atyre që kishin synime në Ballkan e te ne. Kështu ai ruhej të mos e thoshte fjalën e keqe kundër tyre.

Naimi nuk ishte historian dhe nuk shkroi një traktat historie; ai ishte artist dhe shkroi një vepër poetike. Vepra e tij duhet parë në prizmin e ideve të mëdha të lëvizjes sonë kombëtare dhe të politikës së përgjithshme të saj ndaj pushtuesit, fqinjëve dhe fuqive evropiane, në prizmin e qëllimeve që ndiqte poeti me shokët e tij, në çastin kur ai shkruante «Historinë e Skënderbeut», që ishte, mund të thuhet, si testamenti i tij poetik e politik, në prizmin e kërkesave të këtij çasti në lëvizjen kombëtare shqiptare. Dhe kjo vepër duhet parë edhe në prizmin e botëkuptimit të përgjithshëm të poetit, të pikëpamjeve të tij filozofike e shoqërore në përgjithësi,

dhe të mënyrës romantike me të cilën ai e konceptonte historinë. Po, në thelb, poeti është edhe një politikan realist. Ai e di se «peshku i madh e ha të voglin» dhe, në Evropën ku shtypen ende shumë popuj, p.sh. në Rusi dhe Austro-Hungari, në Evropën që ka kolonizuar një pjesë të madhe të kontinenteve, ai e di se sytë duhet t'i bësh katër, duhet të dish të manovrosh, të jesh i matur, kur e do oportuniteti koniunktural-politik, t'i thuash edhe «derrit dajë».

Nga ana tjeter, ai drejtësinë s'e kërkon fort përtej çlirimt kombëtar dhe përtej një fqinjësie të mirë, gjë që ishte plotësisht në synimet, dhe në taktikën realiste të kohës. Çështjet e drejtësisë shoqërore brendapërbrenda kombit, poeti nuk i shtron, ose vetëm sa bën aluzion në to, duke përmendur Rusinë e Volterin, që «*zgjuan*» Evropën nga «*gjumi*» i mesjetës. Pra, me gjendjen shoqërore në të cilën ka mbetur Turqia dhe Shqipëria, më nuk mund e nuk duhet të shkohet. Prapë, si romantik, ai kohën e Skënderbeut e paraqit së idealin e kohëve «*të lumtura*» dhe «*të ndritura*» të Shqipërisë, pikërisht sepse e ka mendjen te shembulli që dha ajo kohë nën heroin e madh. Fjalët «*Rilindje*» ose «*Përlindje*», që i dhanë Naimi dhe shokët e tij periudhës në të cilën jetonin, tregon se si ata e idealizonin qoftë të kaluarën feudale, së cilës i kënduan për ekzaltime e ndjenjës patriotike, qoftë të ardhmen borgjeze, që ata në fakt e shikonin si idealin e shoqërisë.

«Historia e Skënderbeut» ishte një kushtrim nga më të fortit për të rrëmbyer menjëherë armët çlirimtare. Kuptohet përsë patriotët e prisin me padurim botimin e veprës dhe përsë kjo pati një përhapje të shpejtë dhe jehonën më të madhe në letërsinë e Rilindjes, jehonë që u rrit edhe pas krijimit të shtetit të lirë shqiptar më 1912, me përgjysmimin e tokave shqiptare, me rreziqet e mëdha që sollën vitet e luftës së përbotshme. Kjo jehonë nuk u shua asnjëherë, sa kohë që atdheu kérçenohej nga të huajtë dhe një tingull aktual vepra e ruan edhe sot, kur Shqipëria përfaqëson të ardhmen e njerëzimit, socializmin, komunizmin, pra është halë në

sy për armiqtë e shumtë, imperialistë e revizionistë, me pasuesit e tyre, që i shërbejnë regresit shoqëror, që përpiken të marrin nëpër këmbë të drejtat e popujve të vegjël, që provokojnë e ndezin luftëra për interesat e tyre gjakatare, p.sh. në tokat palestinez, që shpien luftën në brigjet e largëta të Argjentinës dhe mbajnë në pushtet fashizmin në Salvador, për të shtypur luftën çlirimtare të pullit të atjeshëm, që, duke e ngritur në sistem pabarazinë dhe shtypjen kombëtare brendapërpendresa shtetit të tyre, si në Jugosllavinë shumëkombëshe titiste, ia venë fajet Shqipërisë, sepse shqiptarët e atjeshëm kërkojnë të drejtat kushtetuese, që të kenë republikën e tyre.

«Historia e Skënderbeut» mbetet një nga veprat madhore të letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Prapë, duke mos pasur njësi ndërtimi, një thurje dramatike të mjaftueshme dhe një vijë kulminante, poema paraqitet zakonisht si një kronikë në vargje dhe merr këshfu një karakter didaskalik, që vete duke u rënduar. Ngjarjet e njëllojta, si luftërat, janë përshkruar me mjetet shpesh të njëjta ose të afërtë, që bëjnë këshfu të humbë emocioni estetik. Në mënyrë të njëllojtë apo të ngjashme janë dhënë edhe personazhet, nga njëra anë pozitivet, nga tjetra negativet. Vetë kjo ngjyrë bardhë e zi shkakton monotoninë. Mjediset nuk janë sa duhet të individualizuara.

Prapëseprapë, në poemë gjejmë pasazhe të shumta që janë në lartësinë e poeziës më të mirë të Naimit, çaste dramatike të spikatura, si protesta e Kamanit, ndarja e Vojsavës nga djemtë e saj, të faniturit e Gjon Kastriotit të birit në Siri, etj. Ka përshkrime të shumta të një bukurie të vërtetë, si p.sh. ky i fushës së betejës pas luftës:

*Erdh të mugëtit dhe nata,
yjtë duall të venitur;
të shihnje, të merrte data,
të vrarëtë q'ishin shtritur!
Hëna përmbi ret të errët*

*dukej me vrap sikur shkonte,
të gjithë ata të mjerët
me pakë drit' i mbulonte.*

Poeti ia qëllon shpesh me përshkrimin e natës:

*Nata me robet të zezë
po tfaqeji në hapësirë,
dritat e qjellit u ndezë,
dukeshin si ar i ngrirë.*

Ja dhe një përshkrim mëngjesi:

*Dielli posa kish dalë
edhe drit' e tij kish rënë
e kishte ndriturë malë,
hieja rrëzat kish zënë.
E kish xbukuruar vera
vendinë me lule t'arta,
fushat e ndera të gjera
ishinë bërë të zjarra.
Trim' i madh doli nga tenda,
thëllëzatë po dëgjonte...*

Fillimet e disa këngëve janë të paharrueshme, p.sh. ai i këngës V, kur Gjon Kastrioti i fanitet të birit në Azi («*U ngrit fat' i Shqipërisë/ si i vdekuri nga varri...*»), fillimi i këngës VI, ku flitet për çlirimin e Krujës:

*Kruj' o qytet i bekuar
prite, prite Skënderbenë,
po vjen si pëllumb i shkruar
të shpëtonjë mëmëdhënë,
shqiptarët t'i shpëtonjë
nga xgjedh' e rënd' e Tyrqisë...*

Edhe aty ku tregimi rrjedh i zakonshëm, bukuria e gjuhës bën punën e saj për ruajtjen e interesit te lexuesi:

*Mbreti me shokëtë dolli
e pa gjithë Shqipërinë*

*dhe nqado që vate mbolli
trimërin' e mirësinë.
Fortesat i fortësojti
dhe ushtarëtë i mblodhi,
nga vate e kudo shkojti
shpresë dha e trima xgjodhi...*

Pasuria gjuhësore e «Historisë së Skënderbeut», poemë prej 12 mijë vargjesh (ndarë në 22 këngë), rrallë mund të krahasohet me të ndonjë tjetër vepre të Naimit e të Rilindjes, veçanërisht për frazeologjinë e saj. Me gjithë përsëritjet, e pasur është edhe pasuria figurative.¹ Kjo gjuhë dhe kjo pasuri figurative i ruajnë vlera të përhershme këtij eposi të parë kombëtar të shkruar në letërsinë e zhvilluar në Shqipëri, pa harruar pjesët e frysëzuar të veprës.

De Rada dhe Dara i Ri i patën kënduar kohës së Skënderbeut në poemat e tyre epiko-lirike. Naimi krioi një poemë kryesisht epike, në të cilën nuk mungoi dhe një lirizëm i spikatur, dhe kjo vepër, e para, bëri për protagonist, në epikën tonë të gjinisë së gjatë poetike, Heroin e Kombit, Skënderbeun.

Ribotimi i «Historisë së Skënderbeut» dvherësh në Shqipëri pas Luftës Nacionalçlirimtare dhe nën kujdesin e shkencës sonë, si dhe dy ribotime të tjera në Kosovë, tregon interesin që aio ruan te lexuesit e sotëm shqiptarë. Ajo e bashkon zërin e rilindësve me tonin, duke qenë një nga ato vepra e tregon të vërtetën e madhe të shprehur në fialët e shokut Enver Hoxha, që populli shqiptar rrugën e historisë «e ka çarë me shpatë në dorë».

1 Për poemën tjetër të gjatë epike të Naimit, «Qerbelaja» (1898) nuk po flasim vecanërisht. Karakteristikat kryesore të kësaj vepre i kemi përmendur. Është evident qëllimi edhe patriotik i kësaj vepre. Vlerat e saj gjuhësore janë ato të gjithë veprës së Naimit dhe nuk i mungon vende-vende impulsit poetik. Ajo luajti një rol të vecantë për t'i lidhur me lëvizien kombëtare besimtarët e shumtë bektashini dhe për një letërsi fetare të shkruar, në gjuhë të pastër shqipe, kundër rrymës osmanizante në gjuhë e në të tjera të bejtexhinjve.

Përmbyllje. Arti i Naimit. Gjuha.

Romantizmi shqiptar i arriti kulmet e tij me De Radën e me Naimin. Tek ata ai u derdh si llava e dy vullkaneve, po që morën trajta në forma epike dhe lirike, shpesh të një bukurie të jashtëzakonshme, por edhe duke u shpëtuar më se një herë «pritave» dhe duke u lëshuar në natyrë të hapur, me format shpesh të padisiplinuara dhe të lirshme, po të një bukurie fluidi të zjarrtë apo të një skorie të ashpër.

Lindën poetë të tjera gjatë Rilindjes sonë dhe që patën një botë të pasur, porse jo me atë kraharon vigan. U dridhmua nga ndjenjat më të kapërthyera Serembeja; përdori mjeshterinë edhe të punuesit të filigranit Mjeda, në tingëllima e strofa të mbushura me Shqipérinë e me dliresi të shquar konceptesh. Erdhi pastaj Çajupi, i cili e vuri edhe një herë letërsinë në shtigjet e realizmit, pa e lënë rrugën e madhe të romantizmit. Thamë «edhe një herë», sepse, një shekull më parë, realizmi kishte njojur talente të rrepta, si Hasan Zyko Kamberi. Dhe do të vinte, me Çajupin, romantiku dhe realisti Asdren,

nxënës i drejtpërdrejtë i Naimit në fillimet e tij, që do të ishte dhe ai ashik i vargjeve është i strofave, ndonëse jo me atë vetveti të një Mjede dhe Serembeje, as zakonisht me atë gjuhë burimtare të Naimit.

Romantizmi shqiptar është pjesë e rrymës së mëdha që mbuloi Evropën me poezinë e tij, — pa harruar dramën e prozën,— që nga Bajroni dhe Hygoi me të tjerë. Në çdo vend, ai pati edhe tipare të vetat. që ia dha mijedisi i veçantë me historinë e vet politike dhe shoqërore, me traditat e veta kulturore dhe letrare. Po në vendet që e kishin kryer revolucionin borgjez, ai qe shprehje e nië zhgënjimi të madh, kur më të zemëruar e kur të hidhur e të dëshpëruar, kundër regjimit të ri të një klase që zbuloi tërë egërsinë e saj prej grabitgareje dhe shfrytëzueseje, borgjezia e parullës së mëdha të «Lirisë, barazisë, vëllazërisë», që doli aq false. Regjimi i ri përjetësoi kaq vese dhe mënxyra të regjimit feudal, duke u shtuar të tjera jo më pak të shëmtuara. Këto, klasikët e marksizëm-lininizmit i kanë analizuar e treguar në tërë kompleksitetin dhe lakuriqësinë e tyre, duke bërë aktakuzën e madhe të borgjezisë si klasë. e cila duhej shembur dhe do të shembei nga proletariati. Romantikët, të zhgënjyer nga e tashmja. u hodhën në të kaluarën, për ta mohuar pikërisht të tashmen. Shumë e bënë në emër të një ideali të paçanësuar, po ndonjëri parandjeu se e ardhmia i përkiste proletariatit, si Shelli, të cilin e admironte Engelsi. Të tjera kërkuan në të kaluar jo një ideal përbarimtar. po rikthimin e feudalizmit që ata qanë, si Shatobriani.

Në vendet ku ishte në rend të ditës cështja kombëtare, si në Italinë e copëtuar në kaq principata e dukate. disa dhe në duart e të huave dhe të papës. dhe ku borgjezia dhe aristokracia liberale kërkonte bashkimin e vendit në një shtet të vetëm, apo në Evropën Qendrore dhe në Ballkan, ku pooui fë tërë vuanin nën robërinë shekullore të Austro-Hungarisë. Rusicë. Turoisë. romantizmi ngriti lart flamurin e clirimit kombëtar. Romantizmi shqiptar i përket kësaj lëvizieje të gjerë clirimtare. Ka pasur edhe një romantizëm turk, siç e pamë. Ai u ku-

fizua në dëshirat për një të ardhme të «qytetëruar» të vendit, në shembullin e Evropës borgjeze, po dëshirat iu bënë pranga, sapo ai i vuri vetes për detyrë të shpëtonte dhe perandorinë që ishte në buzë të humnerës.

Tipari më kryesor i romantizmit shqiptar, që shquar edhe veprën e Naim Frashërit, ishte mishërimi në art i idealeve kombëtare në të gjitha llojet që letërsia jonë e Rilindies lëroi në pœzi, sadopak edhe në prozë dhe dramë. Letërsia i vuri për detyrë vetes të ndriçonte ndërgjegjen kombëtare dhe t'u bënte thirrje shqiptarëve për t'u çliruar njëherë e mirë nga zgjedha e gjatë osmane. Ajo u bë një flamurtare e vërtetë e gjithë përpjekjes kulturore e përgjithësisht ideologjike të lëvizjes sonë kombëtare. Parullën e fundit të saj do ta formuloonte Çajupi më 1902: «*Ja të vdesim, ja të rrojmë! për Liri!*»

Tipar tjetër krvesor i romantizmit shqiptar ishte iluminizmi. Shek. XVIII evropian, që i dha goditjen më të rëndë feudalizmit, me Revolucionin Borgjez të Francës (1789), ishte edhe shekulli i iluminizmit, që pushtoi edhe Ballkanin, që u përhap edhe në Shqipëri. Shek. XIX qe ai i impulseve të lëvizjeve kombëtare, por edhe i kërcimeve në fushën e shkencës e të teknikës. Shqipëria, që s'i kishte reshtur kurrë përprojekjet për liri, këto përpiekje nis tanë t'i bëjë jo vetëm nën parullën e luftës së armatosur, por edhe në luftën për zhvillimin e një kulture të re kombëtare, për ndricjimin e masave. Rilindësit ishin të bindur se ky ishte një nga faktorët bazë për të siguruar dirimin dhe një të ardhme të begatë të atdheut. Naimi shnallte: pa dituri s'ka liri.

Shoku Enver Hoxha ka shkruar: «*Dihet se zakonishat popujt dhe talentet e mëdha krijuase e tregojnë veten më tepër se kurdoherë në momente kthesë të rënësishtësishme.*»¹ Rilindja jonë Kombëtare qe nië e tillë kthesë nér popullin shqiptar. Pra, ajo edhe i kërkoi edhe i lindi talentet e mëdha krijuase të saj, politikanë, ushtarakë, mendimtarë, poetë, publicistë etj. të shumtë e

1 Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 132.

nga më të shqarit. U krijuar një letërsi e madhe me vlera të larta idesh kombëtare dhe njerëzore, me nivele artistike nga më të lëkuarështet, me pasuri mjetesh, që bëri shumë edhe për edukimin estetik të masave dhe që ishte baza e shëndoshë e zhvillimit të mëpastajmë të letërsisë shqipe.

Kësaj lëvizjeje letrare e përgjithësisht kulturore, iluministët, në Shqipëri i priu sidomos Naimi, si poet e si mendimtar. Naimi ishte ndër iluministët tanë, që, siç thotë shoku Enver Hoxha, «...ishin njerëz të popullit, ata ishin të lidhur me të, ia ndienin pulsin, të rrashurat e zemrës së tij, ata dinin ku ishin të mirat dhe të metat e tij, për të mirat luftuan dhe i zmadhuani, i shumëzuan, të metat e tij u përpotojnë me të gjitha forcat që t'ja zhduknin.»¹

Romantizmi ynë, edhe pse i njoihu herë pas here theksat e dëshpërimit, — p.sh. te Serembeja, — dhe të sentimentalizmit, — p.sh. në prozën e në dramën e kohës, — kishte për veti optimizmin dhe tonin kush-trues, besimin në forcat popullore dhe në një të ardhme më të mirë, demokratike. Ai lidhej kështu drejt përdrejt me humanizmin shqiptar të shek. XVI-XVII, pjellë e kryengritjeve popullore, që shungulluan atëherë Shqipërinë për të dëbuar osmanët nga vratat tona. Ai, kështu, ndryshe nga romantizmi francez, fjala vjen, që, në fushën e letërsisë, ishte dhe një reaksion kundër klassizmit të mëparshëm, që lulëzoi pas humanizmit, nuk u zhvillua te ne në luftë të hapur me letërsinë e vjetër shqiptare, veçse kur qe çështja për të luftuar ndikimin e letërsisë osmane mbi letërsinë tonë të shek. XVIII e më pas, siç bëri Naimi.

Duke luftuar kundër kulturës së pushtuesit, romantizmi shqiptar i mohoi dhe i luftoi përvjekjet osmanizante të shumë beztexhinive. Kjo nuk do të thotë se ai nuk përfitoi nga c'kishte më vlerë në përvojën e tyre, po duke e kapërcyer së forti këtë përvojë, një

1 Enver Hoxha, *Disa mendime për rilindasit*, në rev. «Studime politiko-shoqërore», T. 1982/2, f. 15.

herë me përbajtjen e re kombëtare dhe, në thelb, antifeudale, pastaj në punën ngulmuese për ta pastruar shqipen nga ndikimi oriëntal, duke u mbështetur fuqimisht e në mënyrë të shquar krijuese në letërsinë popullore.

Romantikët tanë u mbështetën gjithashtu në letërsinë përparimtare evropiane të shekullit të tyre, por edhe të shekujve të mëparshëm, p.sh. te klasicizmi (kemi përmendur përshtatjet nga La Fonteni, mund të përmendim dhe ndikimë nga Molieri e ndonjë tjetër), te rrjima e letërsisë kalorsiane (p.sh. De Rada e Dara). Naimi, njohës i thellë i letërsive orientale, u mbështet edhe tek ato. Dhe romantikët tanë vështruan me përfitim gjer te letërsia antike greko-latine, që pati si admirues të saj më të shquar ndër ne një Naim e një De Radë.

Romantizmi shqiptar e kapérceu letërsinë tonë të vjetër didaskalike dhe fetare, po ruajti frymën e përgjithshme patriotike të nië pjese të saj, që zbulohet në veprat e Budit, të Bardhit e Bogdanit me shokë, të Dhaskal Todhrit, të njohura prej tyre dhe prej të diturve dhe shkrimitarëve tanë të tjerë të kohës, si Kristoforidhi. Jubani. Dorsa, Kamarda, Samiu, Vretoja, Mjeda eti. U shpunë me hov përparrë gjinitë poetike, që nga vjershat e gjer te poemat e llojeve të ndryshme, me subjekt ose pa subjekt, epike dhe lirike, satirikë, duke i dhënë këtij lloji të nomës pa subjekt ato cilësi aë çoi lart Naimi te «Bagëti e bujqësia». Letërsia e vjetër shqipe nuk i traitoi gjinitë e prozës artistike. — gjë aë nuk do të thotë se nuk ka art në prözën e saj. Ajo letërsi nuk i preku gjinitë e skenës. Prözën artistike dhe dramën, romantizmi ynë sapo i provoi. Naimi dramën nuk e provoi fare.

Kështu, nië prej karakteristikave kryesore të romantizmit shqiptar, qe se ai mbeti një rrymë letrare poetike, pa harruar publicistikën e tij të pasur e plot vlera. Giatë Rilindies nisën të bëhen hapat e parë seriozë drejt realizmit vetëm pas vdekjes së Naim Frashërit, por edhe ato, më me sukses, vazhduan të bëhen në fushën e poezisë.

Nuk është vendi këtu pér t'u marrë me gjithë karakteristikat e romantizmit shqiptar, po do shënuar se të dyja rrymat e këtij romantizmi, ajo e Shqipërisë dhe ajo e arbëreshëve, me karakteristikat që përmendëm e me të tjera, flasin pér një unitet të madh që njofton romantizmi ynë në përbajtje dhe në formë, pavarësisht nga giuha që arbëreshët e ruajtën arkaike, duke bërë ndonjë përpjekje pér t'u afruar me gjuhën e Shqipërisë (o.sh. Serembeia, Sairoi), pavarësisht një trajtimi më të gjerë që arbëreshët i bënë temës së të kaluarës, thua se vetëm asaj të kohës së Skënderbeut, pér të cilën ruanin nostalgiinë e krenarinë e kuptueshme, si mërgimtarë të atij «Moti të madh», që u patën jetuar stërgjyshërit dhe që nuk ishte shlyer nga letërsia e tyre gojore, pavarësisht edhe nga nië afrim më i dukshëm me romantizmin evropian. Po fakt është se letërsia arbëreshe, e cila, në kohë, i priu romantizmit shqiptar, — poema e «Milosaos» që e cel atë. Është e vitit 1836, prashashkëkohëse e romantizmit të madh evropian. — aio letërsi u njoh dhe ndikoi pak në Shqipëri, në rrëthimin e disa intelektualëve. Në veprën e Naimit ka ndonjë ndikim deradian, më shumë rastësor ose të sivërfaqshëm. Atë e afroi pak krijuimtaria e De Radës. së pari pér shkak të arkaizmit të gjuhës.

Ishte e ardhshnjë, shkenca ionë socialiste, që tregoi mirë unitetin e romantizmit shqiptar dhe që zbuloi pér masat e lexuesve tanë vlerat e letërsisë arbëreshe të shek. XIX. ë cila në kohën e sai pak mundi të depërtonte këndëri Adriatikut. Naimi, në Shqipëri, mbeti poeti i madh i pakontestueshëm dhe luanti rolin kryesor atë shekulli i letërsinë shqiptare në nërgjithësi.

Gier te Naimi, letërsia e Rilindies Kombëtare, në Shqipëri kishte dhënë prova të një gjallërimi me Thimi Mitkon, Preng Docin, Leonard de Martinon, Pashko Vassën eti. Ndonëse ky gjallërim nuk ishte i shpejtë, prapë ai iedate shoresa pér një të nesërme të navonuar e me cilësi. Me Naimin bën ballë meniherë një talent i ia-shtëzakonshëm, që do të imponohet brenda katër-nëse vjetëve, dhe kjo ngjan që në çastet e Lidhjes Shqiptare

të Prizrenit. Atëherë, De Rada ishte në kulmin e krijimtarisë së vet. De Rada mbështetë një poezinë popullore, një rapsoditë tradicionale arbëreshe, që ai kishte mblidhur e botuar. Ai u mbështetë një to një mënyrë gjeniale krijuese. Edhe Naimi u mbështetë një poezinë e popullit. Po te De Rada kemi një mbështetje të drejtpërdrejtë, që ruan mirë formën popullore, me mjetet prozodike dhe stilistike të rapsodive, gjë edhe te mënyra e ndërtimit, ndonëse ai ka një individualitet shumë të spikatur, që i vjen si nga brendia e re, si nga idetë dhe figuracioni, si edhe nga puna me gjuhën.

Naimi bën të vetën, një mënyrë gjeniale dhe ai, frymën popullore, frymën e poezisë së popullit, kryesisht përmes materialit gjuhësor, më pak përmes teknikës dhe sintaksës poetike. Edhe kur duket se ai citon, ai krijon një atë frymë. Rrallëherë krijimi i tij ruan pamjen e jashtme të vjershës folklorike, një vargje dhe pjesë të veçanta, një thënie të urta, kurse një vjersha të veçanta gati jo, si ngjet zakonisht te De Rada dhe ka për të ngjarë shpesh te Çajupi. Naimi solli kështu një përvjojë tjetër të mbështetjes një artin e popullit, siç e kishte provuar herë-herë poezia shqipe përparrë tij, bie fjala te Pashko Vasa, më shumë te Serembeja, që Naimi nuk e njihte. Poezia e tij është përgjithësisht strofike, ndryshe nga ajo e De Radës, që është një vargjet e bardha e të përziera, karakteristike të rapsodive të mogme. Edhe poema më e gjatë e Naimit, «Histori e Skënderbeut», ndonëse autori e paraqit një monokolonë, është strofike, me strofat e tipit *abab*, të cilat veçse rrallë nuk kanë unitetin e mendimit apo të figurës, që kërkohet zakonisht nga strofa, si një mis i vjershës. Po te poema të tjera të gjata, si «Qerbelaja» dhe, përparrë kësaj, «Parajsa», ai përdori monokolonën me rimë të puthur. Kështu edhe te «Bagëti e bujqësia».

Sidoqoftë, poezia e Naimit është përgjithësisht strofike dhe ai, kështu, një Shqipëri i drejtohet përvojës së bejtexhinjve, kurse, jashtë, përvojës lindore dhe më shumë perëndimore. Përvoja lindore ka sjellë edhe një ndikim një numërimin e vargjeve, gjë që e prek theksin.

min e tyre. Një varg 16 rrokësh, p.sh., poeti do ta numërojë e do ta plotësojë me 16 rrokje tërësisht, edhe sikur në rimë apo në hemistish¹ të ketë fjalë oksitone, të cilat, në metrikën e re shqipe dhe në atë popullore vetë, numërohen për një rrokje më shumë. Kështu Naimi vargjet çifte të strofës

*O bilbil, e di se ç'thua,
andaj zëri i bukur yt
ma dogji shpirtinë mua
edhe gjumë s'më hyn në syt, —*

duke i numëruar rrokje për rrokje, por edhe duke i vështruar si tetërrokësh dhe jo si nëntërrokësh, që janë ata në të vërtetë me rrokjen e tyre të fundit e të gjatë, na detyron t'i theksojmë në rrokjet e parafundit, — *kur* dhe *në*, gjë që sjell një shqetësim shqiptimi, skandimi. Po në fakt, ne nuk i bindemi autorit dhe gjejmë mënyrën se si t'i shmangemi theksimit të tij, që shkakton një thyerje të harmonisë. Kështu ngjet edhe në vargjet aq të njohura të «Bagëti e bujqësisë»:

*Shqipëri ti më jep nderë, më ep emërin shqipëtar,
zemërnë ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.*

Kemi vizuar rrokjet që ky procedim metrik i Naimit, i huajtur nga poezia e Lindjes, kërkon të theksojmë. Në këtë rast lexuesi e ka më lehtë të hajë ndonjë rrokje të secilit varg e të veprojë sipas sistemit metrik të shqipes:

*...më ep emrin shqipëtar,
...plot me dëshir' e me zjarr. —*

Vizuam vendet ku lexuesi ha një rrokje.

1 Në mes të vargut të formuar nga dy pjesë të njënjëshme, si 8+8, 5+5, etj.

Kështu thamë se mund të ngjasë edhe në mes të vargut; p.sh. tek e njëjtë poemë:

*Njëri mihi, jatëri, lëron, njëri mbjell, jatëri...,
një pret e qep, një merr e jep, një mbath, një shikon
mullinë...*

Duhet të theksonim fjalët që vizuam, po nuk e bëjmë. Atëherë, në përdorimin e parë të fjalës «*jatëri*», lejoxjmë efektivisht «*jatri*», hamë një rrrokje, kurse në vargun tjetër na pëlqen prej vetiu përzierja e nëntërrorëkëshit të parë me tetërrrokëshin e dytë që përbëjnë vargun, ajo sjell një thyerje të lumtur të harmonisë në këto vargje ku sjell monotonit ai numërim i punëve të bujkut.

Po ky është një përjashtim, ndonëse i dukshëm, në sistemin prozodik të Naimit, sistem që i është përbajtjur ndërtimit të vargut shqip në mënyrë të përsosur, me tërë nuancat e mundshme melodike, ngadoqë ai e ka marrë metrin.

Duhet shënuar se dhe autorë si Pjetër Zarishi e Leonard de Martino, që shkruan para tij, patën një sistem të pasur strofash, pa harruar më herët Bogdanin. Po vjershat e Bogdanit ishin tanimë larg dhe duhet studiuar se në ç'mënyrë e sollën gjer vonë ndikimin e tyre mbi prozodinë shqiptare, ndërsa Zarishi nuk pati fatin t'i botonte vjershat e tij, si dhe Serembeja, i cili edhe ai ishte i pasur në strofa e ritme. De Martinoja që një poet pak i lexuar dhe u njoh sidomos në Veri, ku do të ndikonte mbi Mjedën e Shirokën.

Naimi s'i ka njohur botimet e rralla të Serembes shqip; me sa duket, ai nuk është ndalur te De Martinoja se, p.sh., nuk e shohim të shkruajë asnjë tingëllimë, siç bën tjetri me art e siç ka për të bërë Mjeda. Naimi, përkëtë lloj vjershe aq të njohur në poezinë evropiane, të paktën që nga Danteja, nuk tregoi asnjë interes, se e fuste në kallëpe metrike të ngushta, ai që, ndonëse përdori strofat më të larmishme, pëlqeu ta ndiente veten sa më të lirë në të vjershëruar.

Në kahasim me tërë poezinë e mëparshme shqipe, edhe me atë arbëreshe, bota poetike e Naim Frashërit shtrihet në një gjerësi më të madhe. Është bota poetike e një novatori të madh. Ai lëroi dhe i shpuri me hov përparrë gati tërë gjinitë që do të lëronte poezia jonë gjer në fund të shek. XIX, që të mos themi gjatë tërë Rilindjes: lirikën patriotike apo qytetare, atë meditative e filozofike, erotikën, lirikën mbi natyrën, vjershëni dëdaskalike, fabulën, poezinë epike, duke bërë edhe përshtatjet më të përsosura poetike të kohës. Naimi u tregua edhe mjeshtër i prozës, jo kaq se inauguroi ndonjë gjini të saj (autori shkroi pak tregime për fëmijë dhe copëza leximi), po sepse, bashkë me Samiun, dha shembullin e një proze me veti të shquara, në shkrimet e tij patriotike e përgjithësisht etike. Kemi dhënë si shembull «Ligën e përjetëshme të shqipëtarëvet», që dallohet në prozën shqipe të kohës për ritmin e saj gati si të një proze poetike, për koncizitetin.

Letërsia jonë, edhe në ditët më novatore të saj, siç janë ato të sotmet, të realizmit socialist, më fushën e prodzodisë e të artit poetik në përgjithësi, është kthyer përherë me përfitim nga përvoja e pasur naimjane, e kandier vazhdimisht gratin e saj mbi kaq përvoja të tjera, duke çmuar shumë edhe gjithë ndihmesat e ndërmjetme, si të Mqedës e Çajupit, Asdrenit e Nolit, Lazgushit e Migjenit. Shembuj nga të rinjtë, Kadareja, Agolli, Arapi dhe të tjerë.

Për sa i takon frymës kombëtare dhe popullore të Naimit në tërësinë e veprës së tij, le të përsëritim se, duke iu përgjigjur kërkesave themelore të kohës, duke njojur thellë aspiratat kombëtare dhe psikologjinë e popullit të vet, duke njojur historinë, kulturën, gjuhën, shpirtin poetik të shqiptarit, Naim Frashëri është ndër të parët që e ngritën në lartësi kombëtare poezinë tonë të lëruar e i dhanë asaj atë karakter, atë vulë të fortë të sajën, që e dallon nga letërsitë e kombeve të tjera.

Biblioteka e Shitetit

* * *

Përpjekja për shkrimin e shqipes dhe përpjekja vëcanërisht për hedhjen e bazave të gjuhës letrare, përrapa Naimit qe e rëndësishme. Që të mos përmendim të tjerë, po vetëm Vangjel Meksin e Kostandin Kristoforidhin, të shek. XIX, shohim se Naimi nuk pati pararendës të vegjël. Puna e elbasanashit të shquar, që e vuri shqipen letrare plotësisht në rrugën e Rilindjes, me pahëzimin e thesareve të saj të fjalorit e të frazeologjisë, me pastrimin sistematik të kësaj lënde, me pasurimin e ndjeshëm të saj, me përpjekjen e tij për afrimin ndërdialektor, ishte hapi më i rëndësishëm që u bë atë shekull përrapa Naimit për shkrimin e gjuhës. Mund të thuhet se në «shkollën» e Kristoforidhit hynë shumica e rilindësve bashkëkohës, edhe Pashko Vasa e Mjeda, edhe më shumë Samiu e Naimi.

Vepra e Naimit pati meritën e jashtëzakonshme që zbatoi në art atë që Kristoforidhi nuk e bëri përmes përkthimeve. Dhe qe një artist i madh që e bëri atë zbatim, një njeri, i cili, pikërisht sepse qe artist i tillë, pati edhe një ndijë çuditërisht të mprehtë të vlerave dhe të bukurisë së gjuhës. Ai e njohu shqipen në gamën e koloriteve të shumta që ajo kishte marrë me gojë dhe me shkrim. T'i kundërvesh Faik Konicën Naim Frashërit në meritën që ky i fundit pati për hedhjen e bazave të gjuhës letrare shqipe gjatë Rilindjes, është sikur t'i kundërvesh publicistin poetit. Pavarësisht se cila qe përbajtja e publicistikës së Konicës, — e cila «shkëllqen» edhe nga «këllira» — ajo ishte publicistikë dhe, në historinë e gjuhëve, nuk është gjendur shembull që një publicist të ketë hedhur themelet e një gjuhe letrare. Gjuha jonë letrare nuk bën përjashtim në këtë mes, — ajo e ka poetin e saj të madh të Rilindjes, që dha më shumë se askush atëherë për hedhjen e themeleve të saj pas Kristoforidhit. Dhe ajo ka rrëth tyre një «ekip» të fortë shkrimitarësh të ndryshëm, që sollën

dhe pasurinë gjuhësore të disa krahinave, të disa të folmeve, të të dy dialekteve.

Naimi u pasurua me gjuhë jo vetëm përmes librave, po veçanërisht në kontakt me njerëzit, në disa krahina kryesore të jugut shqiptar ose në vise të banuara nga shqiptarët, siç qenë krahinat e Përmetit e Beratit, të Korçës e Sarandës, të Janinës e Çamërisë, dhe gati njëzet vjet në Stamboll, ku shqiptarët e ardhur nga të gjitha anët e atdheut ishin me qindra mijë. Bir i Dangëllisë, i kësaj krahine qendrore toske, ku dialekti jugor kishte dhënë e marrë shumë, duke ruajtur trajtë më të përgjithshme e duke braktisur më se një trajtë anësore, ku, në fushën e krijimtarisë letrare të popullit e veçanërisht të poezisë, përzihej folklori i jugut dhe kishëtë një veprimitari krijuese që spikaste për vlerat e saj në të gjitha gjinitë, Naimi pati, nga kjo anë, një plus, i cili do çmuar. Dhe kështu gjuha që ai shkroi, nëpër veprën e tij, më e vëllimshmjë dhe më e përhapura e Rilindjes, më e lexuara për vlerat e përbajtjes e të formës, me vetitë e saj artistike e me pasuritë e leksikut e të frazeologjisë, — këto të fundit janë vërtet mahnitëse, — nisi të vihet në themel të gjuhës letrare, duke pasur ndikimin e vazhdueshmë që njihet mbi kaq breza. Mund të thuhet, pa asnjë teprim, se fare pak gjë nga çka hyri në shkrimet e Naimit, si leksik e si frazeologji, nuk hyri në gjuhën letrare dhe nuk rron edhe sot në të, apo nuk meriton të rifitojë jetë, nëse ka qenë lënë pas dore.

Nuk duhet harruar këtu ndihma e Samiut, njeriut më të afërt të Naimit në gjithçka, edhe në vepime, edhe në mendime, edhe në përpjekjet për shkrimin e shqipes, të Samiut që e shpuri më tej punën e Kristoforidhit për njësimin e drejtshkrimit të shqipes.

Kur është çështja për gjuhën e Naimit, nuk do përmendur vetëm poezia e tij, po do kujtuar posaçërisht edhe ajo përpjekje për terminologjinë shkencore, sado në fillimet e saj gjatë Rilindjes, kurse përshtatjet e tij poetike tregonin edhe ato se çfarë mundësish shprehëse

kishte dhe mund të fitonte shpejt gjuha jonë, e Yeruar prej dore mjeshtri.

Te Naimi, edhe kur çalon vargu, gjuha fluturon. Një ndijë e tillë e gjuhës mund të quhet e jashtezakonshme. Gjuha eci shumë përpara dhe arriti ato mundësi të plota që i dha kultura jonë socialiste. Po gjuha e Naimit nuk vërtetohet vetëm se mbeti në bazë të shqipes letrare tanimë të njëzuar; ajo mbeti edhe një shembull i punës me gjuhën, shembull i një shqipeje që e ruan të pastër natyrën e saj, që niset nga burimi popullor e kthehet tek ai, për t'u freskuar e pasuruar vazhdimit. Kemi treguar se si e çmonte Naimi thesar-in dialektor, se si kërkonte ai ta vinte në përdorim gjithë pasurinë e gjuhës, kudo që të gjendej. Kjo qe edhe rruga e madhe që ndoqi e po ndjek shqipja letrare, me ndihmesën e të folmeve dhe të dialekteve të saj, që fliten në shtetin shqiptar apo jashtë tij.

Aq sa na bën për vete gjuha, kuptohet se na bën për vete dhe stili i shkrimtarit. Naimin e lexojmë përherë jo vetëm për bukuritë poetike, për imazhet e figurat, që veshin një përmrbajtje të pasur kombëtare e njerëzore. Atë e lexojmë ngaherë edhe për bukuritë thjesht gjuhësore, edhe për stilin aq të vetin e që na tingëllon aq i afërt, aq i natyrës shqiptare.

Stili i Naimit shquhet nga po ato veti të lirizmit të tij. I thjeshtë e i ngrohtë, ai e aftron lexuesin menjëherë, e bën të ndiejë émbëlsinë e një shpirti të përgjëruar, tek i cili rri ndezur gjithmonë një flakë dashurie për njeriun, dashuri që, së pari, e ndien lexuesi vetë. Kur është i zjarrtë ai stil, rrallë e humb njëfarë qetësie, njëfarë force statike, të cilën ia jep toni prej mësuesi dhë predikuesi të frymëzuar, që merr Naimi shpesh. Në poezinë e Naimit, lexuesi ndien një mendim e një ndjenjë të gjerë, hapësirë, liri. Fjala e tij, me kumbimin e saj të rrallë, është zakonisht shumë sugjesteive. Kadencia e frazës së tij të bën për vete jo me atë mënyrën klasike, që ka disa herë fraza e Samiut dhe që do të ketë sidomos ajo e një Noli, i cili është stilisti më i shquar i shqipes në letërsinë tonë të kaluar.

Po natyrësia e stilit të Naimit është e tillë, që vjen si prej burimesh të kulluara malore, rrjedh nëpër gjeth¹ e nëpër gérxh, ka gjithë hieshinë e freskinë e mjesdit nga lind e rrjedh, ka gjithë dëlirësinë e tij.

Shoku Enver Hoxha, shpesh në veprat e tij dhe në bisedat, ka folur për Rilindjen Kombëtare Shqiptare, duke dhënë për të gjykime shumë të çmueshme dhe vlerësimë të larta. Ai e ka çmuar atë si «...një epokë revolucionare, demokratike me shumë rëndësi në historinë dhe letërsinë e popullit tonë», si «një epokë e ndritur e udhëhequr nga idetë iluministe, nga njerëzit tanë të shquar të asaj periudhe, që me të drejtë është quajtur Rilindja Kombëtare, dalja nga errësira mesjetare — feudale, imperialiste, në dritë, në kryengritje, në luftë për liri, pavarësi, demokraci për dritë dhe arsim.»²

Duke folur veçanërisht për Naimin, shoku Enver e ka çmuar shumë lart figurën dhe veprën e tij, rolin e tij në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, si shkrimtar e si udhëheqës rilindës. Le të përsëritim edhe një herë atë që ai ka thënë më 1961, duke u shprehur për rilindësit, për patriotizmin e tyre, për trashëgimin e çmueshëm që ata na kanë lënë:

«Naim Frashëri mbetet Naim, poeti ynë më i madh, që adhurohet nga të gjithë, sepse ai i ka kënduar me patos të madh bukurisë së atdheut, u shkri si qiriri për lirinë, gjuhën shqipe; èndërroi, punoi, luftoi për të ardhmen e popullit tonë, të cilën e bënë realitet Partia e Punës e Shqipërisë me pushtetin popullor.»²

1 Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin,» f. 275.

2 Enver Hoxha, Po aty f. 132.

Kronologji bazë

- 1797, lind i ati i Naimit, Halid Frashëri.
1814, lind nëna e Naimit, Emineja, nga shtëpia e vjetër e Mirahorëve-Mytevelinj të Korçës.
1822, thyhet Ali pashë Tepelena dhe shkatërrohet shteti i tij.
1831, thyhet Mustafa pashë Bushati dhe shkatërrohet shteti i tij.
1836, Jeronim de Rada boton poemën e «Milosaos», fillim i romantizmit shqiptar.
1839, shpallet në Turqi Tanzimati.
1839, lind Abdyl Frashëri.
1842, Dalip Frashëri mbaron «Hadikanë».
1846, 19 prill, Naum Veqilharxhi shpall «Qarkoren» e tij. Ai helmatiset në Stamboll, në spitalin e Patriarkanës së Fanarit, përpara mbarimit të atij viti.
1846, 25 maj, lind në Frashër Naimi.

- 1847, kryengritja e fshatarësise së Mallakastrës e Kurveleshit kundër Tanzimatit.
- 1847, Vinçenco Dorsa boton veprën «Mbi shqiptarët» («Su gli Albanesi»).
- 1850, lind Sami Frashëri.
- 1853-54, J. von Hahn boton «Studimet shqiptare» të tij («Albanesische Studien»).
- 1860, vdes babai i Naimit, Halidi.
- 1862, vdes edhe e ëma, Emineja.
- 1864, nis të botojë Kostandin Kristoforidhi.
- 1864 dhe 66, Dhimitër Kamarda boton «Gramatologjinë» e tij dhe «Shtojcën» e saj («Saggio di grammatica comparata sulla lingua albanese». — «Appendice»).
- 1865, Abdyli e vendos familjen në Janinë, ku Naimi dhe Samiu nisin mësimet në gjimnaz.
- 1866, lind Andon Zako-Çajupi.
- 1866, lind Ndre Mjeda.
- 1866, Dora d'Istria boton studimin e saj «Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore» («La nationalité albanaise d'après les chants populaires»).
- 1866, De Rada boton «Rapsoditë arbëreshe» («Rapsodie d'un poema albanese»), ribotuar më 1883-84 nën titullin «Rapsodi kombëtare» («Rapsodie nazionali»).
- 1869, Naimi dhe Samiu mbarojnë «Zosimean».
- 1871, Naimi kalon disa muaj si nëpunës në Drejtoren e Shtypit në Stamboll, sëmuret e kthehet për klimë në Shqipëri. Samiu qëndron atje nëpunës.
- 1871, në Stamboll bëhen përpjekje për riorganizimin e një shoqërie kombëtare shqiptare.
- 1871, Naimi boton në Stamboll një «Gramatikë të persishtës».
- 1871, Zef Jubani boton «Përbledhjen» e tij folklorike të veriut («Raccolta di canti e rapsodie di poemi albanesi»).
- 1872-84, De Rada boton «Skënderbeun e pafat».

- 1873, Naimi është nëpunës të dhjetash në Berat.
 1874, vdes vëllai i Naimit, Sherifi.
- 1874-77, Naimi është nëpunës dogane në Sarandë.
- 1874-75, shkruhet dhe luhet (1875) drama «Besa» e Samiut, turqisht, botuar këtë kohë në Stamboll.
- 1876, dhjetor, shpallet Kushtetuta në Turqi.
- 1877-78, lufta midis Ruseve dhe Turqisë.
- 1877, vdes vëllai i Naimit, Tahsini.
- 1878, Thimi Mitko boton «Bletën shqiptare», në mars.
- 1878, 10 qershori, themelohet Lidhja Shqiptare në Prizren.
- 1878, Kongresi i Berlinit mbyllt më 13 korrik (hapur më 13 qershori).
- 1878, Naimi mori pjesë në mbledhjen e degëve të jugut të Lidhjes Shqiptare në Frashër.
- 1879, 12 tetori, themelohet Shoqëria e Stambollit («Shqipëria e të shtypurit shkronja shqip»). Më parë ishte botuar «Allfabetareja».
- 1879, Pashko Vasa boton frengjisht, pastaj dhe gjermanisht e turqisht veprën «E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët» («La vérité sur l'Albanie et des Albanais»).
- 1879-80, Anastas Kullurioti boton, në Athinë, gazeten «Zëri i Shqipërisë» («I foni tis Alvanias»).
- 1879, Kristoforidhi boton të plotë, në dialektin jugor, «Dhjatën e Re» (bot. i plotë në dialektin vërior, 1872).
- 1880, Naimi shkruan poemën e tij të parë të njohur shqip, «*Shqipëria*», botuar shumë më pas më 1897, te revista «Albania» e Brukselit.
- 1880, pranverë, Pashko Vasa boton në «fletë volante» vjershën e tij «O moj Shqypni!» dhe e përhap më atdhe.
- 1880, Thimi Mitko boton më «fletë volante» përshtatjen shqip të «Marsejezës».
- 1880, Mali i zi merr Ulqinin, më nëntor.
- 1881, thyhen forcat e Lidhjes Shqiptare nga ushtria

- turke, e cila më 8 maj merr Gjakovën; më 23 prill ajo kishte hyrë në Prizren.
- 1881, arrestohet Abdyl Frashëri.
- 1881, themelohet dega e Bukureshtit e Shoqërisë së Stambollit, që më 1884 riorganizohet me emrin «Drita» dhe më 1887 merr emrin «Dituria».
- 1881, Naimi boton turqisht veprën «*Shpikjet e zbulimet*» («Ihtiaraat ve qeshfijat»), Stamboll.
- 1882, Naimi vendoset familjarisht në Stamboll, përparrë para gushtit. Emërohet anëtar i komisionit të censurës pranë Ministrisë së Arsimit, më pas kryetar i atij komisioni.
- 1882, Kristoforidhi boton «Gramatikën» e tij të dialektit jugor, greqisht («Gramatiki tis alvanikis glosis»). Lejen e botimit e ka firmuar Naimi, më 14 gusht.
- 1882, vdes Dhimitër Kamarda.
- 1883-87, De Rada boton revistën «Fjamuri i Arbit».
- 1884, Abdyl le burgun e Prizrenit dhe internohet në Anadoll.
- 1884, Naimi boton në Stamboll turqisht novelën e përshtatur nga frëngjishtja «*Katër stinët*» («Fusuli erbea»).
- 1884-85, botohet në Stamboll nga Naimi, Samiu, Vretoja, Pandeli Sotiri (drejtor), Koto Hoxhi etj., revista «Drita», më pas «Dituria». Në nr 1 (gusht 1884) botohet vjersha e Naimit «*Fjalët e qiririt*». Naimi i firmon me siglën D. shkrimet e tij.
- 1884, nis të shkruajë vjersha Ndre Mjeda.
- 1884, dhjetor, Naimi boton në gazeten greke «Iris» të Bukureshtit, vjershën «*Nga dolli shqiptari*» (ribotuar më 1897 me titull «*Pellazgët — Shqiptarët*» te revista «Albania» e Brukselit). Firmoi: Biri i Shqipërisë.
- 1885, vdes Gavril Dara i Ri, kur firmon dhe poemën e tij «*Kënga e sprasme e Ballës*», e cila botohet e plotë vetëm më 1906.

- 1885, Naimi boton në Stamboll përbledhjen e lirikave persishte «*Endërrimet*» («*Tehajylat*»).
- 1886, ngs nga puna shtypshkronja shqipe e Bukureshtit, me botimin e 10 librave, të Naimit, Samiut, Vretos.
- 1886, Samiu boton në Bukuresht «Shkronjëtoren e gjuhësë shqip» (gramatikën). Firmon S.H.F.
1886. Naimi boton atje «*Bagëti e bujqësinë*», shkruar më 1 maj dhe kushtuar Anastas Lakçes më 25. Firmon N.H.F.
- 1886, Naimi boton në Bukuresht «*Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve*», poemë greqisht («*O alithis pothos ton Alvanon*»), pa emër autori.
- 1886, ai boton «*Vjershat për mësonjëtoret të para*», si dhe: «*E këndimit të çunave këndonjëtoreja*», në dy vëllime;
- 1886, «*Histori e përgjithëshme*».
- 1886, Naimi boton në Stamboll përshtatjen e tij turqisht të këngës I të «*Iliadës*» së Homerit.
- 1887, Naimi riboton në Stamboll «Gramatikën persisht» të tij.
- 1887, 7 mars, hapet e para shkollë shqipe në Korçë.
- 1888, Naimi boton «*Dituritë*» (bot. 2, me titullin «*Gjithësia*», del më 1895).
- 1890, themelohet shoqëria «*Dëshira*» e shqiptarëve të Sofjes, degë e Shoqërisë së Stambollit.
- 1890, Naimi boton «*Lulet e verës*».
- 1890, vdes Thimi Mitkoja.
- 1892, vdes Pashko Vasa.
- 1892, hapet shkolla e parë shqipe për vajza në Korçë.
- 1893, vdes Abdyli në Stamboll.
- 1894, themelohet në Benisuef shoqëria «*Vëllazëria*» e shqiptarëve të Egjiptit.
- 1894, Naimi boton, në një vëllim, «*Mësimet*», «*Paraja*» dhe «*Fjala fluturake*».
- 1895, ai boton në Stamboll përbledhjen greqishte të lirikave «*Dashuria*» («*O eros*»).
- 1895, boton «*Gjithësia*», pa emër autori (ishte një ribotim i «*Diturive*» 1888),

- 1895, vdes Kristoforidhi.
- 1896, Naimi boton shqipërimin e këngës I të «Iliadës», «*Iliadhë e Omirit*». Turqisht e batoi më 1886.
- 1896, ai boton «*Fletoren e bektashinjet*», kushtuar *Abdylit*.
- 1897, riboton, të ripunuar, te «Albania» e Brukselit, vjershën «*Pellazgët*, — *Shqiptarët*», botuar së pari më 1884.
- 1897, boton po aty poemthin «*Shqipëria*» të vitit 1880, që s'e kishte botuar më parë; doli si libër më 1902.
- 1897, boton po aty vjershën «*Feja*».
- 1897, nis botimin revista «Albania» e Faik Konicës në Bruksel, për të vazhduar pastaj në Londër gjer më 1909.
- 1897, nis botimin e përkohshmjë e Anselmo Lorekjos, «*Kombi shqiptar*» («La nazione albanese») tek arbëreshët e Italisë, për të vazhduar gjer më 1928.
- 1897, nis botimin «*Kalendari kombiar*» në Sofje, për të vazhduar pastaj në Selanik e së fundit në Tiranë gjer më 1928.
- 1897, nis botimin e përkohshmjë e Bukureshtit «*Shqipëria*», për të vazhduar edhe vitin tjetër. Boton pjesë nga «*Historia e Skënderbeut*» e Naimit.
- 1898, Naimi boton poemën «*Histori e Skënderbeut*», pa emër autori dhe pa emër vendi.
- 1898, boton poemën «*Qerbelaja*».
- 1899, Samiu boton «*Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet*», pa emër autori dhe vend botimi.
- 1899, Naimi boton «*Histori e Shqipërisë*», pjesë e «*Historisë së përgjithëshme*», Sofje (i pari libër i tij i dalë në këtë qytet dhe i fundit botim që shkrimitari bën me gjallje. Librat e tij të tjera shqipe u botuan në Bukuresht).
- 1899, janar, mbahej Kuvendi i Pejës që vendoste për riformimin e Lidhjes Shqiptare.
- 1900, para qershor-korrik, vdes Jani Vreto.

- 1900, 20 tetor, vdes Naim Frashëri, në Erenqoj, lagje
aziatike e Stambollit, pranë Ysqydarit.
- 1902, btohet në Sofje poemthi «Shqipëria» si libërth.
1904, vdes Samiu në Stamboll.
- 1904, btohet në Sofje e shqipëruar poëma e Naimit
«Dëshira e vërtetë e shqiptarëve», me një ri-
botim të përmirësuar më 1912. Poeti kishte
bërë ndonjë ripunim me gjallje të tij.



P A S Q Y R A E L È N D È S

Faqe

Hyrje,	3
--------	-------	---

J E T A

Koha,	15
Kultura dhe letërsia shqiptare përpëra Naim Frashërit,	24
Frashëri dhe Frashërinjtë,	36
Halid Frashëri dhe familja e tij e madhe,	44
Rinia e Naimit në Frashër,	47
Njohja me kulturën perëndimore,	54
Naimi në vitet 70,	60
Vitet e mëdha: Vitet 80 (I),	76
Vitet e mëdha: Vitet 80 (II),	92
Vitet e mëdha: Vitet 90,	97
Jehona e vdekjes së Naimit dhe e kujtimit të tij,	110

V E P R A

Mendimtari dhe ideologu,	117
Fillimet poetike shqip të Naimit,	132
«Endërrimet» persishte,	141
«Bagëti e bujqësia»,	147
«Dëshira e vërtetë e shqiptarëve»,	158
«Vjershat për mësonjëtoret të para»,	166
«Lulet e verës»,	179
«Histori e Skënderbeut»,	192
Përmbyllje. Arti i Naimit. Gjuha,	211
Kronologji bazë,	225

Shuteriqi, DH. S.

Naim Frashëri (Jeta dhe vepra) [Red.:
E. Kadare] T., «8 Nëntori», 1982.

236 f. fl. il.

(B.m.): 891.983(092)

+ 92:891.983 [Frashëri, N.]

(B.v.): 891.983(092)

+ 92 Frashëri, N.

SH. 97

10.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-79

NATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re Tiranë, 1982